



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/39
Datë: 13.10.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 tetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumentit për zhvillimin e procesit të Vetingut në Sistemin e Drejtësisë.
2. Obligohen Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë, e në bazë të konkluzioneve të paraqitura brenda Koncept-dokumentit nga paragrafi 1 i këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTARSTVO PRAVDE / MINISTRY OF JUSTICE

KONCEPT DOKUMENTI
PËR ZHVILLIMIN E PROCESIT TË VETINGUT NË
SISTEMIN E DREJTËSISË

shtator, 2021

Përmbajtja

<i>Përmbledhje e Koncept Dokumentit.....</i>	<i>4</i>
<i>Hyrje.....</i>	<i>6</i>
<i>Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit.....</i>	<i>7</i>
1.2. Problemi Kryesor, shkaqet dhe efektet.....	55
PROBLEMI KRYESOR.....	55
Shkaqet	56
1.4. Standardet relevante ndërkombëtare	69
1.5 Praktikrat e vendeve të tjera	100
1.5.1 Praktika e shteteve të rajonit.....	100
1.5.2 Praktika e shteteve të Evropës Lindore	132
1.5.3 Praktika tjera	159
<i>Kapitulli 2: Objektivat.....</i>	<i>168</i>
<i>Kapitulli 3: Opsionet</i>	<i>169</i>
Kapitulli 3.1: Opsioni “asnjë ndryshim”	169
Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore	171
Kapitulli 3.3: Zhvillimi i procesit të vetingut dhe vlerësimi i vazhdueshëm i performancës, integritetit dhe pasurisë përmes ndryshimeve ligjore.....	173
1. PROCESI I VETINGUT.....	175
2. NDËRTIMI I MEKANIZMAVE PËR VLERËSIM TË VAZHDUESHËM.....	188
Kapitulli 3.4: Opsioni i katërt - Zhvillimi i procesit të vetingut dhe vlerësimit të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe verifikimit të pasurisë përmes ndryshimeve kushtetuese	189
1. NDRYSHIMET KUSHTETUESE	190
2. MEKANIZMI PËR VETING	191
3. MEKANIZMI PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS, INTEGRITETIT DHE VERIFIKIMIN E PASURISË	192
4. PROCEDURA E PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË MEKANIZMIT	195
5. PROCEDURA E VETINGUT DHE E VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS, INTEGRITETIT DHE PASURISË	195
6. BAZA E TË DHËNAVE.....	196
7. SUBJEKTET E VETINGUT	197
8. SANKSIONET	198
9. EFEKTET TJERA PËR GJYQTARË DHE PROKURORË NGA PROCESI I VETINGUT.....	199
Kapitulli 3.5. Opsioni i pestë: Zbatimi i procesit të vetingut me ndryshime Kushtetuese që mundëson vetingun nga një trup <i>ad-hoc</i> dhe më pas vazhdimin e vlerësimit të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë në kuadër të KGJK dhe KPK	201
1. VETINGU ME NDRYSHIME KUSHTETUESE	203
2. VLERËSIMI I VAZHDUESHËM I PERFORMANCËS, PASURISË DHE INTEGRITETIT	215
<i>Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme.....</i>	<i>225</i>

Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave.....	241
<i>Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi.....</i>	<i>242</i>
<i>Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve.....</i>	<i>248</i>
Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme	257
<i>Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm.....</i>	<i>287</i>
Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin	287
<i>Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik.....</i>	<i>288</i>
<i>Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore.....</i>	<i>292</i>
<i>Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore</i>	<i>298</i>
<i>Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore</i>	<i>301</i>

Përmbledhje e Koncept Dokumentit

Informacionet e përgjithshme	
Titulli	Koncept dokument për Zhvillimin e procesit të vetingut në sistemin e drejtësisë
Ministria bartëse	Ministria e Drejtësisë
Personi kontaktues	Lulzim Beqiri, Drejtor i Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave / Kryesues i Grupit Punues, 03820018092
PPQ	Qëllimi Strategjik 1 , Objektiva operacionale 1.1, Aktiviteti 1.1.1
Prioriteti strategjik	Qëllimi - Përmirësimi i integritetit të institucioneve të drejtësisë, përmes vetingut dhe mekanizmave tjerë. Objektiva operacionale - Zhvillimi i kornizës juridike për fillimin e procesit të vetingut në sistemin e drejtësisë.

Vendimi	
Çështja kryesore	Profesionalizmi dhe integriteti i gjyqtarëve, prokurorëve dhe nëpunësve civil në pozita të larta në administratën e sistemit të drejtësisë.
Përmbledhje e konsultimeve	Konsultimi paraprak i Koncept Dokumentit është planifikuar për muajin Korrik, 2021 Takimi publik për Koncept Dokumentin është mbajtur me datë 17 maj 2021. Konsultimi paraprak është zhvilluar nga data 15 - 30 qershor 2021. Konsultimi publik është zhvilluar nga data 29 korrik - 19 gusht 2021.
Opsioni i propozuar	Opsioni 5

Ndikimet kryesore të pritshme	
Ndikimet buxhetore	Priten ndikime buxhetore.

Ndikimet ekonomike	Parashihen ndikime ekonomike, veçanërisht në klimën e të bërit biznes dhe rritjen e investimeve.
Ndikimet shoqërore	Parashihen ndikime shoqërore përmes përmirësimit të integritetit të institucioneve të drejtësisë dhe luftimit të korrupsionit në këto institucione.
Ndikimet mjedisore	Nuk ka ndikime direkte relevante të pritshme në këtë kategori.
Ndikimet ndër-sektorale	Parashihen ndikime në të drejtat themelore, të cilat janë trajtuar në detaje më poshtë, në Kapitullin VI.
Ngarkesat administrative për kompanitë	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta
Testi i NVM-ve	Nuk është aplikuar testi i NVM-ve

Hapat e ardhshëm

Afatshkurtër	Hartimi i amendamenteve kushtetuese dhe ndryshimeve ligjore.
Afatmesëm	Krijimi i mekanizmave dhe zhvillimi i vetingut.

Hyrje

Figura 1: Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin

Titulli	Koncept Dokumenti për Zhvillimin e procesit të vetingut në sistemin e drejtësisë
Ministria bartëse	Ministria e Drejtësisë
Personi kontaktues	Lulzim Beqiri , Drejtor i Departamentit për Integrim Evropian dhe koordinim të politikave/ Kryesues i Grupit Punues 03820018092
PPQ	Qëllimi Strategjik 1 , Objektiva operacionale 1.1, Aktiviteti 1.1.1
Prioriteti strategjik	Qëllimi - Përmirësimi i integritetit të institucioneve të drejtësisë, përmes vetingut dhe mekanizmave tjerë. Objektiva operacionale - Zhvillimi i kornizës juridike për fillimin e procesit të vetingut në sistemin e drejtësisë.
Grupi punues	Lulzim Beqiri , DIEKP/MD - <i>Kryesues i Grupit Punues</i> Feride Podvorica , DL/MD - <i>Zëvendës Kryesuese</i> Qerim Ademaj , KGJK - <i>Anëtar</i> Bahri Hyseni , KPK - <i>Anëtar</i> Alberita Hyseni , ZKM - <i>Anëtare</i> Merita Stublla-Emini , OAK - <i>Anëtare</i> Besim Kelmendi , Shoqata e Prokurorëve të Kosovës - <i>Anëtar</i> <i>Anëtar nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit</i> <i>Anëtar nga Ministria e Punëve të Brendshme</i> Fatos Haziri , Policia e Kosovës - <i>Anëtar</i> <i>Anëtar nga AKI</i> Esad Ejupi , AKK - <i>Anëtar</i> Genc Nimoni , Kabineti i Ministres/MD - <i>Anëtar</i> Noliana Kusari , DL/MD - <i>Anëtare</i> Eris Hana , DBJN/MD - <i>Anëtar</i> Rreze Hoxha-Zhuja , GLPS - <i>Anëtare</i> Kreshnik Gashi , BIRN - <i>Anëtar</i> Gëzim Shala , IKD - <i>Anëtar</i> Arton Demhasaj , Çohu - <i>Anëtar</i>

	<p>Florent Spahija, KDI - <i>Anëtar</i> Nora Bajrami, Lëvizja FOL - <i>Anëtare</i></p>
Informata shtesë	<p>Pas takimit të parë të Grupit Punues, në cilësinë e anëtarëve shtesë janë përfshirë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Hydajet Hyseni, Deputet i Kuvendit të Kosovës 2. Agim Maliqi, Gjyqtar në Gjykatën Supreme 3. Riza Livoreka, Shoqata e Gjykatësve të Kosovës 4. Yll Sadiku, Zyrtar i Lartë Ekzekutiv, Presidenca 5. Lyra Çela, DBJN/MD 6. Albulena Uka, MD 7. Vlora Maxhuni, ZL/ZKM 8. Egzon Osmanaj, DIEKP/MD <p>Procesi i hartimit të Koncept Dokumentit është mbështetur drejtpërdrejtë nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë përmes projektit “Fuqizimi i sistemit të drejtësisë në Kosovë”, ekspertëve të projektit në Ministrinë e Drejtësisë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Donikë Qerimi 2. Rinor Hoxha

Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

Sistemi i drejtësisë është shtyllë kryesore e funksionimit demokratik të një shteti. Pavarësia dhe paanshmëria e sistemit, gjegjësisht anëtarëve të tij, është element bazë për të siguruar që ky sistem të jetë i drejtë dhe të sigurojë qasje të barabartë për të gjithë. Gjyqësori dhe prokuroria janë institucione kryesore në kuadër të sistemit të drejtësisë, sipas Kushtetutës së Kosovës dhe legjislacionit përcjellës.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës është institucioni kryesor përgjegjës për sigurimin e pavarësisë, paanësisë dhe profesionalizimit të sistemit gjyqësor. Pushteti gjyqësor në Kosovë ushtrohet nga gjykatat të cilat janë të organizuara në tri shkallë: gjykatat themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Gjykata Kushtetuese është gjykatë e veçantë, si autoritet përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.¹

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 112.1.

Këshilli Prokurorial i Kosovës është institucioni kryesor përgjegjës për sigurimin e pavarësisë, paanësisë dhe profesionalizimit të Prokurorit të Shtetit. Prokuroria e Shtetit organizohet në: Prokurorinë Themelore, Prokurorinë e Apelit, Prokurorinë Speciale dhe zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.

Në këtë sistem, aktualisht shërbejnë 391 gjyqtarë (me mesataren 22 gjyqtarë për 100,000 banorë) dhe 176 prokurorë (me mesataren 10 prokurorë për 100,000 banorë).² Figura në vijim, paraqet numrin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të ndarë sipas njësive organizative. Kjo figurë nuk përfshin Gjykatën Kushtetuese, ngase ajo është jashtë fushëveprimit të këtij Koncept Dokumenti. Sipas këtij Koncept Dokumenti, vetingu në sistemin e drejtësisë nuk do të përfshijë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese. Kjo si rrjedhojë e faktit se në Gjykatën Kushtetuese nuk identifikohen problemi kryesor, shkaqet dhe efektet, sikurse në gjykatat e rregullta dhe prokuroritë. Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.³ Ajo siguron funksionalitetin e institucioneve të vendit në pajtim me Kushtetutën dhe garanton mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive individuale të garantuara me Kushtetutë. Përderisa gjykatat e rregullta merren me shqyrtimin e fakteve, me verifikimin e ligjshmërisë së krijimit dhe të marrjes së provave, Gjykata Kushtetuese merret vetëm me kontrollin kushtetues të procesit të rregullt gjyqësor.

Sistemi i drejtësisë dhe Gjykata Kushtetuese janë të ndarë në kapituj të veçantë në Kushtetutë⁴, ku sistemi i drejtësisë përfshinë Gjykatat e rregullta, Prokurorinë, Këshillat (KGjK dhe KPK) dhe Avokatinë, ndërsa Gjykata Kushtetuese ka një përbërje, mandat dhe rregullim tjetër.

Tutje, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese kanë një mandat nëntëvjeçar, pa mundësi vazhdimi,⁵ për dallim nga mandati i përhershëm i gjyqtarëve të gjykatave të rregullta dhe prokurorëve. Kombinuar me sistemin e rotacionit të mandateve, kjo do të thotë se në këtë gjykatë ka rregullisht ri-përtëritje në përbërje në mesin e gjyqtarëve, e cila dallon nga gjykatat dhe prokuroritë e rregullta. Për më tepër, në kuptim të organizimit institucional dhe funksional të gjyqësorit, Gjykata Kushtetuese përbën entitet krejt të veçantë. Në këtë

² Mesatarja evropiane është 21 gjyqtarë/11 prokurorë për 100.000 banorë - Shih Raportin për vendin të KE për vitin 2019, sipas CEPEJ.

³ Neni 112, paragrafi 1, Kushtetuta e Republikës së Kosovës

⁴ Kapitulli VII Sistemi i Drejtësisë dhe Kapitulli VIII Gjykata Kushtetuese

⁵ Neni 114, paragrafi 2 Kushtetuta e Republikës së Kosovës


kontekst, vlen të theksohet sidomos procesi i emërimit dhe propozimit nga Kuvendi i gjyqtarëve të kësaj gjykate.


Vetingu për Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese do të nënkuptonte ndryshime të thella në Kushtetutë apo suspendim të neneve kushtetuese që flasin për përbërjen, mandatin, pavarësinë dhe organizimin e saj rezultati i të cilave nuk do të ishte përmirësimi i Gjykatës Kushtetuese, por bllokim i saj. Fakti që mandati i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese është i kufizuar në nëntë vite dhe pa të drejtë rizgjedhje si dhe kohëzgjatje e ndryshme për gjyqtarët e kësaj gjykate janë një mundësi që përmes Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të parashihet një veting para se ata të votohen nga Kuvendi i Kosovës.



Për më tepër, planifikohet që në Koncept Dokumentin për Gjykatën Kushtetuese që është paraparë të hartohet gjatë mandatit qeverisës, të adresohet çështja e nevojës për verifikim të gjyqtarëve kushtetues. Përderisa raportet vendore e ndërkombëtare kanë qenë vazhdimisht të zëshme për sa i përket performancës dhe profesionalizmit të gjyqtarëve të gjykatave të rregullta dhe prokurorëve⁶, nuk evidentohen raporte të kenë kritikuar profesionalizmin dhe integritetin e Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk është pjesë e këtij Koncept Dokumenti.


⁶ Shih fq. 43-50 të këtij dokumenti.



Figura 2: Gjyqtarët dhe Prokurorët në njësitë organizative






















7

⁷ 17 gjyqtarë janë nga marrëveshja e Brukselit.





Për funksionimin adekuat të sistemit të drejtësisë në Kosovë, është krijuar një kornizë ligjore, që përfshinë legjislacionin primar dhe sekondar, si dhe ligjet 'e buta', siç janë, politikat strategjike ose udhëzuesit, që përshkruajnë dhe promovojnë praktikën më të mirë në zbatimin e legjislacionit.

Në këtë drejtim, në figurën e mëposhtme renditen dokumentet e politikave, ligjet, aktet nënligjore dhe dokumente të tjera që ndërlidhen me funksionimin e gjyqësorit dhe prokurorisë.

Figura 3: Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore

Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor	Institucioni(-et) shtetëror (e) përgjegjës(e) për zbatim	Roli dhe detyrat e Institucionit(-eve)
Kushtetuta e Republikës Kosovës ⁸ Amandamenti i Kushtetutës së Republikës Kosovës lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të	Institucionet e Republikës së Kosovës	Kushtetuta i normon si kategori kushtetuese gjyqësorin dhe prokurorin e shtetit. Kushtetuta përcakton që parimi i pavarësisë dhe paanshmërisë udhëheq gjyqtarët dhe prokurorin e shtetit gjatë ushtrimit të funksionit të tyre. Sipas Kushtetutës, mandati fillestar për prokurorë dhe gjyqtarë, është tre (3) vjeçar, ndërsa me rastin e riemërimit mandati është i përhershëm deri në moshën e pensionimit. Kushtetuta përcakton dy situata kur gjyqtarët dhe prokurorët mund të shkarkohen nga funksioni, dhe atë për shkak të dënimit për një vepër të rëndë penale ose për mosrespektimin e rëndë të detyrave. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) si kategori kushtetuese sigurojnë pavarësinë dhe paanshinë e sistemit të drejtësisë.

⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>

<p>pavarësisë së Kosovës⁹</p> <p>Amendamenti i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Amendamenti nr. 25)¹⁰</p>		<p>Këshillat janë përgjegjës për rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërim dhe riemërim, transferim dhe për procedurën disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.</p> <p>Kushtetuta përcakton se propozimet për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve bëhen në bazë të procesit të hapur për emërim, në bazë të meritave të kandidatëve, ku të gjithë kandidatët duhet t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj.</p> <p>Me amendamentin e Kushtetutës (Amendamenti nr.25), shtatë (7) anëtarë të Këshillit Gjyqësor do të jenë të zgjedhur nga anëtarët e gjyqësorit.</p>
<p>LIGJI NR. 06/L-055 PËR KËSHILLIN GJYQËSOR TË KOSOVËS¹¹</p>	<p>Ministria e Drejtësisë</p> <p>Këshilli Gjyqësor i Kosovës</p>	<p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Këshilli Gjyqësor i Kosovës sipas këtij Ligji si institucion përgjegjës për organizimin, menaxhimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të gjykatave sipas ligjit, i propozon Presidentit emërimin, riemërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve, si dhe siguron se të gjithë kandidatët e propozuar i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj, i propozon Presidentit emërimin dhe shkarkimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës, vendos për përzgjedhjen, emërimin dhe shkarkimin e Kryetarit Gjykatës së Apelit, të kryetarëve të Gjykatave Themelore dhe gjyqtarëve</p>

⁹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3293>

¹⁰ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=12222>

¹¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18335>

		<p>Speciale dhe Prokurorisë së Apelit, në pajtim me Ligjin për Prokurorinë e Shtetit dhe Ligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, siguron zbatimin dhe mbikëqyrë kriteret për pranim në prokurori, të cilat duhet të bëhen në pajtim me parimet e meritës, mundësive të barabarta, barazisë gjinore, mos-diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve, vendos dhe mbikëqyrë zbatimin e kriterëve për përbërjen etnike të juridiksionit territorial të prokurorisë përkatëse, të garantuara për anëtarë të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë, vendos për numrin e prokurorëve në secilin Prokurori, vendos për avancimin, transferimin dhe disiplinimin e prokurorëve, vendos kriteret për vlerësimin e prokurorëve, miraton Kodin e Etikës Profesionale për anëtarët e Këshillit, etj.</p>
LIGJI NR. 06/L-054 PËR GJYKATAT ¹³	<p>Ministria Drejtësisë</p> <p>Gjykatat</p>	<p>e Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Gjykatat e themeluara me këtë ligj gjykojnë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës. Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit dhe marrjes së vendimeve janë të pavarur, të paanshëm, të pandikuar në çfarëdo mënyre nga asnjë person fizik apo juridik, përfshirë edhe organet publike.</p>

¹³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18302>

<p>LIGJI NR. 03/L-225 PËR PROKURORIN E SHTETIT, I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 05/L-034 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.03/L- 225 PËR PROKURORIN E SHTETIT, DHE LIGJIN NR. 06/L - 025 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L- 225 PËR PROKURORIN E SHTETIT I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR</p>	<p>Ministria Drejtësisë</p> <p>Prokurori Shtetit</p>	<p>e Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>i Zbatimi i legjislacionit: Prokurorët e shtetit ushtrojnë funksionet prokuroriale në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme dhe të sigurohen që të gjithë personat trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit, zbatojnë standardet më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare, mbrojnë të drejtave ligjore të viktimave, dëshmitarëve, të dyshimtëve, të akuzuarve dhe personave të dënuar, ndërmarrin veprime të nevojshme juridike për zbulimin e veprave penale dhe të autorëve të krimit si dhe hetimin dhe ndjekjen me kohë të veprave penale, marrin vendime mbi iniciimin, vazhdimin apo ndërprerjen e procedurës penale ndaj personave të dyshuar apo të akuzuar për kryerjen e veprave penale, ngritin aktakuza dhe përfaqësojnë ato para gjykatës, etj.</p>
--	--	---

ME LIGJIN NR. 05/L-034 ¹⁴		
LIGJI NR. 03/L-052 PËR PROKURORINË SPECIALE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS ¹⁵	Ministria Drejtësisë Prokuroria Speciale Republikës Kosovës	e e së
LIGJI NR. 06/L-086 PËR DHOMËN E POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË	Ministria Drejtësisë Dhoma Posaçme Gjykatës Supreme Kosovës	e e e të

Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit

Zbatimi i legjislacionit: Prokuroria Speciale, si një organ prokurorial i përhershëm dhe i specializuar që vepron në kuadër të Prokurorit të Shtetit të Kosovës, merr përgjegjësi për një lëndë që është në kompetencë të saj të veçantë a plotësuese, ndërsa organet e zbatimit të ligjit dhe prokurorët që punojnë në Kosovë do t'i ofrojnë PSRK-së tërë ndihmën e kërkuar më qëllim të ushtrimit të drejtë të funksioneve dhe mandatit të kësaj zyre.

Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit

Zbatimi i legjislacionit: Dhoma e Posaçme ka kompetencë ekskluzive mbi gjitha rastet dhe procedurat në lidhje me çështjet në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, siç janë: kundërshtimi ndaj një vendimi apo ndonjë veprimi tjetër nga AKM-ja apo Agjencia, ndërmarrë në bazë të Rregullores së AKM-së, apo përkatësisht në bazë të Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, kërkesa kundër AKM-së apo Agjencisë të cilat rrjedhin nga dështimi apo refuzimi i

¹⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2710>

¹⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2526>

KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT ¹⁶		AKM-së apo Agjencisë për të kryer një akt apo për të përmbushur një obligim që kërkohet me ligj apo kontratë; 1.3. kërkesa kundër AKM-së apo Agjencisë për humbjet financiare që pohohen të jenë shkaktuar nga një vendim a veprim i ndërmarrë nga AKM-ja apo Agjencia, etj.
LIGJI NR. 06/L-057 PËR PËRGJEGJËSINË DISIPLINORE TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE ¹⁷	Ministria e Drejtësisë Këshilli Gjyqësor i Kosovës Këshilli Prokurorial i Kosovës	Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit Zbatimi i legjislacionit: KGJK dhe KPK sipas këtij ligji fillon procedurat disiplinore mbi bazën e kërkesës së Autoritetit Kompetent (Kryetarët e Gjykatave, Kryetarin e Gjykatës Supreme, Kryeprokurorin e Shtetit, Kryeprokurorët dhe Këshillat si autoritete kompetente për pranimin e ankesave ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve) ndaj gjyqtarit, respektivisht prokurorit, zhvillojnë procedurën disiplinore, vendos nëse është kryer shkelja e supozuar disiplinore dhe, në rast se konstaton se gjyqtari ose prokurori ka kryer shkeljen e supozuar disiplinore, shqipton sanksionin disiplinor sipas dispozitave të këtij Ligji.
LIGJI NR. 06/L-082 PËR MBROJTJEN E	Zyra e Kryeministrit	Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit Zbatimi i legjislacionit: KGJK, KPK, Gjykatat dhe Prokurori i Shtetit sipas këtij Ligji përpunojnë të dhënat personale, në mënyrë të paanshme, të ligjshme dhe

¹⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20290>

¹⁷ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18336>

<p>TË DHËNAVE PERSONALE¹⁸</p>	<p>Këshilli Gjyqësor i Kosovës</p> <p>Këshilli Prokurorial i Kosovës</p> <p>Gjykatat</p> <p>Prokurori i Shtetit</p>	<p>transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave, duke grumbulluar të dhënat personale vetëm për qëllime të caktuara, të qarta dhe legjitime.</p>
<p>LIGJI NR. 05/L-095 PËR AKADEMINË E DREJTËSISË¹⁹</p>	<p>Ministria e Drejtësisë</p> <p>Akademia e Drejtësisë</p>	<p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Sipas këtij Ligji, Akademia e Drejtësisë rregullon mënyrën dhe kushtet sipas të cilave kryhet trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit të Republikës së Kosovës, trajnimi i personelit administrativ gjyqësor dhe prokurorial, zhvillon procesin e vlerësimit të nevojave për trajnime në bazë të kërkesave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (më tej: KGJK), Këshillit Prokurorial të Kosovës, si dhe çështje të tjera.</p>

¹⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18616>

¹⁹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=13318>

<p>LIGJI NR.04/L-050 PËR DEKLARIMIN, PREJARDHJEN DHE KONTROLLIN E PASURISË SË ZYRTARËVE TË LARTË PUBLIK DHE DEKLARIMIN, PREJARDHJEN DHE KONTROLLIN E DHURATAVE PËR TË GJITHË PERSONAT ZYRTARË, I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJI NR. 04/L-228 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-</p>	<p>Ministria e Drejtësisë</p> <p>Këshilli Gjyqësor i Kosovës</p> <p>Këshilli Prokurorial i Kosovës (Anëtarët e KGJK, KPK, Gjyqtarët dhe Prokurorët</p>	<p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Anëtarët e KGJK-së, KPK-së, gjyqtarët dhe prokurorët sipas këtij ligji deklarojnë pasurinë në Agjencia kundër Korrupsionit me rastin e marrjes së detyrës, deklarimin e rregullt vjetor, deklarimin sipas kërkesë së Agjencisë, si dhe deklarimin pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni në lidhje me gjendjen e pasurisë së tyre dhe anëtarëve të familjes së tyre, i cili përmban informacione rreth pasurisë, të ardhurave të tyre.</p>
---	--	--

<p>050 PËR DEKLARIMIN, PREJARDHJEN DHE KONTROLLIN E PASURISË TË ZYRTARËVE TË LARTË PUBLIK DHE DEKLARIMIN, PREJARDHJEN DHE KONTROLLIN E DHURATAVE PËR TË GJITHË PERSONAT ZYRTARË²⁰</p>		
<p>LIGJI NR. 06/L-011 PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT NË</p>	<p>Ministria e Drejtësisë Zyrtarët publik</p>	<p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Me dispozitat e këtij ligji përcaktohen parimet, rregullat dhe procedurat lidhur me sjelljet e lejuara dhe të ndaluara të zyrtarëve gjatë</p>

²⁰ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2767>

USHTRIMIN E FUNKSIONIT PUBLIK ²¹		kryerjes së detyrës publike si dhe masat e parapara për shkeljen e dispozitave të përcaktuara në këtë ligj.
LIGJI NR. 03/L-178 PËR KLASIFIKIMIN E INFORMACIONE VE DHE VERIFIKIMIN E SIGURISË ²²	Zyra e Kryeministrit Gjyqësori dhe Prokuroria	<p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Ky ligj zbatohet ndaj të gjitha institucioneve publike që ushtrojnë kompetenca ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore dhe ndaj Presidencës së Kosovës.</p>
LIGJI NR. 06/L - 114 PËR ZYRTARËT PUBLIKË (Aktgjykimi nr. <u>KO203/19, Gjykata Kushtetuese</u>) ²³	MAP/MPB	<p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Ligji për Zyrtarët Publik ka për qëllim krijimin e bazës ligjore për punësim të zyrtarëve publikë në institucionet e Republikës së Kosovës.</p> <p>Me këtë ligj rregullohet marrëdhënia juridike ndërmjet shtetit dhe zyrtarëve publikë. Ligji ndër të tjera përcakton se nëpunës civil në kuadër të Shërbimit</p>

²¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16314>

²² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2690>

²³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=25839>

		Civil është zyrtari publik në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë.
KODI I ETIKËS DHE SJELLJES PROFESIONALE PËR GJYQTARË ²⁴	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	<p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për gjyqtarë, përcakton se gjyqtari ushtron funksionin e tij në mënyrë të pavarur, bazuar në Kushtetutë, ligj dhe vlerësimin individual të fakteve, pa ndonjë kufizim, ndikime të padrejta, nxitje, presione, kërcënime ose ndërhyrje, direkt ose indirekt, nga çdokush e për çfarëdo arsye, duke ruajtur dhe promovuar pavarësinë në aspektin individual dhe institucional. Gjatë ushtrimit të funksionit të tij i trajton të gjitha palët në procedure në mënyrë të barabartë pa favorizime, anime dhe paragjykime. Gjate gjithë kohës gjyqtari duhet të jete dhe duhet të duket i paanshmen. Paanshmëria ka të beje jo vetëm me vendimin, por edhe me procedurën e marrjes se vendimit. Gjyqtari gjate punës se tij respekton parimet e barazisë se palëve ne procedure duke njohur dhe respektuar diversitetin ne shoqëri ne bazë te racës, ngjyrës, gjinisë, përkatësisë fetare, përkatësisë nacionale, orientimit seksual, nevoja te veçanta, moshës, statusit martesor, shoqëror dhe ekonomik dhe çdo kriteri tjetër, si dhe i trajton ne mënyrë te barabarte te gjithë ata me te cilët ka kontakte profesionale. Gjyqtari sillet ne mënyrë te ndershme, te dinjitetshme dhe duhet te jete gjate tërë kohës ne harmoni me karakterin e larte moral, i cili është thelbësor për ruajtjen e reputacionit te gjyqësorit, etj.</p>

²⁴ <https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs1/Kodi%20Etikes%20Profesionale%20per%20gjyqtar.pdf>

<p>RREGULLORE NR. 01/2021 PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË GJYQTARËVE, I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME RREGULLOREN NR. 02/2021 PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 01/2021 PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË GJYQTARËVE²⁵</p>	<p>Këshilli Gjyqësor i Kosovës</p> <p>Gjykatat (Gjyqtarët)</p>	<p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Sipas kësaj rregullore të gjithë gjyqtaret e gjykatave të Kosovës, përveç kryetareve të gjykatave, gjyqtareve të cilët për më tepër se tri vitet e fundit kanë mbajtur pozita udhëheqëse dhe anëtarëve të KGJK-së për kohën sa kanë shërbyer me orar të plotë në Këshill, i nënshtrohen vlerësimit të performancës sipas kritereve dhe rregullave për vlerësimin e performancës të përcaktuara me këtë rregullore. Vlerësimi i performancës përbën bazë për ngritje apo ulje në detyrë, ri-emërimin e gjyqtarit dhe për inicimin e procedurës për shkarkim.</p>
<p>RREGULLORE (04/2020) PËR AUTORITETIN, ORGANIZIMIN, DHE</p>	<p>Këshilli Gjyqësor i Kosovës</p> <p>Këshilli Gjyqësor i Kosovës</p>	<p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Sipas Rregullores, Njësia e Inspektimit Gjyqësor ndihmon Këshillin Gjyqësor të Kosovës në vlerësimin e punës së gjykatave dhe</p>

²⁵https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/89895_Rregullore_Nr_01_2021_per_vleresimin_performances_se_Gjyqtareve.pdf

FUNKSIONIMIN E NJËSISË SË INSPEKTIMIT GJYQËSOR ²⁶	(Njësia Inspektimit Gjyqësor)	i propozon praktika për përmirësimin e gjykatave. Njësia ndër të tjera zhvillon studime për të vlerësuar efikasitetin e procedurave gjyqësore, ndikimin e ligjeve, rregulloreve dhe politikave të Këshillit, si dhe bën rekomandime për të përmirësuar efektivitetin dhe efikasitetin e gjyqësorit, etj.
RREGULLORE (03/2020) MBI ORGANIZIMIN DHE VEPRIMTARINË E KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS ²⁷	Këshilli Gjyqësor i Kosovës Këshilli Gjyqësor i Kosovës	Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit Zbatimi i legjislacionit: Këshilli Gjyqësor sipas kësaj rregullore përcakton mënyrën e punës, organizimin dhe funksionimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe njësive të tij.
RREGULLORE (02/2020) PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM TË GJYKATAVE ²⁸	Këshilli Gjyqësor i Kosovës Gjykatat	Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit Zbatimi i legjislacionit: Kjo rregullore zbatohet në të gjitha gjykatat e Republikës së Kosovës, përfshirë Gjykatën Supreme të Kosovës me Dhomën e

²⁶https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/85990_Rregullore%20nr.%2004-2020%20-%20Per%20autoritetin,%20organizimin%20dhe%20funksionimin%20e%20Njesise%20se%20Inspektimit%20Gjyqesor.pdf

https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/43176_Rregullore%20nr.%2003-2020%20mbi%20organizimin%20dhe%20veprimtarine%20e%20Keshillit%20Gjyqesor%20te%20Kosoves.pdf

²⁸https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/31597_Rregullore_Nr_02_2020_per_organizimin_dhe_veprimtarine_brendshme_te_gjykatave.pdf

		Posaçme të Gjykatës Supreme dhe Kolegjin e Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës, në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatat Themelore me degët e tyre. Veprimtaria e brendshme në gjykata, sipas rregullores organizohet në atë mënyrë që gjykatat funksionin e vet ta realizojnë në mënyrë të ligjshme e duke i'u lehtësuar palëve kryerjen e punëve, lidhur me realizimin e të drejtave që u takojnë me ligj, në afat të arsyeshëm dhe me shpenzime të arsyeshme.
RREGULLORE (NR. 09/2019) PËR PROCEDURËN DHE KRITERET E ZGJEDHJES SE ANËTAREVE TE KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS NGA GJYQËSORI ²⁹	Këshilli Gjyqësor i Kosovës Këshilli Gjyqësor i Kosovës Gjykatat	Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit Zbatimi i legjislacionit: Me këtë rregullore përcaktohen kriteret dhe procedura për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga gjyqësori. Kjo Rregullore zbatohet ndaj të gjithë gjyqtarëve, duke përfshirë ata që kandidojnë për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe zyrtarëve të tjerë të cilët janë të përfshirë në procesin e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit nga gjyqësori.
RREGULLORE (05/2019) PËR PROCEDURËN	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit

²⁹https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/92188_Rregullore_Nr_09_2019_per_Proceduren_dhe_Kriteret_Zgjedhjes_%20Anetareve_te_KGJK-se_nga_Gjyqesori.pdf

<p>DISIPLINORE TË GJYQTARËVE³⁰</p>	<p>Këshilli Gjyqësor i Kosovës</p>	<p>Zbatimi i legjislacionit: Kjo rregullore përcakton procedurat për pranimin, shqyrtimin, hetimin dhe vendosjen e ankesave për shkelje disiplinore ndaj gjyqtarëve si dhe organizimin e punës së Autoriteteve Kompetente dhe të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe zbatohet për të gjitha Autoritetet Kompetente, Këshillin dhe gjyqtarët, përfshirë gjyqtarët të cilët gjatë procedurës disiplinore kanë lënë detyrën ose kur funksioni i tyre është ndërprerë në ndonjë mënyrë tjetër.</p>
<p>RREGULLORE NR.03/2019 PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONALIZI MIN E DEPARTAMENTIT SPECIAL NË KUADËR TË GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË DHE</p>	<p>Këshilli Gjyqësor i Kosovës</p> <p>Gjykata Themelore në Prishtinë Dhe Gjykata e Apelit</p>	<p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Departamenti Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka kompetencë të shqyrtojë lëndët të cilët bien në kompetencë të Prokurorisë Speciale, në pajtim me ligjin. Ndërsa Departamenti Special në kuadër të Gjykatës së Apelit gjykon në shkallë të dytë dhe ka kompetencë që të shqyrtojë lëndët që bien në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.</p>

³⁰ https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/6651_Rregullorja%2005-2019.pdf

GJYKATËS SË APELIT ³¹		
<u>RREGULLORE NR.02/2019 PËR REKRUTIMIN EMRIMIN TRAJNIMIN SHPËRBLIMIN DISIPLINIMIN DHE LIRIMIN NGA DETYRA TË GJYQARËVE POROT</u> ³²	Këshilli Gjyqësor i Kosovës Gjykatat Këshilli Gjyqësor i Kosovës	Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit Zbatimi i legjislacionit: Gjykata përkatëse rekruton gjyqtarët porotë sipas konkursit publik, të cilët emërohen nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në pajtim me ligjin për një mandat pesë vjeçar, me të drejtë ri-emërimi. Gjyqtarët porotë ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë. Mandati i gjyqtarëve porotë mund të përfundoj edhe me lirim nga detyra në rast se dënohen për kryerjen e veprës penale, me përjashtim të veprave nga pakujdesia, si dhe në rast të shkeljes së rëndë të detyrave dhe Kodit të Etikës Profesionale për gjyqtarë.
RREGULLORE NR. 09/2016 PËR PROCEDURAT E ZGJEDHJES, EMËRIMIT, VLERËSIMIT,	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit Zbatimi i legjislacionit: Këshilli Gjyqësor sipas kësaj Rregullore do të bëjë zgjedhjen dhe emërimin e kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës

³¹https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/57641_Rregullore_Nr.03_2019_per_Organizimin_Funksionalizimin_Departamentit_Special_Kuader_Gjykates_Themelore_Prishtine_Gjykates_Apelit.pdf

³²https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/66108_Rregullore_Nr.02-2019_per_Rekrutimin_Emrimin_Trajnimin_Lirim_nga_Detyra_Gjyqtareve_Porot.pdf

<p>PEZULLIMIT DHE SHKARKIMIT TË KRYETARËVE TË GJYKATAVE DHE GJYQTARËVE MBIKËQYRËS, E NDRYSHUAR ME RREGULLOREN (NR. 01/2020) PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES (NR. 09/2016) PËR PROCEDURAT E ZGJEDHJES, EMËRIMIT, VLERËSIMIT, PEZULLIMIT DHE SHKARKIMIT TE KRYETARËVE TË GJYKATAVE DHE GJYQTAREVE MBIKËQYRËS³³</p>	<p>Këshilli Gjyqësor i Kosovës</p> <p>Këshilli Gjyqësor i Kosovës</p>	<p>përmes një procesi të hapur, konkurrues, transparent dhe meritor, siç përcaktohet me ligj, duke përjashtuar çfarëdo lloj diskriminimi. Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të bëjë vlerësimin e përshtatshmërisë së kandidatit për kryetar dhe gjyqtar mbikëqyrës. Në rastet kur arsyet për shkarkim paraqet shkelje disiplinore, KGJK zbaton dispozitat e Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.</p> <p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Dispozitave të kësaj rregullore iu përmbahen të gjithë kandidatët për gjyqtarë gjatë procesit të rekrutimit, KGJK-ja, anëtarët e Komisionit të themeluar me këtë Rregullore, si dhe personeli i KGJK-së të cilët janë të përfshirë në proces.</p>
---	---	---

³³<https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/Rregullore%2009%20-2016%20per%20procedurat%20e%20perzgjedjese,%20emerimit,%20vlersimite,%20pezullimit%20dhe%20shkarkimit%20te%20kyetareve%20te%20gjykatave%20dhe%20gjyqtareve%20mbikqyres.pdf>

<p>RREGULLORE (05/2016) PËR REKRUTIMIN, PROVIMIN, EMËRIMIN DHE RIEMËRIMIN E GJYQTARËVE, i ndryshuar dhe plotësuar me RREGULLOREN (13/2016) PER NDRYSHIMIN E RREGULLORS (05/2016)PER REKRUTIMIN, PROVIMIN, EMERIMIN DHE RIEMERIMIN E GJYQTAREVE, dhe REGULLOREN (12/2016) PER NDRYSHIMIN E RREGULLORS (05/2016)PER REKRUTIMIN, PROVIMIN,</p>		
---	--	--

EMERIMIN DHE RIEMERIMIN E GJYQTAREVE ³⁴		
KODI I ETIKËS DHE SJELLJES PROFESIONALE PËR PROKURORË ³⁵	Këshilli Prokurorial i Kosovës Prokurori i Shtetit	<p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Prokurori i Shtetit ushtron funksionin e tij në mënyrë të pavarur në bazë të vlerësimit të saktë të fakteve dhe në përputhje me Kushtetutën, si dhe bën zbatimin e drejtë të ligjit, i pandikuar nga brenda dhe jashtë, duke shmangur çdo përpjekje të parregullt dhe të paligjshme, e cila mund të ndikojë në vlerësimin dhe vendimmarrjen e tij, nuk kërkon dhe nuk pranon përfitime materiale apo jo-materiale për vete, familjarët e tij, persona të tretë dhe institucione, nuk zhvillon veprimtari ekonomike, përfshirë çdo lloj pune apo biznesi për të përfituar për interesa materiale ose jomateriale, që mund të ndikojnë në pavarësinë e tij dhe mund të krijojnë përshtypjen e përdorimit të detyrës për interesat e tij ose personave të tjerë, si dhe nuk duhet të anëtarësohet në organizata shoqërore, të cilat krijojnë dyshimin se komprometojnë figurën e prokurorit dhe janë të papajtueshme me funksionin e tij, etj.</p>

³⁴<https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/REGULLORE%205-2016%20per%20Provimin%20Emerim%20dhe%20Riemerim%20e%20gjyqtareve.pdf>

³⁵https://www.prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Legjislacioni/ANKodet/2019_02_08_082355_Shqip.pdf

<p>RREGULLORE NR. 06.2020 PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË PROKURORË TË KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS³⁶</p>	<p>Këshilli Prokurorial i Kosovës</p>	<p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Me këtë Rregullore përcaktohen rregullat dhe procedurat e zgjedhjes së anëtarëve prokurorë të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Sipas rregullores procesi i zgjedhjes së anëtarëve të KPK-së do të jetë i hapur, transparent, në përputhje me parimet e konkurrencës, objektivitetit, paanshmërisë, përfaqësimit adekuat gjeografik për anëtarët prokurorë, barazisë gjinore dhe shumë etnicitetit.</p>
<p>RREGULLORE NR.05.2020 PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË PROKURORËVE³⁷</p>	<p>Këshilli Prokurorial i Kosovës</p>	<p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Rregullorja përcakton procedurën dhe kriteret e vlerësimit të performancës së prokurove, dhe përcakton mandatin, detyrat, përgjegjësitë, organizimin dhe funksionimin e autoriteteve që zbatojnë vlerësimin e performancës së prokurorëve. Kjo rregulloret zbatohet ndaj të gjithë prokurove të shtetit në Republikën e Kosovës. Llojet e vlerësimit të prokurove janë: Vlerësimi i prokurorëve me mandat fillestar, vlerësimi i prokurorëve me mandat të përhershëm dhe vlerësimi i parregullt.</p>

³⁶<https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/AkteNenLigjore/Udh%C3%ABzuesit/Rregullore/Rregullore%20Nr.06.2020%20-%20p%C3%ABr%20Zgjedhjen%20e%20an%C3%ABtar%C3%ABve%20prokuror%C3%AB%20t%C3%AB%20KPK-s%C3%AB.pdf>

³⁷<https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Legjislacioni/rregullore/Rregullore%20Nr.05.2020%20p%C3%ABr%20Vler%C3%ABsimin%20e%20Performanc%C3%ABs%20s%C3%AB%20Prokuror%C3%ABve.pdf>

<p>RREGULLORE NR.02.2020 PËR ORGANIZIMIN DHE VEPRIMTARINË E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS³⁸</p>	<p>Këshilli Prokurorial Kosovës</p> <p>Këshilli Prokurorial Kosovës</p>	<p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Kjo rregullore përcakton mënyrën e punës, organizimin dhe veprimtarinë e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe komisioneve të tij, si institucion tërësisht i pavarur në kryerjen e funksioneve të veta.</p>
<p>RREGULLORJA NR.01.2020 PËR TRAJNIME DHE ZHVILLIMIN PROFESIONAL NË SISTEMIN PROKURORIAL³⁹</p>	<p>Këshilli Prokurorial Kosovës</p>	<p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Kjo rregullore zbatohet për të gjitha nivelet e organizimit të Prokurorit të Shtetit dhe njërive përkatëse të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Format kryesore të zhvillimit profesional janë trajnimi fillestar, i vazhdueshëm, vullnetar apo i detyrueshëm.</p>
<p>RREGULLORJA NR.06.2019 PËR EMËRIMIN E KRYEPROKURORI</p>	<p>Këshilli Prokurorial Kosovës</p>	<p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p>

³⁸[https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/AkteNenLigjore/Rregullore%20Nr.02.2020%20-%20P%C3%ABr%20organizimin%20dhe%20veprimtarin%20e%20K%C3%ABshillit%20Prokurorial%20t%C3%AB%20Kosov%C3%ABs\(1\).pdf](https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/AkteNenLigjore/Rregullore%20Nr.02.2020%20-%20P%C3%ABr%20organizimin%20dhe%20veprimtarin%20e%20K%C3%ABshillit%20Prokurorial%20t%C3%AB%20Kosov%C3%ABs(1).pdf)

³⁹<https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Legjislacioni/Rregullore%20Nr.01.2020%20-%20P%C3%ABr%20trajnime%20dhe%20zhvillimin%20profesional%20n%C3%AB%20sistemin%20prokurorial.pdf>

<p>T TË SHITIT DHE KRYEPROKUROR ËVE TË PORKURORIVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS⁴⁰</p>	<p>Këshilli Prokurorial i Kosovës</p>	<p>Zbatimi i legjislacionit: Këshilli Prokurorial i Kosovës sipas kësaj Rregullore do të bëjë nominimin e kryeprokurorëve dhe propozimin për emërim për Kryeprokurorin e Shtetit në një proces objektiv, transparent, jodiskriminues dhe gjithëpërfshirës të bazuar në meritokraci.</p>
<p>RREGULLORJA NR.05/2019 PËR PROCEDURËN DISIPLINORE TË PROKURORËVE⁴¹</p>	<p>Këshilli Prokurorial i Kosovës</p> <p>Këshilli Prokurorial i Kosovës</p>	<p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Kjo rregullore përcakton procedurat për pranimin, shqyrtimin, hetimin dhe vendosjen e ankesave për shkelje disiplinore ndaj prokurorëve si dhe organizimin e punës së Autoriteteve Kompetente dhe të Këshillit prokuroria të Kosovës, dhe zbatohet për të gjitha Autoritetet Kompetente, Këshillin dhe prokurorët, përfshirë gjyqtarët të cilët gjatë procedurës disiplinore kanë lënë detyrën ose kur funksioni i tyre është ndërprerë në ndonjë mënyrë tjetër siç parashihet me Ligjin për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.</p>

⁴⁰[https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Rregullorja%20Nr.06.2019%20p%C3%ABr%20em%C3%ABrimin%20e%20Kryeprokurorit%20t%C3%AB%20Shtetit%20dhe%20kryeprokuror%C3%ABve%20t%C3%AB%20prokurorive%20t%C3%AB%20Republik%C3%ABs%20s%C3%AB%20Kosov%C3%ABs\(1\)\(1\).pdf](https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Rregullorja%20Nr.06.2019%20p%C3%ABr%20em%C3%ABrimin%20e%20Kryeprokurorit%20t%C3%AB%20Shtetit%20dhe%20kryeprokuror%C3%ABve%20t%C3%AB%20prokurorive%20t%C3%AB%20Republik%C3%ABs%20s%C3%AB%20Kosov%C3%ABs(1)(1).pdf)

⁴¹<https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/AkteNenLigjore/Nr.1009.2019-Rregullore%2005.2019-P%C3%ABr%20Procedur%C3%ABn%20Disiplinore%20t%C3%AB%20Prokuror%C3%ABve.pdf>

<p>RREGULLORE NR.07.2016 PËR PROCEDURËN DISIPLINORE PËR ANËTARËT E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS⁴²</p>	<p>Këshilli Prokurorial Kosovës</p> <p>Këshilli Prokurorial Kosovës</p>	<p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Kjo rregullore përcakton procedurat për hetimin e sjelljes së pahijshme të anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe zhvillimin e procedurës ndaj tyre. Sipas Rregullores anëtarët e Këshillit i nënshtrohen procedurës disiplinore në rastet kur ka kryer shkelje të Kodit të Etikës dhe sjelljes profesionale për anëtarët e KPK-së, dhe kur nuk ka ushtruar funksionin e anëtarit të Këshillit në pajtim me Kushtetutën, Ligjin dhe rregulloret e Këshillit.</p>
<p>Rregullore nr. 03/2016 për transferimin dhe avancimin e prokurorëve të shtetit⁴³</p>	<p>Këshilli Prokurorial Kosovës</p> <p>Këshilli Prokurorial Kosovës</p>	<p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Kjo rregullore përcakton kriteret dhe procedurat për transferimin dhe avancimin e prokurorëve të shtetit dhe zbatohet për Prokurorin e Shtetit, duke përfshirë të gjitha nivelet.</p>

⁴²<https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/AkteNenLigjore/Rregullore%20NR.07.2016%20-%20p%C3%ABr%20procedur%C3%ABn%20disiplinore%20p%C3%ABr%20an%C3%ABtar%C3%ABt%20e%20KPK-s%C3%AB.pdf>

⁴³<https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/AkteNenLigjore/Rregullore%20Nr.03.2016-%20p%C3%ABr%20transferimin%20dhe%20avancimin%20e%20prokuror%C3%ABve%20t%C3%AB%20Shtetit.pdf>


<p>RREGULLORE NR. 07/2015 PËR REKRUTIMIN, PROVIMIN, EMËRIMIN DHE RIEMËRIMIN E PROKURORËVE TË SHETIT⁴⁴</p>	<p>Këshilli Prokurorial i Kosovës</p> <p>Këshilli Prokurorial i Kosovës</p>	<p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Dispozitave të kësaj rregullore i'u përmbahen të gjithë kandidatët për prokurorë të shtetit gjatë procesit të rekrutimit, Këshilli Prokurorial i Kosovës, anëtarët e Komisionit për rekrutim dhe Komisionit për Rishqyrtim si dhe personeli i KPK-së të përfshirë në këtë proces.</p>
<p>Projekt Strategjia për Sundimin e Ligjit (2021-2026)⁴⁵</p>	<p>Institucionet e sistemit të drejtësisë dhe ato të sigurisë</p>	<p>Projekt Strategjia ka identifikuar veçanërisht probleme me llogaridhënien, efikasitetin, profesionalizmin dhe integritetin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me institucionet e sistemit të drejtësisë dhe të sigurisë kanë përgatitur aktivitete për adresimin e këtyre problemeve.</p>

⁴⁴<https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/380.%20Rregullore%20NR.07.2015-Per%20rekrutimin%20Cprovimin%20Cemerimin%20dhe%20riemerimin%20e%20prokurore%20te%20Shtetit.pdf>

⁴⁵ Projekt Strategjia është e qasshme në: <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41053>

Gjyqësori dhe prokuroria vazhdojnë të përballen me sfida të shumta dhe të natyrave të ndryshme, pavarësisht ndërtimit dhe përparimit të vazhdueshëm, veçanërisht pas vitit 2008. Një nga këto sfida është profesionalizimi dhe integriteti i disa gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, por edhe personelit administrativ dhe mbështetës të tyre. Ky është një konstatim i cili pranohet nga të gjitha palët e përfshira, duke filluar nga vetë institucionet e gjyqësorit dhe prokurorisë, komuniteti ndërkombëtar që vepron në Kosovë, Qeveria, subjektet e ndryshme politike si dhe pjesëtarë të shoqërisë civile - konstatim ky i pasqyruar në raporte të ndryshme të këtyre palëve, të referuara më poshtë.

Në raportet ndërkombëtare, Kosova vazhdon të rangohet si njëra nga vendet me korrupsion të lartë. *Transparency International* e rangon Kosovën në vendin e 104, me vetëm 36 pikë nga 100 sosh. Për më tepër, qysh nga viti 2012, Kosova ka pasur ngritje për vetëm dy pozita në këtë rangim⁴⁶. Kjo tregon për një ritëm tejet të ngadalësuar të përmirësimit të situatës.



Burimi: *Transparency International*

⁴⁶ Indeksi i perceptimit të korrupsionit, Transparency International, i qasshëm në: <https://www.transparency.org/en/cpi/2020/index/ksv>

Për të luftuar një shkallë të këtellë të korrupsionit, funksionimi i mirëfilltë, i paanshëm dhe i pacenuar i gjyqësorit dhe prokurorisë është jetik. Për këtë, raporti i Komisionit Evropian për disa vite me radhë, përfshirë edhe në vitin 2020, ka konkuduar se “gjyqësori është ende i cenueshëm nga ndikimi i papërshtatshëm politik” dhe se “administrimi i drejtësisë mbetet i ngadaltë dhe joefikas dhe institucionet e sundimit të ligjit kanë nevojë për përpjekje të vazhdueshme për të ngritur kapacitetet e tyre”⁴⁷.

Konstatime të ngjashme janë bërë edhe nga Raportet e Departamentit Amerikan të Shtetit, të cilat identifikojnë mosndëshkimin e zyrtarëve të korruptuar si njërin nga problemet më të mëdha në vendin tonë. Sipas tyre, “mungesa e mbikëqyrjes efektive të gjyqësorit si dhe dobësia e përgjithshme e sundimit të ligjit ka kontribuar në këtë problem”⁴⁸. Më me rëndësi, ky raport thekson se “rastet e korrupsionit vazhdimisht kanë qenë subjekt i apelimit, dhe sistemi gjyqësor shpesh i ka lejuar afatet e parashkrimit që të rrjedhin pa i gjykuar rastet”⁴⁹.

Në raportin e vitit 2019, i njëjti burim thekson se përkundër garancive kushtetuese për të siguruar pavarësinë, sistemi gjyqësor shpesh nuk ka arritur gjykim të drejtë, duke qenë i ngadalshëm dhe duke mos e garantuar llogaridhënien e zyrtarëve⁵⁰. Sërish, ky burim konkludon se “strukturat gjyqësore ishin subjekt i ndërhyrjeve politike, me emërimet të kundërshtuara dhe mandate të paqarta”⁵¹.

Raporti i brendshëm i misionit kolegjial të Komisionit Evropian thekson se prokurorët kanë presion dhe ndërhyrje nga jashtë, përfshirë këtu mediat, policia, të dyshuarit por edhe nga vetë eprorët e tyre⁵². Ata gjithashtu cekin përshtypjen se ka ndikim politik mbi zyrën e prokurorit të shtetit e cila, sipas tyre, reflektohet në numrin e ulët të rezultateve në luftimin

⁴⁷ Raporti për Kosovën, fq. 6 i qasshëm në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/default/files/kosovo_report_2020.pdf.

⁴⁸ Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit mbi të drejtat e njeriut, për vitin 2020, fq. 22, i qasshëm në: <https://www.state.gov/wp-content/uploads/2021/03/KOSOVO-2020-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf>; I njëjti raport gjithashtu rithekson problematikën e mosndëshkimit të zyrtarëve policorë për disa incidente të dhunës si dhe caktimin e paraburgimit pa arsytim të mirëfilltë.

⁴⁹ Ibid.

⁵⁰ Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit mbi të drejtat e njeriut, për vitin 2019, fq. 9, i qasshëm në: <https://www.state.gov/wp-content/uploads/2020/02/KOSOVO-2019-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf>

⁵¹ Ibid.

⁵² “Peer Assessment mission to KOSOVO on their ability to successfully address high level corruption, organised crime and money laundering covering the entire criminal procedure from the investigation to the final court rulings”, nëntor 2019, fq. 14.

e krimin të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë⁵³. Probleme me ndërhyrje politike janë raportuar edhe nga gjyqtarët⁵⁴.

Anketa e opinionit publik nga ana e NDI-së Amerikane konkludon se besimi i publikut në sistemin e drejtësisë është mjaft i ulët, ku veçanërisht gjyqësori dhe prokuroria shihen nga publiku si institucione të ndikuara nga korrupsioni dhe politika.⁵⁵ Si indikacione të ndikimit të politikës në gjyqësor, shoqëria civile ka cilësuar rezultatet e munguara në luftën kundër korrupsionit të profilit të lartë; si dhe dënimet e lehta të shqiptuara edhe në rastet e pakta të trajtuara.⁵⁶

Ngjashëm me këtë, raporti i UNDP-së mbi pulsën publik për vitin 2020, tregon një shkallë shumë të ulët të kënaqshmërisë së popullatës me gjyqësorin.

Tabela 1. Kënaqshmëria e qytetarëve me institucionet kyçe ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore në Kosovë

Treguesit politikë		Mar-15	Sep-15	Apr-16	Oct-16	Oct-17	May-18	Nov-18	May-19	Nov-19	Apr-20	Trendi
Kënaqshmëria me ekzekutivin	Qeveria	18.10%	17.30%	17.80%	20.20%	32.40%	30.00%	31.30%	17.70%	14.40%	60.70%	
	Kryeministri	23.60%	14.60%	18.30%	19.70%	42.30%	33.20%	35.10%	36.50%	20.70%	65.40%	
Kënaqshmëria me legjislativin	Kuvendi	19.30%	19.90%	17.30%	18.90%	31.70%	32.90%	36.10%	19.60%	18.60%	33.40%	
	Kryetari i Kuvendit	20.10%	19.80%	24.30%	24.90%	36.00%	31.50%	36.30%	23.60%	20.50%	72.40%	
Kënaqshmëria me Presidentin	Kryetari	30.20%	30.40%	45.70%	25.50%	37.60%	39.10%	38.40%	20.40%	21.20%	18.70%	
Kënaqshmëria me gjyqësorin	Gjykata	17.20%	13.90%	18.40%	22.10%	36.90%	31.20%	37.80%	18.70%	13.60%	24.80%	
	Prokuroria	17.00%	12.80%	16.90%	16.30%	33.10%	29.90%	35.30%	16.40%	14.20%	22.30%	

Burimi: Public Pulse Brief XVIII për Kosovën, për vitin 2020⁵⁷

⁵³ Ibid.

⁵⁴ Ibid. fq. 27.

⁵⁵ Shih: 'Anketa e Opinionit Publik në Kosovë', NDI. 2020. Faqe 9 dhe 10. I qasshëm në: <https://www.ndi.org/sites/default/files/NDI%20Kosovo%20Public%20Opinion%20Poll%20-%20May%202020.pdf> ose 'Indeksi i Performancës së Institucioneve të Sundimit të Ligjit në Kosovë' GLPS. 2020. Faqe 10, 11 dhe 15. I qasshëm në: http://www.legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2020/01/RoLPIK_Botimi-5.pdf

⁵⁶ Shih për shembull: Emisioni "Iustitia", Episodi 1, "Amnistia e ligjshme e korrupsionit të nivelit të lartë": <https://www.youtube.com/watch?v=owetDPfnhkQ> (qasur për herë të fundit më 29.05.2021).

⁵⁷ I qasshëm në: https://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic_governance/public-pulse-xviii.html

Në të njëjtën frymë, raportet e punuara nga organizata të ndryshme vendore të shoqërisë civile kanë shpërfaqur një numër të konsiderueshëm të parregullsive në gjyqësor. Ato kanë raportuar për “përkëdheljen e korrupsionit” nga gjykatat⁵⁸. Për më tepër, arsyet për mungesë të llogaridhënies, ato mëtojnë të jenë kryesisht mungesa e vullnetit të institucioneve gjegjëse (KGjK dhe KPK)⁵⁹. *Tabela në vijim përmban një listë të shkurtër të burimeve të publikuara nga organizatat e shoqërisë civile, të cilat përfshijnë të gjetura në linjë me këtë:*

ORGANIZATA	TITULLI	LINKU
IKD	Vetingu pa alternativë	https://kli-ks.org/vetingu-pa-alternative-2/
IKD	PANDËSHKUESHMËRIA E KORRUPSIONIT, RREZIK PËR SHOQËRINË DHE SHTETIN	https://kli-ks.org/pandeshkueshmeria-e-korrupsionit-rrezik-per-shoqerine-dhe-shtetin/
IKD	Integriteti i sistemit të drejtësisë në luftimin e korrupsionit	https://kli-ks.org/integriteti-i-sistemit-te-drejtise-ne-luftimin-e-korrupsionit/
IKD	“Lufta” për Kryeprokuroret	https://kli-ks.org/lufta-per-kryeprokuroret/
IKD	Pavarësia, efikasiteti, llogaridhënia dhe integriteti i Këshillave	https://kli-ks.org/pavaresia-efikasiteti-llogaridhenia-dhe-integriteti-i-keshillave/
IKD	Dështimet në rastet e shënjestruara	https://kli-ks.org/deshtimet-ne-rastet-e-shenjestruara/
IKD	Prokuroret në Kosovë ngritin aktakuza ndaj të vdekurve	https://kli-ks.org/prokuroret-ne-kosove-ngrisin-aktakuza-ndaj-te-vdekurve/
IKD	Krimet e përgjithshme në Kosovë, ligji vs praktika	https://kli-ks.org/krimet-e-pergjithshme-ne-kosove-ligji-vs-praktika/

⁵⁸ Ballkan Investigative Research Netëork, “Përkëdhelja e korrupsionit”, Raporti i monitorimit të gjykatave për vitin 2020, i qasshëm në: <https://kallxo.com/wp-content/uploads/2021/05/RAPORTIO-I-MONITORIMIT-2020-WEB.pdf>

⁵⁹ Instituti i Kosovës për Drejtësi, “Llogaridhënia e gjykatësve dhe prokuroreëve”, Tetor 2020, i qasshëm në: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2020/10/IKD-Llogaridh%C3%ABnia-e-gjykat%C3%ABsve-dhe-prokurore%C3%ABve-14.10.2020-1.pdf>

IKD	Politika e dënimeve në Kosovë	https://kli-ks.org/politika-e-denimeve-ne-kosove/
IKD	Dështimet speciale në luftimin e korrupsionit	https://kli-ks.org/deshtimet-speciale-ne-luftimin-e-korrupsionit/
IKD	Shënjestrimet e dështuara	https://kli-ks.org/shenjestrime-e-deshtuara/
IKD	Kosova (s)KA korrupsion të profilit të lartë	https://kli-ks.org/kosova-ska-korrupsion-te-profilit-te-larte/
IKD	Drejtësia në shkallë të dytë	https://kli-ks.org/drejtesia-ne-shkalle-te-dyte/
IKD	Këshilla për Këshillat: Raport vjetor i monitorimit të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial (1 janar-31 dhjetor 2019)	https://kli-ks.org/keshilla-per-keshillat-raport-vjetor-i-monitorimit-te-keshillit-gjyqesor-dhe-keshillit-prokurorial-1-janar-31-dhjetor-2019/
IKD	(Pa) ligjshmëria e gjykimit të armëmbajtjes pa leje	https://kli-ks.org/pa-ligjshmeria-e-gjykimit-te-armembajtjes-pa-leje/
IKD	Dështimi i gjykatave në mbushjen e Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit	https://kli-ks.org/deshtimi-i-gjykatave-ne-mbushjen-e-programit-per-kompensimin-e-viktimave-te-krimit/
IKD	Lufta për statistika të korrupsionit	https://kli-ks.org/lufta-per-statistika-te-korrupsionit/
IKD	Drejtësia në sytë e qytetarëve	https://kli-ks.org/drejtesia-ne-syte-e-qytetareve/
IKD	Amnistia e krimeve të luftës në Kosovë	https://kli-ks.org/amnistia-e-krimeve-te-luftes-ne-kosove/
IKD	Prokuroria Pasive e Apelit	https://kli-ks.org/prokuroria-pasive-e-apelit/
IKD	Praktika e GjEDNj-së, obligim në letër	https://kli-ks.org/praktika-e-gjednj-se-obligim-ne-leter/

IKD	Llogaridhënia e Gjykatësve dhe Prokurorëve	https://kli-ks.org/llogaridhenia-e-gjykesve-dhe-prokurore/
IKD	Mungesa e dënimeve plotësuese në luftimin e kriminalitetit	https://kli-ks.org/mungesa-e-denimeve-plotesuese-ne-luftimin-e-kriminalitetit/
IKD	Drejtesia Civile 2019	https://kli-ks.org/drejtesia-civile-2019/
IKD	Ligjshmëria e avancimeve dhe përfitimeve në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit	https://kli-ks.org/ligjshmeria-e-avancimeve-dhe-perfitimeve-ne-zyren-e-kryeprokurorit-te-shtetit/
IKD	Ligjshmëria e përfitimeve në Gjykatën Supreme të Kosovës	https://kli-ks.org/ligjshmeria-e-perfitimeve-ne-gjykatene-supreme-te-kosoves/
IKD	Shteti me mos veprim, privon nga jeta Sebahate Sopin	https://kli-ks.org/shteti-me-mos-veprim-privon-nga-jeta-sebahate-sopin/
IKD	Konflikti i interesit në avancime dhe përfitime në Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial	https://kli-ks.org/konflikti-i-interesit-ne-avancime-dhe-perfitime-ne-keshillin-gjyqesor-dhe-prokurorial/
IKD	Cenimi i integritetit të Këshillave nga Këshillat	https://kli-ks.org/cenimi-i-integritetit-te-keshillave-nga-keshillat/
IKD	Trajtimi i vrasjeve në Kosovë	https://kli-ks.org/trajtimi-i-vrasjeve-ne-kosove/
IKD	Dënimi i korrupsionit si kundërvajtje	https://kli-ks.org/denimi-i-korrupsionit-si-kundervajtje/
GLPS	Five Integral Questions about the Vetting Process	http://www.legalpoliticalstudies.org/five-integral-questions-about-the-vetting-process/
GLPS	OSOVO in 2020: The Breakthrough of the Specialist Prosecutor's Office	http://www.legalpoliticalstudies.org/kosovo-in-2020-the-breakthrough-of-the-specialist-prosecutors-office/
GLPS	The Functional Review of the Kosovar Justice system: an overview of the process so far	http://www.legalpoliticalstudies.org/the-functional-review-of-the-kosovar-justice-system-an-overview-of-the-process-so-far/

GLPS	Rule of Law Performance Index in Kosovo (RoLPIK) – 4th Edition	http://www.legalpoliticalstudies.org/rule-of-law-performance-index-in-kosovo-rolpik-4th-edition/
GLPS	Natyra e çështjeve disiplinore në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës dhe funksionimi i mekanizmit disiplinor	http://www.rolpik.org/natyra-e-ceshtjeve-disiplinore-ne-sistemin-gjyqesor-dhe-prokurorial-te-kosoves-dhe-funksionimi-i-mekanizmit-disiplinor/
GLPS	Mungesa e ndjekjes penale të kompanive private	http://www.rolpik.org/mungesa-e-ndjekjes-penale-te-kompanive-private/
GLPS	Monitorimi i Sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial në Kosovë për periudhën Janar-Dhjetor 2020	http://www.rolpik.org/monitorimi-i-sistemit-gjyqesor-dhe-prokurorial-ne-kosove-per-periudhen-janar-dhjetor-2020/
GLPS	Mangësitë e aktakuzave në veprat penale korruptive	http://www.rolpik.org/mangesite-e-aktakuzave-ne-veprat-penale-korruptive/
GLPS	Indeksi i Performancës së Institucioneve të Sundimit të Ligjit	http://www.rolpik.org/indeksi-i-performances-se-institucioneve-te-sundimit-te-ligjit/
GLPS	Veprat penale të korrupsionit: mungesa e dënimeve plotësuese	http://www.rolpik.org/veprat-penale-te-korrupsionit-mungesa-e-denimeve-plotesuese/
GLPS	Masat disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve	http://www.rolpik.org/masat-disiplinore-ndaj-gjyqtareve-dhe-prokuroreve/
GLPS	Aplikimi i gjykimit të drejtë brenda një afati të arsyeshëm në gjykatat e Republikës së Kosovës	http://www.rolpik.org/aplikimi-i-gjykimit-te-drejte-brenda-nje-afati-te-arsyeshem-ne-gjykatat-e-republikes-se-kosoves/
GLPS	Aplikimi i institutit të pranimit të fajësisë për veprën penale të kryer në bashkëkryerje	http://www.rolpik.org/aplikimi-i-institutit-te-pranimit-te-fajesise-per-vepren-penale-te-kryer-ne-bashkekryerje/

GLPS	Trajtimi Institucional i Rasteve të Mosdeklarimit dhe Deklarimit të Rrejshëm të Pasurisë ndaj Zyrtarëve të Lartë Publik në Kosovë gjatë Vitit 2019	http://www.rolpik.org/trajtimi-institucional-i-rasteve-te-mosdeklarimit-dhe-deklarimit-te-rrejshem-te-pasurise-ndaj-zyrtareve-te-larte-publik-ne-kosove-gjate-vitit-2019/
BIRN	Liberalizimi i korruptuar	https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2018/04/BIRN-Raporti2018-LiberalizimiiKorruptuar-Final-Web.pdf
BIRN	Raporti i monitorimit të gjykatave 2018	https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2019/10/Court-Monitoring-Report_ENG-final.pdf
BIRN	Raporti i monitorimit të gjykatave 2020	https://kallxo.com/wp-content/uploads/2021/05/RAPORTIO-I-MONITORIMIT-2020-WEB.pdf
BIRN	Raporti i monitorimit të gjykatave 2017	https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2019/04/BIRN-RAPORTI-I-GJYKATAVE-RAPORTI-ENG-WEB.pdf
BIRN	Raporti i monitorimit të gjykatave 2019	https://kallxo.com/wp-content/uploads/2020/11/Recesioni-i-Drejtësisë-per-print.pdf
KDI	“KULTURA E PANDËSHKUESHMËRISË” NË KOSOVË	https://kdi-kosova.org/publikimet/kultura-e-pandeshkueshmerise-ne-kosove/
KDI TRANSPARENCY INTERNATIONAL	EXAMINING STATE CAPTURE: UNDUE INFLUENCE ON LAW-MAKING AND THE JUDICIARY IN THE WESTERN BALKANS AND TURKEY	https://kdi-kosova.org/publikimet/examining-state-capture-undue-influence-on-law-making-and-the-judiciary-in-the-western-balkans-and-turkey/
KDI CILC FOL	SKANIMI I INTEGRITETIT NË SEKTORIN E DREJTËSISË	https://kdi-kosova.org/publikimet/skanimi-i-integritetit-ne-sektorin-e-drejtësisë/

KDI	RAPORTI I ANKETËS “INICIATIVA PËR INTEGRITET NË SISTEMIN E DREJTËSISË”	https://kdi-kosova.org/publikimet/raporti-i-anketes-iniciativa-per-integritet-ne-sistemin-e-drejtesses/
KDI	PRITJA PËR DREJTËSI	https://kdi-kosova.org/publikimet/pritja-per-drejtessi/
FOL	REALIZIMI I PLANIT TË PUNËS SË KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS (KPK) DHE TË PROKURORIT TË SHTETIT (PSh) PËR VITIN 2020	https://levizjafol.org/wp-content/uploads/2021/05/REALIZIMI-I-PLANIT-T%C3%8B-PUN%C3%8BS-S%C3%8B-K%C3%8BSHILLIT-PROKURORIAL-T%C3%8B-KOSOV%C3%8BS-KPK-DHE-T%C3%8B-PROKURORIT-T%C3%8B-SHTETIT-PSH-P%C3%8BR-VITIN-2020.pdf
FOL	PERFORMANCA E PROKURORISË NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT 2020	https://levizjafol.org/wp-content/uploads/2021/04/Performanca-E-Prokuroris%C3%AB-N%C3%AB-Luft%C3%ABn-Kund%C3%ABr-Korrupsionit.pdf
BIRN FOL	PROGRAMI PËR FUQIZIMIN E SISTEMIT TË DREJTËSISË RAPORTI MBI MONITORIMIN E PUBLIKIMIT TË AKTGJYKIMEVE	https://kallxo.com/wp-content/uploads/2021/04/01-Raporti-per-publikimin-e-aktgjykimeve-ALB-05.pdf
BIRN FOL	ANKESAT DISIPLINORE NDAJ GJYQTAR VE	https://kallxo.com/wp-content/uploads/2020/11/Raporti-Shqip_compressed.pdf
BIRN FOL	Ankesat Disiplinore ndaj Gjyqtarëve	https://kallxo.com/wp-content/uploads/2020/02/AL-Ankesat-Disiplinore-ndaj-Gjyqtar%C3%ABve-31.01.pdf

Gjatë viteve 2018 - 2021 Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me KGjK, KPK dhe institucione të tjera dhe partnerë ndërkombëtarë, ka zhvilluar procesin e Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit. Procesi tashmë ka kulmuar me miratimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit, për vitet 2021-2026, në gusht të vitit 2021. Ky proces u zhvillua përmes një sërë analizash të thella të sfidave kyçe të sundimit të ligjit në Kosovë. Në mesin e tyre, Dokumenti i Politikave mbi llogaridhënien në sistemin gjyqësor dhe prokurorial (i përpiluar me ndihmë të ekspertëve të angazhuar nga Bashkimi Evropian) si dhe ai mbi integritetin në sistemin gjyqësor dhe prokurorial janë relevante për temat që

trajtohen në këtë dokument. Dokumenti mbi llogaridhënien ka gjetur se, në përgjithësi, sistemit gjyqësor dhe Prokurorial i mungojnë mekanizma adekuatë për llogaridhënie brenda vetë sistemeve. Ngjashëm me këtë, dokumenti mbi integritetin (i përpiluar me ndihmë të ekspertëve të angazhuar nga Ambasada Britanike në Kosovë) ka gjetur se këtyre sistemeve ju mungon një proces adekuat i verifikimit. Ai dokument ka theksuar, në mes tjerash, se njëra nga të metat kryesore të sistemit është pikërisht mungesa e një sistemi adekuat të verifikimit apo kontrollit të integritetit në baza të rregullta dhe të vazhdueshme. Disa nga të gjeturat e këtyre dokumenteve janë të përmbledhura shkurtimisht e të ndërthurura përgjatë këtij dokumenti.

Ky Koncept Dokument do të analizojë gjendjen aktuale - sfidat lidhur me profesionalizmin dhe integritetin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Kosovë; objektivat që synohen të arrihen përmes vetingut në sistemin e drejtësisë; opsionet e ndryshme që mund të ndiqen drejt funksionalizimit të mekanizmave të vetingut; dhe ndikimet e pritura. Në fushëveprimin e këtij Koncept Dokumenti do të trajtohen gjithashtu pozita të caktuara të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues në sistemin e drejtësisë, gjegjësisht: Drejtori i Përgjithshëm të Sekretariatit të KGJK-së, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, zyrtarët që shërbejnë në rolin e zyrtarëve kryesor administrativ të këshillave⁶⁰, si dhe administratorët e gjykatave, përgjegjës për administrimin efikas dhe efektiv të gjykatave⁶¹, por edhe Drejtori i Njësisë për Inspektim gjyqësor në kuadër të KGJK-së⁶². Ndërsa për nëpunësit tjerë civilë, Ministria e Drejtësisë tanimë ka filluar punën me themelimin e Grupit Punues për hartimin e Koncept Dokumentit për nëpunësit civil në administratën e gjykatave dhe prokurorive i cili pritet të realizohet deri në mars të vitit 2022, ku do të trajtohet ndër të tjera edhe çështja e verifikimit të tyre. Duke qenë se “vetingu” në Polici të Kosovës, Inspektorat Policor të Kosovës, AKI dhe institucione tjera bie jashtë kompetencës së Ministrisë së Drejtësisë, zhvillimi i procesit në këto institucione iu mbetet institucioneve përkatëse.⁶³

Për tu kthyer në temën që e trajton ky Koncept Dokument, para se të elaborohet në mënyrë më specifike sfida e profesionalizmit dhe integritetit, vlen të theksohet se një lloj, i vetingut është zhvilluar më parë në Kosovë për gjyqtarët dhe prokurorët.⁶⁴ Kjo ka ndodhur në vitin

⁶⁰ Shih Nenin 35 të Ligjit për KGJK-në dhe Nenin 32 të Ligjit për KPK-në.

⁶¹ Shih Nenin 38 të Ligjit për KGJK-në.

⁶² Shih Nenin 36 të Ligjit për KGJK-në.

⁶³ Ky përfundim ka rrjedhur edhe gjatë diskutimeve të Grupit Punues në punëtorinë e mbajtur në Prevallë, më datë 2 dhe 3 qershor 2021. Aty është diskutuar se vetingu i institucioneve tjera do të realizohet nga vetë këto institucione.

⁶⁴ Ky proces është spjeguar në dokumentin ‘Modalitetet e llogaridhënies me përfshirjen e Vetingut në sistemin e drejtësisë në Kosovë’, 15 dhjetor 2020 (Kapitulli 1.6, faqe 14-17). Dokumenti është përgatitur nga grupi punues i përbërë nga Qeveria, institucionet e sistemit të drejtësisë, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe

2010, ku Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial (KPGJP) si një organ i pavarur i KGJK-së, sipas Kushtetutës, ka pasur mandatin për të vendosur për përshtatshmërinë e të gjithë kandidatëve për emërim të përhershëm si gjyqtarë dhe prokurorë në Kosovë. Ky proces ishte zhvilluar në tri faza të njëpasnjëshme:

- Faza e I-rë, e cila ishte fokusuar në përzgjedhjen e gjyqtarëve për Gjykatën Supreme dhe përzgjedhjen e prokurorëve për Prokurorinë e Shtetit dhe Prokurorinë Speciale;
- Faza e II-të ishte përqendruar në përzgjedhjen e gjyqtarëve për Gjykatat e Qarkut, Gjykatën Ekonomike, për Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje dhe për Prokuroritë e Qarkut, dhe
- Faza e III-të, e cila ishte përqendruar në zgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve në komuna.

Sipas Urdhëresës Administrative 2008/2 që e ka rregulluar këtë proces, të gjithë kandidatët, pa përjashtim kanë qenë të detyruar t'i nënshtrohen provimit mbi Kodet relevante të Etikës dhe vetëm ata të cilët e kanë kaluar, kanë mundur të vazhdojnë punën e tyre. Në përgjithësi, prej 372 pozitave gjyqësore të shpallura, 274 gjyqtarë janë emëruar, kurse prej 89 pozitave prokuroriale të shpallura, janë emëruar 60 prokurorë. Tabela në vijim paraqet të dhënat e procesit nga tri fazat:

Figura 4: Të dhënat e vetingut të vitit 2010

Faza	Pozitat e shpallura	Të emëruar	Riemërimet	Të emëruarit e rinjë	Femra	Minoritetet
Faza I	33	26 (78.79%)	9 (34.61%)	17(65.38%)	11 (42.31%)	1 (3.84%)
Faza II	109	86 (78.90%)	31 (36.04%)	55 (63.96%)	21 (24.4)	6 (6.97%)
Faza III	319	222 (69.59%)	92 (41.44%)	130 (58.56%)	63 (28.37%)	8 (3.60%)
Totali	461	334 (72.45%)	132 (39.52%)	202 (60.48%)	95 (28.44%)	15 (4.45%)

Nga Faza e I (parë) prej 33 pozitave të shpallura janë plotësuar 26 pozita për gjyqtarë dhe prokurorë ose (78.79%), me rëndësi është se nga këto 26 pozita 9 prej tyre kanë qenë riemërim ose 34.61% dhe 17 të emëruar të rinj ose 65.38%. Në fazën e II (dytë) janë shpallur 109 pozita, janë plotësuar 86 pozita ose 78.90%, prej të cilave 31 ose 36.04% kanë qenë riemërimet dhe 55 ose 63.96% të emëruarit e rinj. Në fazën e III (tretë) kanë qenë të shpallura 319 pozita prej të cilave janë plotësuar 222 ose 69.59%, prej të cilave të riemëruar 92 ose 41.44%, ndërsa të emëruar të rinj 130 ose 58.56%. Pra, nga totali i pozitave të shpallura prej

461, janë plotësuar 334 ose 72.45% prej të cilave 132 kanë qenë riemërime ose 39.52% ndërsa 202 ose 60.48% të emëruar të rinj në pozita të gjyqtarit dhe prokurorit. Ky krahasim vë në pah se procesi sa i përket reformës së pozitive ka qenë mjaft pozitiv dhe vlerësim shumë i paanshëm dhe kredibil.⁶⁵ Kështu, ky proces rezultoi në pamundësi të plotësimi të gjitha vendeve të shpallura, e që pamundësoi që me këtë numër të gjyqtarëve dhe prokurorëve të përballet sistemi gjyqësor me numrin e lëndëve nëpër gjykata dhe prokurori - edhe ashtu të stërngarkuara, si dhe me numër të pamjaftueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve edhe para këtij procesi.

Mund të thuhet se ky proces ka pasur anët negative dhe pozitive, mirëpo i njëjti mund të shfrytëzohet në aspektin pozitiv, marrë parasysh përvojat në këtë proces, disa prej të cilave të renditura si më poshtë⁶⁶:

- Përvoja e fituar në organizimin dhe administrimin e një procesi të tillë në mënyrë të sigurt përfshinë edhe përdorimin e teknologjisë së informacionit për të lehtësuar procesin;
- Bashkëpunimi me institucione vendore dhe ndërkombëtare për t'i përdorur të dhënat e tyre për këtë proces;
- Shfrytëzimi i procedurave standarde të veprimit për verifikim/veting të secilit aplikant;
- Krijimi dhe shfrytëzimi i pyetjeve standarde për intervista të cilat mbulojnë të gjitha kriteret relevante të vlerësimit;
- Shfrytëzimi i formularëve standard të vlerësimit;
- Procesi i verifikimit duhet të jetë i vazhdueshëm i përcjellë në periudha të caktuara kohore. Verifikimi nuk duhet të jetë i kryer njëherë dhe mos të vazhdohet në të ardhmen në periudha të caktuara kohore;
- Nga analiza e raportit përfundimtar të këtij procesi konstatohet se procesi nuk ka përfshirë në mënyrë të duhur verifikimin e pronës, aspektin financiar - interesat financiare, të ardhurat dhe shpenzimet, punën e kaluara të aplikantit etj;
- Nuk ka pasur kriteret të sakta të vlerësimit të caktuara paraprakisht, e në veçanti kriteret eliminuese për një kandidat. Këto kriteret duhet të jenë të caktuara paraprakisht në mënyrë që të eliminohet mundësia e subjektivizmit në proces.

⁶⁵ Shih për shembull: Raporti Kryesor Final, Shtojca G: Raporti i Vendit - Kosova nën Vlerësimin Tematik të Sundimit të Ligjit, Reforma në Drejtësi dhe Lufta kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në Ballkanin Perëndimor - Lot 3, shkurt 2013, f. 209. E qasshme në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/financial_assistance/phare/evaluation/2013_final_main_report_lot_3.pdf

⁶⁶ Ky proces është shpjeguar në dokumentin 'Modalitetet e llogaridhenies me përfshirjen e Vetingut në sistemin e drejtësisë në Kosovë', 15 dhjetor 2020 (Kapitulli 1.6, faqe 16-17).

1.2. Problemi Kryesor, shkaqet dhe efektet

Për të kuptuar më mirë gjendjen aktuale në gjyqësorin e Kosovës, në përputhje me udhëzimet e miratuara të Qeverisë për hartimin e Koncept Dokumentit⁶⁷, është punuar pema e problemit e cila paraqet ‘**problemin kryesor**’, ‘**shkaqet**’ - faktorët që e shkaktojnë problemin kryesor, si dhe ‘**efektet**’ që prodhon problemi kryesor për shoqërinë e Kosovës dhe individët në veçanti.

Figura 5: Pema e problemit

Efektet	Humbje e besimit të qytetarëve në drejtësi
	Shkelje e të drejtave të njeriut
	Ngecje në zhvillim ekonomik dhe shoqëror
Problemi kryesor	Profesionalizmi dhe integriteti i gjyqtarëve, prokurorëve dhe nëpunësve civil në pozita të larta në sistemin e drejtësisë
Shkaqet	Mangësitë ligjore
	Zbatimi jo adekuat i legjislacionit në fuqi

PROBLEMI KRYESOR

Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit dhe balancës në mes tyre. Sipas rregullimit Kushtetues dhe ligjor në vend, të bazuar në instrumentet ndërkombëtare, pushteti gjyqësor duhet të jetë pushtet krejtësisht i pavarur nga pushteti ekzekutiv dhe ai legjislativ. Krahas pavarësisë, paañësia e gjyqësorit është një tjetër cilësi qenësore e gjyqësorit.

⁶⁷http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/06/Udhezuesi-dhe-Doracaku-per-Hartimin-e-Koncept-Dokumenteve-Shq-24-05-18_Publish.pdf

Megjithatë, siç u evidentua në hyrje të këtij Koncept Dokumenti, vazhdimisht është vlerësuar dhe raportuar se sistemi i drejtësisë në Kosovë është i ndikuar dhe i ndikueshëm nga grupet e ndryshme të interesit, politika dhe faktorë të tjerë të jashtëm. Për më shumë, ka edhe mungesë të profesionalizmit në sistem. Si rrjedhojë, disa gjyqtarë dhe prokurorë, por edhe nëpunës civilë në pozita të larta mund të ndërmarrin veprime ose nxjerrin vendime të cilat nuk i shërbejnë drejtësisë dhe qëllimit kushtetues dhe ligjor, për të cilin duhet të shërbejnë. Përkundër këtij imazhi të përgjithshëm të krijuar, në mesin e gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe stafit administrativ e mbështetës, ka individë profesionistë e të rregullta. Megjithatë, rrethanat ekzistuese nuk u lejojnë që të kenë ndikim në përmirësimin e këtij imazhi të përgjithshëm.

Shkaqet

Grupi punues ka identifikuar dy shkaqe kryesore që kanë ndikuar deri më tani dhe që kanë potencial të ndikojnë edhe në të ardhmen në cënueshmërinë e integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Kosovës, si dhe nëpunësve në pozita të larta përbrenda sistemit të drejtësisë. Të njëjtat shtjellohen në vijim.

1.2.1. Mangësitë ligjore

Legjislacioni që rregullon sistemin e drejtësisë në një masë dështon të ofrojë zgjidhje për të siguruar një sistem, pjesëtarët e së cilit janë persona me integritet të lartë. Kjo për arsye se:

1. Fillimisht, korniza ligjore ekzistuese nuk flet për një **mekanizëm adekuat të verifikimit të përsëritur apo të vazhdueshëm të integritetit** të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Verifikimi i integritetit personal bëhet, në parim, vetëm me rastin e rekrutimit të kandidatëve për këto funksione. Edhe përgjatë këtij procesi, integriteti i kandidatit vlerësohet me pikë, të cilat më pas llogariten kumulativisht me pikët e tjera që vlerësojnë aftësitë profesionale të kandidatit. Siç është përmendur më sipër, këto dy vlerësime do të duhej të ishin të ndara. Kështu, do të pamundësohej akumulimi i pikëve të larta të një kandidati i cili është vlerësuar lartë në shkathtësi profesionale, por është treguar i mangët në integritet, dhe anasjelltas.

Duhet përmendur gjithashtu se një lloj vlerësimi i përshtatshmërisë ndërmerret edhe me rastin e avancimeve, përkatësisht marrjes së pozitave menaxheriale nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Vlerësimi i tillë nuk është se ka ndonjë rregullativë specifike në legjislacionin primar. Kjo rregullohet vetëm me akte nënligjore të nxjerra nga KGJK, respektivisht KPK. Te avancimi i prokurorëve, ky vlerësim, në termat e integritetit, është më i limituar pasi që bazohet kryesisht në të dhënat sa i përket historikut disiplinor që ka

kandidati. Për avancimin e gjyqtarëve, analizohet një spektër më i gjerë i të dhënave sa i përket integritetit të tyre.

E meta më e madhe qëndron në faktin se vlerësimi i integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve gjatë karrierës së rregullt të tyre aktualisht ezaurohet⁶⁸ në kuadër të vlerësimit periodik të performancës, si një segment që vlerësohet numerikisht, me ç'rast kalkulohet kumulativisht me segmentet e tjera gjegjëse për të matur performancën. Në këtë rast, nuk angazhohen mekanizmat për hetim sa i përket verifikimit të integritetit. Përveç kësaj, duhet rikujtuar se baza e të dhënave që mund të mblidhen në kuadër edhe të këtij vlerësimi, është ligjërisht e kufizuar dhe pamundëson mbledhjen e duhur të të dhënave (shih më sipër për sqarimet mbi këtë të metë).

Pra, si përfundim, ekzistojnë vetëm dy momente kur hetohet në mënyrë të mirëfilltë se a ka një individ integritet të përshtatshëm personal për të bartur pozitë gjegjëse brenda sistemit të drejtësisë në Kosovë apo jo.

Situatë e ngjashme është edhe me nëpunësit civilë në pozita të larta në sistem. Ata nuk i nënshtrohen verifikimit të nevojshëm të integritetit, as në fazën e rekrutimit por as në mënyrë të vazhdueshme. Kriteret e pranimit të tyre, që vlejné për të gjithë zyrtarët publikë⁶⁹, ndër të tjera që kanë të bëjnë me integritetin janë vetëm:

1. të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; dhe
2. të mos kenë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik.

Ndërsa largimi i tyre nga pozita është i mundshëm vetëm nëse:

1. dënohen me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;⁷⁰
2. dënohen me vendim të formës së prerë për çfarëdo vepre penale, për mbajtjen e burgut efektiv për tre (3) muaj e më tepër;⁷¹

⁶⁸ Sipas komenteve të KGJK-së, një testim i integritetit bëhet edhe në momentin e përfundimit të trajnimit fillestar. Megjithatë, është konfirmuar se vlerësimi final pas përfundimit të trajnimit fillestar është vlerësim i fokusuar vetëm në aspektet e profesionalizmit të gjyqtarit. Gjithashtu, baza e kufizuar e të dhënave që ligjërisht mund të merren është shumë e kufizuar, siç është shpjeguar brenda dokumentit.

⁶⁹ Ligji për Zyrtarët Publik, Neni 8.

⁷⁰ Po aty. Neni 60.1.5.

⁷¹ Po aty. Neni 60.1.6.

3. pas dy vlerësimeve “jo kënaqshëm”, për dy vjet radhazi, të rezultateve në punë;⁷² nëse deklarohen të paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor, sipas ligjit;⁷³
4. gjenden në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit, të deklaruar nga vetë ata dhe, sipas ligjit, nuk merren masat e parashikuara për shmangien e konfliktit të interesit;⁷⁴
5. kur anëtarësohen në një parti politike ose bëhen anëtarë të organeve drejtuese të një partie politike;⁷⁵

KGJK ka nxjerrë edhe Rregullore specifike për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KGJK-së në vitin 2017.⁷⁶ Aty si kriter, ndër të tjera, theksohet reputacioni i lartë profesional dhe integriteti personal që kandidatë për këtë pozitë duhet të kenë, por për këtë çështje nuk ka pasur procedurë formale të verifikimit.

Sa i përket deklarimit të pasurisë, sipas Ligjit për Deklarimin e Pasurisë, Drejtorët e Sekretariateve e deklarojnë pasurinë e tyre dhe i nënshtrohen verifikimit të pasurisë në përputhje me atë Ligj, ndërsa administratorët e gjykatave dhe prokurorive nuk janë të detyruar të deklarojnë pasurinë fare.

Për më tepër, sipas Aktgjykimi nr. KO203/19, Gjykata Kushtetuese, ka konstatuar se Ligji nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk zbatohet në raport me këto pozita. Rrjedhimisht, edhe çështja e rekrutimit dhe disiplinimit të këtyre pozitave mbetet e parregulluar, meqenëse nuk gjejnë zbatim as dispozitat e as rregullorja përkatëse e ligjit të përmendur. Lidhur me institucionet e sistemit të drejtësisë, Gjykata Kushtetuese nuk ka parë të nevojshme të anulojë këto dispozita në tërësinë e tyre pasi këto dispozita aplikohen edhe ndaj nëpunësve të institucioneve të pavarura kushtetuese përderisa ato nuk cenojnë pavarësinë e tyre dhe gjithashtu aplikohen në raport me nëpunësit e institucioneve të tjera, kushtetutshmëria e të cilave nuk është kontestuar para Gjykatës në mënyrë specifike. Deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë nga ana e

⁷² Po aty. Neni 61.1.3.

⁷³ Po aty. Neni 61.1.2.

⁷⁴ Po aty. Neni 61.1.5.

⁷⁵ Po aty. Neni 61.1.6.

⁷⁶ Rregullorja nr.03/2017 për Procedurën e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorit të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor. E qasshme në: [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/LREGULLORE%20NR.%2003%202017%20P%C3%8BR%20PROCEDUR%C3%8BN%20E%20P%C3%8BRZGJEDHJES%20DHE%20EM%C3%8BRIMIT%20T%C3%8B%20DREJTORIT%20T%C3%8B%20SEKRETARIATIT%20T%C3%8B%20KOSOVO%20C3%8BS.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/LREGULLORE%20NR.%2003%202017%20P%C3%8BR%20PROCEDUR%C3%8BN%20E%20P%C3%8BRZGJEDHJES%20DHE%20EM%C3%8BRIMIT%20T%C3%8B%20DREJTORIT%20T%C3%8B%20SEKRETARIATIT%20T%C3%8B%20K%C3%8BSHILLIT%20GJYQ%C3%8BSOR%20T%C3%8B%20KOSOVO%20C3%8BS.pdf)

Kuvendit, dispozitat e këtij Ligji zbatohen vetëm për atë që nuk cenon pavarësinë funksionale dhe organizative të Institucioneve të Pavarura të referuara specifikisht në Dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Pra, nga ato që u thanë më lartë vërehet se edhe sa i përket nëpunësve civil në pozita të larta, ka mangësi ligjore për verifikim të integritetit.

1. Mangësi ka edhe sa i përket **përcaktimit ligjor të mekanizmave që bëjnë vlerësimin e integritetit** të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë. Deri më sot, mekanizmat e vlerësimit të integritetit, nuk gjejnë bazë në legjislacionin primar, mirëpo përcaktohen sipërfaqësisht me rregullore derivuese të hartuara nga Këshillat. Madje, përderisa KGJK ka përcaktuar krijimin e një njësie të verifikimit të integritetit, rregullorja e KPK-së parasheh që Komisioni për Rekrutim me rastin e vlerësimit të kandidatëve, ndihmohet nga zyrtarët përgjegjës të KPK-së. **Askund nuk flitet për verifikimin e integritetit të vet atyre që bëjnë vlerësimin e integritetit të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë dhe si rrjedhojë në praktikë ata nuk i nënshtrohen vetingut.**
2. Tutje, rregullativa e tanishme përcakton **bazë të ngushtë të të dhënave që merren** me rastin e vlerësimit të integritetit të kandidatëve. Burimet e të dhënave që shfrytëzohen me rastin e vlerësimit të integritetit përfshijnë të dhënat e dorëzuara nga vet kandidati dhe të dhënat nga regjistrat publik ku hyjnë edhe regjistrat nga e kaluara penale. **Shqetësim i madh mbetet se nuk vlerësohen të dhënat financiare**, përfshirë këtu xhirollogaritë bankare, të kandidatëve.
3. Dispozitat në fuqi, po ashtu **nuk i japin peshën e duhur rezultateve nga vlerësimi i integritetit**. Njësia e Verifikimit nuk ka fuqinë që të ndalojë emërimin e kandidatit si prokuror apo gjyqtar pasi Komisionet për Rekrutim janë autoritetet të cilave i është mveshur vendim-marrja.
4. Mangësi ligjore ka edhe sa i përket **suspendimit të gjyqtarit apo prokurorit që hetohet për shkelje të rëndë disiplinore**. Gjatë hartimit të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, është bërë një lëshim teknik për përmirësimin e së cilit është dashur që të inicohet procedura e ndryshimit dhe plotësimit të ligjit. Rrjedhimisht, prokurorët dhe gjyqtarët të cilët aktualisht po hetohen për shkelje të rëndë disiplinore mund të vazhdojnë të ushtrojnë në mënyrë të rregullt funksionin e tyre gjersa të ketë një vendim për disiplinimin e tyre. Vlen të theksohet që ky ligj tanimë është në procedurë të plotësimit/ndryshimit në Kuvend, kështu që shumë shpejtë pritet të tejkalohet kjo mangësi.

5. Si mangësi konsiderohet edhe **paqartësia dhe fushëveprimi i bazës për shkarkim mbi “mosrespektimin e rëndë të detyrave”**. Kushtetuta e Republikës së Kosovës parasheh si arsye për shkarkim nga funksioni dënimin për vepër të rëndë penale ose mosrespektimin e rëndë të detyrave, por kjo e fundit nuk është e definuar qartë⁷⁷. Dilema qëndron mbi atë se nëse të metat në integritet të një gjyqtari përbëjnë “mosrespektim të rëndë të detyrave”. Ritheksohet se momentalisht, vlerësimi i integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve hyn në kuadër të vlerësimit të performancës së tyre. Gjithashtu, gjyqtarët detyrohen që të deklarojnë pasurinë e tyre në baza vjetore. Megjithatë, cila nga të metat që gjenden gjatë këtyre vlerësimeve do të përmbushnin kushtin e të qenit “mosrespektim i rëndë të detyrave” është e paqartë nga korniza aktuale ligjore e Kushtetuese.

Si rrjedhojë e të sipërpërmendurave, duke pasur në mendje kërkesat kushtetuese për një sistem të drejtësisë të pavarur dhe të paanshëm, mund të thuhet se korniza ligjore që është në fuqi nuk shtyn përpara garantimin e këtyre kërkesave.

1.2.2. Zbatimi jo adekuat i legjislacionit në fuqi

Të pasurit një kornizë ligjore të kompletuar dhe mirë të strukturuar është parakusht për mirë funksionim të një shteti demokratik. Mirëpo, normimi si i vetëm jo gjithmonë është garantues për sukses. Ka kritika të shumta sa i përket zbatimit të legjislacionit në fuqi nga gjyqtarët dhe prokurorët dhe Këshillat. Janë vërejtur të metat në zbatim, si në vijim:

1. Zbatimi jo adekuat, i rregullave për **pa/pajtueshmërinë për të qenë gjyqtar apo prokuror apo edhe anëtar i KGJK, respektivisht KPK**

Sa i përket gjyqtarëve dhe prokurorëve, me legjislacionin në fuqi, të njëjtit, për t'u angazhuar në aktivitete jashtëgjyqësore të cilat nuk janë shprehimisht të ndaluara, duhet të marrin aprovimin paraprak nga Kryetari i Gjykatës apo Kryeprokurori përkatës. Ndërkaq, Kryetarët e Gjykatave dhe Kryeprokurorët, duhet t'i kërkojnë aprovim paraprak KGJK-së apo KPK-së. Shqetësime ekzistojnë lidhur me faktin se vendimet lidhur me këto kërkesa, në përgjithësi, nuk rezultojnë të jenë të bazuara në një analizim të përshtatshëm për ushtrimin e aktivitetit për rastet konkrete. Tutje, ka raportime të shpeshta për disa gjyqtarë dhe prokurorë të cilët kryejnë një numër funksionesh jashtëgjyqësore nga të cilat kanë përfitim financiar - kjo madje jo vetëm nga buxheti i shtetit, por edhe nga donatorë të huaj, e me raste edhe nga

⁷⁷ Nenet 104 dhe 109 të Kushtetutes së Republikës së Kosovës.

organizata joqeveritare.⁷⁸ Rrjedhimisht, këto dukuri rrezikojë seriozisht pavarësinë dhe paanshmërinë e këtyre gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe potencialisht të shpien në konflikt të interesit.

Përfaqësues të sistemit prokurorial dhe gjyqësor bëjnë jo rrallëherë interpretim të zgjeruar të pavarësisë së sistemit të drejtësisë, duke çuar kështu në **ngecje në llogaridhënie**, edhe pse me rregullativën kushtetuese dhe ligjore parashihet detyrimi i tillë.

Ngecje ka në llogaridhënien brenda sistemit, si dhe në llogaridhënien e jashtme. Këto ngecje evidentohen sidomos në kuptimin kualitativ të llogaridhënies. Përbrenda gjyqësorit dhe prokurorive, problemet me llogaridhënien konsiderohet se shtrihen në dy aspekte: 1) sa i përket raportit në mes të gjyqtarëve, respektivisht, prokurorëve me Këshillat përkatës, dhe 2) raportin ndërmjet prokurorëve dhe gjyqtarëve në pozita drejtuese me Këshillat përkatës.⁷⁹

Më mirë nuk qëndron as llogaridhënia në raport me publikun, ku ndër vite është raportuar për vështirësi në qasje të informatave si dhe për raporte vjetore me të dhëna jo gjithëpërfshirëse dhe të fragmentuara, megjithëse ka pasur progres periudhën e fundit.⁸⁰ Duke qenë se puna e gjykatave dhe prokurorive ka qenë vazhdimisht vështirë e qasshme për publikun, kështu që edhe puna e mirë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ka mbetur larg syrit të publikut.

2. Problem tjetër në kuadër të zbatimit jo adekuat të legjislacionit aktual është edhe **vlerësimi i performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve**. Me rregullativën ligjore ndër vite është punuar për krijimin e mekanizmave dhe procedurave adekuate për kryerjen e vlerësimeve të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Megjithatë, organizatat e shoqërisë civile vërejnë se rregulloret e këtilla janë ndryshuar vazhdimisht. Sipas tyre, përveç se këto ndryshime nuk kanë siguruar cilësi, ky ndryshim i shpreshtë deri në një masë ka cenuar edhe sigurinë juridike të subjekteve të cilat i nënshtrohet vlerësimit të performancës.⁸¹ Po ashtu, në praktikë, gjatë gjithë kohës raportohet dukuria e vlerësimit “shabllon” të performancës, si dhe mungesa e masave të ndërmarra si përgjigje për mungesën e së njëjtës. Në vitin 2018, 94% të prokurorëve dhe 100% të gjyqtarëve me mandate të përhershme janë vlerësuar me

⁷⁸ Dokumenti i politikave “Përmirësimi i llogaridhënies së sistemeve gjyqësore dhe prokuroriale”, Rishikimi Funkcional i Sundimit të Ligjit të Kosovës (qershor 2019).

⁷⁹ Kjo pjesë do të elaborohet më tutje

⁸⁰ Shih: Dokumenti i politikave “Përmirësimi i llogaridhënies së sistemeve gjyqësore dhe prokuroriale”, fq. 38.

⁸¹ Komentet e IKD-së nga Konsultimi Publik, fq. 6.

“mirë” ose “shumë mirë” dhe asnjë prej tyre nuk është vlerësuar me “pamjaftueshëm”⁸². Ngjashëm me këtë, në vitin 2019, 95% e prokurorëve dhe 99% e gjyqtarëve me mandate të përhershme u vlerësuan “mirë” ose “shumë mirë” dhe asnjë nuk u vlerësua me “pamjaftueshëm”⁸³. Këto shifra në pamje të parë krijojnë iluzionin se sistemi është duke funksionuar në mënyrë pothuajse perfekte, pa vonesa, pa ndikime, me profesionalizëm të nivelit të lartë, mirëpo kur shqyrtohen raportet ndërkombëtare dhe ato të shoqërisë civile, vërehet se shifrat e lartpërmendura nuk përkojnë me realitetin.

Si rrjedhojë e këtyre shifrave, janë paraqitur vështirësi edhe me rastin e avancimit të gjyqtarëve, respektivisht, prokurorëve. Për shkak të vlerësimit kryesisht identik të performancës së tyre, është vështirësuar përzgjedhja e kandidatit më profesional⁸⁴. Për shkak të kësaj, sipas organizatave të shoqërisë civile, edhe manipulimet eventuale me rastin e avancimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve është vështirë të provohen, për arsye se pothuajse të gjithë kandidatët kanë nivel të njëjtë të aftësive formale dhe ky fakt rritë edhe potencialin për arbitraritet me rastin e avancimeve të gjyqtarëve apo prokurorëve.⁸⁵ Për më tepër, ngecjet në vlerësimin e performancës krijojnë perceptimin e amnistimit të gabimeve të gjyqtarët dhe prokurorët e caktuar dhe potencialisht, i bën të njëjtit komod përballë ndikimit dhe joprofesionalizmit. Njëkohësisht, me këto ngecje dhe parregullsi në vlerësim të performancës, nuk arrihet të vlerësohet si duhet e drejtë as performanca e atyre gjyqtarëve dhe prokurorëve që bëjnë punë të mirë. Tani për tani, të dy Këshillat kanë miratuar rregullore të reja të matjes së performancës për gjyqtarë dhe prokurorë, të cilat fokusohen më shumë në kritere cilësore. Situatë e ngjashme është edhe me vlerësimin e performancës së nëpunësve civil në pozita të larta.

3. Raportohet po ashtu për **mosfunksionim të rregullt të mekanizmave të disiplinimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve**. Ndonëse legjislacioni vendor parasheh një numër sanksionesh që mund të shqiptohen nga KGJK/KPK, sanksionet disiplinore të shqiptuara deri më tani vlerësohet se kanë qenë joproporcionale përballë shkallës së keqpërdorimeve apo sjelljeve të pahijshme të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në këtë drejtim, organizatat e shoqërisë civile shprehin se shpesh kanë kërkuar incimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve dhe gjyqtarëve për

⁸² Raporti i Progresit për Kosovën, 2019, fq. 17.

⁸³ Raporti i Progresit për Kosovën, 2020, fq. 20.

⁸⁴ Intervistë me Kryetarin e Gjykatës së Apelit, më 18.11.2019, realizuar nga projekti i Ambasadës Britanike për Fuqizimin e Drejtësisë, cituar në Dokumentin e Politikave për Integritetin.

⁸⁵ Komentet e IKD-së nga Konsultimi Publik, fq. 5.

shkelje disiplinore, por që rrallëherë janë marrë masa.⁸⁶ Edhe në ato raste kur janë adresuar pretendimet për shkelje, sipas shoqërisë civile, masat kanë qenë të lehta, si: sanksione lidhur me pagën, tërheqje e vërejtjes, e të ngjashme.⁸⁷ Megjithatë, Këshillat nuk pajtohen me konstatimin e tillë. Sipas KPK, deri në vitin 2021 ky Këshill ka shqiptuar masa disiplinore ndaj më shumë se 20% të prokurorëve, madje gjatë viteve të fundit janë marrë edhe vendime për dërgim në trajnim të detyrueshëm.⁸⁸ Ndonëse është për tu mirëpritur fakti që Këshillat kanë filluar shqiptimin e masave adekuata ndaj shkeljeve dhe performancës së dobët, shqetësimi mbetet që nuk ka mekanizma dhe procedurë të caktuar për t'i zbatuar këto masa.⁸⁹ Sipas Akademisë së Drejtësisë, asnjë nga gjyqtarët që ju janë shqiptuar masa e trajnimit, nuk i është nënshtruar të njëjtit.⁹⁰

Efektet

Problematika e shtjelluar në kuadër të këtij Koncept Dokumenti ka pasur si pasojë paraqitjen e **një numër efektesh negative** në shoqërinë kosovare. Tre janë ato më thelbësore:

1. Fillimisht, gjendja e tanishme me gjykatat dhe prokurorinë e shtetit, si dhe sistemin e drejtësisë në përgjithësi, ka për rrjedhojë humbjen e besimit të qytetarëve në drejtësi, dëshmuar me matjet e realizuara ndër vite e me rezultate të pandryshuara. Sigurisht se në sistemin e drejtësisë ka gjyqtarë e prokurorë të denjë dhe me integritet të lartë. Përkundër kësaj, situata e përgjithshme ka sjellë si efekt humbjen e besimit qytetar, duke e lënë kështu në hije punën e mirë të këtyre gjyqtarëve dhe prokurorëve
2. Përtej humbjes së besimit në drejtësi, si pasojë paraqitet edhe shkelja e të drejtave të njeriut. Janë raportuar ndër vite raste të shumta të parashkrimit të lëndëve dhe shkeljet e afateve ligjore të qëllimshme nga ana e profesionalistëve brenda sistemit. Dukuri si këto me të cilat përballet qytetari i cenojnë atij, ndër të tjerash, të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me Kushtetutë dhe me të drejtën ndërkombëtare.
3. Së fundi, mungesa e integritetit në sistemin e drejtësisë ndikon negativisht edhe zhvillim ekonomik dhe shoqëror të Kosovës. Kjo qoftë me mungesën e investimeve

⁸⁶ Shkëputur nga Puntoria për hartimin e Koncept Dokumentit për zhvillimin e procesit të vetingut në sistemin e drejtësisë, më 02-04.06.2021.

⁸⁷ Po aty.

⁸⁸ Marrë nga të dhënat e siguruar nga KPK për qëllimet e këtij Koncept Dokumenti, më 09.06.2021.

⁸⁹ Shkëputur nga Puntoria për hartimin e Koncept Dokumentit.

⁹⁰ Po aty.

nga jashtë, të cilat kërkojnë si parakusht një sistem të drejtësisë së qëndrueshme dhe të drejtë, ashtu edhe stagnimi në rrugëtimin e Kosovës drejtë integrimi euroatlantike.

Kjo problematikë e shtjelluar më lartë ndërlidhet në mënyrë horizontale me institucione dhe kategori shoqërore të ndryshme. Si rrjedhojë, janë identifikuar palët e interesuara, të paraqitura në figurën 4 në vijim. Aty gjithashtu shtjellohet se me cilat shkaqe apo efekte janë prekur këto palë interesi dhe në çfarë mënyre.

Figura 6: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit

Emri i palës së interesuar	Shkakut-qet me të cilat është e lidhur pala	Efektet me të cilat është e lidhur pala	Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet)
Ministria e Drejtësisë	- Mangësitë ligjore.	- Ngecje në zhvillim ekonomik dhe shoqëror; - Humbje e besimit të qytetarëve në drejtësi.	Hartues i politikave mbi të cilat funksionon sistemi i drejtësisë në Kosovë.
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	- Mangësitë ligjore; - Zbatimi jo adekuat i legjislacionit në fuqi.	- Shkelja e të drejtave të njeriut; - Ngecje në zhvillim ekonomik dhe shoqëror; - Humbje e besimit të qytetarëve në drejtësi.	Organ shtetëror që duhet të sigurojë pavarësinë, profesionalizmin dhe paanshmërinë e sistemit gjyqësor.

<p>Këshilli Prokurorial Kosovës</p>	<p>- Mangësitë ligjore; - Zbatimi jo adekuat i legjislacionit në fuqi.</p>	<p>- Shkelja e të drejtave të njeriut; - Ngecje në zhvillim ekonomik dhe shoqëror; - Humbje e besimit të qytetarëve në drejtësi.</p>	<p>Organ shtetëror që duhet të siguroj pavarësinë, profesionalizmin dhe paanshmërinë e sistemit prokurorial.</p>
<p>Prokurori Shtetit</p>	<p>- Mangësitë ligjore; - Zbatimi jo adekuat i legjislacionit në fuqi.</p>	<p>- Shkelja e të drejtave të njeriut; - Ngecje në zhvillim ekonomik dhe shoqëror; - Humbje e besimit të qytetarëve në drejtësi.</p>	<p>Institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale sikurse është rregulluar me ligj.</p>
<p>Gjykatat</p>	<p>- Mangësitë ligjore; - Zbatimi jo adekuat i legjislacionit në fuqi.</p>	<p>- Shkelja e të drejtave të njeriut; - Ngecje në zhvillim ekonomik dhe shoqëror; - Humbje e besimit të qytetarëve në drejtësi.</p>	<p>Njësi organizative që duhet të ushtrojnë pushtetin gjyqësor në vend në mënyrë të pavarur, të drejtë, apolitike dhe të paanshëm.</p>
<p>AKK</p>	<p>- Mangësitë ligjore;</p>	<p>- Shkelja e të drejtave të njeriut;</p>	<p>Organ shtetëror që duhet të mbikëqyr</p>

	- Zbatimi i legjislacionit në fuqi.	jo i në	- Ngecje në zhvillim ekonomik dhe shoqëror; - Humbje e besimit të qytetarëve në drejtësi.	pasuritë e zyrtarëve të lartë publik dhe personave të tjerë, siç parashihet me ligj të veçantë.
OSHC-të	- Mangësitë ligjore; - Zbatimi i legjislacionit në fuqi.	jo i në		OSHC-të monitorojnë hartimin dhe zbatimin e legjislacionit.
Qytetarët			- Shkelja e të drejtave të njeriut; - Ngecje në zhvillim ekonomik dhe shoqëror; - Humbje e besimit të qytetarëve në drejtësi.	Qytetarët pësojnë si rezultat i ngecjeve në sistemin e drejtësisë.

Analiza e gjendjes faktike e shtjelluar në kapitullin "Problemi kryesor", identifikon si problem kryesor profesionalizmi dhe integriteti i gjyqtarëve, prokurorëve dhe nëpunësve civil në pozita të larta në sistemin e drejtësisë. Ky problem serioz dhe kronik është identifikuar në vazhdimësi gjithashtu edhe nga raportet ndërkombëtare, përfshirë Raportet e Vendit të KE-së dhe gjithashtu, nga një sërë raportesh të shoqërisë civile. Këto raporte argumentojnë gjendjen alarmante në sistemin e drejtësisë, e që si e tillë, nuk ka mundur të adresohet me mekanizma të rregullt.

Analiza e zhvilluar vjen në përfundim se shkaqe të këtij problemi janë mangësitë ligjore por edhe zbatimi jo adekuat i legjislacionit në fuqi. Sipas kësaj analize të detajuar, janë identifikuar po ashtu tri efekte kryesore: humbja e besimit të qytetarëve në drejtësi, shkelja e të drejtave të njeriut dhe ndikimi negativ edhe në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Kosovës.

Pikërisht duke u shërbyer me praktikatat e vendeve tjera dhe standardet ndërkombëtare të trajtuara në Koncept Dokument, është arritur te përfundimi se arritja e qëllimit - e që është rritja e integritetit të sistemit të drejtësisë dhe kthimi i besimit qytetar në sistemin e drejtësisë, arrihet vetëm e vetëm përmes zhvillimit të vetingut dhe vlerësimit të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë në sistemin e drejtësisë. Siç shtjellohet në Opsionin 1 dhe 2, përvoja ka dëshmuar se çfarëdo përpjekje tjetër ndër vite, ka dështuar të ofrojë zgjidhje të plotë dhe ka ofruar rezultate të pakënaqshme, gjysmake dhe jo të qëndrueshme. Prandaj, vetingu dhe vlerësimi i vazhdueshëm i frymëzuar nga vetingu është vlerësuar të jetë mënyra e vetme për arritjen e rezultateve të plota dhe të qëndrueshme.

Sqarimet lidhur me termin "veting"

Njëra nga pikat që shpien në paqartësi në lidhje me përmbajtjen e vetingut janë pikërisht keqkuptimet e termit "veting" (në gjuhën angleze "*vetting*") dhe ngatërrimi i tij me shumë procese të tjera të ngjashme.

Për fillim, duhet theksuar se në gjuhën shqipe mungon një term i barasvlershëm me termin "*vetting*" në gjuhën angleze. Ky term tashmë është shqipëruar në termin "veting" që përmendet shpesh në diskursin publik. Megjithatë, diskutimet e zhvilluara në Ministrinë e Drejtësisë dhe brenda grupit punues, tregojnë se ka një larmi mendimesh mbi termin dhe

përmbajtjen e tij. Prandaj, për qëllime të këtij dokumenti, është e rëndësishme që të bëhet një sqarim i përmbajtjes së këtyre termeve dhe proceseve të ndryshme⁹¹.

Kontrollet e të së kaluarës (*background checks*), të kryera para vetingut ose kontrollit të integritetit, bëhen për ta konfirmuar identitetin dhe konstatuar besueshmërinë dhe integritetin e personit. Ato duhet ta verifikojnë identitetin e subjektit, historikun e punësimit, të drejtën e punës në vend dhe të ekspozojnë ndonjë ndëshkim eventual penal të pavuajtur. Kontrollet e tilla kryhen gati nga të gjithë punonjësit dhe janë një parakusht i nevojshëm për proceset më rigorozë të verifikimit. Kur është e nevojshme, kontrollet e integritetit apo vetingu, përfshijnë një sërë verifikimesh shtesë, përfshirë gjendjen financiare dhe çfarëdo rreziku të cenueshmërisë që shfaqet për shkak të familjes dhe bashkëpunëtorëve. Kontrollet duhet të synohen të jenë në mënyrë proporcionale me vlerësimin e asaj nëse një individ është përfshirë në korrupsion në të kaluarën, aktualisht është i përfshirë në korrupsion, ose me gjasë do të përfshihet në të ardhmen në korrupsion dhe rreziku që ata mund ta paraqesin gjatë kryerjes së detyrave të tyre si rrjedhojë e kësaj përfshirje të tyre në këto afera korruptive.

Vlerësimet e performancës dallojnë nga vetingu apo kontrolli i integritetit. Vetingu dhe kontrollet e së kaluarës synojnë adresimin e integritetit dhe cenueshmërive, ndërsa vlerësimet adresojnë kompetencën dhe potencialin. Implikimet e proceseve janë të ndryshme: dështimi i një procesi të verifikimit mund të rezultojë që një kandidat jo kompetent të mos emërohet në një pozitë, mos t'i jepet qasje në materialin e ndjeshëm, ose të mos largohet nga pozita që e mban. Në anën tjetër, pasoja e performancës së dobët në një vlerësim paraqet mos zhvillimin adekuat profesional në karrierë.

Shpesh kombinohen proceset për kontrollin e integritetit dhe hetimet penale ose administrative. Kontrolli i integritetit dhe hetimi penal iu shërbejnë qëllimeve të ndryshme dhe kanë karakteristika të ndryshme procedurale dhe ligjore. Një hetim bazohet në nevojën për konstatimin nëse diçka ka ndodhur, ndërsa verifikimet e integritetit shikojnë rrezikun ose gjasën që diçka do të ndodh në të ardhmen. Në mënyrë kritike, barra e provës dhe standardi i provës shpesh do të jenë të ndryshme. Në juridiksionet që zbatojnë të drejtën zakonore, hetimet penale kërkojnë që të konstatojnë provën përtej dyshimit të bazuar ku barra bie mbi shtetin. Në një sistem të vetingut dhe kontrollit të integritetit, mund të jetë tërësisht legjitime të mos vendoset barra mbi shtetin, por në subjektin që i nënshtrohet vetingut - gjyqtarin apo prokurorin që synon ose mban atë pozitë. Standardi i provës shpesh mund të përmbushet në bilancin e gjasave.

⁹¹ Sqarimet e termeve në vijim janë adaptuar nga Dokumenti i Politikave mbi Integritetin, të përpiluar në kuadër të procesit të Rishikimit Funkcional mbi Sektorin e Sundimit të Ligjit. Citimet e mëtejshme janë eliminuar.

Procesi i rekrutimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve dëshmon për një ngatërrim të këtyre termeve dhe proceseve. Para se të ftohen në intervistë kandidatët që e kanë kaluar testin me shkrim, ata i nënshtrohen vlerësimit të integritetit personal dhe aftësive profesionale. Rezultatet e këtij vlerësimi, të shprehura në numra apo pikë, pastaj llogariten kumulativisht në kuadër të rezultatit të përgjithshëm të intervistës. Ky proces duket të jetë një përzierje e kontrollit të kaluarës, e që duhet të jetë pjesë e procesit të verifikimit të ndërmarrë vetëm pas përfundimit të procesit të rekrutimit apo miratimit të përzgjedhjes në parim, bazuar në cilësitë, aftësitë dhe shkathtësitë e kandidatit.

Marrë parasysh që kontrollet e duhura të së kaluarës në fazën e duhur për emërimin e gjyqtarëve janë një hap thelbësor në luftën kundër korrupsionit, **është shumë me rëndësi që këto dy vlerësime të ndryshme të ndahen njëra nga tjetra**. Kontrollet e të së kaluarës nuk duhet të jenë pjesë e procesit të vlerësimit të aftësisë së kandidatit që të jetë gjyqtar, por duhet të trajtohen veçmas dhe në një mënyrë sistematike dhe më rigorozë.

Vetingu, si formë e kontrollit të integritetit, vlerëson rrezikun ndaj një objekti të përcaktuar dhe parametrat operacional të përcaktuar nga vetë ky objektivi. Në këtë dokument, ky rrezik trajtohet nga perspektiva e përmirësimit të transparencës, integritetit dhe përgjegjshmërisë së sistemit gjyqësor e prokurorial të Kosovës, së bashku me besimin që qytetarët kanë në të. Hulumtimi për këtë koncept dokument tregon që rreziku i cili kërkohet të mënjanohet është ndjeshmëria e një individi ndaj korrupsionit. Të gjitha proceset që vijnë, pra, duhet të synojnë të vlerësojnë besueshmërinë, integritetin dhe kredibilitetin e anëtarëve të sistemit gjyqësor e prokurorial.

Qëllimi i vetingut sipas kësaj politike nuk është ndëshkimi sipas dispozitave të Kodit Penal, në përputhje me procedurën dhe masat mbrojtëse të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, apo njollosja ose hakmarrja ndaj anëtarëve të sistemit të drejtësisë. Përkundrazi, qëllimi në fakt është mbrojtja e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe anëtarëve tjerë me integritet në sistemin e drejtësisë nga ndikimet dhe sigurimi i mundësisë për ta që të marrin vendime të drejta dhe të bazuara në ligj.

1.4. Standardet relevante ndërkombëtare

Për qëllime të hartimit të këtij Koncept Dokumenti janë konsultuar një varg instrumentesh ndërkombëtare, duke nisur nga instrumente multilaterale me karakter detyrues, e deri tek instrumente tjera të ligjit të butë dhe dokumente relevante, të hartuara e sponsorizuara nga OKB-ja, agjencitë e specializuara të OKB-së dhe Këshilli i Evropës.

Përgjithësisht, vërehet se gurë-themeli i mbarë kësaj kornize, vihet nga konventat kyçe për mbrojtjen dhe garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Instrumentet e ligjit të butë përkthejnë parimet e këtyre konventave – si dhe zotimet e detyrimet që shtetet anëtare kanë ndërmarrë përkitazi me to, në veprime konkrete. Këto instrumente japin udhëzime të përgjithshme mbi atë se si do të duhej të duket një sistem gjyqësor dhe prokurorial i pavarur, si parakusht themelor për sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut në një vend.

Krahas statusit si standarde ndërkombëtare, disa prej instrumenteve të shtjelluara më poshtë kanë edhe efekt të drejtpërdrejtë juridik në sistemin juridik të Kosovës, përkitazi me nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.⁹²

1.4.1 Instrumentet multilaterale dhe rajonale me karakter detyrues

Gurë-themeli i rregullativës ndërkombëtare lidhur me të drejtat dhe liritë njerëzore, është vendosur nga, ndër tjerash, nga Karta e Kombeve të Bashkuara, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Në **Kartën e Kombeve të Bashkuara**⁹³, afirmohet përkushtimi për krijimin e kushteve që garantojnë drejtësi dhe si një nga qëllimet, proklamohet bashkëpunimi ndërkombëtar në promovimin dhe nxitjen e respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, pa dallim race, gjinie, gjuhe apo feje.

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut⁹⁴ përcakton në nenin 10 se secili ka të drejtën për gjykim të drejtë dhe publik para një gjykate të paanshme e të pavarur që do të vendosë për të drejtat dhe detyrimet e tij dhe për çdo akuze penale kundër tij.

Sa i përket të drejtës në gjykim të drejtë, **Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike**⁹⁵ saktëson “garancitë” që duhet t’i ofrohen secilit në një procedurë penale, përfshirë prezumimin e pafajësisë, informimin lidhur me natyrën dhe shkakun e akuzës, ofrimin e kohës së mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen, të drejtën për t’u mbrojtur vetë ose nga përfaqësuesi i autorizuar, mbrojtjen nga vetë-inkriminimi, të drejtën e apelimit dhe

⁹² Përkitazi me nenin 22 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me, ndër tjerash, Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

⁹³ <https://treaties.un.org/doc/publication/ctc/uncharter.pdf>

⁹⁴ <https://www.un.org/en/about-us/universal-declaration-of-human-rights>

⁹⁵ <https://treaties.un.org/doc/publication/unts/volume%20999/volume-999-i-14668-english.pdf>

shqyrtimit të çështjes nga një gjykatë e instancës më të lartë dhe të drejtën e rehabilitimit gjyqësor.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁹⁶ obligon garantimin e të drejtës në gjykim të drejtë, të drejtën në privatësi dhe jetë familjare, si dhe të drejtën e ushtrimit të lirë të profesionit. Këto të drejta njihen edhe sipas Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut. Kushtetuta e Republikës së Kosovës gjithashtu parasheh që të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, interpretohen në harmoni me jurisprudencën e Strasburgut.⁹⁷

Kjo Konventë në nenin 6 parasheh të drejtën për një proces të rregullt, sipas së cilës çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për themelësinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

Në paragrafin e dytë të këtij neni vendoset edhe parimi i prezumimit të pafajësisë. Tutje, në paragrafin e 3 të këtij neni garantohen disa të drejta minimale për çdo person të akuzuar për vepër penale, e që përfshijnë: informimin brenda një afati sa më të shkurtër në gjuhën që e kupton, t'i jepet koha për përgatitjen e mbrojtjes, të mbrohet vetë ose nga një mbrojtës të zgjedhur prej tij ose t'i ofrohet ndihmë juridike falas, të kërkojë të merren në pyetje dëshmitarët, dhe të ketë përkthyes pa pagesë nëse nuk e kupton gjuhën që përdoret në gjyq.

Tutje, sipas nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, garantohet e drejta e secilit për respektimin e jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, në përjashtim të rasteve kur kjo parashihet me ligj dhe është e nevojshme, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.

⁹⁶ https://www.echr.coe.int/documents/convention_eng.pdf

⁹⁷ Neni 53, Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian⁹⁸ përcakton liritë dhe të drejtat më të rëndësishme personale në Bashkimin Evropian. Karta renditet si burim primar i së drejtës së BE-së dhe është një dokument i detyrueshëm për shtetet anëtare.

Në kapitullin që përcakton liritë, ky instrument në nenin 7 normon respektimin e jetës private dhe familjare, ndërsa në nenin 8 mbrojtjen e të dhënave personave. Sipas nenit 8, paragrafi 2, përcaktohet se të dhënat personale të një subjekti duhet të procedohen në mënyrë të drejtë, për qëllime të caktuara dhe mbi bazën e pranimit të personit në fjalë ose mbi bazën tjetër legjitime të vendosur me ligj.

Në nenin 47 të kësaj Karte parashihet e drejta për zgjidhje ligjore të efektshme dhe gjykim të drejtë, e drejtë kjo e cila mundëson që kujtdo që iu janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara nga e drejta e Unionit, ka të drejtën për gjykim të drejtë dhe publik brenda një afati kohor të arsyeshëm para një gjykate të pavarur dhe të paanshme të krijuar me ligj. Çdokujt i jepet mundësia që të këshillohet, të mbrohet dhe të përfaqësohet. Ndërkaq, për persona që nuk kanë burime të mjaftueshme, do t'u garantohet e drejta për ndihmë juridike falas deri në masën që kërkohet për të siguruar mundësi të efektshme përdorimi të sistemit të drejtësisë.

Nga sa u shtjellua më sipër, katalogu i të drejtave dhe lirive të garantuara për secilin, përfshirë këtu edhe gjyqtarët dhe prokurorët si objekt vetingu, duhet të merren parasysh me shumë kujdes përgjatë secilës fazë të dizajnit dhe më pas zbatimit të reformës së vetingut. Përvoja me vetingun në shtetet tjera është ilustruesi më i mirë i asaj që procesi i vetingut pashmangshëm prek, cenon e edhe kufizon liritë dhe të drejtat e parapara me instrumente ndërkombëtare. Çështja e vendosjes së baraspeshës në mes të arritjes së qëllimeve të vetingut si interes i përgjithshëm në një anë dhe mos shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut, paraqitet si shumë kritike.

1.4.2 Instrumentet ndërkombëtare të ligjit të butë

1. Parimet Themelore të OKB-së për Pavarësinë e Gjyqësorit⁹⁹

Parimet Themelore të OKB-së për Pavarësinë e Gjyqësorit, të vitit 1985, janë hartuar me qëllim që shteteve anëtare të OKB-së t'u lehtësohet zbatimi i të drejtave dhe parimeve themelore sipas Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe Pakteve. Parakusht qenësor për këtë është konsideruar sigurimi dhe promovimi i pavarësisë së gjyqësorit. Ky instrument përcakton parimet themelore për pavarësinë e gjyqësorit në këto kategori: (1)

⁹⁸ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:12012P/TXT&from=EN>

⁹⁹ <https://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/IndependenceJudiciary.aspx>

pavarësinë e gjyqësorit, (2) lirinë e shprehjes dhe të asociimit, (3) kualifikimet, përzgjedhjen dhe trajnimin, (4) kushtet e shërbimit dhe mandatin, (5) sekretin profesional dhe imunitetin, si dhe (6) disiplinimin, suspendimin dhe largimin.

Në kreun mbi parimin e pavarësisë së gjyqësorit, përmendet se secili duhet të ketë të drejtën të gjykohet nga gjykatat ose tribunalet e rregullta, sipas procedurave të vendosura me ligj. Kompetenca lëndore e gjykatave ose tribunaleve të rregullta nuk duhet të zhvendoset tek tribunalet që nuk veprojnë sipas procedurave të vendosura me ligj.

Sipas parimit të lirisë së shprehjes dhe asociimit, anëtarët e gjyqësorit, sikurse qytetarët tjerë, kanë të drejtën e lirisë së shprehjes, besimit dhe asociimit, me kusht që përgjatë ushtrimit të këtyre të drejtave, gjyqtari sillet në atë mënyrë që të ruajë dinjitetin e institucionit dhe pavarësinë dhe paanësinë e gjyqësorit.

Sa i përket çështjes së mandatit, sipas Parimeve Themelore të OKB-së për Pavarësinë e Gjyqësorit, gjyqtarëve duhet t'iu garantohen kohëzgjatja e mandatit deri në arritjen e moshës së pensionimit, ose deri në skadimin e kohëzgjatjes së paracaktuar të mandatit.

Sipas kapitullit mbi disiplinën, suspendimin dhe largimin, përcaktohet se gjyqtari duhet të ketë të drejtën në gjykim të drejtë përgjatë zhvillimit të procedurave që për objekt kanë shqyrtimin e aftësive të tij gjyqësore dhe profesionale. Procedurat e këtilla duhet të mbahen konfidenciale në fazat fillestare, përveç nëse gjyqtari kërkon ndryshe. Gjyqtarët mund të suspendohen ose largohen nga detyra vetëm për arsye të paaftësisë ose sjelljes që i bën të papërshtatshëm për ushtrimin e profesionit të gjyqtarit.

2. Udhëzuesi i OKB-së për Rolin e Prokurorëve¹⁰⁰

Ky instrument është hartuar nga Kongresi i tetë i Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e Krimit, mbajtur në Kubë nga 27 gushti deri më 7 shtator të vitit 1990. Është hartuar mbi bazamentin e vënë nga Karta e OKB-së dhe Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut.

Ky instrument parasheh se për ushtrimin e detyrës së prokurorit, personi duhet të ketë integritet, aftësi dhe trajnimin dhe kualifikimet e nevojshme. Si agjentë esenciale të administrimit të drejtësisë, prokurorët duhet që gjatë gjithë kohës të ruajnë nderin dhe dinjitetin e profesionit.

¹⁰⁰ <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/roleofprosecutors.aspx>

Prokurorët, sikurse edhe qytetarët tjerë, kanë të drejtën e lirisë së shprehjes, besimit dhe asociimit. Sidoqoftë, gjatë ushtrimit të këtyre të drejtave, prokurorët duhet që në vazhdimësi të sillen në pajtim me ligjin dhe standardet e njohura etike të profesionit të tyre.

Në Kapitullin rreth procedurave disiplinore, Udhëzuesi i OKB-së për Rolin e Prokurorëve, i miratuar në vitin 1990, përcakton se shkeljet disiplinore të prokurorëve duhet të jenë të bazuara në ligj dhe rregullore të ligjshme dhe të zhvillohen sipas procedurave të duhura. Prokurorët duhet të kenë të drejtën në gjykim të drejtë dhe në ankesë. Procedurat disiplinore kundër prokurorëve duhet të garantojnë shqyrtim dhe vendimmarrje objektive.

3. Parimet Bangalore¹⁰¹ dhe Masat për Zbatimin e Parimeve Bangalore¹⁰²

Parimet Bangalore të vitit 2002 janë një instrument i ligjit të butë me pranueshmëri të gjerë ndërkombëtare, që vendosin gjashtë parimet bazike të sjelljes etike të gjyqtarëve. Gjashtë parimet që vendosin standardin e sjelljes së një gjyqtari janë: pavarësia, paanësia, integriteti, përshtatshmëria, barazia dhe kompetenca. Një gjyqtar duhet të paraqesë dhe të promovojë standardet më të larta të sjelljes gjyqësore, me qëllim të përforcimit të besimit qytetar në gjyqësor. Sipas parimit të integritetit, në Udhëzuesin mbi Masat për Zbatimin e Parimeve Bangalore, përcaktohen disa kritere për procedurat disiplinore ndaj gjyqtarëve në përgjithësi dhe njëkohësisht me interes për procedurën e vetingut, që paraqet njëfarë forme të procedurës disiplinore.

Në Udhëzuesin e përmendur përcaktohet që çdo gjyqësor duhet të themelojë një të ashtuquajtur komitet kredibil dhe të pavarur të etikës që do të hulumtojë, zgjidhë dhe të vendosë lidhur me ankesat për sjellje jo etike të gjyqtarëve. Ky trup duhet të përbëhet nga një shumicë e gjyqtarëve, por preferohet të përfshijë edhe përfaqësues laikë.

Sa i përket kualifikimeve për të qenë gjyqtarë, përcaktohet që vlerësimi i një kandidati të bëhet mbi bazën e aftësive, integritetit dhe shkollimit e kualifikimeve nga fusha e drejtësisë. Në bërjen e këtij vlerësimi duhet të merren parasysh edhe vetëdija dhe ndjeshmëria shoqërore dhe cilësitë tjera personale të kandidatit, të tilla si sensi i etikës, durueshmëria, mirësjellja, sinqeriteti, gjakftohtësia, përulësia, përpikshmëria dhe aftësitë e komunikimit. Bindjet politike dhe fetare të personit nuk duhet të merren parasysh vetëm deri në atë masë që do të ndërhyjnë në ushtrimin e detyrave si gjyqtar.

¹⁰¹https://www.unodc.org/ji/resdb/data/2006/_220_/the_bangalore_principles_of_judicial_conduct_eco_soc_resolution_200623.html?lng=en

¹⁰²https://www.unodc.org/ji/resdb/data/2006/_220_/the_bangalore_principles_of_judicial_conduct_eco_soc_resolution_200623.html?lng=en

Sa i përket emërimit të gjyqtarëve, si masa ta zbatimit të Parimeve Bangalore parashihet se dispozitat për emërimin e gjyqtarëve duhet të përcaktohet me ligj. Anëtarët e gjyqësorit dhe anëtarët e komunitetit duhet ta luajnë rolin e tyre përkatës në përzgjedhjen e kandidatëve të përshtatshëm për pozitë gjyqësore. Parashihet që aty ku një këshill ose komisioni i pavarur krijohet për emërimin e gjyqtarëve, anëtarët e tij duhet të përzgjidhen në bazë të kompetencës, ekspertizës, kuptimit të jetës gjyqësore, kapacitetit për diskutim të duhur dhe vlerësim të rëndësisë së kulturës së pavarësisë. Anëtarët e tij jo gjyqtar mund të përzgjidhen nga mes i juristëve të dalluar ose qytetarët me reputacion dhe përvojë të njohur të përzgjedhur nga mekanizmi i duhur i emërimit.

Në përputhje me Parimet Bangalore, gjyqtarëve duhet t'u garantohet mandat deri në pensionim ose të përcaktohet paraprakisht dhe saktësisht kohëzgjatja e mandatit. Gjyqtari mund të përjashtohet nga detyra vetëm në rast të humbjes së aftësisë së veprimit, kryerjes së veprës së rëndë penale, jo kompetencës së shkallës së lartë ose sjelljes që është në kundërshtim me pavarësinë, paanësinë dhe integritetin e gjyqësorit.

Si masë tjetër për zbatimin e Parimeve Bangalore theksohet gjithashtu se procedurat disiplinore kundër një gjyqtari duhet të iniciohen vetëm në raste të rënda të sjelljes së keqe. Ligji i zbatueshëm duhet të precizojë sa më qartë të jetë e mundur rrethanat, sjelljen që çon deri te sanksionet disiplinore, si dhe procedurën që duhet ndjekur për shqiptimin e këtyre sanksioneve. Kompetenca për të shqiptuar masa disiplinore duhet t'i njihet një autoriteti ose tribunali të pavarur nga legjislativi dhe ekzekutivi. Ky autoritet ose tribunal duhet të ketë në përbërje gjithashtu persona që nuk janë gjyqtarë dhe as pjesë e pushtetit legjislativ ose ekzekutiv. Gjyqtari duhet të ketë mundësinë që të apelojë autoritetin disiplinor pranë një gjykate.

1.4.3 Instrumentet rajonale – evropiane të ligjit të butë

4. Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës CM / Rec (2010) 12, "Gjyqtarët: Pavarësia, Efikasiteti dhe Përgjegjësitë"¹⁰³

Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës në vitin 2010 ka miratuar një Rekomandim për pavarësinë, efikasitetin dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve, duke vendosur kështu disa standard të punës së gjyqtarëve. Një ndër këto parime, shtjellohet në paragrafin e tretë të Rekomandimit dhe sqaron se qëllimi i pavarësisë së gjyqësorit, ashtu siç përcaktohet me Konventën Evropiane (neni 6), është të garantojë që çdo individ të ketë të drejtat themelore

¹⁰³ <https://rm.coe.int/cmrec-2010-12-on-independence-efficiency-responsibilites-of-judges/16809f007d>

që rasti i tyre të vendoset në një gjykim të drejtë, mbi baza ligjore dhe pa ndonjë ndikim të panevojshëm.

Ndërkaq, një parim tjetër i këtij rekomandimi jepet në pikën 11 dhe i referohet pavarësisë së jashtme. Sipas këtij paragrafi, pavarësia e jashtme e gjyqtarëve, nuk është një prerogative ose privilegj i garantuar për interes të gjyqtarëve, por është për interesin e sundimit të ligjit dhe qytetarëve që kërkojnë dhe presin drejtësi të paanshme. Thënë kjo, sipas pikës 19, procedurat gjyqësore dhe çështjet e administrimit të gjyqësorit janë çështje të interesit publik, ndërsa sipas pikës 20, gjyqtarët, si pjesë e shoqërisë, nuk mund të administrojnë drejtësinë në mënyrë efektive në rast se nuk e kanë besimin qytetar. Ata duhet të njoftohen me pritjet e shoqërisë nga sistemi gjyqësor dhe pakënaqësitë rreth funksionimit të tij. Prandaj, pavarësia e gjyqtarëve duhet të shihet si garanci e lirisë, respektit për të drejtat e njeriut dhe zbatimit të paanshëm të ligjit.

Në Kapitullin VI që trajton statusin e gjyqtarëve, nga paragrafi 44 e tutje, listohen disa nga garancitë themelore për statusin e gjyqtarëve. Në mesin e tyre, dokumenti rekomandon që vendimet mbi zgjedhjen dhe karrierën e gjyqtarëve të merren mbi kritere objektive, të përcaktuara me ligj dhe nga autoritetet kompetente. Këto vendime duhet të merren nga institucione që janë të pavarura nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ. Me qëllim të garantimit të pavarësisë së tij, të paktën gjysma e anëtarëve të këtij autoriteti duhet të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga kolegët e tyre (*“peers”*). Megjithatë, nëse vendimet duhen të merren nga një pushtet tjetër, siç mund të jetë kreu i shtetit, pika 47 e dokumentit kërkon që rekomandimi për një vendim të tillë duhet të vijë nga “një trup i përbërë në pjesën substanciale nga gjyqësori”.

Tutje, pika 49 përcakton se siguria e kohëzgjatjes së mandatit dhe pamundësia e largimit nga detyra janë elemente kyçe të pavarësisë së gjyqtarëve. Sipas pikës 50, rekomandohet që mandati i përhershëm mund të shkëputet vetëm për shkak të shkeljeve serioze të natyrës disiplinore apo penale, të qartësuara me ligj, apo kur gjyqtari nuk mund të kryej funksionet gjyqësore.

Gjithashtu, kur diskutohet për vlerësimin e gjyqtarëve, ky rekomandim thotë se vlerësimet e tilla duhen bërë bazuar në kritere objektive, duke ua mundësuar gjyqtarëve të shprehin pikëpamjen e tyre si dhe të kenë mundësi që të sfidojnë këto vlerësime para një autoriteti apo gjykate të pavarur. Këtu përcaktohen tri elemente shumë të rëndësishme:

- Interpretimi i ligjit, vlerësim i fakteve dhe peshimi i provave nga një gjyqtar përgjatë shqyrtimit të rasteve, nuk duhet të jetë bazë për përgjegjësinë administrative ose

disiplinore, përveç rasteve të keqdashjes dhe neglizhencës së madhe, e as bazë për përgjegjësinë penale, përveç rasteve të keqdashjes (pika 66 dhe 68);

- Procedurat disiplinore mund të iniciohen në rast se gjyqtari nuk ka ushtruar detyrat në mënyrë efikase dhe të përshtatshme. Këto procedura duhet të zhvillohen nga një autoritet i pavarur ose gjykatë, me të gjitha garancitë e një gjykimi të drejtë dhe të mundësojnë të drejtën e gjyqtarit për të ankimuar vendimin dhe sanksionin. Sanksionet disiplinore duhet të jenë proporcionale (pika 69);
- Gjyqtarët nuk duhet të mbahen **personalisht përgjegjës** në rast se vendimet gjyqësore u prishen, ndryshohen ose apelohehen (pika 70).

5. Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës CM / Rec (2000) 19, "Roli i Prokurorisë Publike në Sistemin e Drejtësisë Penale"¹⁰⁴

Këshilli i Evropës nëpërmjet organit të Komitetit të Ministrave, në vitin 2000 ka miratuar Rekomandimin në lidhje me Rolin e Prokurorisë Publike në Sistemin e Drejtësisë Penale. Parimet e rekomanduara përfshijnë fushën e funksionit të prokurorisë publike në sistemin juridik. Rekomandimi përkufizon nocionin e prokurorisë publike, përgjegjësitë dhe detyrave të prokurorisë publike, masave mbrojtëse për prokurorët publikë për kryerjen e funksioneve të tyre.

Ky rekomandim përcakton që shtetet duhet të marrin masa për të siguruar që rekrutimi, ngritja në detyrë dhe transferimi i prokurorëve publik, të kryhen në përputhje me rrethanat dhe duke ndjekur procedura të drejta dhe të paanshme, që përmbajnë masa mbrojtëse kundër çdo qasjeje që favorizon interesat e grupeve specifike dhe diskriminimit në çdo bazë. Procedurat disiplinore kundër prokurorëve publikë duhet të jenë të rregulluara me ligj dhe duhet të garantojnë një vlerësim dhe vendim i drejtë dhe objektiv, i cili duhet t'i nënshtrohet pavarësisë dhe rishikimit të paanshëm. Përcaktohet se prokurorët publikë kanë qasje në procedura të ankesës, përfshirë ku është e nevojshme edhe ankesën përpara një Tribunali, në rast se preket statusi i tyre.

Po ashtu, Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës parasheh që shtetet të marrin masat e duhura për të siguruar që prokurorët publikë janë në gjendje kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre profesionale pa ndërhyrje të pajustificuar ose ndonjë ekspozim i pajustificuar ndaj përgjegjësisë civile, penale ose ndonjë përgjegjësie tjetër. Sidoqoftë, prokuroria publike duhet të raportojë në mënyrë periodike dhe publike për

¹⁰⁴ <https://rm.coe.int/16804be55a>

aktivitetet në tërësi dhe, në veçanti, mënyrën në të cilën hyjnë të cilat u kryen përparësitë e saj.

6. Opinioni Nr. 1 (2001) për Standardet rreth Pavarësisë së Gjyqësorit dhe Mospërfashtimit nga Detyra të Gjyqtarëve¹⁰⁵

Ky opinion është hartuar në vitin 2001 nga Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (CCJE) në bazë të përgjigjeve të Shteteve në një pyetësor, teksteve të përgatitura nga Partia e Punës e CCJE dhe teksteve të përgatitura nga Kryetari dhe Nënkryetari i CCJE dhe specialisti i CCJE për këtë temë. Qëllimi i këtij opinion ishte të identifikojë dhe adresojë në detaje problemet që ndërlidhen me pavarësinë e gjyqësorit.

Disa nga pikat kyçe që i adreson ky opinion janë: kauza e pavarësisë gjyqësore, emërimi dhe promovimi në detyrë i gjyqtarëve, organet e emërimit dhe këshillimit, mandati i gjyqtarëve dhe pavarësia brenda gjyqësorit. Këto çështje janë në këtë opinion janë trajtuar si në vijim:

Në pikën e 10 të këtij Opinioni, thuhet qartësisht se “pavarësia e gjyqësorit nuk është prerogativë apo privilegj në interes të gjyqtarëve, por në interes të sundimit të ligjit dhe atyre që kërkojnë dhe presin drejtësi”. Kjo nënkupton se gjyqësori duhet të jetë komplet i pavarur dhe objektiv. Gjyqtarët nuk duhet thjesht të jenë të lirë nga çdo lidhje, paragjykim ose ndikim i papërshtatshëm por edhe të perceptohen si të tillë nga një observues i pavarur – shoqëria si tërësi duhet të jetë në gjendje t’i besojë gjyqësorit. Pavarësia e gjyqësorit duhet të garantohet me aktin juridik më të lartë të një shteti, ashtu siç është përcaktuar edhe me parimet themelore të OKB në pavarësinë e gjyqësorit dhe Kartën Evropiane mbi Statutin e Gjyqtarëve.

Emërimi ose ngritja në detyrë duhet bazuar në kritere objektive. Këto kritere nënkuptojnë, që zgjedhja dhe karriera e gjyqtarëve të bazohet në merita, duke pasur parasysh kualifikimet, integritetin, aftësinë dhe efikasitetin. Këto kritere duhet të orientohet drejt objektivit të arritjes së barazisë gjinore në gjyqësor përmes parimeve udhëzuese.

Lidhur me organet e emërimit dhe këshillimit CCJE ka theksuar se veçanërisht tek demokracitë e reja, emërimi duhet të bëhet nga një autoritet i pavarur me përfaqësim të konsiderueshëm të gjyqësorit me anëtar të zgjedhur në mënyrë demokratike nga gjyqtarë të tjerë. Sipas pikës 45 të Opinioni, kjo është sidomos e rëndësishme për vendet që nuk kanë sisteme me traditë të dëshmuar demokratike. Në ato vende ku fillimisht zbatohet

¹⁰⁵ <https://www.coe.int/en/web/ccje/opinion-n-1-on-independence-of-judges-and-opinion-n-2-on-funding-of-courts>

emërimi i përkohshëm, është theksuar se organi përgjegjës për objektivitetin dhe transparencën e metodës së emërimit ose riemërimit si gjyqtar me kohë të plotë janë të një rëndësie të veçantë.

Mandati i përhershëm i gjyqtarëve ka rëndësi qenësore në pavarësinë e gjyqësorit, dhe paraprakisht duhet të përcaktohen standardet të cilat parashikojnë sjelljen që mund të rezultojë në shkarkim si dhe ato që mund të rezultojnë me shqiptimin masave disiplinore ndaj tyre. Kështu, sipas parimit të mos-largimit nga detyra në pikën 59 të Opinionit, përjashtimet nga ky parim, sidomos ato që për bazë kanë sanksionet disiplinore, çojnë tek diskutimi rreth trupit, metodës dhe bazës mbi të cilën gjyqtarët mund të disiplinohen. Sipas Rekomandimit Nr. R (94) 12, Parimi VI(2) dhe (3), duhet të ketë përcaktim preciz të shkeljeve që çojnë tek largimi i gjyqtarit dhe procedurat disiplinore duhet të jenë në përputhje me kërkesat e Konventës Evropiane për gjykim të drejtë.

Lidhur me pavarësinë brenda gjyqësorit, pikë esenciale është që gjyqtari është në kryerjen e funksionit të tij ose të saj, e jo si punonjës i ndokujt: gjyqtarët janë shërbyes të ligjit dhe i përgjigjen vetëm ligjit. Është e pakontestueshme që gjyqtarët nuk veprojnë sipas ndonjë urdhri apo udhëzimi brenda apo jashtë gjyqësorit, duke përjashtuar procedurën e apelimit të parashikuar me ligj (këtu nuk përfshihen amnistia e të ngjashme). Gjithashtu, pavarësia e çdo gjyqtari individual në kryerjen e funksioneve të tij ose të saj, duhet të ekzistojë pavarësisht nga hierarkia e brendshme e gjykatës.

Sa i përket pavarësisë së jashtme, sipas pikës 63 të Opinionit, mos ndikimi nga jashtë përbën një parim të përgjithshëm me pranueshmëri të gjerë. Megjithatë, pranohet se vështirësia qëndron në të vendosurit se çfarë përbën ndikim të papërshtatshëm nga jashtë dhe në vendosjen e baraspeshës në mes të, për shembull, nevojës për mbrojtjen e procesit gjyqësor nga ndikimi dhe presioni, qoftë politik, nga mediat apo tjetër, dhe interesit për një diskutim të hapur të çështjeve në interes publik dhe shtypit të lirë, në anën tjetër. Gjyqtarët duhet të pranojnë se janë figura publike dhe nuk duhet të jenë shumë të ndjeshëm apo fragjilë. Tutje, gjyqtarët nuk duhet të jenë të detyruar t'i raportojnë meritat e çështjeve të tyre askujt jashtë gjyqësorit. "Raportimi" mbi meritat e çështjeve, madje edhe anëtarëve të tjerë të gjyqësorit, duket se është në kundërshtim me pavarësinë individuale.

Fuqia hierarkike e dhënë në shumë sisteme ligjore për gjykatat superiore në praktikë mund të minojë pavarësinë individuale të gjyqësorit. Një zgjidhje do të ishte transferimi i të gjitha kompetencave përkatëse në një Këshill të Lartë Gjyqësor, i cili më pas do të mbronte pavarësinë brenda dhe jashtë gjyqësorit. Kjo e kthen përsëri rekomandimin e Kartës Evropiane mbi statutin për gjyqtarët, për të cilin vëmendja tashmë është ftuar nën titullin e Organeve të emërimit dhe këshillimit.

Në frymën e asaj që është paraqitur më sipër, sistemet e inspektimit gjyqësor, në vendet ku ato ekzistojnë, nuk duhet të merren me meritat ose korrektësinë e vendimeve. CCJE theksoi se, përdorimi i të dhënave statistikore dhe sistemeve të inspektimit gjyqësor nuk shërbejnë për të paragjykuar pavarësinë e gjyqtarëve

7. Opinioni Nr. 17 (2014) për Vlerësimin e Punës së Gjyqtarëve, Cilësisë së Drejtësisë dhe Respektimin e Pavarësisë Gjyqësore¹⁰⁶

Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë më 2014 ka hartuar këtë opinion, përmes të cilit adreson pavarësinë gjyqësore, ku paraqet mënyrat për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të sistemeve gjyqësore përmes vlerësimit individual. Në këtë Opinion, shprehja "vlerësimi individual i gjyqtarëve", përfshin vlerësimin e punës profesionale të gjyqtarëve individualë dhe aftësive të tyre dhe përfshinë vetëm gjyqtarët në detyrë.

Në pikën 5 të këtij dokumenti theksohet se pavarësia e gjyqësorit është një parakusht për ruajtjen e sundimit të ligjit dhe garancia themelore e një gjykimi të drejtë. Rreth çështjes se pse ekzistojnë lloje të ndryshme të vlerësimit, në pikën 21 dhe 23 të këtij Opinioni përmendet se kjo kushtëzohet nga dy faktorë:

- Struktura gjyqësore e një vendi: Vendimi nëse dhe, nëse po, si të vlerësohen gjyqtarët është i lidhur pazgjidhshmërisht me mënyrën në të cilën kanë evoluar strukturat gjyqësore të shteteve të ndryshme anëtare.
- Kultura e vendit në fjalë: Vendimi nëse dhe si të vlerësohen gjyqtarët është gjithashtu i lidhur me historinë dhe kulturën e një vendi dhe ato të sistemit të tij ligjor.

Në pikën 29, thuhet se edhe pse shkeljet e rregullave/standardeve etike dhe profesionale mund të konsiderohen në procesin e vlerësimit, shtetet anëtare duhet të dallojnë qartë midis masave dhe proceseve vlerësuese dhe disiplinore. Parimet e sigurisë së qëndrimit në detyrë dhe të mos-largimit janë elemente kyçe dhe të pranuar të pavarësisë së gjyqësorit dhe duhet të respektohen. Prandaj, një emërim i përhershëm nuk duhet të ndërpritet thjesht për shkak të një vlerësimi të pafavorshëm. Duhet të ndërpritet vetëm në një rast të shkeljeve të rënda të dispozitave disiplinore ose penale të përcaktuara me ligj, ose kur përfundimi i pashmangshëm i procesit të vlerësimit është se gjyqtari është i paaftë apo nuk ka dëshirë për të kryer detyrat e tij/saj gjyqësore me një standard minimal të pranueshëm,

¹⁰⁶ <https://rm.coe.int/16807481ea>

të gjykuar objektivisht. Në të gjitha rastet duhet të ketë masa mbrojtëse të përshtatshme procedurale për gjyqtarin që vlerësohet dhe këto duhet të respektohen me përpikëri.

Kur zbatohet një sistem i vlerësimit formal individual, baza e tij dhe elementet kryesore (kriteret, procedura, pasojat e vlerësimit) duhet të përcaktohen në mënyrë të qartë dhe të plotë nga legjislacioni primar. Detajet mund të rregullohen në akte nënligjore. Vlerësimi formal individual i gjykatësve duhet të bazohet në kritere objektive të publikuara nga autoriteti kompetent gjyqësor. Këto standarde duhet të bazohen në meritë, duke pasur parasysh kualifikimet, integritetin, aftësinë dhe efikasitetin.

Kriteret për vlerësimin e performancës profesionale të gjyqtarëve duhet të jenë gjithëpërfshirëse, dhe duhet të përfshijnë treguesit sasiorë dhe cilësorë, në mënyrë që të lejohet një vlerësim i plotë dhe i thellë i performancës profesionale të gjyqtarëve. Pavarësisht faktit se efikasiteti i punës së një gjyqtari mund të jetë një faktor i rëndësishëm për vlerësimin, CCJE konsideron se mbështetja tërësisht në numrin e çështjeve që një gjyqtar ka vendosur është problematike, sepse ajo mund të çojë në stimuj të rremë.

Për të vlerësuar cilësinë e vendimit të gjyqtarit, vlerësuesit duhet të përqendrohen në metodologjinë që aplikon një gjyqtar në punën e tij/saj të përgjithshme, në vend se të vlerësojnë meritat ligjore të vendimeve individuale. Këto të fundit duhet të përcaktohen vetëm nga procesi i apelimit. Mirëpo, edhe kjo është problematike për vlerësim krejtësisht real përveç nëse numri dhe mënyra e përmbyesjes demonstroi qartë se gjyqtari nuk ka njohuritë e nevojshme të ligjit dhe procedurës.

Gjyqtari i vlerësuar duhet të informohet se kush janë vlerësuesit dhe në rast të shkaqeve për përjashtimin e vlerësuesit duhet të ketë të drejtë të kërkojë zëvendësimin e tij. Sipas pikës 37 të Opinionit, me qëllim të mbrojtjes së pavarësisë gjyqësore, vlerësimi duhet të ndërmerret kryesisht nga gjyqtarët. Këshillat Gjyqësore (aty ku ekzistojnë) mund të kryejnë këtë funksion. Megjithatë, mund të përdoren mjete të tjera të vlerësimit, për shembull, nga anëtarët e gjyqësorit të emëruar apo të zgjedhur nga gjyqtarët e tjerë. Duhet të shmangët vlerësimi nga Ministria e Drejtësisë ose organe të tjera të jashtme dhe të njëjtat nuk duhet të jenë në gjendje të ndikojnë në procesin e vlerësimit.

Burimet e informacionit të përdorura në procesin e vlerësimit duhet të jenë të besueshme dhe të mjaftueshme. Kjo vlen sidomos në rastet e vlerësimit negativ. Gjyqtari i vlerësuar duhet të ketë qasje të menjëhershme në secilën provë që synohet të përdoret në një vlerësim kundër tij, në mënyrë që të mund ta kundërshtojë nëse është e nevojshme.

Vlerësimi individual i gjyqtarëve dhe i gjykatës në tërësi duhet të bëhen ndaras. Megjithatë, faktet e zbuluara gjatë kontrollit gjyqësor mund të merren parasysh edhe në vlerësimin individual të gjyqtarit. Vlerësimet e rregullta lejojnë përfitim të një pasqyre të plotë të performancës së një gjyqtari. Megjithatë, ato nuk duhet të kryhen shumë shpesh, në mënyrë që të shmangët një përshtypje e mbikëqyrjes së vazhdueshme, e cila për shkak të natyrës së saj mund të rrezikojë pavarësinë e gjyqësorit.

Gjyqtarit duhet t'i mundësohet të paraqesë kundërshtime gjatë procedurës së vlerësimit dhe ndaj vendimit pranë një autoriteti të pavarur ose një gjykate. Prandaj, gjyqtari i vlerësuar duhet të ketë mundësinë për të kontribuar në procesin e vlerësimit në një mënyrë që është e dobishme, për shembull duke komentuar mbi draftin paraprak ose duke u dëgjuar në procesin e vlerësimit. Gjyqtari i vlerësuar duhet të ketë një të drejtë efektive për ta kundërshtuar një vlerësim të pafavorshëm, veçanërisht kur ai prek "të drejtat civile" e gjyqtarit në kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Sa më serioze të jenë pasojat e një vlerësimi për një gjyqtar, aq më të rëndësishme janë këto të drejta të shqyrtimit efektiv.

CCJE nuk përkrah rezultate të vlerësimit vetëm përmes pikëve, shifrave, përqindjeve ose numrave të vendimeve të marra. Të gjitha këto metoda, nëse përdoren pa shpjegim dhe vlerësim të mëtejshëm, mund të krijojnë një përshtypje të rreme të objektivitetit dhe sigurisë.

Si përfundim, duhet të ekzistojë një ekuilibër në mes të parimit të pavarësisë së gjyqësorit me procesin e vlerësimit të gjyqtarëve. Mjetet për arritjen e këtij ekuilibri përfshijnë:

1. Duhet të ketë rregulla të qarta dhe transparente në lidhje me procedurën, kriteret dhe pasojat e vlerësimit.
2. Gjyqtari i vlerësuar duhet të ketë të drejtën të dëgjohet në proces, dhe ta kundërshtojë një vlerësim të pakënaqshëm, duke përfshirë edhe të drejtën e qasjes së menjëhershme në materiale që lidhen me vlerësimin.
3. Vlerësimi nuk duhet të bazohet vetëm në numrin e çështjeve të vendosura, por duhet të fokusohet kryesisht në cilësinë e vendimeve të një gjyqtari dhe gjithashtu punën e tij/saj gjyqësore të përgjithshme.
4. Disa pasoja, të tilla si shkarkimi nga detyra për shkak të një vlerësimi negativ, duhet të shmangen për të gjithë gjyqtarët që kanë marrë mandatin e detyrës, përveç në rrethana të jashtëzakonshme. Në rast të mos balancimit mes këtyre, pavarësia e gjyqësorit ka përparësi.

Vëmendje meriton pika 46, ku thuhet se pajtimi i parimit të pavarësisë së gjyqësorit me cilindo proces të vlerësimit individual të gjyqtarëve është i vështirë. Por ekuilibri i saktë

është i një rëndësie vendimtare. Në fund të fundit, pavarësia e gjyqësorit duhet të mbizotërojë në të gjitha kohët. Kështu, sipas këtij Opinioni, procesi dhe rezultatet e vlerësimeve individuale duhet, në parim, të mbeten konfidenciale dhe nuk duhet të bëhen publike. Në të kundërtën, mund të rrezikohet pavarësia e gjyqësorit, për shkak se publikimi mund ta diskreditojë gjyqtarin në sytë e publikut. Po ashtu, publikimi mund të sjellë sulme verbale ose të tjera ndaj gjyqtarit.

8. Opinioni Nr. 13 (2018) "Pavarësia, Përgjegjësia dhe Etika e Prokurorëve"[14]¹⁰⁷

Duke pasuar Rekomandimin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës (2000)¹⁹, "Roli i Prokurorisë Publike në Sistemin e Drejtësisë Penale", Këshilli Konsultativ i Prokurorëve Evropianë i cili është një organ konsultativ për Komitetin e Ministrave të Këshillit të Evropës, nxori opinion mbi pavarësinë, përgjegjësinë dhe etikën e prokurorëve.

Sipas pikës 23 të këtij Opinioni, misioni i prokurorit është kërkues dhe i vështirë, prandaj nevojitet profesionalizëm, karakter, guxim, baraspeshë dhe përkushtim. Të pasurit e këtyre cilësive duhet të jetë kriter përcaktues në rekrutimin e prokurorëve dhe përgjatë karrierës së tyre . Megjithatë, këto kërkesa personale nuk janë të mjaftueshme për të siguruar pavarësinë e prokurorëve. Statusi dhe pavarësia e prokurorëve duhet të jenë qartë të vendosura dhe të garantuara me ligj.

Si një mjet për të siguruar pavarësinë e prokurorëve, duhet të krijohen mekanizma të qartë në lidhje me fillimin e ndjekjes ose procedimeve disiplinore kundër prokurorëve. Për shembull, ekziston një procedurë e veçantë e vendosur me ligj në disa shtete anëtare të Këshillit të Evropës që mundëson fillimin e procedurave për vepra administrative ose penale të pretenduara të kryera nga prokurorët.

Megjithëse të pavarur, prokurorët janë të përgjegjshëm dhe duhet të raportojnë, brenda hierarkisë, tek palët dhe në veçanti tek viktimat, tek autoritetet gjyqësore dhe zyrtare dhe organe të tjera publike, tek shoqëria civile dhe tek mediat. Ata duhet të shpjegojnë veprimet e tyre ose të sigurojnë informacion për publikun në një mënyrë proaktive, veçanërisht në rastet që kërkojnë vëmendje dhe shqetësim të publikut. Informacioni mund të marrë formën e një raporti vjetor (të përgjithshëm ose për një aspekt të veçantë të krimit brenda juridiksionit të tyre), dhe të përmbajë shpjegimin e shkaqeve të një dështimi ose gabimi në procedurë ose thjesht t'i referohet fazës aktuale të një hetimi ose një procedure.

¹⁰⁷<https://rm.coe.int/opinion-13-ccpe-2018-2e-independence-accountability-and-ethics-of-pros/1680907e9d>

Në pikën 47 që i referohet llogaridhënies së prokurorëve, thuhet se kur është e nevojshme, prokurorët janë objekt i procedurave disiplinore që duhet të bazohen në ligj, në rast të shkeljes serioze të detyrës (neglizhencës, mosrespektimit të sekretit të detyrës, rregullave të kundër-korrupsionit etj.), për arsye të qarta dhe të përcaktuara. Procedurat duhet të jenë transparente dhe të zbatojnë kritere të vendosura, të zhvillohen përpara një trupi të pavarur nga ekzekutivi. Prokurorët në fjalë duhet të dëgjohen dhe t'iu lejohet mbrojtja, të mbrohen nga ndikimet politike, si dhe të kenë mundësinë e ushtrimit të së drejtës së ankesës përpara një gjykate. Çfarëdo sanksioni duhet të jetë i nevojshëm, i përshtatshëm dhe proporcional me shkeljen disiplinore. Sipas pikës 48, përveç nëse është gjetur se kanë kryer shkelje disiplinore ose kanë dështuar në kryerjen si duhet të punës së tyre, prokurorët sikurse edhe gjyqtarët, nuk duhet të mbahen personalisht përgjegjës për përzgjedhjen e formës së veprimit që ka rrjedhur nga një analizë personale intelektuale dhe ligjore.

Në seksionin e përgjegjësisë, Opinioni i Këshillit Konsultativ thotë se në mënyrë që të promovojë besimin e publikut, prokurorët duhet të jenë të pavarur, por gjithashtu të ndjehen të përgjegjshëm. Kjo përgjegjësi duhet të ushtrohet në respektimin e të drejtave dhe lirive individuale, përfshirë prezumimin e pafajësisë dhe mbrojtjen e privatësisë. Udhëzime dhe kode të etikës dhe sjelljes profesionale të publikuara dhe azhurnuara rregullisht, do të ndihmonin në promovimin e transparencës, qëndrueshmërisë, llogaridhënies dhe drejtësisë. Duhet të qartësohet se përgjegjësia e prokurorëve nuk ka për qëllim të ndërhyjë në pavarësinë e tyre.

Në përfundim, sipas kapitullit mbi Etikën e prokurorëve, në pikën 51 përcaktohet se respektimi i sundimit të ligjit kërkon që prokurorët si dhe gjyqtarët, të sillen sipas standardit më të lartë etik e profesional, gjatë dhe jashtë detyrës, në mënyrë që shoqëria të ketë besim në drejtësi. Prokurorët veprojnë në emër të njerëzve dhe interesit publik. Prandaj, ata duhet që gjithmonë të ruajnë integritetin personal dhe të veprojnë në përputhje me ligjin, në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe objektive, duke respektuar dhe siguruar të drejtat dhe liritë themelore. Kanë detyrim të jenë të lirë nga ndikimet politike dhe tjera.

9. Magna Carta e Gjyqtarëve (2010): Parimet fundamentale¹⁰⁸

Me rastin e 10 vjetorit të tij në 2010, CCJE gjatë takimit plenar miratoi një Magna Carta të Gjyqtarëve (Parimet Themelore) që përmbledh dhe kodifikon përfundimet kryesore të Opinioneve që ajo tashmë ka miratuar, përfshirë ato që janë shtjelluar më sipër.

¹⁰⁸ <https://rm.coe.int/2010-ccje-magna-carta-anglais/168063e431>

Magna Carta përcakton parimet e përgjithshme për statusin e gjyqtarëve, pavarësisht juridiksionit e traditës juridike. Ndër tjerash, ky dokument përgjithësisht përfshin parimet si sundimi i ligjit, pavarësia e gjyqësorit, pamundësinë e ndryshimit të pozitës së gjyqtarëve, garancitë e pavarësisë së gjyqësorit, autoriteti që garanton pavarësinë, qasja në drejtësi, etika dhe përgjegjësia e gjyqtarëve dhe gjykatat ndërkombëtare. Disa nga këto parime janë adresuar në vijim

Sa i përket pavarësisë së gjyqësorit, thuhet sërish se ajo duhet të jetë statusore, funksionale dhe financiare. Kjo duhet të garantohet në të gjitha aktivitetet gjyqësore, në veçanti gjatë rekrutimit, emërimit deri në moshën e daljes në pension, promovimit, trajnimit, imunitetit gjyqësor, disiplinës, pagesës dhe financimit të gjyqësorit.

Siç edhe është shprehur në Opinionet e mëparshme të CCJE, vendimet për përzgjedhjen, emërimin dhe karrierën duhet të bazohen në kritere objektive dhe ato duhet të merren nga organi përgjegjës për garantimin e pavarësisë. Procedurat disiplinore duhet të iniciohen para një organi të pavarur me mundësi të adresimit të tyre përpara një gjykate. Ky dokument vë theks tek dashja në rast të shkeljeve të detyrave nga ana e gjyqtarëve, ku thekson se gjyqtarët duhet të përgjigjen penalisht në rast të dështimeve të paqëllimshme në ushtrimin e funksioneve të tyre. Duhet të sigurohen sistemi i dyshkallshmërisë.

Tutje, përcaktohet se për të siguruar pavarësinë e gjyqtarëve, secili shtet do të krijojë një Këshill për Gjyqësorin ose një organ tjetër specifik, të pavarur nga pushteti legjislativ dhe ekzekutiv, i pajisur me kompetenca të gjera për të gjitha çështjet në lidhje me statusin e tyre, si dhe organizimin, funksionimin dhe imazhin e institucionet gjyqësore. Këshilli do të përbëhet nga ekskluzivisht nga gjyqtarë ose nga një shumicë e konsiderueshme e gjyqtarëve të zgjedhur nga kolegjet e tyre. Këshilli Gjyqësor është i përgjegjshëm për aktivitetet dhe vendimet e tij.

Karta parashikon pandryshueshmërinë e pozitës së gjyqtarëve, që do të thotë se një gjyqtar nuk mund të caktohet në një gjykatë tjetër ose të ndryshohen detyrat e tij ose të saj pa pëlqimin e tij ose të saj të lirë. Sidoqoftë, lejohen përjashtime kur transferimi përcaktohet brenda kornizës disiplinore, kur bëhet një riorganizim i ligjshëm i sistemit gjyqësor që përfshin për shembull mbylljen e një gjykate ose një transferim i përkohshëm kërkohet për të ndihmuar një gjykatë fqinje. Në rastin e fundit, kohëzgjatja e transferimit të përkohshëm duhet të kufizohet nga statuti përkatës.

Gjyqësori duhet të jetë i përfshirë në të gjitha vendimet të cilat ndikojnë në praktikën e funksioneve gjyqësore (organizimi i gjykatave, procedura, ligje të tjera). Theksohet rolin e

këshillit në gjyqësor sa i përket organizimin, funksionimin dhe imazhin e institucioneve gjyqësore

10. Memorandumi Shpjegues mbi Magna Carta për Statutin e Gjyqtarëve¹⁰⁹

Ky dokument thekson vlerën interpretuese të Kartës si më sipër. Tutje potencon se Karta nuk është qëllim në vetvete, por mjet përmes të cilit garantohen që individët të drejtat, e të cilave *ipso jure* mbrohen nga gjykatat, të kenë masat e nevojshme për një mbrojtje efektive. Parimet themelore për statusin e gjyqtarëve duhet të inkorporohen në kushtetuta. Pikat më relevante për procesin e vetingut të cilat i trajton memorandumi shpjegues janë: përgjegjësia e gjyqtarëve dhe përfundimi i mandatit.

Tek përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve, Karta fillon me një referencë në parimin e ligjshmërisë së sanksioneve disiplinore, duke përcaktuar se shkeljet dhe sanksionet disiplinore mund të përcaktohen vetëm me ligjin në vend që iu referohet gjyqtarëve, dhe asnjë sanksion nuk mund të shqiptohet nëse nuk është para parë me ligj. Lidhur me këtë, Karta përcakton masat siguroese për seancat disiplinore: sanksionet disiplinore mund të vendosen vetëm në bazë të një vendimi të marrë pas një propozimi ose rekomandimi ose me marrëveshjen e një gjykate ose autoriteti, të paktën gjysma e anëtarëve të të cilit duhet të zgjidhen gjyqtarë . Vendimet duhet të merren në seancë të plotë dëgjimore, ku gjyqtari duhet të ketë të drejtë përfaqësimi. Nëse shqiptohet sanksion, i njëjti duhet vendosur sipas parimit të proporcionalitetit.

Sa i përket ndërprerjes së punës, duhet që të listohen të gjitha shkaqet për këtë. Këto janë kur një gjyqtar jep dorëheqjen, është certifikuar nga pikëpamja mjekësore si i papërshtatshëm fizikisht për detyrë të mëtejshme gjyqësore, arrin kufirin e moshës, vjen në fund të një mandati të caktuar ose shkarkohet në kontekstin e përgjegjësisë disiplinore.

Së fundmi, Karta parashikon të drejtën e apelimit tek një autoritet më i lartë gjyqësor kundër çdo vendimi për vendosjen e një sanksioni të marrë nga një autoritet ekzekutiv, gjykatë ose organ, të paktën gjysma e anëtarësisë së të cilit zgjidhen gjyqtarë.

11. Rekomandimet e Kievit për Pavarësinë e Gjyqësorit në Evropën Lindore, Kaukazin Jugor dhe Azinë Qendrore¹¹⁰

Në korrik të vitit 2010 Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) së bashku me Institutin Max Planck për të Drejtën Publike Krahasimore

¹⁰⁹ <https://www.coe.int/en/web/ccje/ccje-opinions-and-magna-carta>

¹¹⁰ <https://www.osce.org/files/f/documents/a/3/73487.pdf>

dhe të Drejtën Ndërkombëtare (MPI) ka publikuar disa rekomandime që prekin tri tema veçanërisht të rëndësishme për pavarësinë gjyqësore. (1) Administrimi i gjyqësorit, duke u përqendruar tek këshillat gjyqësorë, organet gjyqësore vetëqeverisëse dhe rolin e kryetarëve të gjykatave; (2) Përzgjedhja e gjyqtarëve – kriteret dhe procedurat; dhe (3) Përgjegjshmëria e gjyqtarëve dhe pavarësia e gjyqësorit në gjykim.

Administrimi gjyqësor

Administrimi i gjykatave dhe i gjyqësorit duhet të rrisë gjykimin e paanshëm dhe të pavarur në përputhje me të drejtat për një proces të rregullt dhe shtetin e të drejtës. Administrimi gjyqësor nuk duhet përdorur asnjëherë për të ndikuar në përmbajtjen e vendimmarrjes gjyqësore. Procesi i administrimit gjyqësor duhet të jetë transparent. Administrimin gjyqësor duhet ta bëjë këshilli gjyqësor apo organe të ndryshme të pavarura kompetente për aspekte të caktuara të administrimit gjyqësor pa ushtruar mbi to kontroll nga një institut apo autoritet i vetëm. Përbërja e këtyre organeve duhet të reflektojë detyrat e tyre të përcaktuara. Puna e tyre duhet të rregullohet me ligj dhe jo me udhëzime ekzekutive.

- **Këshillat dhe përbërja e tyre**

Këshillat Gjyqësorë sipas Rekomandimeve të Kievit, janë trupa me detyra specifike për administrimin e gjyqësorit dhe kompetenca të pavarura, me qëllim të garantimit të pavarësisë së gjyqësorit.

Në përbërjen e Këshillit Gjyqësor duhet të ketë më shumë anëtar të gjykatave themelore se sa atyre të shkallës më të lartë. Anëtarët gjyqtarë të tij do të zgjidhen nga kolegët e tyre dhe do të përfaqësojnë gjyqësorin në shkallë të gjerë, duke përfshirë edhe gjyqtarë të shkallës së parë. Këshillat gjyqësorë nuk duhet të mbizotërohen nga gjyqtarë të gjykatës së apelit. Këshilli gjyqësor duhet të mblidhet rregullisht në mënyrë që t'i përmbushë detyrat e tij. Mundësia e publikut për të qenë i pranishëm në diskutimet e këshillit gjyqësor dhe publikimi i vendimeve të tij duhet të garantohet në ligj dhe në praktikë.

Përzgjedhja e gjyqtarëve

Nëse nuk ka një organ të pavarur të ngarkuar me këtë detyrë, duhet të krijohet një komision i posaçëm specialistësh për të bërë provimet me shkrim dhe me gojë gjatë procesit të përzgjedhjes së gjyqtarëve. Në këtë rast kompetenca e këshillit gjyqësor duhet të kufizohet në verifikimin e kryerjes së procedurave të rregullta, dhe ose të emërojë kandidatët e përzgjedhur nga komisioni, ose t'ia rekomandojë ata autoritetit emërues.

Anëtarët e komisioneve të posaçme për përzgjedhjen gjyqësore duhet të emërohen nga këshilli gjyqësor nga radhët e profesionistëve të ligjit, duke përfshirë edhe anëtarë të gjyqësorit. Në rastet kur këshillat gjyqësorë, komisionet e kualifikimit apo kolegjet e kualifikimit janë drejtpërdrejt përgjegjës për përzgjedhjen e gjyqtarëve, anëtarët duhet të emërohen për afate të përcaktuara. Preferohet që në këtë përbërje përfshihen edhe grupe të tjera (profesorë të së drejtës, avokatë) duke marrë parasysh edhe kulturën dhe përvojën relevante ligjore.

Në rast se në saje të procesit të rekrutimit, bëhet kontroll i prapavijës (“background check”), duhet të bëhet me kujdesin më të madh dhe në mënyrë strikte mbi bazën e sundimit të ligjit. Autoriteti përzgjedhës mund të kërkojë një kontroll standard për të kaluarën penale dhe çfarëdo baza tjera diskualifikuese nga policia. Rezultatet e këtij kontrolli duhet t’i vihen në dispozicion aplikantit, i cili duhet të ketë mundësinë t’i apelojë gjetjet pranë një gjykate. Asnjë formë e kontrollit të prapavijës nuk duhet të bëhet nga shërbimet e sigurisë. Vendimi për refuzimin e një kandidati mbi bazën e kontrollit të prapavijës, duhet të arsyetohet.

Disiplina

Për të shmangur koncentrimin e tepërt të pushtetit në një trup gjyqësor dhe perceptime për “korporatizim”, rekomandohet që të bëhen dallime në mes të kompetencave të ndara dhe të ndryshme, të tilla si përzgjedhja, promovimi dhe trajnimi, disiplinimi, vlerësimi profesional dhe buxheti. Një opsion i mirë është që të themelohen trupa të pavarur me kompetencë për çështje specifike të administrimit të gjyqësorit, e që nuk janë objekt i kontrollit nga një institucion apo autoritet i vetëm. Përbërja e këtyre trupave duhet të reflektojë qëllimin e tyre të veçantë. Puna e tyre duhet të jetë e rregulluar me ligj dhe jo me dekret ekzekutiv.

Me qëllim të parandalimit të pretendimeve për korporatizim dhe garantimit të procedurave të drejta disiplinore, Këshillat Gjyqësorë nuk duhet të jenë kompetentë edhe për a) pranimin e ankesave dhe zhvillimin e hetimeve disiplinore, dhe në të njëjtën kohë b) të zhvillojnë shqyrtimin dhe të marrin vendim për masat disiplinore. Vendimet disiplinore duhet të jenë objekt i ankesës përpara gjykatës kompetente. Trupat kompetentë për të zhvilluar shqyrtimin në një rast disiplinor dhe për të marrë vendime rreth masave disiplinore, nuk duhet të jenë në përbërje ekskluzive të gjyqtarëve, por duhet të kenë përfaqësim edhe të anëtarëve jashtë profesionit gjyqësor. Çfarëdo lloj i kontrollit nga ekzekutivi mbi Këshillat Gjyqësorë ose trupat tjerë disiplinorë, duhet të shmanget. Për të siguruar një shqyrtim të pavarur dhe objektiv të ankesës, kryetarët e gjykatave nuk duhet të kenë autoritetin për të nisur apo për të miratuar një masë disiplinore.

Procedimet disiplinore ndaj gjyqtarëve duhet të trajtojnë rastet e akuzave për sjellje të keqe profesionale të cilat janë flagrante dhe të pajustificueshme dhe krijojnë një reputacion të keq për gjyqësorin. Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve nuk shtrihet tek përmbajtja e vendimeve të tyre, ku përfshihen edhe interpretimet e ndryshme ligjore ndërmjet gjykatave; ose tek rastet e gabimeve gjyqësore, apo kritikrat ndaj gjykatës.

Për gjykimin e rasteve të disiplinës gjyqësore duhet të ngrihet një organ i veçantë i pavarur. Organet të cilat vendosin për meritat e rastit duhet të veçohen nga ato të cilat i iniciojnë dhe hetojnë ato, si dhe në përbërje të tyre nuk mund të ketë anëtarë të përbashkët që ushtrojnë dy funksionet. Parimisht, seancat disiplinore për gjyqtarët duhet të jenë transparente: transparencja duhet të jetë rregulli i artë për shqyrtimet disiplinore të gjyqtarëve. Këto seanca do të jenë të hapura, me përjashtim të rasteve kur gjyqtari i akuzuar kërkon që të jenë të mbyllura. Në këtë rast vendos gjykata nëse kërkesa është e justifikuar. Vendimet që kanë të bëjnë me disiplinën gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara. Vendimet përfundimtare për masa disiplinore duhet të publikohen.

Kur zhvillohen vlerësime profesionale të gjyqtarëve, nuk duhet të përdoren për të dëmtuar gjykimin e pavarur. Vlerësimi i performancës së gjyqtarëve duhet të jetë së pari cilësor, me fokus në aftësitë, përfshirë:

- kompetencën profesionale (njohurinë e ligjit, aftësinë për të zhvilluar gjykime, kapacitetin për të shkruar vendime të arsyetuara);
- kompetencën personale (aftësinë për të menaxhuar ngarkesën në punë, aftësinë për vendimmarrje, hapjen ndaj teknologjisë së re);
- kompetencat sociale (aftësinë për të ndërmjetësuar, respektimin e palëve); dhe
- në rastin e avancimit në pozita administrative, kompetencën për të drejtuar (leadership).

Këto aftësi duhet të kultivohen përgjatë programeve të trajnimit gjyqësor, si dhe gjatë procesit të punës.

Edhe në këtë dokument përcaktohet se gjyqtarët nuk do të vlerësohen në asnjë rrethanë për përmbajtjen e vendimeve të tyre (qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet llogaritjes së numrit të vendimeve të kthyera). Mënyra se si e gjykon një gjyqtar çështjen nuk duhet të shërbejë asnjëherë si bazë për dënim. Statistikat për eficientësinë e veprimtarisë së gjykatës duhet të përdoren kryesisht për arsye administrative dhe duhet të shërbejnë vetëm si një nga faktorët për vlerësimin e gjyqtarëve. Kriteret për vlerësim profesional duhet të jenë të qarta, transparente dhe uniforme. Kriteret themelore duhet të vendosen me ligj. Kriteret

precize për vlerësimet periodike duhet të vendosen në rregullore të mëtejme, së bashku me planifikimin kohor dhe mekanizmat për bërjen e vlerësimit.

Krahas parimeve e rregullave të përgjithshme, Rekomandimet e Kievit trajtojnë edhe një çështje të ndërlidhur me kontekstin e rajonit që i referohen. Nën titullin “gjykimi i pavarur penal”, thuhet se “anshmëria akuzatore” e sistemeve të drejtësisë në shumicën e vendeve të Evropës Lindore, Kaukazit Jugor dhe Azisë Qendrore, duhet të adresohet. Aktgjykimet liruese vazhdojnë të merren si njollë e zezë apo dështim. Për të zvogëluar presionin tek gjyqtarët që të shmangin aktgjykimet liruese, rekomandohet fuqishëm një ndryshim në sistemin e vlerësimit të tyre profesional (ku është e përshtatshme, të konsiderohen edhe ndryshime në vlerësimin e prokurorëve dhe hetuesve gjithashtu). Numri i aktgjykimeve liruese nuk duhet të jetë kurrë indikator për vlerësimin e gjyqtarëve. Gjyqtarët duhet të ushtrojnë diskrecion real në shqyrtimin e kërkesave për lirim të parakohshëm. Shqyrtimi në shkallë të dytë i aktgjykimeve liruese duhet të kufizohet në rrethanat më të jashtëzakonshme.

1.4.4 Dokumente relevante me udhëzime për procesin e vetingut

12. “Mekanizmat për rregullimin e sundimit të ligjit në vendet post-konflikt: Vetingu: një kornizë operationale” nga UNHCR¹¹¹

Në vitin 2006 Zyra e Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (UNHCR) ka publikuar një udhëzues për vetingut si një mekanizëm për reforma gjyqësore për vendet e dala nga konflikti.

Udhëzimet që ky dokument ofron janë të natyrës operationale dhe vendosin vetingun në kontekstin e reformimit të gjerë të institucioneve publike si dhe propozojnë një kornizë për zhvillimin e një programi efektiv dhe legjitim të reformës së personelit në vendet në tranzicion. Ky dokument trajton dy llojet kryesore të proceseve kalimtare të reformës së personelit: rishikimi dhe riemërimi. Në procesin e rishikimit, nëpunësit kontrollohen për të përcaktuar përshtatshmërinë e tyre për shërbim të vazhdueshëm. Ndërsa, tek procesi i riemërimit, një institucion së pari shpërndahet, të gjithë punonjësit duhet të aplikojnë përsëri në një institucion të ri dhe ekziston një konkurs i përgjithshëm për të gjitha postet. Këto dy lloje korrespondojnë me dy qasje themelore të reformës institucionale: ristrukturimin institucional dhe rindërtimin institucional. Zgjedhja e llojit varet, në veçanti, nga shkalla e reformës së përgjithshme të personelit të kërkuar. Në fund të këtij seksioni, futet një lloj i tretë më pak i mundshëm: procedurat e rregullta disiplinore.

¹¹¹ <https://www.ohchr.org/Documents/Publications/RuleoflawVettingen.pdf>

Për qëllime të këtij koncept dokumenti do të trajtohet vetëm procesi i rishikimit të personelit me fokus në masat siguroese për mbrojtjen e subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi.

Procesi i rishikimit

Në një proces rishikimi, zakonisht krijohet një mekanizëm i veçantë kalimtar për të kontrolluar punonjësit publikë dhe për të përcaktuar përshtatshmërinë e tyre për shërbim të vazhdueshëm. Objektivi kryesor është shkarkimi i atyre që nuk janë të aftë për të mbajtur funksione publike.

Gjatë këtij procesi, zbatohen standardet themelore të procesit të rregullt dhe të drejtë.

Kriteret ligjore për procesin e rishikimit:

Subjektet që i nënshtrohen rishikimit duhet të gëzojnë të drejtat e një procesi të rregullt administrativ siç janë:

- e drejta për gjykim të drejtë;
- fillimi i procesit brenda një kohe të arsyeshme;
- njoftimi i palës që është nën hetime për procedurën kundër tyre;
- e drejta për tu mbrojtur, qasja në të dhënat relevante për proces;
- mundësia e kundërshtimit dhe provimit, e drejta për tu përfaqësuar nga mbrojtësi, dhe njoftimi i palës për vendimin e marrë dhe arsyetimin;
- e drejta e apelimit pranë një gjykate apo ndonjë trupi tjetër të pavarur;
- parimisht, barra e provës bie mbi komisionin.

Rishikimi duhet të jetë i individualizuar dhe përgjegjësia duhet të jetë personale. Ky proces duhet zhvilluar në përputhje me parimin e “barazisë së armëve”.

Ashtu si në procedurat administrative në përgjithësi, një standard i bilancit të probabiliteteve do të jetë standardi i duhur i provës në një proces shqyrtimi, për dallim nga standardi përtej dyshimit të arsyeshëm, që kërkohet në procedurat penale. Sipas këtij standardi, organi shqyrtues duhet të ndjekë versionin e ngjarjeve që duket më i arsyeshmi ose i mundshmi, pasi të marrë të vlerësoj të gjitha rrethanat, provat dhe faktet.

Në fund të procesit, personat të cilët e kalojnë procesin e vetingut me sukses certifikohen dhe pas kësaj i nënshtrohen vetëm procedurave të rregullta të vlerësimit.

13. Udhëzuesi i UNDP për dizajnimin e procesit të vetingut të figurave të larta publike në shoqëritë e pas-konfliktit¹¹²

Më 2004, UNDP publikoi një udhëzues me qëllim që t'iu ndihmojë shoqërive të dalin nga konflikti të dizajnojnë një proces vetingu të ushtruesve të funksioneve të larta publike. Udhëzuesi frymëzohet nga standardet ndërkombëtare dhe nga praktika e disa shteteve të pas-konfliktit. Më poshtë janë shkëputur disa elemente nga udhëzuesi që përkrijnë me kontekstin e vetingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke lënë anash, për aq sa që e mundur, elementet tipike që i referohen shoqërive të pas-konfliktit.

Rregulla e përgjithshme që duhen marrë parasysh në fillet e dizajnit të procesit

Për të dizajnuar një proces të vetingut, së pari duhet të sigurohen parakushtet themelore. Sipas Udhëzuesit të UNDP, të tilla janë:

1. *Kushtet politike: a ka autoritet dhe vullnet politik?*

Sa i përket kushteve politike, procesi i vetingut kërkon stabilitet, autoritet qeveritar real dhe vullnet politik. Prosesi i vetingut rregullon qasjen në pozita të pushtetit dhe si rrjedhojë, është ndërmarrje shumë politike. Individët që rrezikojnë të humbin pushtetin si pasojë e vetingut janë të prirur që të bëjnë rezistencë ndaj zbatimit të vetingut.

2. *Kushtet institucionale: cilat pozita publike do të jenë objekt i vetingut?*

Përkufizimi i qartë i pozitave që do të jenë objekt i vetingut është parakusht themelor. Për vetingun e gjyqtarëve duhet të bëhet kujdes sidomos rreth çështjes së pavarësisë së gjyqësorit dhe ndarjes së pushteteve. Gjithashtu, përmendet se vetingu i gjyqtarëve duhet të bëhet nga gjyqtarë të tjerë ("peers") dhe të zhvillohet përmes një komisioni gjyqësor të shqyrtimit të rregullt ose ad-hoc.

3. *Kushtet individuale: kush janë personat që do t'i nënshtrohen vetingut?*

Grupet e synuara duhet të jenë saktë të identifikuar përpara nisjes së procesit. Të dhënat rreth numrit të të punësuarve janë me vlerë për planifikimin realist dhe të mirë të procesit. Krahas identifikimit, duhet të dihet edhe baza e të dhënave të besueshme lidhur me çështjen e integritetit të personave që do të vetohen. Me qëllim të pasurimit të bazës së të dhënave, informatat duhet të merren në mënyrë pro-aktive, përmes një game burimesh. Burimet e të dhënave përfshijë: dosjet e personelit, të dhënat gjyqësore, raportet nga

¹¹² <https://www.ictj.org/sites/default/files/ICTJ-UNDP-Global-Vetting-Operational-Guidelines-2006-English.pdf>

shoqëria civile, raportet e mediave dhe raportet e pavarura hulumtuese. Dhënia e mundësisë publikut që të ofrojë informacion është po ashtu një mënyrë e mirë e sigurimit të informatave. Me kujdes për çështjet e sigurisë dhe privatësisë, një listë me emrat e personave që do të vetohen duhet të bëhet publike e të promovohet gjerë dhe të caktohet një pikë kontakti që pranon informata nga publiku.

4. *Kushtet ligjore: cili është mandati i vetingut?*

Baza e qartë ligjore është esenciale për dizajnimin e procesit të vetingut. Secili proces i vetingut do të kontestohet dhe do të ballafaqohet me rezistencë politike. Legjislacioni i brendshëm duhet të jetë i qartë, preciz dhe në përputhje me Kushtetutën dhe standardet ndërkombëtare.

5. *Kushtet operationale: a ekzistojnë resurset e përshtatshme?*

Suksesi apo dështimi i një procesi të vetingut shpesh varet nga analiza e mirë paraprake e nevojave institucionale dhe planifikimit të mirë të afateve dhe resurseve. Prosesi i vetingut është i ndërlikuar, që kërkon kohë dhe kuadro me aftësi multi-disiplinare.

6. *Kushtet kohore: çfarë është momentum?*

Përzgjedhja e momentumit për vetingut ngritë pyetje lidhur me sekuencimin dhe ndërlidhjen me procese të tjera tranzicionale – kjo sidomos e rëndësishme në kontekstin e shoqërive të sapodala nga konflikti. Momentumit kushtëzon vendimet strategjike të dizajnit të procesit, në kuptim të institucioneve apo grupit të targetuar, llojit të mekanizimit dhe përbërjes së komisionit të vetingut.

Këto elemente, Udhëzuesi i UNDP i përmbledh në formë të një “check-list”. Vetëm pasi të gjitha kutitë të jenë bërë “check (✓)”, mund të nisë dizajnimi i një procesi të suksesshëm vetingu.

Faktorët për t’u pasur në konsideratë përpara dizajnimin të procesit të vetingut (Vetting check-list):

- A ka nivel minimal të stabilitetit, autoritetit qeveritar dhe vullnetit politik?
- A janë definuar qartë pozitat që do t’i nënshtrohen vetingut?
- A janë identifikuar saktë personat që do të vetohen?
- A janë ndërmarrë masat e nevojshme të përkohshme me qëllim të daljes nga grupi i personave që do të vetohen?
- A ekziston bazë e të dhënave të besueshme për të vlerësuar integritetin e personave që do të vetohen? Nëse jo, si do të krijohet?

- A ekziston bazë e të dhënave të besueshme për të vlerësuar kompetencën e personave që do të vetohen? Nëse jo, si do të krijohet?
- Cili është mandati ligjor i procesit të vetingut?
- A nevojitet legjislacion i veçantë?
- A janë të disponueshme resurset e nevojshme njerëzore dhe materiale?
- A ka përkushtim ndërkombëtar për të mbështetur procesin e vetingut, si në aspektin politik, ashtu edhe në rrafshin operacional?

Gjithashtu, që nga momenti i dizajnit të procesit, duhet të merret parasysh shmangia e pasojave të padëshirueshme, të tilla si:

1. *Keqpërdorimi politik;*

Një proces vetingu mund të përdoret për qëllime partizane politike. Procese të këtilla mund të cenojnë në vend se të sigurojnë respektimin e të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit. Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut duhet të respektohen me përkushtim të plotë në mënyrë që të shmangët keqpërdorimi politik i procesit.

2. *Zbrazëtia në qeverisje;*

Largimi nga detyra i numrit të madh të personave, mund të pengojë funksionimin e institucionit dhe të sjell zbrazëti në qeverisje. Një proces vetingu do të duhet të zbatohet në faza dhe nevoja për zëvendësime duhet të identifikohet në mënyrë pro-aktive për të shmangur zbrazëtitë e mundshme.

3. *Destabilizimi*

Zyrtarët e larguar që nuk gjejnë punësim tjetër dhe nuk integrohen në shoqëri, mund t'i kthehen krimit dhe të jenë faktorë destabiliteti. Efektet e mundshme destabilizuese të largimit duhet të llogariten paraprakisht me rastin e dizajnit të procesit të vetingut dhe duhet të konsiderohen mundësitë e ofrimit të asistencës së përkohshme këtyre personave.

Pra, në formë të përmbledhur, një tjetër “check-list” me pasojat e padëshirueshme që duhet shmangur:

- A ka rrezik të keqpërdorimit politik të procesit? Nëse po, si mund të shmangët?
- A ka rrezik të zbrazëtirës në qeverisje? Nëse po, si mund të shmangët?
- A ka rrezik të destabilizimit si pasojë e procesit? Nëse po, si mund të shmangët?

Llojet e vetingut

Udhëzuesi përshkruan disa lloje të vetingut. Lloji më i përshtatshëm i vetingut duhet të zgjidhet varësisht nga institucioni që vetohet.

1. *Vetingu i të gjitha apo disa pozitive*

Përgjithësisht, mund të dëshirohet një proces vetingu ndaj të gjitha pozitive publike, me qëllim që të gjithë funksionarët publikë të kenë të përmbushura standardet minimale të integritetit. Për arsye praktike dhe operacionale, është e arsyeshme që t'i jepet përparësi vetingut të pozitive të larta drejtuese.

2. *Rishikimi apo riemërimi i zyrtarëve në detyrë*

Përgjatë procesit të rishikimit, themelohet një mekanizëm i veçantë i "screening", me qëllim të largimit të atyre që janë të papërshtatshëm për ushtrimin e detyrës. Në këtë procedurë vlejné standardet themelore të procesit të drejtë, barrën e provës e ka trupi që bën rishikimin dhe baraspeshimi i probabilitetit do të jetë standardi i duhur i të provuarit. Një mënyrë e tillë do të duhej të konsiderohej në rastet kur trupat e rregullt disiplinor dhe të emërimit do të tej ngarkoheshin apo nuk janë në dispozicion dhe kur është nevoja për një reformë më të gjerë. Vetingu i policisë në Bosnje ishte i modeluar sipas këtij lloji.

Procesi i riemërimit në anën tjetër, i shndërron të gjithë të punësuarit në aplikantë dhe barra e provës bie mbi këta persona, që duhet të dëshmojnë se janë të përshtatshëm për ushtrimin e pozitës në fjalë. Personat në një procedurë të tillë nuk kanë të drejtën për ankesë në rast se nuk përzgjidhen. Sidoqoftë, procesi i riemërimit të tërësishëm të një institucioni duhet të konsiderohet vetëm në rast se institucioni është totalisht jofunksional dhe do të duhet të bëhen ndryshime rrënjësore. Vetingu i gjyqësorit në Bosnje ishte i modeluar sipas këtij lloji.

3. *Vetingu i zyrtarëve në detyrë apo kandidatëve të jashtëm*

Vetingu mund të kufizohet vetëm tek emërimet e reja, përfshirë transferimin apo ngritjen në detyrë dhe jo personat në detyrë. Një proces i tillë është rëndom më pak kundërthënës politikisht dhe përbën një masë të rëndësishme për të siguruar rezultate të qëndrueshme dhe afatgjata.

Kjo metodë, megjithatë, meqenëse nuk mundëson largimin e personave në detyrë me mungesë serioze të integritetit, e ngadalëson dukshëm ripërtërirjen e pozitive dhe nuk është formë e përshtatshme në rastet kur synohet reformë thelbësore.

4. *Vetingu përmes një mekanizmi të veçantë ose të rregullt*

Përgjithësisht, një komision i veçantë, ad hoc, duhet të themelohet me qëllim të bërjes së vetingut.

Në rrethana të caktuara, është e mundur që të përdoren procedurat e rregullta për largimin e personave me mungesë serioze të integritetit. Për dallim nga procedurat e veçanta, procedurat e rregullta nuk kanë për pasojë pasigurinë juridike dhe janë më pak të kushtueshme dhe me efekt pengues. Procedurat e rregullta mund të zhvillohen në formë e mekanizmave të brendshëm disiplinorë. Procedurat e rregullta mund të përdoren kur përqindja e individëve që do të preken nga vetingu është e vogël, institucioni vazhdon të mbetet funksional dhe kur nuk ka nevojë urgjente për reformë dhe as vullnet të mjaftueshëm politik.

Si dizajnohet një proces vetingu?

Udhëzuesi i UNDP përshkruan faktorët bazë të dizajnit të mirë të procesit të vetingut. Dizajnimi i mirë garanton sukses tutje në zbatim.

1. Informimi dhe konsultimi me publikun

Me qëllim të rikthimit të besimit dhe ri-legjitimitit të institucioneve, publiku duhet të jetë i njoftuar dhe t'i besojë procesit. Transparenca rreth procesit dhe konsultimi rreth objektivave, do të ndihmojë në ndërtimin e besimit në proces. Nuk ka një formulë të saktë për vetingun. Konsultimet publike do të ndihmojnë në dizajnimin e kontekstit dhe strategjive specifike për institucionin që vetohet. Vetëdije publike gjithashtu ndikon që të shmanget mundësia që më vonë të hidhen dyshime apo të kontestohet ligjshmëria e procesit. Procesi i vetingut jo vetëm se duhet të përmbajjë një mekanizëm të informimit publik, por edhe vetë dizajnimi i procesit duhet të ketë për bazë konsultime të gjera me shoqërinë civile dhe hisedarët tjerë.

2. Vendosja e prioriteteve të vetingut dhe përzgjedhja e llojit të vetingut

Procesi i vetingut duhet t'i vendosë qartë prioritetet. Lloji më i përshtatshëm i vetingut duhet të zgjidhet varësisht nga institucioni që vetohet.

3. Definimi i kritereve të vetingut dhe rezultateve

Integriteti nënkupton veprimin e një personi sipas standardeve relevante të të drejtave të njeriut dhe sjelljes profesionale, përfshirë rregullsinë me financat. Kërkesat specifike të integritetit varen nga kërkesat e pozitës, ushtrimi i së cilës është në pyetje. Kriteret e vlerësimit duhet të rrjedhin nga një vlerësim i detajuar dhe realist, me qëllim të zhvillimit

të një procesi të drejtë dhe efikas. Instrumente me standardet ndërkombëtare mund të shërbejnë si referencë për hartimin e standardeve për vlerësimin e integritetit.

Kriteret meritore rreth integritetit dhe kompetencës, mund të komplementohen me kriteret formale, të tilla si shprehja e pajtueshmërisë me procesin e vetingut, pjesëmarrja në intervistë, plotësimi i formularëve të vetingut dhe dorëzimi i dokumenteve të kërkuara. Kriteret e këtilla formale kanë rëndësi të madhe në proceset kur qasja në informata të besueshme rreth prapavijës së personit është e kufizuar.

Rezultatet e procesit të vetingut për personat që nuk plotësojnë kriteret, duhet të përkojnë me arsyet për largim nga detyra dhe kontekstin specifik. Një person që konsiderohet se ka integritet të mangët, mund të diskualifikohet nga një kategori e posteve publike, nga të gjitha postet në një institucion ose nga shërbimi publik në përgjithësi. Diskualifikimi mund të jetë i përhershëm ose i përkohshëm dhe ri-integrimi duhet të varet nga përmbushja e kushteve të caktuara.

Nëse një person largohet për shkak të mungesës së kompetencës profesionale, atëherë ai mund të aplikojë për një pozitë tjetër ose të ri-aplikojë për pozitën e njëjtë sapo të ketë fituara kompetencat e munguara. Kujdes i veçantë duhet pasur tek të larguarit për arsye tjetër arsye se integriteti.

4. Zhvillimi i mekanizmit

Zakonisht, mekanizmat e rregullt disiplinues nuk janë të mjaftueshëm dhe duhet të themelohet komision i veçantë, ad hoc. Ky komision duhet të jetë i pavarur, në mënyrë që të sigurojë zbatim të paanshëm dhe legjitim të procesit. Anëtarët e komisionit duhet të jenë personalitete të shquara dhe të respektuara. Përbërja mund të përfshijë edhe anëtarë ndërkombëtarë me qëllim të rritjes së pavarësisë dhe legjitimitetit të komisionit. Konsultimi gjerë duhet t'i paraprijë emërimit të këtyre anëtarëve nga një autoritet i pavarur dhe i lartë - Gjykata Kushtetuese, Presidenti ose një organizatë ndërkombëtare. Emërimi i anëtarëve duhet të zgjasë gjatë tërë kohëzgjatjes së procesit.

Komisioni ad-hoc do të ketë nevojë për një sekretari të aftë, që do të përgatisë informatat e nevojshme dhe do të mbështesë procesin vendimmarrës. Stafi i sekretarisë duhet të jetë multi-disiplinar dhe të përfshijë menaxherë projekti, menaxherë të IT, juristë dhe ekspertë të nivelit teknik. Komisioni dhe sekretaria duhet të kenë resurse të përshtatshme financiare dhe materiale. Në këtë drejtim, mbështetja ndërkombëtare është shpesh e nevojshme.

Komisioni ad-hoc me shumë gjasë do të duhet të marr vendime që nuk do të priten mirë, e që mund të kenë pasoja për sigurinë e anëtarëve. Prandaj, duhet të merret parasysh dhe të trajtohet me kujdes çështja e sigurisë së anëtarëve.

Pronësia vendore në proces është e preferuar sidomos kur procesi ka elemente ndërkombëtare, meqenëse shkon në dobi të legjitimitetit të procesit dhe ofron bazë më të mirë për pajtueshmërinë me procesin dhe qëndrueshmërinë e tij. Sidoqoftë, në rast se zhvillohet proces i ndërkombëtarizuar, atëherë duhet të bëhet çdo përpjekje për të përfshirë akterët vendorë, rregullimin sipas ligjit të brendshëm dhe vendosjen e garancive për transformimin e rrjedhshëm nga një proces i jashtëzakonshëm i vetingut, tek një proces i rregullt i përzgjedhjes dhe rekrutimit. Megjithatë, vetingu do të ballafaqohet me rezistencë. Mbështetja e fortë ndërkombëtare, si në rrafshin politik, ashtu edhe në atë operacional, do të jetë e rëndësishme kritike.

5. *Respektimi i Standardeve Ndërkombëtare Procedurale*

Proceset e vetingut që nuk respektojnë standardet ndërkombëtare mund të cenojnë në vend se të forcojnë respektimin e të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit. Sipas standardeve ndërkombëtare, procesi i vetingut duhet të bazohet në vlerësim individual dhe jo të lidhet me anëtarësinë në një grup apo institucion.

Se cilat standarde vlejnë, varet nga lloji i procesit. Në një proces të rishikimit, duhet të respektohen standardet minimale të procedurës administrative, të tilla si inicimi i procedurës në kohë të arsyeshme, njoftimi i palëve se janë duke u rishikuar, e drejta e palëve për t'u mbrojtur dhe qasja në informatat relevante, e drejta për përfaqësim nga avokati, e drejta e ankesës në gjykatë apo trup tjetër të pavarur etj.

Standarde të veçanta ndërkombëtare dhe Kushtetuta garantojnë pavarësinë e gjyqësorit, përfshirë ndarjen e pushteteve, kohëzgjatjen e garantuar të mandatit, pamundësinë e largimit nga detyra me urdhër ekzekutiv etj. Vetingu i gjyqtarëve duhet të bëhet nga "peers", përmes një komisioni të rregullt ose ad-hoc.

Si rrjedhojë e asaj që u tha më sipër, Udhëzuesi i UNDP liston këta hapa kritikë gjatë procesit të vetingut:

- Të konsiderohen kushtet dhe pasojat e padëshirueshme si më sipër;
- Të konsultohet gjerë publiku;
- Të prioretizohen institucionet që do të vetohen;
- Të përzgjidhet lloji i vetingut që është më i përshtatshëm për institucionin dhe situatën në fjalë;

- Të definoohen kriteret e vetingut;
- Nëse është e nevojshme, të themelohet një Komision ad-hoc i vetingut;
- Të respektohen standardet ndërkombëtare përgjatë dizajnit të procesit;
- Të identifikohen reformat e gjera institucionale që janë qenësore për të siguruar qëndrueshmërinë e rezultateve të vetingut.

Nga sa u tha më sipër, propozohet që procesi i vetingut të marr parasysh këto kriteret:

Kriteret e Propozuara të Vetingut

1. Integriteti individual:

- Sjellja profesionale;
- Rregullsia financiare;
- Lidhjet me organizata të kundërligjshme;

2. Cilësitë individuale:

- Shtetësia, mosha minimale;
- Niveli i edukimit;
- Kualifikimet profesionale, kompetenca dhe përvoja;
- Mirëqenie fizike dhe mendore;

3. Kriteret procedurale:

- Pajtueshmëria (bashkëpunimi) me procesin e vetingut;
- Plotësimi i formularëve dhe deklaratave;
- Dorëzimi i dokumenteve të kërkuara;
- Paraqitja në datën dhe kohën e caktuar.

1.4.5 Përfundime lidhur me standardet dhe instrumentet ndërkombëtare

Nga sa u shtjellua më sipër, rrjedhë se gurthemeli i procesit të vetingut vendoset nga instrumentet themeltare ndërkombëtare të sistemit të të drejtave të njeriut. Në një shoqëri demokratike, janë pikërisht këto instrumente që në njërin anë, përcaktojnë të drejtat e qytetarëve të vendit për gjyqësor të pavarur e funksional, e rrjedhimisht sundim të ligjit e respektim të të drejtave të njeriut. Në anën tjetër, po këto instrumente të karakterit detyrues, përcaktojnë të drejtat e njeriut nga këndvështrimi i gjyqtarit apo prokurorit në procedurë, sidomos të drejtën në gjykim të drejtë e të paanshëm, bashkë me garancitë procedurale dhe masat mbrojtëse përkatëse.

Në frymën e substratit të vendosur nga këto instrumente, organizatat më autoritative ndërkombëtare e rajonale-europiane, kanë dalë me instrumente të ligjit të butë, me qëllim

të ofrimit të udhëzimeve dhe rekomandimeve. Sigurisht, çështjet e gjyqësorit janë “punë të brendshme” të secilit vend, prandaj, në aspektin juridik dhe të detyrueshmërisë së akteve, këto instrumente kufizohen tek dhënia e udhëzimeve dhe rekomandimeve. Sidoqoftë, duhet pasur parasysh që pavarësisht se si quhen, janë pikërisht këto instrumente të ligjit të butë e dokumente relevante, që vlerat e parimet e instrumenteve obligative, i përkthejnë në hapa konkretë operacionalë. Vëmendje meriton sidomos seksioni i fundit, me dokumente relevante që i referohen shprehimisht dhe saktësisht dizajnimin të një procesi të vetingut.

Si përfundim, nga standardet dhe instrumentet ndërkombëtare si më sipër, mund të vihet në përfundim se nuk ka formulë të saktë për dizajnimin e një procesi të vetingut. Dizajnimi, e më vonë zbatimi i një procesi të vetingut në vendin e caktuar, varen kryekëput nga konteksti shoqëror e juridik i vendit, qëllimi dhe objektivat e synuara, korniza legislative e normative e vendit, si dhe struktura institucionale e atij vendi. Çfarë mund të thuhet është se një proces i vetingut, pashmangshëm prek, cenon e edhe kufizon liritë dhe të drejtat e njeriut të parapara me instrumente ndërkombëtare. Çështja e vendosjes së baraspeshës në mes të arritjes së qëllimeve të vetingut si interes i përgjithshëm në një anë, dhe respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut në anën tjetër, paraqitet si shumë kritike.

1.5 Praktikrat e vendeve të tjera

Ky koncept dokument ka qëllim të dyfishtë. Fillimisht, të shqyrtoj sfidat në sistemin aktual ligjor, funksional dhe organizativ të procesit të vetingut në sistemin e drejtësisë në Kosovë. Së dyti, për të rregulluar procesin aktual të vetingut në sistemin e drejtësisë në Kosovë në përputhje me standardet ndërkombëtare për pavarësinë e gjyqësorit. Përveç kësaj, ky koncept dokument kërkon të sigurojë disa shembuj të proceseve të mëparshëm dhe aktuale të vetingut në disa vende në Evropë dhe Afrikë.

1.5.1 Praktika e shteteve të rajonit

1.5.1.1 Përvoja me vetingun në Shqipëri

1. Prapavija

Procesi i vetingut në Shqipëri u iniciua si nevojë e çrrënjësjes së korrupsionit dhe e rikthimit të besimit të popullit në sistemin gjyqësor. Kjo e bën të veçantë këtë proces në krahasim me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor, të cilët ju nënshtruan këtij procesi si masë institucionale post-konfliktit. Shqipëria edhe pse jo në fazë post-konfliktuale, sistemi i saj i drejtësisë ka çaluar në shumë aspekte, gjë që nxiste nevojën për reforma radikale për të

rikthyer integritetin, pavarësinë dhe efikasitetin e gjyqësorit si elemente qenësore të shtetit të së drejtës.

Nxitës i këtij procesi ishte edhe faktori ndërkombëtar, e në veçanti Bashkimi Evropian, ku në vitin 2014 me rastin e fitimit të statusit të kandidaturës për anëtarësim në BE, kjo e fundit paraqiti një numër kërkesash që Shqipëria duhet t'i plotësonte si parakusht për fillimin e bisedimeve për anëtarësim në BE. Në këtë drejtim, rivlerësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve ishte një ndër kushtet kryesore që Shqipëria duhej të përmbushte. Sipas konkludimit të Këshillit të Stabilizim Asociimit mes Shqipërisë dhe BE-së, reforma gjyqësore në Shqipëri mbetet qenësore për procesin e integritetit të saj në BE.

Në korrik 2016, Kuvendi i Shqipërisë unanimisht ka miratuar reformat gjyqësore, të dizajnuara për pastrimin e sistemit të drejtësisë nga korrupsioni dhe ndikimi politik.

2. Modaliteti

Procesi i vetingut në Shqipëri është funksionalizuar përmes amendamentimeve kushtetuese të përcjella me miratimin e ligjeve të reja.

Si pjesë integrale e paketës së ndryshimeve kushtetuese, që ka për qëllim reformimin e sistemit të drejtësisë dhe kthimin e besimit të qytetarëve tek Shteti i së Drejtës, Kuvendi i Shqipërisë miratoi, *inter alia*, ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në tekstin e mëtejshëm: Ligji i Vetingut).

Ligji i Vetingut targeton vetëm gjyqtarët dhe prokurorët, duke përfshirë edhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe ka për qëllim kontrollimin e gatishmërisë profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të integritetit moral të tyre, nivelit të pavarësisë dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

3. Institucionet e rivlerësimit dhe kompetencat

Bazuar në Kushtetutën e Shqipërisë dhe Ligjin për Veting, institucionet kryesore të procedurave të vetingut janë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA), Komisionerët Publikë (KP) dhe Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM).

KPK dhe KPA

Bartëse kyçe të procesit të vetingut janë KPK dhe KPA. Anëtarët e këtyre trupave përzgjidhen nga Kuvendi, sipas listës dhe rekomandimeve të ONM, të cilat ky i fundit i

përpilon në bashkëpunim me Presidentin e vendit. Në shqyrtimin e çështjeve, këto dy trupa udhëhiqen nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit.

Anëtarët e institucionit të rivlerësimit janë të detyruar të plotësojnë deklaratën vjetore të pasurisë. Mosplotësimi me saktësi dhe vërtetësi i kësaj deklarate përbën shkak për shkarkim nga detyra.

Anëtari i institucioneve të rivlerësimit deklaron dhe shmang çdo situatë konflikti interesi, në respektim të ligjit “Mbi parandalimin e konfliktit të interesit”. Në mënyrë që të sigurohet besueshmëria dhe konfidencialiteti i anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, komunikimet elektronike të tyre monitorohet nga Njësia e Posaçme Hetimore kurse të ardhurat financiare të tyre monitorohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, sipas pëlqimit të dhënë prej tyre për të gjithë kohëzgjatjen e mandatit të tyre.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

Është trupa kryesore për kryerjen e procesit të verifikimit. Është organ kolegjal i përbërë nga 12 komisionerë, të miratuar në bllok me vendimin nr.82/2017 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë Bazuar në Ligjin për Veting, veprimtaria e Komisionit drejtohet nga Kryetari. Komisioni organizohet në 4 trupa gjyquese të përbërë nga 3 anëtarë, të cilët caktohen me short. Mandati i Komisionit është 5 vjet.

Kolegji i Apelimit

Kolegji i Apelimit gjykon në trupa gjyquese të përbërë nga 7 gjyqtarë, të cilët caktohen me short për çdo çështje. Trupi gjykues i Kolegjit kryesohet nga kryesuesi, i cili caktohet me short së bashku me relatorin e çështjes.

Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Komisionit dhe ka mandat 9 vjeçar.

Kolegji i Apelimit ka juridiksion të shqyrtojë edhe a) shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; b) ankesat kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.

Kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të KPK dhe KA

- Duhet patjetër të jenë shtetas shqiptar nën moshën 65 vjec;

- të ketë përfunduar studimet “master” në Shqipëri ose jashtë vendit me kusht që diploma të jetë nostrifikuar;
- të ketë njohuri të larta të gjuhës angleze,
- të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor i së drejtës, nëpunës i shërbimit civil në nivel drejtues ose në një përvojë të njohur në fushën e së drejtës administrative ose sfera të tjera të së drejtës;
- të ketë marrë një vlerësim të lartë për aftësitë e tij profesionale, etike dhe integritetin moral të tij, nëse u është nënshtruar vlerësimeve të mëparshme;
- të mos ketë ushtruar funksione politike gjatë 10 viteve të fundit,
- ndaj tij të mos jetë nisur ndonjë hetim penal, të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerje të veprave penale, për kryerjen e një kundërvajtjeje me dashje;
- të mos ketë qenë subjekt i masave tjera disiplinore të parapara me legjislacionin në fuqi, duke përfshirë ato që rrjedhin nga marrëdhënia e punës;
- të mos ketë qenë gjyqtar, prokuror, këshilltar ligjor ose ndihmës ligjor gjatë dy viteve të fundit përpara kandidimit dhe anëtar i Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, ose ekspert i caktuar nga partitë politike.

Vlerësimi për plotësimin e kriterëve të mësipërme e bazohet në provat si në vijim:

a) titujt shkencorë në fushën e së drejtës; b) përvoja të veçantë të kandidatit në sfera të caktuara të së drejtës; c) vjetërsinë në profesion; ç) përvojën studimore dhe profesionale jashtë shtetit shqiptar; d) notën mesatare jo më pak se 8 në studimet Master.

Komisionerët Publikë

Komisionerët Publikë gëzojnë statusin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë gjatë mandatit të tyre.

Ky institucion ushtron kompetencat e tij mbi bazën e parimeve të barazisë para ligjit, të kushtetueshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. Komisionerët Publikë dhe njësia e shërbimit ligjor trajtojnë informacionin për procedurën e rivlerësimit, në respektim të parimit të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Kompetencat e këtij institucioni përfshijnë, *inter alia*, paraqitjen e ankesave ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të cilat shqyrtohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelit.

Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit

Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit monitoron KPK dhe KA dhe udhëhiqet nga Komisioni Evropian. Sipas kësaj procedure, vëzhguesit ndërkombëtarë kanë rol monitorues dhe mbështetës në procesin e vetingut dhe jo ekzekutiv të vendimmarrjes. Funkcioni i ONM kufizohet në përpilimin e listës së kandidatëve për rekomandim për të dy organet (institucionet e vetingut). ONM-ja mbikëqyr procesin e krijimit të organeve të vetingut. ONM-ja jep një rekomandim mbi kualifikimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisioneve të Pavarura të Kualifikimit, të Dhomës së Specializuar të Kualifikimit dhe dy posteve të Komisionerëve Publikë. Kjo detyrë kryhet me asistencën e katër vëzhguesve afatshkurtër (tre gjyqtarë/prokurorë të lartë nga gjyqësorët e Shteteve Anëtare të BE-së dhe një nga Departamenti i Drejtësisë i Shteteve të Bashkuara). Pas rekomandimit të ONM-së, Kuvendi është më së fundi përgjegjës për emërimin e gjithë anëtarëve të organeve të vetingut.

Së dyti, pas krijimit të organeve të vetingut, ONM-ja sjell vëzhgues ndërkombëtare për të monitoruar kryerjen aktuale të procesit të vetingut, përmes një operacioni afatgjatë që do të zgjasë derisa gjithë anëtarët përkatës të gjyqësorit në Shqipëri, siç rekomandohet nga ligji, t'i nënshtrohen këtij vlerësimi transitor të kualifikimit.

Po ashtu, ONM u jep Komisionerëve rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, për vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

4. Buxheti

Buxheti i institucioneve të rivlerësimit financohet nga Buxheti i Shtetit, në të cilin ato pasqyrohen si institucione të veçanta. Institucionet e rivlerësimit zbatojnë në mënyrë të pavarur buxhetin e tyre, të miratuar nga Kuvendi dhe kanë të drejtë të përdorin të ardhurat dytësore, të përfituara nga projektet ndërkombëtare, donacionet dhe botimet e tyre.

5. Procedura e vetingut

Rivlerësimi përfshin: a) vlerësimin (verifikimi) e pasurisë; b) Kontrollin e të së kaluarës dhe c) vlerësimin e aftësive profesionale.

Në vijim shkurtimisht do të sqarohet çka nënkuptojnë secila prej këtyre llojeve të vlerësimit dhe procedura e tyre e performimit të tyre.

a) verifikimi i pasurisë; Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur

me të (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore dhe çdo person të përmendur në certifikatën familjare).

Procedura e verifikimit të pasurisë fillon me dorëzimin e deklaratës nga subjektet e vetingut dhe personat e lidhur me ta tek Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPI) së bashku me dokumentet tjera të cilat e justifikojnë pasurinë e personave në fjalë. ILDKPI-ja, bazuar në deklaratimet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për qëllimet e rivlerësimit, ILDKPI-ja përmes Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave ose Ministrisë së Drejtësisë dokumentet për pasuritë në pronësi të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta, mund të kërkojë dokumentet që përdoren jashtë shtetit nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur me ta, ose të dhënat financiare mbi çdo transaksion financiar brenda ose jashtë vendit në përputhje me ligjin *“Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”* të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta. Këto dokumente ose informacione mund të përdoren në cilësinë e provave përpara Komisionit ose Kolegjit të Apelit.

ILDKPI-ja mundëson qasje të plotë për vëzhguesit ndërkombëtarë që të kërkojnë informacione, të konsultojnë, të kopjojnë dhe të hetojnë deklaratimet e pasurive të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit ose personat e lidhur me të, si dhe dokumentet shoqëruese.

Në fund të procedurës kontrolluese, ILDKPI-ja përgatit një raport me të cilin konstaton se:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe që nuk gjendet në situatë konflikti interesi;
- b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) është kryer fshehje e pasurisë;
- d) është kryer deklarim i rremë;
- e) subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Ky lloj vlerësimi ka hasur në më së shumti rezistencë nga ana e prokurorëve dhe gjyqtarëve dhe ka rezultuar në një numër të madh të dorëheqjeve.

b) Kontrolli i figurës (verifikimi i së kaluarës); konsiston në verifikimin e deklaratave të vlerësimeve dhe të dhëna të tjera që synojnë identifikimin e lidhjeve me individë të përfshirë në krimin e organizuar. Nëse pas vlerësimit është konstatuar se personi i vlerësuar ka ndërlidhje me persona ose organizata kriminale, ai / ajo shkarkohet nga detyra, përveç nëse e dëshmon te kundërtën, që do të thotë se barra e të provuarit bie mbi te vlerësuarit).

Procedura e kontrollit të figurës fillon me dorëzimin e deklaratës nga ana e subjektit të vetingut tek Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH) dhe Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave (SHKÇBA) pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, krijojnë një grup pune i cili gjatë procedurave të kontrollit të figurës, i përmbahet kërkesave *“a) verifikimi i saktë i identitetit në të shkuarën dhe të tashmen, për çdo individ; b) verifikimi nëse ka tendenca kriminale për përfshirjen në krimin e organizuar; c) vlerësimi i përgjithshëm, nëse individi mund të vihet nën presion nga struktura kriminale; ç) kontrolli nëse ka qenë, është ose tenton të angazhohet fshehurazi, vetëm, në bashkëpunim, ose në përbërje të një organizate kriminale”*.

Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm i subjektit të vlerësimit me një person të përfshirë në krimin e organizuar ndër tjera janë :

- a) është fotografuar, ose kur një dëshmitar përshkruan një takim me një person të përfshirë në krimin e organizuar;
- b) subjekti i rivlerësimit ose personi i lidhur me të ka pasur një komunikim jo rastësor me një person të përfshirë në krimin e organizuar;
- c) subjekti i rivlerësimit ose një person i lidhur me të ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar;
- d) subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar;
- e) subjekti i rivlerësimit merr pjesë ose është i pranishëm në takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Pas përfundimit të verifikimit të informacioneve, Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, ia dorëzon KPK-së raportin e përgatitur nga grupi i punës. Ky dokument/raport përcakton nëse subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaratimit për kontrollin e figurës, në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi, nëse nga deklarimi i tij ose gjetkë vërehet se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, si dhe konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë e tij për vazhdimin ose jo të detyrës.

Ligji për veting ka paraparë një numër rrethanash lehtësuese që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, dhe rrethanat që merren parasysh kur deklarata e dhënë është jo e plotë apo jo e besueshme.

c) **Vlerësimi i aftësive profesionale:** Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i veprimtarisë etike dhe profesionale të subjekteve të rivlerësimit në përputhje me Ligjin për Veting dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Sipas kësaj procedure subjekti i vlerësimit fillimisht plotëson një formular përmes të cilit vetë vlerësohet në aspektin profesional. Burimet tjera të vlerësimit janë dokumentet ligjore të cilat gjyqtarët dhe prokurorët i kanë punuar dhe raportet e vlerësimit të aftësive profesionale.

“Dokument ligjor” për qëllim të vlerësimit të aftësive profesionale nënkupton çdo dokument të përgatitur nga personi gjatë ushtrimit të detyrës profesionale, si vendim gjykate, kërkesë për gjykim, raport/relacion, padi, mendim/opinion ligjor, si dhe akte të tjera që provojnë kapacitetet profesionale të personit.

Për qëllim të vlerësimit të aftësive profesionale, organet e vlerësimit bazohen në burimet parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve.

Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale bëhet nga relatori i çështjes mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit sipas legjislacionit në fuqi dhe i propozon Komisionit të Pavarur të Kualifikimit njëri nga këto kategori për subjektin e rivlerësimit:

- a) “I aftë”, kur subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve ose viktimave, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme;
- b) “Me mangësi”, kur subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve ose viktimave, nuk është efektiv. Komisioni ka rekomanduar program trajnimi pranë Shkollës së Magjistraturës për të plotësuar këto mangësi brenda një viti;
- c) “I papërshtatshëm”, kur subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve ose viktimave, nuk është efektiv, në atë shkallë sa programi i trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës nuk mund ta zgjidhë këtë çështje për një vit, ose nuk ka kaluar me sukses testimin pranë Shkollës së Magjistraturës.

6. Vendimmarrja

Vendimi i Komisionit merret me votim të hapur dhe me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të trupit gjykues. Bisedimet për marrjen e vendimit ndaj subjektit të rivlerësimit zhvillohen me dyer të mbyllura në praninë e vëzhguesit ndërkombëtar. Vendimi me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore.

Vendimi publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit.

7. Ankesa

Vendimet e Komisionit mund të ankimohen në Kolegjin e Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

Kolegji mund të kërkojë mbledhjen e fakteve ose të provave, si dhe të korrigjojë çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit, duke mbajtur parasysh të drejtat themelore të subjektit të rivlerësuar.

Pas shqyrtimit të çështjes, Kolegji i Apelit vendos: a) lënien në fuqi të vendimit të Komisionit; b) ndryshimin e vendimit të Komisionit; c) prishjen e vendimit të Komisionit.

Vendimi i Kolegjit të Apelit, për shkarkim nga detyra, ka efekt të menjëhershëm *ex lege*.

8. Masat disiplinore

Në përfundim të procesit, Komisioni mund të vendosë për subjektet e rivlerësimit:

- a) konfirmimin në detyrë;
- b) pezullim nga detyra për një periudhë 1-vjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës;
- c) shkarkimin nga detyra;

Shkaqet e shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit janë të numëruara taksativisht në Ligjin për Veting, si në vijim:

- kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të;
- kur rezulton se ka pasur probleme serioze gjatë kontrollit të figurës, për shkak të kontakteve papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar që bën të pamundur vazhdimin e detyrës;

- kur rezulton se ka bere deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, kur nuk është vlerësuar si i “papërshtatshëm” në vlerësimin e aftësive profesionale;
- kur rezulton si i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale
- në rast se rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra në çdo fazë të procesit të rivlerësimit. . Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit. Në rast se subjekti aplikon në të ardhmen për pozitën e gjyqtarit ose prokurorit,, subjekti do të hyjë në proces të vlerësimit të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë njëjtë sikurse të gjithë kandidatët e rinj për rekrutim.

9. Përmbledhje e Opinioneve të Komisionit të Venecias

Opinionin e përkohshëm Nr. 824 / 2015 i Komisionit të Venecias mbi draftin e amendamenteve kushtetuese mbi gjyqësorin në Shqipëri i datës 21 dhjetor 2015

Në opinionin e përkohshëm, Komisioni i Venecias ka theksuar se nevoja për veting rrjedh nga prezumimi se ka nivel të lartë të korrupsionit në gjyqësor. Ky proces në situata normale nuk do preferohej sepse mund të shkaktojë tensione në gjyqësor dhe rrezikun e kapjes së tij nga forcat politike. Mirëpo, duke pasur parasysh situatën në vend, vetingu është konsideruar si i nevojshëm përderisa mbetet si masë e jashtëzakonshme dhe tejet e përkohshme.

Komisioni i Venecias ndër tjera theksoi që përbërja e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe statusi i anëtarëve të tyre duhet të garantojë pavarësinë dhe paanësinë e tyre, gjyqtarët dhe prokurorët të cilët i nënshtrohen procesit të vetingut duhet t’iu sigurohet gjykimi fer si dhe të kenë të drejtën të apelojnë tek një organ i pavarur, duhet të përcaktohet statusi dhe kushtet e emërimit / largimit të vëzhguesve ndërkombëtarë dhe kompetencat e tyre duhet të përshkruhen në mënyrë precize përmes legjislacionit.

Opinionin final Nr. 824 / 2015 i Komisionit të Venecias mbi draftin e rishikuar të amendamenteve të kushtetuese mbi gjyqësorin në Shqipëri i datës 14 mars 2016

Në opinionin final, Komisioni i Venecias ritheksoi se vetingu është i domosdoshëm për largimin e korrupsionit në Shqipëri. Në këtë opinion Komisioni parashtrroi një numër

rekomandimesh, ku ndër tjera sugjeroi që mandati i organeve bartëse të vetingut të zvogëlohet, që gjyqtarët e trupit apelues, në fund të mandatit të tyre duhet të jenë në gjendje të integrojnë automatikisht gjyqësorin, dhe që gjyqtarët dhe prokurorët që i nënshtrohen vetingut të gëzojnë të drejtën e ankimit në Gjykatën Kushtetuese në rast të shkeljes së të drejtave të tyre themelore, me disa përjashtime të arsyetuara dhe diktuar nga domosdoshmëria e procesit të vetingut.

Komisioni i Venecias ndër tjera theksoi që përbërja e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe statusi i anëtarëve të tyre duhet të garantojë pavarësinë dhe paanësinë e tyre, duhet të përcaktohet kompetencat e vëzhguesve ndërkombëtarë dhe kompetencat e tyre të jenë të natyrës procedurale por jo të vendosin meritorisht.

Opinion Nr. 868/2016- Amicus Curiae brief

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, në tetor të 2016 ka kërkuar nga Komisioni i Venecias të vlerësojë dhe të japë opinion rreth përputhshmërisë së dispozitave të Ligjit për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë me standardet ndërkombëtare duke përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ). Në këtë drejtim Gjykata kushtetuese ka parashtruar 4 pyetje si ne vijim:

1. *Duke pasur parasysh faktin se të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese janë subjekt i ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", a paraqet pjesëmarrja e tyre në shqyrtimin e kësaj çështje konflikt interesi?*

Lidhur me këtë çështje Komisioni i Venecias, ka theksuar se Ligji për Veting nuk parasheh ndonjë rregull të veçantë për konflikt interesi që kërkon tërheqjen e gjyqtarëve. Prandaj, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë mund ose të përjashtohet nga vlerësimi i legjislacionit të vetingut ose duhet të pranojë rëndësinë bazike të rolit të funksionit të gjykatës në rishikimin e legjislacionit, dhe rrjedhimisht të vendos mbi kërkesën e parashtruar pranë saj. Sipas opinionit të Komisionit të Venecias, Gjykata Kushtetuese nuk ka nevojë të tërhiqet në rastet kur vendos për çështjet të cilat prekin ndonjë interes të anëtarëve të saj, përveç nëse ajo çështje do trajtonte shkarkimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Ne opinion, Komisioni i Venecias i është referuar edhe 'Parimeve Bangalore të Sjelljes Gjyqësore 2002' e cila ofron udhëzime se si të adresohet një situatë e tillë, duke deklaruar se në parim gjyqtari i cili nuk perceptohet i paanshëm nuk duhet t'i lejohet pjesëmarrja në seancë si dhe të vendosë për atë çështje. Sidoqoftë, përjashtimi i gjyqtarit nuk duhet të kërkohej nëse është e pamundur që të themelohet një trup gjykues tjetër për të vendosur

në çështjen (*doctrine of necessity*). Ngjashëm, nëse kushtetushmëria e dispozitave të cilat rregullojnë procedurën në Gjykatën Kushtetuese dhe kriteret për mbajtjen e pozitës nga zyrtarët në këtë Gjykatë, bazat për dorëheqje apo masa disiplinore ngritën si çështje pranë kësaj gjykate, tërheqja e gjyqtareve të Gjykatës Kushtetuese nuk kërkohet. Mirëpo, nëse ka arsye të besohet se gjyqtari i cili vlerëson kushtetutshmërinë e Ligjit të Vetingut nuk i përmbush kriteret e përcaktuara nga ky ligj, rrjedhimisht nuk është adekuat për të mbajtur atë post dhe si pasoje e vlerësimit do mund të shkarkohej dhe është i obliguar të jap dorëheqje (p.sh. nëse i njëjti konsideron se mund të dështoj në kontrollin e të së kaluarës për arsye të ndërlidhjes me organizata kriminale). Sidoqoftë, duke pasur parasysh faktin se ekziston supozimi se anëtarët e Gjykatës Kushtetuese veprojnë me mirëbesim, të njëjtit lejohen të vlerësojnë kushtetutshmërinë e dispozitave përkatëse të Ligjit për Veting.

2. A i respekton Ligji për Veting parimet themelore të sundimit të ligjit dhe ndarjes dhe balancimit të pushteteve? A rrezikohet pavarësia e gjyqësorit nga përfshirja në procesin e rivlerësimit të organeve të ekzekutivit?

Lidhur me këtë pyetje, Komisioni i Venecias ka theksuar se emërimi i anëtarëve të Komisionit të Pavarur dhe Dhomës së Apelit behet me procedurë të njëjtë si për gjyqtarët e rregullt. Bazuar në nenin 4 paragrafi 2 i Ligjit për Veting, Komisioni i Pavarur dhe Dhoma e Apelit janë institucione që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të vlerësimit". Rrjedhimisht parimet që vlejné për gjyqtarët dhe gjykatat e rregullta, vlejné edhe për Komisionin e Pavarur si shkallë e parë dhe Dhomën e Apelit si shkallë e dytë.

Çështje më diskutabile në këtë aspekt ka qene vlerësimi i aseteve, pasi që mbledhja e të dhënave bëhet nga organet e ekzekutivit. Në këtë rast Komisioni i Venecias ka vlerësuar se ky proces paraqet një procedurë të rregullt dhe në linjë me standardet evropiane që provat e paraqitura në një gjykatë fillimisht merren nga ekzekutivi (psh. policia). Meqenëse vlerësimin final të peshës dhe vërtetësisë së tyre e siguron gjykata, rrjedhimisht mbledhja e materialit në këtë mënyrë nuk paraqet ndërhyrje të ekzekutivit në gjyqësor.

3. A është Ligji për Veting në përputhje me nenin 6 të KEDNJ-së (e drejta për gjykim të drejtë)? A është në kundërshtim me nenin 6 të KENDNJ mohimi i të drejtës së gjyqtarëve dhe prokurorëve që i nënshtrohen vetingut që t'iu drejtohen gjykatave të rregullta lidhur me të drejtat e tyre që rrjedhin nga ky proces?

Sipas Komisionit të Venecias, Dhoma e Apelit mund të konsiderohet si një juridiksion i specializuar, e cila sipas dispozitave kushtetuese mund të interpretohet si një specifikim i fushës nga neni 135 të Kushtetutës (Gjykatat) dhe në veçanti, të paragrafit 2 (gjykatat e

posaçme). Rrjedhimisht e njëjta përmban elementet e Gjykatës e cila ndër tjerash është e obliguar që të ofrojë gjykim të drejtë.

4. A janë dispozitat e Ligjit për Veting që rregullojnë kontrollin e figurës (kontrollin e së kaluarës) në kundërshtim me nenin 8 të KEDNJ (respektimi i jetës private dhe familjare të gjyqtarëve dhe prokurorëve)?

Komisioni i Venecias ka theksuar se e drejta privatësisë është e limituar me neni 17 te Kushtetutës (për interes publik), e cila ne rastin konkret mund të justifikohet me nevojën e intervenimeve specifike legislative marrë parasysh nivelin e korrupsionit në Shqipëri. Lidhjet inkriminuese me persona dhe organizata kriminale shkelin sigurinë nacionale dhe rrjedhimisht e justifikojnë kontrollin e së kaluarës të personave të cilët i nënshtrohen vlerësimit. Çështje kontestuese në këtë rast ka qenë nëse masat e parapara në Ligjin për Veting për kontrollin e së kaluarës janë jo proporcionalisht ndërhyrëse në jetën private të personat që vlerësohen. Komisioni i Venecias ka vlerësuar se, duke marrë parasysh se Ligji për Veting obligon shpалosjen e një segmenti të madh kontaktesh, i njëjti proces duhet të mbikëqyret me kujdes dhe të kontrollohet nga Komisioni dhe të mund të ankimohet në Dhomën e Apelit. Po ashtu, informatat e nxjerra nga verifikimi i së kaluarës të cilat bazohen në deklaratën e subjekteve të vlerësimit mund të përdoren vetëm për qëllime të rivlerësimit dhe jo për qëllime vetë-inkriminuese në procedure penale.

Lidhur me kontrollin e së kaluarës, Ligji për Veting parasheh që bartës të këtij procesi janë institucionet e rivlerësimit së bashku me Autoritetin e Sigurisë Kombëtare (ASK). Tutje, Shërbimi Shtetëror i Inteligjencës dhe Shërbimi i Ankesave së bashku me ASK formojnë një grup punues për të bërë kontrollin e së kaluarës të subjekteve të vlerësimit.

Një proces i tillë për qëllime të rivlerësimit duhet bërë nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e Komisionit të Pavarur dhe të jetë subjekt i ankimimit tek Dhoma e Apelit. Komisioni i Venecias ka shprehur shqetësime lidhur me përbërjen e grupit punues për rivlerësim, duke marrë parasysh se anëtarë të saj janë vetëm personeli i organeve të sigurisë pa përfaqësim të Komisionit të Pavarur. Gjithsesi, është qenësore që i gjithë materiali relevant në posedim të grupit punues të jetë i qashtë për institucionet të rivlerësimit (Komisionit të Pavarur dhe Dhomës së Apelit).

Tutje aneksi Ç i Kushtetutës, i mundëson institucioneve të rivlerësimit qasjen në data bazën qeveritare dhe të gjitha dosjet, nëse nuk janë klasifikuar si sekret shtetëror, duke përfshirë edhe dosjet personale, mendimet e mbikëqyrësit, informata rreth trajnimeve e të ngjashme. Organet të cilat posedojnë këto të dhëna kanë për detyrë të bashkëpunojnë dhe t'ju japin qasje në dokumentet relevante institucioneve të rivlerësimit.

Si përfundim, pavarësisht autorizimit që institucionet e rivlerësimit të kenë apo të mos kenë qasje dhe kontroll të plotë në kontrollin e së kaluarës dhe të sigurojnë qasjen në gjitha dokumentet dhe materialin relevant, është një çështje me rëndësi për tu konsideruar nga Gjykata Kushtetuese me rastin e ekzaminimit të Ligjit për Veting. Në qoftë së Gjykata konstaton se trupat e rivlerësimit kanë kontroll të plotë mbi procesin e kontrollin të së kaluarës, dispozitat ligjore mbi kontrollin e së kaluarës të subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, mund të konsiderohet se nuk paraqesin shkelje të pajustificuar në jetën privatë të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe familjarëve të tyre në kundërshtime me nenin 8 të KEDNJ.

10. Praktika gjyqësore

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)

Xhoxhaj v. Shqipëria [Kërkesa nr. 15227/19]

Kërkesa është parashtruar nga A.XH. ish gjyqtare në Gjykatës Kushtetuese, rreth procesit të rivlerësimit të ushtruar ndaj saj. Në kërkesën e saj, kishe pretenduar se i janë shkelur të drejtat që burojnë nga neni 6, 8 dhe 13 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Rreth shkarkimit të parashtrueses së kërkesës znj. A.Xhoxhaj

Në 2016 Komisioni i Pavarur i Kualifikimit kishte gjetur se znj. Xhoxhaj kishe asete likuide të pajustificueshme (nuk e kishte justifikuar ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të përdorura në blerjen e një banese 100m²) dhe se e njëjta nuk ishte vetë përjashtuar nga një çështje e cila përbente konflikt interesi për të. Rrjedhimisht, në përputhje me ligjin, barra e provës i kaloi asaj për të justifikuar ligjshmërinë e pasurisë së saj. Si shkak i këtyre shkeljeve e njëjta u shkarkua nga detyra. Ndaj këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar ankesë në Kolegjin e Apelit për shfuqizim të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Kjo e fundit nuk e shfuqizoi vendimit e Komisionit.

Më 2019 znj. A. Xhoxha ka parashtruar kërkesë në GJEDNJ. Znj. Xhoxha, në kërkesën e saj ka pretenduar shkelje të nenit 6, 8 dhe 13 të KEDNJ si në vijim:

- organet e vetingut nuk ishin të pavarura dhe të paanshme, pasi anëtarët e tyre nuk kishin profesionalizmin dhe përvojën e duhur, dhe të njëjtit janë emëruar nga parlamenti pa përfshirjen e pushtetit gjyqësor;
- organet e njëjta ishin përfshirë në tre fazat: kryerjen e hetimit paraprak, përpilimin dhe ngritjen e « akuzës » dhe kanë vendosur njëkohësisht mbi thelbin e « akuzës »;
- u kishte mohuar e drejta për t'u mbrojtur;

- pa nevojë iu kishte bartur barra e të provuarit në lidhje me rrethanat që kishin lindur dekada më parë;
- akti i vetingut nuk kishte paraparë periudhën e parashkrimit;
- nuk kishte pasur kohë të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen;
- Dhoma e Apelit kishte dështuar të mbante seancë publike;
- ka pasur ndërhyrje në jetën private;
- I është mohuar e drejta për mjete efektive juridike.

Lidhur me pretendimet e parashtrueses nga neni 6 i KEDNJ

Në lidhje me parimin ‘nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj’ gjykata vlerësoi se organet e vetingut ishin themeluar në mënyrë të ligjshme, për shkak të bazës ligjore mjaftueshëm të qartë (duke iu referuar Kushtetutës dhe Ligjit të Vetingut) e cila parashikonte ngritjen e KPK-së dhe të KA-së, për shkak të juridiksionit dhe kompetencave të tyre ekskluzive për të kryer rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve, prokurorëve, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë si dhe të mënyrës së formimit të tyre në çështjen e kërkujes. Gjykata nuk e gjeti të bazuar pretendimin për mungesë të pavarësisë së KPK-së dhe Kolegjit të Apelit. **Zgjedhja e organeve të vetingut ishte në përputhje me procedurën ligjore dhe mos përfshirja e gjyqtarëve aktualë ishte në përputhje me frymën dhe qëllimin e procesit të vetingut, në veçanti në përpjekje për të shmangur ndonjë konflikt të interesit dhe për të garantuar besimin e publikut në këtë proces.** Kohëzgjatja e mandatit të tyre ishte e pranueshme duke pasur parasysh natyrën e jashtëzakonshme të procesit të vetingut. Gjykata arriti në përfundimin që legjislacioni i brendshëm kishte parashikuar garanci ndaj palëvizshmërisë së tyre si dhe për funksionimin e duhur të organeve të vetingut.

Për sa i përket paanshmërisë, Gjykata vuri re se nuk kishte dyzim të roleve të KPK-së: detyrimi ligjor për të filluar hetimin ishte automatik dhe nuk kushtëzohej nga ngritja e ndonjë ‘akuze’ për shkelje disiplinore ndaj parashtrueses së kërkesës. Gjetjet paraprake të organeve ishin bazuar mbi informacionin që ndodhej në dosje kur ende nuk ishin marrë parasysh argumentet mbrojtëse të parashtrueses. Vendimi mbi përgjegjësinë disiplinore ndaj parashtrueses ishte bazuar *inter alia*, në të gjitha parastresat dhe provat e propozuara nga parashtruesja. Sipas Gjykatës, fakti që KPK-ja kishte bërë kërtime paraprake nuk përbënte dyshim të arsyeshëm për anshmërinë e tij. Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 të KEDNJ për sa i takonte pretendimit për mungesën e pavarësisë dhe paanshmërisë të organeve të vetingut.

Në lidhje me detyrimin për një proces të rregullt, Gjykata vuri re se fillimi i hetimit nga KPK-ja kishte qenë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Të gjeturat fillestare paraprake

nga Komisioni i ish-in bërë me dije parashtrueses, të cilat ishin të mjaftueshme për mbrojtjen e saj. Gjykata konstatoi se KPK-ja ka vendosur brenda kompetencave dhe vendimi ishte i arsyetuar mirë.

Gjykata konstatoi se Kolegji i Apelit kishte ushtruar kompetencat e plota në procedurat e zhvilluara përpara tij, në përputhje me ligjin, dhe kishte shqyrtuar çdo shkak të ankimit të parashtrueses së kërkesës, përfshirë edhe refuzimin për të pranuar prova të reja, duke dhënë arsye të mjaftueshme për vendimin e tij. Si rrjedhojë, Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 në lidhje me pretendimin për parregullsinë e procedurave.

Lidhur me detyrimin për të mbajtur një seancë publike përpara Kolegjit të Apelit Gjykata theksoi se, sipas jurisprudencës së saj, drejta për një seancë publike nënkuptonte të drejtën për një seancë dëgjimore përpara të paktën një shkalle gjykimi. Për më tepër, Gjykata u shpreh se, vetëm në raste përjashtimore, procedurat disiplinore ndaj gjyqtarëve mund të zhvilloheshin pa asnjë seancë dëgjimore. Për shkak të natyrës së procedurave në apel, gjatë të cilave kërkuesja kishte pasur mundësi të plota të paraqiste argumentet e saj me shkrim, dhe faktin se nuk kishte qenë e nevojshme të merrej në pyetje ndonjë apo prova tjera që kërkonin nevojën e thirrjes së seancës dëgjimore, mbajtja e një seance të tillë nuk kishte qenë e domosdoshme. Si rrjedhojë, Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 në lidhje me pretendimin për mungesë të një seance publike përpara Kolegjit të Apelit.

Lidhur me respektimin e parimit të sigurisë juridike, Gjykata theksoi se afatet e parashkrimit janë të rëndësishme për respektimin e sigurisë juridike. Megjithatë, Gjykata shtoi se kontrolli i pasurive, si masë në luftën kundër korrupsionit, është specifike, pasi pasuritë normalisht akumulohen gjatë gjithë jetës dhe autoritetet e brendshme kishin detyrimin të vlerësonin ligjshmërinë e të gjitha pasurive të fituara nga subjektet e vlerësimit. Po ashtu, fakti që barra e provës i kishte kaluar kërkueses pas të gjeturave në procedurë paraprake, në procedurat e vetingut nuk nënkupton se procedura në vetvete arbitrarë. Si rrjedhojë, Gjykata vendosi se nuk kishte shkelje të nenit 6 në lidhje me pretendimin e shkeljes të parimit të sigurisë juridike.

Lidhur me pretendimet e parashtrueses së kërkesës nga neni 8 i KEDNJ

Parashtruesja e kërkesës është ankuar se shkarkimi nga detyra dhe ndalimi i përjetshëm për të ushtruar profesionin e gjyqtarës ka qenë i paligjshëm dhe arbitrar.

Gjykata rreth këtij pretendimi shpreh se shkarkimi nga detyra përbënte një ndërhyrje me të drejtën e parashtrueses së kërkesës për respektimin e jetës private, ndërhyrje e cila kishte qenë në përputhje me të drejtën e brendshme dhe në interes të qëllimeve legjitime sipas Konventës. Shkarkimi nga detyra ishte mbase masa disiplinore më e rëndë që mund të jepej ndaj një personi, e cila kërkonte prova shumë bindëse të shkeljeve etike dhe profesionale.

Në vlerësimin e domosdoshmërisë për marrjen e kësaj mase, Gjykata mori parasysh 'nevojën e domosdoshme shoqërore' në Shqipëri për të reformuar sistemin e drejtësisë për shkak të nivelit të lartë të korrupsionit në gjyqësor.

Për sa i përket vlerësimit të pasurive, ajo vuri re se parashtrueses së kërkesës i ishte kërkuar të justifikonte të ardhurat e ligjshme fillestare që kishin shërbyer për blerjen e pasurive të saj, të cilën gjë për disa asete nuk e kishte bere. Gjykata iu referua parimeve ndërkombëtare të cilat kërkojnë që gjyqtarët t'u përmbahen standardeve të larta të integritetit edhe në administrimin e interesave të tyre private jashtë detyrës - përtej çdo qortimi sipas këndvështrimit të një vëzhguesi të arsyeshëm - në mënyrë që të ruajnë dhe forcojnë besimin e publikut dhe të rivendosin besimin në integritetin e gjyqësorit.

Lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, Gjykata vlerësoi se, duke u bazuar në rrethanat e çështjes, organet e vetingut nuk kishin dhënë arsye të mjaftueshme për të justifikuar përfundimin se ishte cenuar besimi i publikut në sistemin gjyqësor për shkak të mos tërheqjes së kërkuases nga gjykimi kushtetues. Për më tepër, Gjykata theksoi se, për një vend të vogël si Shqipëria, nuk mund të kërkohej tërheqja automatike e një gjyqtari i cili kishte lidhje gjaku me një gjyqtar tjetër që kishte marrë pjesë në një gjykim tjetër në lidhje me një ose të gjitha palët e procesit.

Pavarësisht këtij përfundimi, Gjykata çmoi se përfundimet e nxjerra në lidhje me vlerësimin e pasurive ishin mjaftueshëm të rënda sipas të drejtës së brendshme sa të justifikonin shkarkimin nga detyra të parashtrueses, dhe se i njëjti kishte qenë proporcional.

Ndalimi i përhershëm për të rihyrë në sistemin e drejtësisë për shkak të shkeljeve të rënda etike, kishte qenë i pajtueshëm me garantimin e integritetit të detyrës së gjyqtarit dhe të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Ky ndalim ishte i justifikuar edhe për shkak të konsolidimit e sipër të drejtësisë në Shqipëri. Si rrjedhojë, nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës.

Lidhur me pretendimet e parashtrueses së kërkesës nga neni 13 i KEDNJ

Gjykata hodhi poshtë pretendimin se parashtrueses së kërkesës i është mohuar e drejta për mjete efektive juridike. Kjo sepse, znj. A.Xh është ankuar për vendim të Komisionin e Pavarur për Kualifikim të cilën ankesë e ka shqyrtuar Dhoma e Apelit sipas kompetencave të saj dhe të njëjtën e kishte hedhur poshtë si të pa bazuar. Rrjedhimisht, arsyeja se Dhoma e Apelit kishte hedhur poshtë ankesën si të pa bazuar nuk paraqet shkelje të së drejtës për mjete efektive juridike.

1.11. Përfundime relevante për Kosovën

- Ndryshimet kushtetuese kanë lënë hapësirë për përcaktimin e autoriteteve vlerësuese dhe kompetencave të tyre, metodave dhe kritereve të vlerësimit dhe rrjedhimisht kanë zvogëluar probabilitetin e kundërthënies mes dispozitave ligjore dhe kushtetuese
- Gjyqtarët dhe prokurorët aktualë nuk duhet përfshirë në procesin e vetingut në mënyrë që të evitohet mundësia për konflikt të interesit.
- Themelimi i trupave të vetingut sipas parimeve të gjykatave të rregullta ka ndikuar në perceptimin e procesit të vetingut si një proces objektiv.
- Përfshirja e faktorit ndërkombëtar në rolin e monitoruesit ka mundësuar që procesi në tërësi të jetë më objektiv, dhe njëkohësisht lënia e kompetencave të natyrës procedurale ka ndikuar në mos-ndërrhyrje në materien e procesit të vetingut
- Kriteret e vlerësimit dhe i burimeve të informacionit në të cilat bazohet vlerësimi duhet të përcaktohen taksativisht, në mënyrë që të shmanget mundësia e arbitraritetit të organeve të vetingut.
- Performimi i kontrollit të së kaluarës duhet të bëhet nën mbikëqyrjen dhe kontrollin efektiv të institucioneve të rivlerësimit. Do të thotë që informatat e mbledhura nga autoritete e inteligjencës duhet të jenë të qasshme dhe në dispozicion të Institucioneve të rivlerësimit.
- Sanksionimi kushtetues i ndërhyrjes në jetën private për shkaqe nacionale ka mundësuar hulumtim më të gjerë të kontrollit të së kaluarës.
- Duhet të bëhet një veting gradual i cili mundëson ngritjen e kapaciteteve të reja dhe punësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj. Në Shqipëri është nisur nga supozimi se nuk do të ketë shkarkime shumë të mëdha të gjyqtarëve, prandaj, ne mungesë të planifikimit të legjislacionit të mirëfilltë e cila do adresonte saktësisht probabilitetet e rezultateve të sistemit të vetingut, ka rezultuar në numër të madh të shkarkimeve të gjyqtarëve dhe vonesat në ngritjen e institucioneve të tjera të reja të drejtësisë kanë shkaktuar problem në qasjen në gjykata dhe eficiencën e gjyqësorit. Vetëm në Gjykatën Kushtetuese, nga 9 gjyqtar, vetëm tre nuk janë shkarkuar apo nuk kanë dhënë dorëheqje.

- Procesi i vetingut ka pasur jehonë pozitive dhe ka ngjallur interes dhe besim tek publiku. Është rritur numri i denoncimeve (deri me 2018, janë bere 736 denoncime ose ankesa në total për subjektet e vetingut, gjyqtarë apo prokurorë).
- Sipas të dhënave të fundit të KPK janë shkarkuar 155 gjyqtarë dhe prokurorë, pasi kanë hasur probleme me pasurinë, me pastërtinë e figurës ose me aftësitë profesionale, janë marrë 56 vendime për ndërprerje të procesit (dorëheqje), 8 vendime për pushim të procesit, 25 vendime për përfundimin e procesit pa vendim përfundimtar, 3 vendime për pezullimin nga detyra per një periudhë 1-vjecare dhe 174 vendime për konfirmimin në detyrë.
- Qasja e shtetasve te Shqipërisë ne GJEDNJ ka justifikuar pamundësinë ne qasje ne Gjykatën Kushtetuese.
- Parimisht, është lejuar vlerësimi i kushtetutshmërisë se Ligjit per Veting nga ana e Gjykatës Kushtetuese edhe pse vlerësimi i janë nënshtruar edhe anëtarët saj.

1.5.1.2. Përvoja me vetingun në Maqedoninë e Veriut

1. Prapavija

Sistemi gjyqësor i Maqedonisë së Veriut ka përjetuar dy sisteme të ndryshme shoqërore dhe, në parim, ka kryer tre riemërime të gjyqtarëve. I pari ishte ai "revolucionar" në vitin 1944; e dyta ishte emërimi "evolucionar" dhe i pjesshëm, i cili zgjati për dy dekada; dhe e treta ishte riemërimi i përgjithshëm "reformues" i gjyqtarëve në Republikën e Maqedonisë në 1996. Që nga shpallja e pavarësisë nga ish Federata Jugosllave, Maqedonia e Veriut ka përjetuar tre valë të reformave në sistemin gjyqësor duke filluar nga viti 1996. Nga atëherë, ka pas një sërë ndryshimesh kushtetuese e ligjore, por asnjëherë një proces më thelbësor *vetingu*, pavarësisht deklarimeve dhe përpjekjeve të mëvonshme për një gjë të tillë.

Reformat në gjyqësor në Maqedoninë e Veriut janë inspiruar për arsye të ndryshme në periudha të ndryshme kohore. Sidoqoftë, çdo përvojë e reformimit të sistemit gjyqësor në Maqedoninë e Veriut është shtyrë nga dështimet e reformave paraprake qofshin ato *de jure* apo *de facto*. Qëllimi kryesor i këtyre reformave ishte krijimi i një sistemi gjyqësor të pavarur nga dy pushtete tjera dhe luftimi i korrupsionit. Këto reforma ishin po ashtu të shtyra edhe nga faktori ndërkombëtar, e në veçanti nga institucionet e Bashkimit Evropian.

Përshkrimi i përvojës së vetingut në Maqedoninë e Veriut do të fokusohet në reformat e sistemit gjyqësor që ky vend i ka përjetuar gjatë tre periudhave kryesore të reformave gjyqësore pas shpalljes së pavarësisë, respektivisht gjatë periudhës së parë (1996), periudhës së dytë (2005-2006) dhe periudhës së tretë (2018).

2. Reformat në sistemin gjyqësor të vitit 1996

Reformat e vitit 1996 janë iniciuar nga nevoja për krijimin e një gjyqësori të pavarur pas shpalljes së pavarësisë nga ish Federata Jugosllave dhe ndarjen e qartë të kompetencave mes legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit.

Në vitin 1996 ka hyrë në fuqi Ligji për Gjykatat përmes të cilit në tërësi ishte rimodeluar sistemi gjyqësor. Ky ligj ka shfuqizuar gjykatat e specializuara si ato për çështje komerciale apo kundërvajtje dhe ka përcaktuar një proces të përgjithshëm riemërimi (*vetingu*) të të gjithë gjyqtarëve në gjykatat themelore (gjithsej 27) dhe ato të apelit (gjithsej 3).

Sa u përket gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, ligji kishte paraparë se Kryetari i Gjykatës Supreme dhe gjyqtarët e kësaj gjykate, që ishin emëruar mbi bazën e rregulloreve të mëparshme, me mandat të përhershëm, do të vazhdonin të mbanin funksionet e tyre. Kjo zgjidhje, që lironte Gjykatën Supreme nga vetingu, ishte një përpjekje për të siguruar vazhdimësinë në punën e Gjykatës Supreme dhe për të shmangur ndonjë vakum të përgjithshëm në sistemin gjyqësor.

Kushtet e emërimit dhe të lirimit nga detyra të gjyqtarëve ishin të përcaktuara në Ligjin për Gjykatat, derisa procedura ishte detajuar në Ligjin për Këshillin Gjyqësor.

Procesi i emërimit të gjyqtarëve është bërë në dy faza. Fillimisht, Këshilli Gjyqësor ishte përgjegjës për të shpallur thirrjet për pozitat dhe për të bërë përzgjedhjen e gjyqtarëve, ndërsa Kuvendi i Republikës së Maqedonisë vendoste për emërimin e tyre.

Procedura e propozimeve të emërimeve është perceptuar nga publiku si proces transparent ndërsa procesi i emërimit në kuvend është kritikuar për shkak të mungesës së transparencës në vendimmarrje.

Implikimet negative rreth procesit të emërimit kanë rezultuar, *inter alia*, si shkak i votimeve të para organizuara, ku një numër i madh i deputetëve kanë absentuar gjatë votimit. Për më tepër, në seancë plenare të Kuvendit, nuk ka pasur diskutime rreth argumenteve kundër të kandidatëve që nuk janë zgjedhur, pavarësisht faktit që ata ishin propozuar nga ana e Këshillit Gjyqësor, i cili ka bërë verifikimin paraprak të plotësimit të kriterëve për emërim në funksion gjyqësor.

3. Reforma në sistemin gjyqësor e periudhës 2005-2006

Në vitin 2005 është iniciuar amendamenti i Kushtetutës të cilat janë përcjellë me miratimin e ligjeve të reja, në mënyrë që të evitohen të metat e procesit të vetingut të

inicuar në 1996, përmes së cilit gjyqtarët emëroheshin nga Kuvendi, e që konsiderohej si ndërhyrje politike në gjyqësor,

Këto ndryshime kushtetuese kishin përcaktuar një status të ri, si dhe strukturë, përbërje dhe kompetenca të reja për Këshillin Gjyqësor. Tashmë Këshilli i ri Gjyqësor përbëhej nga pesëmbëdhjetë anëtarë, shumica e të cilëve ishin drejtpërdrejt të zgjedhur nga vetë gjyqtarët (8 nga 15 anëtarët). Sipas amendamentit XXIX, Këshilli Gjyqësor *“emëron gjyqtarët dhe gjyqtarët porotë, vendos për përfundimin e funksionit gjyqësor, emëron dhe liron nga detyra kryetarët e gjykatave, monitoron dhe vlerëson performancën e gjyqtarëve; vendosë për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve; vendosë për heqjen e imunitetit gjyqësor; propozon dy gjyqtarë Gjykatës Kushtetuese ...”*.

Qëllimi i këtyre ndryshimeve ishte krijimi i një sistemi tërësisht autonom dhe të pavarur të emërimit, vlerësimit të performancës dhe lirimimit nga detyra të gjyqtarëve. Pra, një sistem që do të funksiononte jashtë presionit politik dhe institucional, që ishte ushtruar në të kaluarën, veçanërisht përmes emërimeve nga pushteti legjislativ.

Këto amendamente kushtetuese ishin konkretizuar përmes miratimit të dy ligjeve kryesore: Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë dhe Ligjit për Gjykatat, të vitit 2006.

Ligji për Këshillin Gjyqësor rregullonte në tërësi procedurën dhe kriteret për vlerësim të performancës gjyqësore, derisa kushtet për largim nga pozita e gjyqtarit ishin të përcaktuara në Ligjin për Gjykatat; përderisa, sërish, procedura ishte e rregulluar në Ligjin për Këshillin Gjyqësor.

Ligji për Gjykatat parashihte dy mënyra të largimit të gjyqtarëve nga pozita:

- a) përmes përfundimit të mandatit gjyqësor dhe
- b) përmes shkarkimit

Këshilli Gjyqësor merrte vendim për përfundim të mandatit gjyqësor për arsyet si në vijim: me kërkesë të gjyqtarit; në rastet kur gjyqtari nuk është më i aftë të ushtrojë funksionin gjyqësor; gjyqtari ka arritur moshën e pensionimit; gjyqtari është dënuar për vepër penale dhe i është shqiptuar një dënim me burgim prej së paku gjashtë muajve; ose nëse gjyqtari është zgjedhur apo emëruar në funksion tjetër publik.

Sa i përket shkarkimit të gjyqtarit, Ligji për Gjykatat përcaktonte dy arsye mbi bazën e të cilave një gjyqtar mund të largohet nga zyra:

Për shkak të shkeljes së rëndë disiplinore që e bën gjyqtarin të diskreditueshëm për të ushtruar funksionin gjyqësor dhe,

a) për shkak të ushtrimit joprofesional dhe të pakujdesshëm (neglizhent) të funksionit gjyqësor sipas kushteve të përcaktuara në ligj.

Shkelje serioze disiplinore konsideroheshin:

- shkelja serioze e rendit publik që e diskrediton gjyqtarin dhe gjykatën;
- shkelja serioze e të drejtave të palëve në procedurë që e diskrediton gjykatën dhe funksionin gjyqësor;
- shkelja e parimit të mos diskriminimit mbi çfarëdo baze;
- Performancë e ulët në punë për më tepër se tetë muaj pa justifikim, në bazë të përcaktimit të bërë nga Këshilli Gjyqësor.

Përveç shkeljeve serioze disiplinore, ligjvënësi kishte sanksionuar edhe situata të lidhura me sjelljen joprofesionale dhe të pakujdesshme (neglizhente) të funksionit gjyqësor sipas kushteve të përcaktuara në legjislacion në fuqi, e që përbënin bazë për shkarkimin e gjyqtarit. Këto shkelje janë si në vijim:

- Jo efikasiteti i gjyqtarit si shkak i zvarritjes së procedurës përmes tejkalimit të afateve për ndërmarrjen e veprimeve procedurale, marrjen e vendimit, publikimin ose përgatitjen e vendimeve gjyqësore në më shumë se pesë raste, ose nëse brenda një viti kalendarik, më tepër se 20 % e numrit të përgjithshëm të rasteve të zgjidhura janë shfuqizuar ose më tepër se 30 % e numrit të përgjithshëm të rasteve të zgjidhura janë ndryshuar;
- Ushtrimi i pandërgjegjshëm, jo në kohë dhe i pakujdesshëm i funksionit gjyqësor;
- Trajtimi jo i barabartë i palëve në procedurë;
- Zbulim i paautorizuar i informacionit të klasifikuar;
- Zbulim publik i informacionit dhe të dhënave në lidhje me rastet gjyqësore për të cilat ende nuk ka aktgjykime përfundimtare;
- Shkelje e qëllimshme e rregullave për gjykim të drejtë;
- Keqpërdorim i pozitës ose/ dhe tejkalim i detyrave zyrtare;
- Cenimi i pavarësisë së gjyqtarit dhe shkelja serioze e Kodit të Gjykatës, që kësajsoj dëmton perceptimin për funksionin gjyqësor;
- Nëse Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konfirmon shkeljen e të drejtës në gjykim të drejtë sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ose një vendim i miratuar nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë që konfirmon shkeljen e të drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme, si rezultat i veprimit të gjyqtarit.

Lista shteruese e arsyeve për shkarkimin e gjyqtarëve ka hapur rrugën për shkarkimin e një numri të konsiderueshëm të gjyqtarëve. Për shkak të shkeljeve të rënda disiplinore dhe ushtrimit joprofesional dhe të pakujdesshëm (neglizhent) të funksionit gjyqësor, Këshilli Gjyqësor ka liruar nga detyra 80 gjyqtarë brenda një periudhe prej pesë (5) vitesh (2010-2014).

Përfundime nga reforma e periudhës 2005-2006

Kjo mënyrë e shkarkimeve të gjyqtarëve ishte mbikëqyrur dhe kritikuar nga Komisioni Evropian për shkak të ndërhyrjes së pushtetit ekzekutiv dhe kontrollit politik në punën e gjyqësorit.

Si rezultat i kritikave të vazhdueshme nga Raportet e Progresit të Komisionit Evropian dhe Rekomandimeve të GRECO-s ishte hartuar dhe miratuar një Ligj i ri për Këshillin për Përcaktimin e Fakteve dhe Inicimin e Procedurave për Përcaktimin e Përgjegjësisë për Gjyqtarët.

Me këtë ligj, krijohet një trup i ri institucional në sistem të drejtësisë, që përbëhet nga nëntë anëtarë dhe që përfshinte gjyqtarë të pensionuar, prokurorë, avokatë dhe profesorë të drejtësisë.

Sipas Komisionit të Venecias, funksionet e këtij Këshilli do të duhej të transferoheshin mbrapa te Këshilli Gjyqësor, duke saktësuar se anëtarët ose trupat e Këshillit Gjyqësor që janë të përfshirë në fazat fillestare të procedurës disiplinore si “akuzues” ose “hetues” të mos merrnin pjesë në vendimin përfundimtar si “gjykatës”.

Në vitet 2015 dhe 2016, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke vepruar në lidhje me rastet e gjashtë gjyqtarëve që kishin pretenduar shkarkim të jashtëligjshëm, kishte nxjerrë katër aktgjykime që përbënin shkelje të **nenit 6 - e drejta në gjykim të drejtë** - të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në procedurat për shkarkimin e të gjashtë gjyqtarëve. Në të gjitha rastet, Gjykata kishte gjetur shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë. **Kjo për shkak të faktit të pjesëmarrjes së Kryetarit të Gjykatës Supreme si në procesin e inicimit të procedurës për shkarkim ashtu dhe në vendimmarrje në meritat e rastit në procedurën e votimit për shkarkim.** Ky detyrim i roleve, ku të njëjtit gjyqtar marrin pjesë si në inicimin e procedurës dhe hetimin e rastit ashtu edhe në vendosjen në meritat e rastit bie ndesh me parimin e objektivitetit. Një rast i tillë, sipas Gjykatës, vë dyshime objektive në paanshmërinë e anëtarit (në këtë rast, kryetarit të Gjykatës Supreme) kur vendos për meritat e rastit.

Në njërin prej rasteve, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përveç pjesëmarrjes së diskutueshme të Kryetarit të Gjykatës Supreme, kishte kundërshtuar pjesëmarrjen e Ministrit të Drejtësisë, i cili kishte marrë pjesë në hetimin e rastit mbi të cilin hetim pastaj ishte mbështetur shkarkimi.

4. Reformat gjyqësore të vitit 2018

Ndryshimet legislative të vitit 2018 kanë rrjedhë si shkak i nevojës së riparimit të imazhit të gjyqësorit dhe për të përmirësuar kualitetin e drejtësisë në vend. Vetë gjyqtarët u pajtuan se sistemi gjyqësor kishte nevojë për pastrim, pasi që vlerësimet aktuale të gjyqtarëve nuk reflektonin realitetin. Intervistat me juristë të shquar në vend konfirmuan perceptimin e gjyqtarëve.

Këto nevoja veçanërisht u parashtruan pas skandalit lidhur me sigurinë kombëtare dhe korrupsionin të vitit 2015, ku janë publikuar komunikime të personave publik të përgjuara në mënyrë të jashtëligjshme. Në njërin prej tyre, për shembull, Kryetari i Këshillit Gjyqësor e informonte kabinetin e Kryeministrit të Qeverisë së Maqedonisë se zgjedhjet gjyqësore do të ndodhnin së shpejti dhe cili gjyqtar do të emërohej e të ngjashme.

Kjo situatë kishte krijuar një krizë politike, e cila është zgjidhur përmes një marrëveshjeje politike - e njohur si Marrëveshja e Përzhinës - me asistencën dhe ndërmjetësimin e parlamentarëve të Parlamentit Evropian. Ndërkohë, Komisioni Evropian kishte përgatitur prioritetet urgjente të reformës mbështetur edhe në rekomandimet e mëparshme të ofruara nga grupet e ekspertëve të pavarur për sundim të ligjit që ishin ftuar të analizonin situatën. Grupi i Ekspertëve *Priebe* ishte caktuar që të shqyrtonte zhvillimet në lidhje me përgjimin e komunikimeve, sistemin gjyqësor dhe prokurorial, dhe mbikëqyrjen e jashtme nga trupat e pavarur, zgjedhjet dhe median.

Në qershor të vitit 2015, Grupi i Ekspertëve të *Priebe*-s kishte publikuar raportet e tij. Grupi kishte ndër tjerash kishte rekomanduar emërimin dhe promovimin e de-politizuar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, i cili do të bëhej sipas kritereve transparente, objektive dhe të mbështetura në mënyrë strikte në merita, dhe duke përdorur procedura transparente të përcaktuara në ligj dhe jo vetëm në rregullore të brendshme, në pajtueshmëri me rekomandimet e Opinioneve të Komisionit të Venecias për emërimet gjyqësore dhe pavarësinë e gjyqësorit, si dhe rekomandimet specifike në lidhje me Republikën e Maqedonisë, shumë prej të cilave nuk ishin zbatuar.

Më vonë në vitin 2017, ky grup me qëllim të vlerësimit të përparimit të bërë në drejtim të zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportin fillestar ka publikuar një raport tjetër, e

cila në veçanti thekson çështjen e *vetingut* të përgjithshëm për të gjithë gjyqtarët. Sipas këtij raporti, vetëm se një numër i gjyqtarëve kanë keqpërdorur detyrën, kjo nuk do të thotë se keq bërja gjyqësore është universal. Pakica e gjyqtarëve të ndikuar politikisht duhet të jetë **subjekt i rregullave efektive profesionale** dhe etike dhe, aty ekziston evidenca që **provon përgjegjësinë penale**, duhet të jetë penalisht përgjegjëse për sjelljen e tyre të ndaluar. Rrjedhimisht, gjyqtarëve të shkarkuar duhet t'i ndalohet ushtrimi i profesionit ligjor në të gjitha nivelet.

Në maj të vitit 2018, Kuvendi i Maqedonisë ka miratuar plotësim-ndryshimet e Ligjit për Gjykatat dhe Ligjit për Këshillin Gjyqësor, në bazë të Strategjisë për Reformë të Gjyqësorit 2017-2022 dhe Planit të Veprimit. Këto amendamente kryesisht përfshinin ndryshime në sistemin për vlerësim gjyqësor dhe shkarkim dhe ishin në funksion të harmonizimit me rekomandimet e Komisionit të Venecias në lidhje me përgjegjësinë disiplinore dhe vlerësimin e gjyqtarëve **(që kryesisht bënin thirrje për fuqizim të kriterëve cilësorë në vlerësimin gjyqësor; shkurtimin e listës së panevojshme të gjatë të rrethanave që mund të nxisin sanksione disiplinore; përcaktimin e qartë/të padiskutueshëm të “fajësisë” si bazë për përcaktimin e përgjegjësisë gjyqësore, etj.)**.

Ligji për Ndryshimin e Ligjit për Gjykatat, *inter alia*, ripërcakton dhe shtjellon shkelje të rënda disiplinore që paraqesin bazë për shkarkim dhe që rezultojnë në masa disiplinore. Sipas ndryshimeve në ligjin e ri, shkelje e rëndë disiplinore e cila përbën bazë për shkarkimin e gjyqtarit konsiderohen:

- anëtarësimi në një parti politike;
- parandalimi i një gjykate më të lartë nga ushtrimi i mbikëqyrjes së performancës gjyqësore;
- përdorimi i funksionit dhe reputacionit të gjykatës për interesa private;
- prishje e rëndë e rendit publik duke dëmtuar reputacionin e gjykatës dhe të tyre reputacioni i vendosur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- rezultate të pakënaqshme të vlerësimit në dy vlerësime të njëpasnjëshme të kryera nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë përmes të cilit konstatohet se gjyqtari është joprofesional dhe neglizhent në kryerjen e funksionit gjyqësor.
- kryerja e funksionit, punës ose veprimtarisë tjetër publike në mos përputhje me ushtrimin e funksionit gjyqësor;
- pranimi i dhuratave dhe përfitimeve të tjera për kryerjen e funksionit gjyqësor;
- Nëse gjyqtari në çështjet për të cilat vendos, nuk arrin të zbatojë pikëpamjet nga aktgjykimet përfundimtare të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe
- ndarjen (zbulimin) e informacionit konfidencial të pranuar gjatë kryerjes së funksionit gjyqësor

Shkelje tjera disiplinore që rezultojnë në masa disiplinore:

- shkelja e rregullave të kodit të etikës për gjyqtarët që dëmtojnë perceptimin e funksionit gjyqësor;
- prishje e rëndë e marrëdhënieve brenda gjykatës që ndikojnë fuqimisht në performancë të funksionit gjyqësor;
- dështimi për të përmbushur detyrat e mentorimit në lidhje me aftësimin profesional të bashkëpunëtorëve;
- mungesa në punë në kundërshtim me rregullat në fuqi;
- mos vijueshmëria e trajnimeve të detyrueshme;
- mosrespektimi i kodit të veshjes,
- dështimi në caktimin e seancave dëgjimore në rastet e caktuara për ta ose në mënyra të tjera që zvarrisin procedurën gjyqësore pa një shkak të arsyetuar ose dështimi për të proceduar çështjen e cila nga ana e tij shkakton çështja të vjetrohët për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale ose më tej zbatimin e sanksionit penal të shqiptuar për një vepër penale. ”

Një ndryshim tjetër i rëndësishëm i Ligjit për Gjykata ka të bëjë me përcaktimin e kriterit kualitativ të performancës së gjyqtarit. Vetë gjyqtarët kanë përkrahur përcaktimin e kriterëve kualitative për vlerësimin e performancës në krahasim më ato kuantitative, pasi që vetëm në këtë mënyre do të rritej kualiteti i gjyqësorit në tërësi. Treguesit e kriterit kualitativ konsistojnë si në vijim:

- cilësia e performancës së gjyqtarit për sa i përket numrit të vendimeve të anuluar për shkak të shkeljes së rëndë të procedurave në lidhje me numrin e përgjithshëm të çështjeve të zgjidhura;
- cilësia e performancës së gjyqtarit për sa i përket numrit të vendimeve të prishura të numrit të përgjithshëm të vendimeve të marra;
- cilësia e procedurave gjyqësore (respektimi i afateve ligjore për ndërmarrjen e veprimeve procedurale, respektimi i afateve ligjore për miratim, shpallje dhe marrja e vendimeve, kohëzgjatja e procedurës gjyqësore dhe respektimi i parimit të gjykimit brenda një kohe të arsyeshme) ;
- cilësia e vendimit të dhënë, e cila do të përcaktohet përmes depërtimit në pesë çështje, të zgjedhura rastësisht nga sistemi i automatizuar i sistemit të informacionit për menaxhimin e çështjeve gjyqësore dhe pesë çështje të zgjedhura nga gjyqtari në periudhën e vlerësimit; dhe
- masa disiplinore e shqiptuar.

5. Përfundime relevante për Kosovën

- Hetimet duhet të targetojnë përgjegjësinë individuale

- Subjekteve të shkarkuar për shkak shkelje të detyrave të funksionit të gjyqtarit (varësisht prej shkeljes së paraparë me legjislacion) duhet t'i ndalohet ushtrimi i profesionit.
- Të evitohet dyzimi i roleve të organeve bartëse të vetingut. Kjo nënkupton se duhet të përcaktohet ndaras se kush e inicion procedurën dhe heton dhe kush vendos për meritat e rastit
- Të shmangët një inkorporimi i gjerë i rrethanave jo shumë relevante që mund të shkaktojnë ndëshkim disiplinor
- Tek vlerësimi i performancës, kriteret kualitative të kenë peshë më të madhe se sa ato kuantitative
- Të vlerësohet integriteti personal i gjyqtarëve

1.5.1.3 Përvoja me vetingun në Serbi

1. Prapavija

Ndër vendet e Evropës Lindore, Serbia ishte e fundit që kaloi të ashtuquajturin “prag minimal” të demokracisë, transferimin e parë të pushtetit nga ish-qeveria socialiste në një qeveri demokratike. Kjo vonesë kishte ardhur si rezultat i çrregullimeve në rajonin të Ballkanit. Më 2009, Serbia dorëzoi kërkesën e saj për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian e cila më 1 mars 2012 pasoi me fitimin e statusit të kandidatit. Për të hyrë në Bashkimin Evropian, Serbia u paraqit para sfidës së reformës radikale në çdo segment, duke përfshirë edhe sistemin gjyqësor. Shtytës për këtë proces ishte edhe presioni publik.

Reformat post-socialiste filluan më 2001 me ndryshimin e ligjeve relevante që adresojnë gjyqësorin.

Në maj 2006, Asambleja Kombëtare miratoi Strategjinë e parë Kombëtare të Reformës në Drejtësi 2006- 2011, i cili u konsiderua si një hap pozitiv për të ardhmen e Serbisë. Fokusi i strategjisë ishte ngritja e pavarësisë, transparencës, llogaridhënies dhe efikasitetit të gjyqësorit

Edhe pse Serbia konsiderohet proces i dështuar që nga ndryshimet kushtetuese dhe ligjore, rasti i saj është trajtuar në këtë dokument për shkak të relevancës së opsioneve të Komisionit të Venecias për ndryshimet në sistemin gjyqësor në Serbi, e që ndriçojnë shumë aspekte rreth vetingut, dhe rrjedhimisht shërbejnë si një udhëzues rreth respektimit të parimeve themelore të gjyqësorit gjatë hartimit të dispozitave të akteve juridike që adresojnë vetingun.

2. Modaliteti dhe reformat

Për implementimin e ndryshimeve në drejtësi, më 2006 Serbia ka miratuar Kushtetutën e re me qëllimin e themelimit të një sistemi gjyqësor dhe Prokurorial të pavarur.

Kushtetuta e vitit 2006 sanksionon rolin dhe kompetencat e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe themelimin e Këshillit Prokurorial të Shtetit (KPS). Ligji Kushtetues për Zbatimin e Kushtetutës ka paraparë riemërimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve publik nga përbërja kalimtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial të Shtetit.

Gjatë vitit 2008, janë miratuar ligjet si në vijim:

- Ligji mbi Organizimin e Gjykatave; Ligji mbi juridiksionin Territorial të Gjykatave dhe Prokurorive Publike; Ligji për Gjyqtarët; Ligji për Këshillin e Lartë Gjyqësor; Ligji për Prokurorin Publik dhe Ligji për Këshillin Prokurorial Shtetëror.

- Ligji për Organizimin e Gjykatave parashikonte zvogëlimin e numrit të gjykatave nga 168 në 64, gjë që ka rezultuar në largimin nga puna të një numri të madh të gjyqtarëve. Ky ligj ka sanksionuar themelimin e gjykatave më kompetencë të përgjithshme, siç janë: gjykatat themelore, gjykata e lartë dhe gjykatat e apelit si dhe Gjykata Supreme e Kasacionit si institucioni më i lartë gjyqësor në vend. Ky ligj po ashtu ka themeluar gjykata me kompetenca të specializuara sic janë, gjykatat komerciale, për kundërvajtje dhe administrative.

Arsyet për këtë reformë, pasi që duke marrë parasysh ngritjen e numrit të rasteve pazgjidhura në gjykatë nuk kishte sens që numri i gjyqtarëve të reduktohej.

- Tutje, Ligji për Gjyqtarët i miratuar më 22 Dhjetor 2008 dhe Kushtetuta e vitit 2006 parashihte “riemërimin e përgjithshëm” të gjyqtarëve, ku të gjithë gjyqtarët në detyrë u lejuan të merrnin pjesë. Sidoqoftë, edhe kandidatëve të rinj iu dha mundësia të aplikojnë në pozitat e hapura të gjyqtarëve, ku fillimisht kandidatët e suksesshëm emëroheshin në mandat 3 vjeçar (periudha provuese), me mundësi të kalimit në mandat të përhershëm.

Kjo nënkupton se është aplikuar një sistem i riemërimit kolektiv të cilët i janë nënshtruar të gjithë, kandidatët për herë të parë në pozita të gjyqtarëve dhe gjyqtarët që veçse ishin në detyrë.

3. Institucionet

Bartës kyç për procesin e riemërimit dhe rivlerësimit ishte Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Bazuar në nenet 156 dhe 157 të Kushtetutës, KLGJ është trup i pavarur dhe autonom i cili siguron dhe garanton që gjykatat dhe gjyqtarët të jenë të pavarur. Ky këshill ka 11 anëtar me mandat 5 vjeçar. Prej anëtarëve të zgjedhur 6 janë gjyqtarë me mandat të përhershëm, 2 janë juristë të shquar me përvojë 15 vjeçare në fushën ligjore, njëri avokat dhe tjetri

profesor i se drejtës. Të tjerët janë Kryetari i Gjykatës së Lartë të Kasacionit, Kryetari i Komitetit të Autorizuar të Asamblesë dhe Ministri i Drejtësisë.

4. Kompetencat

Këshilli i Lartë Gjyqësor emëron dhe shkarkon gjyqtarët si dhe i propozon Asamblesë Kombëtare kandidatët e rinj për gjyqtar. Ky organ nxjerr akte që rregullojnë zbatimin e kritereve të përcaktuara me ligj për zgjedhjen, ngritjen në detyrë dhe përfundimin e funksionit të gjyqtarit.

Procedura e riemërimit

Në 2009, KLGJ ka shpallur thirrjen për aplikim në pozita të gjyqtarëve. Koha për aplikim ishte 15 nga dita e shpalljes. Në 2009, para fillimit të riemërimit të përgjithshëm, KLGJ ka marrë një vendim për themelimin e kritereve dhe standardeve të vlerësimit të aftësive, kualifikimin dhe integritetit të riemërimit të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, në bazë të së cilit ka bërë edhe organizimin e rivlerësimit dhe riemërimit të përgjithshëm të gjyqtarëve.

Në këtë rrjedhë, gjithsej janë hapur 2483 pozita për gjyqtarë në gjykatat e kompetencave të përgjithshme dhe të specializuara, dhe ka pasur 5 030 aplikime, gjysma e të cilave vinin nga gjyqtarët në detyrë. Prej tyre vetëm 1531 gjyqtarë u riemëruan. Më konkretisht, një e treta e gjyqtarëve në detyrë nuk u emëruan dhe numri i përgjithshëm i gjyqtarëve u zvogëlua në një të katërtën.

Gjyqtarët të cilët nuk u riemëruan, nuk u informuan për këtë vendim. Kjo iu ishte bërë e ditur kur u shpallën listat dhe emri i tyre mungonte në listën e gjyqtarëve të emëruar. Pas kësaj, KLGJ mori një vendim të përgjithshëm me një arsyetim të përgjithshëm për të gjithë gjyqtarët të cilën nuk u emëruan.

5. Mekanizmi i apelim

Bazuar në Kushtetutën e Serbisë, gjyqtarët e pakënaqur me vendimin e KLGJ kanë të drejtë ankese pranë Gjykatës Kushtetuese.

Si pasojë e numrit të madh të gjyqtarëve të pa riemëruar, numri i ankesave pranë Gjykatës Kushtetuese ishte shumë i lartë (pothuajse të gjithë gjyqtarët paraqitën ankesë). Pavarësisht faktit se këto raste u shqyrtuan me prioritet nga Gjykata, brenda një viti vetëm për dy nga këto është vendosur. Kjo ka pasur ndikim negativ në respektimin e të drejtave të njeriut, e veçanërisht ne te drejtën për qasje në gjykatë.

Lidhur me vendimin e KLGJ për riemërim, Gjykata Kushtetutës kërkoi sqarim nëse për gjyqtarët të cilët nuk u riemëruan është vendosur me vendim individual të arsyetuar. Këshilli u përgjigj duke u thirrë në faktin se situatat e gjyqtarëve të riemëruar ishin të njëjta dhe për ta do ishin marrë vendime identike. Prandaj e kishte parë të pa nevojshme t'u jepet

një vendim individual gjithë secilit gjyqtar të pa emëruar. Ky rezonim ishte i pa pranueshëm për Gjykatën Kushtetuese dhe rrjedhimisht urdhëroi KLGJ që të përpilonte vendim individual për gjyqtarët e pa emëruar dhe t'i arsyetonte ato. Meqenëse kjo e fundit nuk respektoi këtë urdhër, Gjykata Kushtetuese mori një vendim përmes të cilit shfuqizoi vendimin e KLGJ për shkarkim kolektiv të gjyqtarëve, sepse dispozitat e kontestuara të cilat nuk respektonin garancitë për gjykim të drejtë.

6. Draft-Kriteret dhe standardet për e gjyqtarëve

Ky dokument ka paraparë vlerësimin në tri baza: kualifikimi, kompetenca dhe denjësia e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Denjësia: nënkupton cilësitë etike që një gjyqtar duhet të ketë dhe sjellja në përputhje me ato cilësi. Për gjyqtarët që veçse janë në detyrë ekziston prezumimi se janë të denjë.

Kriteret lidhur me cilësitë etike të kërkuara nga një gjyqtar përfshijnë ndershmërinë, ndërgjegjshmerinë, trajtimin e barabartë të palëve, dinjitetin, këmbënguljen dhe dhënien e një shembulli të mirë. Sipas draftit “shembulli i mirë” nënkupton që gjyqtari duhet të përmbahet nga çdo veprim i pahijshëm, veprim që jep bazë për dyshime, apo ndonjë mënyrë tjetër që do të ndikonte në dobësimin të publikut ndaj gjyqësorit, përmbajtja nga gjuha e urrejtjes, të jetë i paanshëm dhe tolerant, të mos ketë shprehje vulgare etj. Këto vlerësime bazohen në rezultatet e intervistave dhe të tjera metoda të tilla si kryerja e testeve dhe teknika të tjera psikosociale. Këto vlerësime mund të nxirren edhe përmes marrjes së mendimeve të personave me të cilët kanë punuar kandidatët, siç janë gjyqtarët ose anëtarët e avokatisë. **Komisioni i Venecias e vlerësoi këtë teknikë si të vështirë për tu realizuar në praktikë [Opinion Nr. 528 / 2009].**

Kualifikimi: nënkupton njohuritë teorike dhe praktike të nevojshme për performimin e detyrave të gjyqtarëve. Tregues të këtij kriteri janë: kohëzgjatja e studimeve, nota mesatare, suksesi në provimin e Jurisprudencës, arsimit shtesë pasues, punime të botuara dhe rrethana tjera që ndikojnë në njohuritë e gjyqtarit. Komisioni i Venecias këto tregues i ka konsideruar vështirë të matshëm dhe jo reflektues të saktë të kualifikimit real të gjyqtarit.

Kapaciteti (performanca): është i lidhur ngushtë me performancën në punë. Kapaciteti, sipas draftit të vendimit të KLGJ, nënkupton shkathtësitë të cilat i mundësojnë gjyqtarit aplikimin efikas të njohurive ligjore në çështjet për të cilat ai/ajo vendos. Në fjalë të tjera, konsiderohej efikasiteti në punë dhe u vlerësua në baze të treguesve: numri i rasteve të zgjidhura dhe lidhja midis atë numër dhe normën e vlerësuar. Tek performanca në punë janë marrë parasysh kriteret si në vijim: vonesa të pajustificueshme të draftimit të vendimeve; dështimi i pa arsyetueshëm/justifikueshëm për caktimin e seancave dëgjimore; trajtimi jo i duhur i pjesëmarrësve në procedurë dhe stafit të gjykatës, vonim i pa arsyeshëm i procedurës gjyqësore në tërësi ishin disa nga treguesit që u morën parasysh.

Tek vlerësimi i performancës, përveç gjyqtarëve, është matur edhe performanca e asistentëve gjyqësor.

Mënyra e vlerësimit të performancës në punë është kritikuar nga Komisioni i Venecias (Opinion Nr. 528 / 2009). Komisioni i Venecias ka theksuar se kualiteti dhe kuantiteti i punës së gjyqtarëve veprojnë kundër njëra tjetrës. Disa gjyqtar mund të ngarkohen me lëndë shumë më të vështira për t'u zgjidhur, gjë që ndikon në numër më të vogël të rasteve për të cilat vendos gjyqtari. Në anën tjetër, presioni për të zgjidhur më shumë raste mund të ndikojë në kualitetin e punës së gjyqtarit.

Metodologjia e vlerësimit e kapacitetit ishte çështja më diskutabile, për shkak se konsiderohej si tregues jo i mjaftueshëm për vlerësimin e cilësisë së gjyqtarit / prokurorit të punës. Komisioni i Venecias në veçanti theksoi se : *'Fakti që një gjyqtar nuk ka vendosur në numër të madh të rasteve dhe vendimet e saj janë apeluar jo domosdoshmërisht nënkupton jo kompetencë dhe jo profesionalitet të gjyqtarit. Sidoqoftë është e arsyeshme që një gjyqtar vendimet e te cilit janë anuluar, mund të krijojë baze e cila ve në dyshim kompetencën e tij/saj.'* Tutje, theksoi se vlerësimi duhet specifikohet në çdo çështje individuale, duke marrë parasysh kompleksitetin e rasteve të zgjidhura nga gjyqtaret, dhe kur ato janë zvarritur me apo pa fajin e gjyqtarit dhe jo vetëm numri i rasteve të zgjidhura nga gjyqtaret. D.m.th. nuk ka një "one rule fits all".

Vlerësimi i performancës së asistentëve është kritikuar nga Komisioni i Venecias pasi që kanë munguar kriteret objektive për kalkulim dhe për kontributin e asistentit/es në arsyetimin e vendimit gjyqësor.

7. Opinionet e Komisionit të Venecias

Opinion Nr. 405/2006

Lidhur me ri-emërimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve, komisioni i Venecias ka shprehur se një proces kaq i shpejtë dhe gjithëpërfshirës është i pranueshëm vetëm nëse jep garancion të mjaftueshëm se do përformohet në mënyrë të drejtë. Kjo nënkupton se kjo procedurë duhet të bazohet në kritere të qarta dhe transparente dhe se vetëm sjellja e gjyqtarit në të kaluarën në kundërshtim në rolin e një gjyqtari të pavarur mund të jetë arsye për riemërim.

Procedura duhet të jetë fer dhe të kryhet nga trup i pavarur dhe i paanshëm dhe të sigurojë një proces të drejtë për të gjitha palët e interesuara. Duhet të ofrohet mundësia e ankimit në gjykatë të pavarur.

Opinion Nr. 464/2007 për Draft Ligjin për Gjyqtarët dhe Organizimin e Gjykatave

Komisioni i Venecias, edhe njëherë ka ritheksuar faktin se nevoja për riemërimin e gjyqtarëve nuk është krejtësisht e qartë dhe dispozitat e draft ligjit nuk sigurojnë mjaftueshëm zbatimin e drejtë/fer të procesit. Sipas Komisionit, ky draft ligj thjeshtë

përcakton procedurën e ri-emërimit për të gjithë gjyqtarët, si për ata në detyrë edhe për ata që aplikojnë për herë të parë për këtë pozitë. Rrjedhimisht, gjyqtarët aktualë nuk iu është kushtuar trajtim më specifik gjatë zbatimit të procedurës së riemërimit. Të njëjtit për pozitën që kanë pasur duhet të aplikojnë sikurse personat që nuk kanë shërbyer në këtë kapacitet para hyrjes në fuqi i draft ligjit. Kjo në fakt do të thotë se ky proces nuk paraqet proces të "ri-emërimit".

Komisioni e ka parë si problematike çështjen e riemërimit të gjyqtarëve aktual për shkak se e njëjta nuk ka ndonjë bazë kushtetuese dhe ka theksuar se:

"Largimi i gjyqtarëve nga detyra pa përcaktimin e masave siguruese nuk do të ishte në përputhje me parimet e një shoqërie ku ka sundim të ligjit. Sipas Ligjit, siç është hartuar, është e mundur që një gjyqtar ekzistues i cili nuk është as i paaftë dhe as fajtor për sjellje të keqe dhe i cili aplikon për riemërimi do të kalojë në favor të aplikantit tjetër. Ky do të ishte një rezultat i papranueshëm."

Tutje, duhet të specifikohen organet kompetente për iniciimin e kësaj procedure. Po ashtu, rekomandohet që përveç që gjyqtari ka të drejtë të njoftohet për arsyet e fillimit të procedurave të pushimit nga puna kundër tij ose saj, rekomandohet që të specifikohet nëse vetëm gjyqtari/ja që i nënshtrohet procesit ka të drejtë të japë deklaratë lidhur me këtë çështje apo edhe personat e autorizuar nga ai (p.sh përfaqësuesi/ja ligjore). Kundër vendimeve për masa disiplinore ndaj gjyqtarëve, ankimimi duhet t'i drejtohet Gjykatës së pavarur të themeluar me ligj dhe jo organeve tjera, siç është KLGJ.

8. Opinioni i Komisionit Evropian

Komisioni Evropian e ka komentuar procesin e vetingut si proces jo transparent i cili ka vënë në rrezik parimin "gjyqësor i pavarur". Këshillat kanë vepruar në përbërje transitorë, gjë që ka ndikuar në përfaqësim adekuat nga profesionist dhe ka lejuar ndikime politike, sidomos përmes mënyrës së përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit. Opinionet e Komisionit të Venecias për kritere objektive të vlerësimit të performancës nuk u morën parasysh. E drejta e ankimit është kufizuar në qasje vetëm në Gjykatën Kushtetuese dhe është vendosur një sistem uniform i gjykatave.

9. Përfundime (relevante për Kosovën)

- Duhet të definohet baza ligjore për përfundimin e mandatit të gjyqtarëve në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës. Lidhur me këtë duhet pasur parasysh standardet ndërkombëtare dhe parimet themelore të sistemit gjyqësor, veçanërisht kur kemi të bëjmë me shkarkimin e gjyqtarëve me mandate të përhershëm.
- Ka pasur mungesë të stafit administrativ në procedurën e rivlerësimit. Rrjedhimisht, duhet paraprakisht të kalkulohet dhe vlerësohet nevoja dhe eksperiencia e stafit mbështetës në zhvillimin e procesit të vetingut.

- Procesi i vetingut duhet të zhvillohet në mënyrë transparente, veçanërisht sa i përket përzgjedhjes së mekanizmave të vetingut dhe arsyeve të shkarkimit të subjekteve të vlerësimit.
- Lidhur me të drejtën e njoftimit për arsyet e fillimit të procedurave të pushimit nga puna kundër subjekteve të rivlerësimit, rekomandohet që të specifikohet se kush ka të drejtë të japë deklaratë lidhur me këtë çështje, vetëm subjekti i rivlerësuar apo edhe personat e autorizuar nga ai (p.sh përfaqësuesi/ja ligjore).
- Afatet kohore për secilën fazë të vetingut duhet të caktojnë në përputhje me mundësitë reale të zhvillimit të procedurave.
- E drejta e ankimit për gjyqtarët e pa-emëruar ishte e kufizuar në rekursin në Gjykatën Kushtetuese, e cila nuk kishte kapacitetin për të shqyrtuar plotësisht vendimet. Rrjedhimisht, duhet të sigurohet një mekanizëm që vepron si instancë e dytë dhe e cila përmban të gjitha atributet e gjykatave të rregullta.
- Kriteret për vlerësimin e gjyqtarëve duhet të jenë të specifikuar dhe të matshme në praktikë.
- Duhet përcaktuar se cilët janë mekanizmat përgjegjës në kuadër të këshillave për të përformuar vlerësimin e performancës si dhe të përcaktohet se si do bëhet vlerësimi kualitativ dhe kuantitativ i punës së gjyqtarit. Duhet të përcaktohet/themelohet trupi përgjegjës që do të performoj këtë analizë/vlerësim në kuadër të Këshillit Gjyqësor.
- Arsyet për veting nuk ishin të qarta dhe ligjet relevante (për organizim të gjykatave) nuk reflektonte realitetin si dhe nuk kishte rezonim konkret se pse parashihej zvogëlimi i numrit të gjyqtareve.
- Është kritikuar përzgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga Kuvendi, nga i cili konsiderohej të ishte i ndikuar. Rrjedhimisht, duhet vendosur një proces apo të paktën masa siguroese që evitojnë ndërhyrjen e pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv në gjyqësor.
- ‘Vetingu’ në formën e riemërimit kolektiv është kritikuar nga Komisioni i Venecias sepse i ka hapur dyert për shkarkimin e gjyqtareve të cilët nuk kanë bërë ndonjë shkelje. Si i tillë është konsideruar proces jo fer.

1.5.2 Praktika e shteteve të Evropës Lindore

1.5.2.1 Përvoja me vetingun në Moldavi

1. Prapavija

Moldavia është përballur me korrupsion të lartë për shumë vite me radhë dhe është vlerësuar nga organizatat ndërkombëtare të ketë progres të pamjaftueshëm në

parandalimin e korrupsionit në lidhje me anëtarët e parlamentit si dhe në sistemin e drejtësisë tek gjyqtarët dhe prokurorët. Pavarësia e gjyqtarëve ka qenë një nga prioritetet në agjendën e reformave të të gjitha qeverive moldave që nga viti 2009 e tutje. Për këto arsye, Moldavia filloi një reformë në sistemin e drejtësisë me anë të ndryshimeve ligjore dhe kushtetuese për të përmirësuar pavarësinë, llogaridhënien dhe efikasitetin e gjyqësorit.

Procesi i vetingut – ndryshimet ligjore

Me anë të ndryshimeve ligjore Moldavia vendosi procesin e vetingut ta fillojë me anë të disa hapave të ndryshëm. Një nga propozimet e para ishte reduktimi i numrit të gjyqtarëve në Gjykatën Supreme nga 33 sa ishin në 17. Për identifikimin e gjyqtarëve që do të vazhdonin të mbanin pozitën në Gjykatën Supreme pas ri-organizimit, ligji themeloi një trup të veçantë *ad-hoc* jashtëgjyqësor të quajtur Komiteti i Vlerësimit që do të bëjë vlerësimin dhe përzgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme.

Ky Komitet i Vlerësimit përbëhet prej 20 anëtarëve: 2 anëtarë që përzgjidhen nga Parlamenti, 2 nga Presidenca, 2 nga Qeveria, 2 nga Këshilli Superior i Gjyqtarëve, 2 nga Këshilli Superior i Prokurorisë, 4 nga Shoqëria Civile, 6 nga Ministri e Drejtësisë (ekspertë të huaj bazuar në propozimet e organizatave ndërkombëtare partnere të Moldavisë).

Nëse gjyqtari refuzon vlerësimin ose nuk merr pjesë në vlerësim bazuar në datën e përcaktuar nga Komiteti, ai duhet të japë dorëheqje.

Vlerësimi i Gjyqtarëve bëhet në dy faza:

1. Integriteti/mënyra e jetesës dhe
2. Aktiviteti/vlerësimi i cilësive personale.

Më pas Komiteti harton një raport ku përcakton nëse gjyqtari e ka kaluar apo jo vlerësimin. Gjyqtarët që e kalojnë testin vazhdojnë punën në Gjykatën Supreme e nëse numri i tyre do jetë më i madh se 17, vetëm 17 gjyqtarët me më së shumti pikë në vlerësim do të qëndrojnë në Gjykatën Supreme kurse të tjerët do vendosen në gjykata tjera por do të mbajnë pagën sikurse gjyqtarë në Gjykatën Supreme.

Vlerësimi negativ mund të sfidohet nga gjyqtari i rastit me ankesë në Sekretariatën e Komitetit të Vlerësimit. Ankesa vlerësohet nga një bord tjetër vlerësimi që nuk ka marrë pjesë në fazën fillestare të vlerësimit, por mbi të dhënat e mbledhura nga Komiteti i Vlerësimit.

Raporti i lëshuar nga Komiteti i Dytë i Vlerësimit (Bordi) mund të rishikohet me ankesë të gjyqtarit para Këshillit Superior të Gjyqtarëve brenda 14 ditësh në sesion publik dhe Këshilli mund ta refuzoj raportin e vlerësimit dhe ta kthej në Komisionin e Vlerësimit.

Komisioni i Vlerësimit do të japë vlerësimin përfundimtar duke verifikuar të gjeturat e Këshillit Superior dhe vendos nëse do ta mbaj raportin e bordit apo do miratoj raport të ri. Ky raport nuk do të mund të refuzohet nga Këshilli Superior.

Në rast se pa ankimim ose pas ankimimit të pasuksesshëm të raportit ku gjyqtari është vlerësuar negativisht, atij i propozohet ndonjë vend vakant në gjykata tjera pa procedurë konkurrimi. Mirëpo, në rast refuzimi të transferimit, mund të dorëhiqet dhe nuk ka të drejtë të konkurroj sërish për gjyqtar për 10 vite.

Nëse numri prej 17 gjyqtarëve mbetet i paplotësuar, do të hapet konkurs për plotësimin e këtyre pozitave nga Komiteti i Vlerësimit. Vlerësimi i kandidatëve bëhet nga Bordi i Vlerësimit dhe raporti dërgohet tek Këshilli Superior i cili mund ta refuzojë raportin e Bordit. Vendimi final i takon Komitetit të Vlerësimit.

E njëjta procedurë vlerësimi do të zbatohet edhe për Kryetarin dhe zëvendëskryetarin e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore. Procedurë e ngjashme vlen për prokurorët në Zyrën e Prokurorisë Kundër korrupsionit, Prokurorit Gjeneral dhe zëvendësve, kryeprokurorët e Prokurorive Themelore, zyrës së Prokurorit për Luftimin e Krimeve të Organizuara, zyrën e prokurorit të rrethit dhe prokuroritë rajonale.

Përgjegjësia disiplinore dhe vlerësimi i performancës së gjyqtarëve

Moldavia me ligj ka rregulluar arsyet e përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve, kategoritë e shkeljeve disiplinore të kryera nga gjyqtarët, detyrat e institucioneve të përfshira në procedurën disiplinore, si dhe procedurën për shqyrtimin, miratimin dhe apelimin e vendimeve në çështjet disiplinore në lidhje me gjyqtarët.

Shkeljet disiplinore përfshijnë:

- Shkelje e kohës së përfundimit të veprimeve procedural;
- Moskryerja, kryerja me vonesë ose e papërshtatshme e një detyre pune pa një justifikim të arsyeshëm;
- Përdorimi i pozitës së gjyqtarit për të kërkuar ose pranuar zgjidhjen e interesave personale ose të tjerëve, ose për të marrë avantazhe të padrejta.

Me ligj themelohet Bordi Disiplinor që do bëjë ekzaminimin e procedurës disiplinore të gjyqtarëve dhe përbëhet nga 5 gjyqtarë dhe 4 anëtarë të shoqërisë civile.

Procedura para Bordit Disiplinor mund të inicohet nga: personi që iu kanë shkelur të drejtat, anëtar i Këshillit Superior të Gjyqtarëve, Bordi për vlerësimin e performancës së Gjyqtarëve dhe Qendra Kombëtare kundër korrupsionit.

Çështjet disiplinore shqyrtohen nga Bordi Disiplinor i cili miraton një vendim mbi përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarit në fjalë. Bordi mund të vendosë për:

- a. gjetjen e një shkeljeje disiplinore dhe zbatimin e një prej sanksioneve disiplinore (a. Paralajmërim b. Qortim c. Ulje e pagës d. Pushim nga puna);
- b. pushimin e procedurës disiplinore në rast se ka skaduar afati për përgjegjësinë disiplinore;
- c. ndërprerja e procedurës në rast se nuk është kryer ndonjë shkelje disiplinore;
- d. ndërprerja e procedurës në rast të revokimit të njoftimit të paraqitur.

Vendimi i Bordit Disiplinor mund të apelohej pranë Këshillit Superior të Gjyqtarëve i cili mund të mbajë vendimin e njëjtë apo ta pranojë ankesën dhe ndryshojë vendimin. Ky vendim i Këshillit Superior mund të apelohej pranë Gjykatës Supreme.

Këto ndryshime ligjore të parapara nga Moldavia janë dërguar për rishikim tek Komisioni i Venecias i cili dha këto rekomandime:

- Që ky ligj i propozuar të jetë në përputhje me Kushtetutën, të gjitha vendimet në lidhje me transferimin, ngritjen në detyrë dhe largimin nga detyra të gjyqtarëve duhet të merren nga Këshilli Superior i Gjyqtarëve. Këshilli Superior duhet t'i besohet kompetenca për të marrë vendime bazuar në rekomandimet e përfshira në raportin e Komisionit të Vlerësimit. Vendimi i Këshillit Superior duhet të jetë publik dhe plotësisht i arsyetuar dhe duhet të nxitet automatikisht nga raporti i komitetit të vlerësimit.
- Projektligji nuk duhet të parashikojë një ankesë kundër raportit të vlerësimit nga një bord i Komitetit të Vlerësimit në bordin tjetër, por, projektligji duhet të parashikojë një ankesë përpara një organi gjyqësor kundër vendimeve të Këshillit Superior të Gjyqtarëve. Ky organ gjyqësor duhet të projektohet jashtë grupit të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme. Kriteret për zgjedhjen e anëtarëve të saj dhe procedura që duhet të ndiqet duhet të përcaktohen në ligj.
- Kriteret e vlerësimit që duhet të përdoren gjatë procesit të vlerësimit në lidhje me integritetin, profesionalizmin dhe mënyrën e jetesës së gjyqtarëve duhet të tregohen qartë dhe të përcaktohen me ligj.
- Komiteti i Vlerësimit duhet të përbëhet nga një numër substancial i anëtarëve me prapavijë juridike (nëse jo gjysma).

- Nëse një gjyqtar dështon në vlerësim, atij nuk duhet t'i ofrohet një pozitë tjetër as në gjykatat e nivelit më të ulët.
- Barra e kundërt e provës që gjyqtari në vlerësim të largojë dyshimin e Komisionit të Vlerësimit duhet të hiqet

Pas marrjes së rekomandimeve nga Komisioni i Venecias, Moldavia ndërmori disa hapa tjerë legjislativ dhe me procedurë urgjente kërkoi mendim nga Komisioni i Venecias për amandamentimet e ligjit për Këshillin Superior të Gjyqtarëve.

Ligji për Këshillin Superior të Gjyqtarëve në Moldavi përcakton se ky Këshill përbëhet prej 12 anëtarë, prej të cilëve gjashtë gjyqtarë, tre profesorë universitar dhe tre anëtarë sipas detyrës zyrtare që janë Kryetari i Këshillit Superior, Ministri i Drejtësisë dhe Prokurori Themelor, të gjithë me mandat 4 vjeçar. Procedura e organizimit dhe funksionimit të këtij Këshilli është përcaktuar nga Kushtetuta të rregullohet me ligj të veçantë.

Sipas propozimit të ri, Moldavia do të rrisë numrin e anëtarëve të Këshillit Superior nga 12 në 15, prej të cilëve një do të jetë gjyqtar dhe dy të tjerët anëtarë porotë.

Në lidhje me numrin e anëtarëve të Këshillit Superior, Komisioni i Venecias thekson se duhet të arrihet një përbërje e balancuar dhe duke iu referuar Rekomandimit CM/Rec (2010)12 të Këshillit të Ministrave të Këshillit Evropian: *“Jo më pak se gjysma e anëtarëve të këshillave të tillë duhet të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga kolegët e tyre nga të gjitha nivelet e gjyqësorit dhe me respekt për pluralizmin brenda gjyqësorit”*.

Në lidhje me përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Superior, shtatë anëtarët gjyqtarë zgjedhën nga Kuvendi Themelor i Gjyqtarëve me votë të fshehtë, prej të cilëve, katër nga gjykatat themelore, dy nga gjykatat e Apelit dhe një nga Gjykata Supreme. Një përbërje e tillë mirëpritet nga Komisioni i Venecias bazuar në idenë që një përbërje e tillë e rritë përfaqësimin e gjykatave më të ulëta si dhe rritë pluralizmin.

Pesë anëtarët tjerë të Këshillit propozohet të emërohen nga Parlamenti me shumicën e votave të deputetëve të zgjedhur. Mirëpo, shumica e deputetëve që janë prezent konsiderohet si prag i ulët dhe rekomandon që një shumicë prej 2/3 të jetë e nevojshme për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit. Mirëpo, Komisioni poashtu thekson se kërkesa për një shumicë më të lartë (për shembull dy të tretat) mund të bllokojë procedurën e emërimit të anëtarëve porotë për shkak të dështimit për të arritur një shumicë të tillë në rrethanat e Moldavisë.

Procesi i vetingut – ndryshimet kushtetuese

Përveç ndryshimeve ligjore që Moldavia ndërmori për procesin e vetingut, së fundmi qeveria ka paraparë edhe disa ndryshime kushtetuese që i kontribuojnë këtij procesi.

Kushtetuta e Moldavisë parashihte që gjyqtarët të emërohen për 5 vite dhe pas kësaj periudhe mund të emërohen deri në pensionim. Sipas propozimit për amendamentim, kjo periudhë provuese prej 5 vitesh largohet. Një gjë e tillë mirëpritet nga Komisioni i Venecias.

Emërimi i gjyqtarëve

Sipas Kushtetutës së Moldavisë, gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Moldavisë me propozim nga Këshilli Superior i Gjyqtarëve. Sipas amendamentit kushtetues, Presidenti do ta ketë të drejtën për të refuzuar vetëm një herë nominimin e propozuar nga Këshilli Superior. Komisioni i Venecias parasheh se propozimi i gjyqtarëve nga Këshilli Superior dhe emërimi nga Presidenti së bashku me mundësinë për refuzim vetëm një herë është i vlefshëm dhe paraqet një reflektim të ekuilibrit të roleve midis Këshillit Superior dhe rolit politik të Presidentit të shtetit.

Emërimi i gjyqtarëve të Gjykatës Supreme

Sipas Kushtetutës së Moldavisë, gjyqtarët e Gjykatës Supreme emërohen nga Parlamenti me propozim të Këshillit Superior kurse me amendamentin kushtetues propozohet që ky nen të largohet tërësisht në mënyrë që përzgjedhja e të gjithë gjyqtarëve në të gjitha nivelet e gjykatave të bëhet nga Presidenti me propozime nga Këshilli Superior. Edhe sipas mendimit të Komisionit të Venecias, përfshirja e Parlamentit shpie në politizim të emërimit të gjyqtarëve andaj e sheh si pozitiv këtë ndryshim.

Komisioni i Venecias mirëpret veçanërisht:

- heqjen e periudhave provuese për gjyqtarët;
- emërimi i gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Drejtësisë nga presidenti (me veton e njëhershme).
- deklarata në Kushtetutë se të paktën gjysma e anëtarëve të Këshillit do të ishin gjyqtarë të zgjedhur nga kolegët e tyre dhe se anëtarët gjyqtarë të Këshillit Superior duhet të përfaqësojnë të gjitha gjykatat e niveleve të ligjit;
- Ndërkaq, ndryshimet shtesë që i ka rekomanduar Komisioni ishin si në vijim:
- numri i anëtarëve të Këshillit Superior të Gjyqtarëve duhet të përcaktohet me Kushtetutë;
- metoda e zgjedhjes së anëtarëve porotë nga Parlamenti ose me shumicë të cilësuar me një mekanizëm anti-blokim ose me një metodë proporcionale duhet të specifikohet në Kushtetutë por duhet të parashikohet edhe me ligj. Për më tepër,

autoritetet mund të konsiderojnë mundësinë e dhënies së organeve të jashtme, jo nën kontrollin e qeverisë, siç janë Oda e Avokatëve ose fakultetet juridike, për të propozuar kandidatë;

- kërkesa që anëtarët prototë të Këshillit Superior që nuk duhet të jenë “të lidhur politikisht” mund të zëvendësohet me frazën “nuk janë anëtarë të partive politike”;
- në rrethana të veçanta të Moldavisë, mund të jetë e këshillueshme të përmendet në mënyrë të qartë në Kushtetutë se rastet e jashtëzakonshme kur ligji mund të parashikojë që gjyqtarët të pezullohen ose të largohen përfshijnë sjellje korruptive.

2. Përfundime – relevante për rastin e Kosovës

- Nëse procesi i vetingut bëhet me ndryshime ligjore duhet të bëhet në përputhje të plotë me Kushtetutën.
- Periudha provuese e gjyqtarëve duhet të largohet.
- Anëtarët e Këshillit që bën përzgjedhjen dhe vlerësimin e gjyqtarëve duhet që të jenë gjysma me prapavijë juridike dhe sa më përfaqësues të të gjitha niveleve të gjykatave.
- Nëse Kushtetuta parasheh një Këshill përgjegjës për transferimin, ngritjen në detyrë dhe largimin nga detyra të gjyqtarëve, atëherë duhet të jetë po ky Këshill që vendos gjatë procedurës së vetingut me rastin e ndryshimeve ligjore.
- Raportet e vlerësimit të gjyqtarëve nga ndonjë trup tjetër mund të përdoren si bazë për vendimin e Këshillit.
- Kriteret e vlerësimit që do të përdoren gjatë procesit të vlerësimit në procesin e vetingut duhet të listohen qartë dhe të përcaktohen të jenë të përcaktuara me ligj.
- Gjyqtarët nuk duhet të kenë barrën e kundërt e provës për të dëshmuar në proces të vetingut.

1.5.2.2. Përvoja me vetingun në Ukrainë

1. Prapavija

Gjatë viteve 2013 dhe 2014 shumë kryengritje u organizuan kundër qeverisë së udhëhequr nga Presidenti i atëhershëm Viktor Yanukovych, që e kishin origjinën në vendimin e këtij të fundit për tërheqjen e Ukrainës nga Marrëveshja e Asociimit e paraparë me Unionin Evropian në Nëntor 2013. Këto protesta që në Ukrainë u quajtën “Revolucioni i Dinjitetit” ose “Euromaidan” kërkonin vendosjen e integritit Evropian si pjesë të politikës së jashtme të Ukrainës dhe zvogëlim të korrupsionit.

Qeveria e re e zgjedhur në fillim të vitit 2014 nisi një projekt gjithëpërfshirës të reformës institucionale që përfshiu krijimin e katër organeve të reja anti-korrupsion: (a) Byroja Kombëtare Kundër Korrupsionit (NABU), e cila heton rastet e nivelit të lartë të korrupsionit; (b) Prokuroria e Specializuar Antikorrupsion (SAPO), një njësi e pavarur brenda Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm që mbikëqyr hetimet e NABU dhe ndjek çështjet e saj; (c) Agjencia Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit (NAPC), e cila administron sistemin e deklarimit të pasurisë dhe merr pjesë në krijimin e politikave anti-korrupsion; dhe (d) Agjencia e Riparimit dhe Menaxhimit të Aseteve (ARMA), e cila përqendrohet në rikuperimin e asetëve të vjedhura.

Pas debateve të shumta, Qeveria miratoi edhe Ligjin "Për Pastrimin e Qeverisë" që përfshinte një listë të gjerë të zyrtarëve që do të verifikohen (vetohen), përfshirë: Kryeministrin dhe Zëvendës Kryeministrin, Kryetarin e Bankës Kombëtare, Kryetarin e Komitetit Shtetëror për Televizionin dhe Radion; Prokurori i Përgjithshëm; dhe Shefat e Shërbimit të Inteligjencës së Jashtme, Administrata e Gardës së Shtetit, dhe agjencitë e taksave dhe doganave; oficerët, drejtuesit e ndërmarrjeve shtetërore në lidhje me kompleksin ushtarak-industrial dhe të Ministrisë së Brendshme. Në Ligjin "Për Pastrimin e Qeverisë" gjithashtu janë përfshirë pozita gjyqësore si anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, anëtarët e Komisionit të Lartë të Kualifikimit të Gjyqtarëve të Ukrainës, gjyqtarë profesionistë, Shefi i Administratës Gjyqësore të Shtetit të Ukrainës. Individët që janë pjesë të një nga këto kategori të lustracionit u ndalohet të kenë pozita publike për pesë ose dhjetë vjet.

Reforma e vitit 2017

Ukraina ka nisur një reformë gjithëpërfshirëse të gjyqësorit që përfshin miratimin e ligjeve: "Për sigurimin e së drejtës për një gjykim të drejtë" (Shkurt 2015), "Për sistemin gjyqësor dhe Statusin e Gjyqtarëve" (Qershor 2016), "Për Këshillin e Lartë të Gjyqtarëve" (Dhjetor 2016), "Për Gjykatën Kushtetuese" (Korrik 2017) dhe legjislacion të ri procedural. Ligji i vitit 2016 "Për sistemin gjyqësor dhe statusin e gjyqtarëve" parasheh krijimin e një Gjykate të Lartë Kundër Korrupsionit (HACC). Duke qenë se korrupsioni është konsideruar një nga problemet kryesore të Ukrainës, e që edhe vetë pjesët e gjyqësorit janë konsideruar për shumë vite si të dobëta, të politizuara dhe të korruptuara, 6 organizata ndërkombëtare duke përfshirë BE-në dhe donatorët e huaj i kanë bërë thirrje në mënyrë të përsëritur Ukrainës për t'u ngritur një Gjykatë Kundër Korrupsionit (HACC). Kjo është zyrtarizuar gjithashtu si një angazhim në Memorandumin e Mirëkuptimit midis Ukrainës dhe FMN-së në mars 2017.

Një nga shqetësimet më të mëdha në lidhje me Gjykatën e themeluar ishte konformiteti me dispozitat kushtetuese. Kushtetuta e Ukrainës lejon themelimin e "Gjykatave të Larta të Specializuara" por ndalon "Gjykatat e jashtëzakonshme dhe të speciale. Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (CCJE) theksoi në Opinionin Nr. 15 se "meqë gjyqtarët specialistë duhet përmbushur kompleksitetin ose kërkesa të veçanta në fusha të veçanta ligjore është një çështje e veçantë nga krijimi i veçantë, ad hoc ose gjykata të jashtëzakonshme siç diktohen nga rrethanat individuale ose specifike. Ky është një rrezik i mundshëm i këtyre gjykatave që të mos sigurojnë të gjitha masat mbrojtëse të parashikuara në nenin 6 të KEDNJ. Ndërkaq, në anën tjetër mund të theksohet edhe rasti i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *Fruni kundër Sllovakisë* ku Gjykata thotë se neni 6 § 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për të drejtën për një gjykim të drejtë nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj nuk mund të lexohet në kuptimin se ndalon krijimin e gjykatave penale speciale / të specializuara nëse ato kanë një bazë në ligj. Gjykata nuk hyri në diskutime rreth diferencimit midis gjykatave të specializuara dhe atyre speciale, por ajo nuk kishte kundërshtime ndaj konceptit të gjykatës sllovaqe në fjalë e cila kishte në atë kohë juridiksionin penal *ratione personae* e kishte mbi zyrtarë të caktuar publik dhe *ratione materiae* mbi korrupsionin, krimin e organizuar dhe shkelje të tjera serioze. Gjykata tha se "luftimi i korrupsionit dhe krimin të organizuar mund të kërkojë masa, procedura dhe institucione të një karakteri të specializuar".

Ata që argumentojnë se HACC mund të jetë një gjykatë e veçantë ose e jashtëzakonshme kryesisht i referohen juridiksionit të HACC i cili, të paktën pjesërisht, përcaktohet duke iu referuar kategorive të caktuara të zyrtarëve, për faktin se HACC do të ishte i ndarë nga gjykatat themelore dhe subjekt i një numri dispozitash specifike dhe devijimit të procedurës për emërimin e gjyqtarëve të HACC nga procedura e zakonshme.

Juridiksioni i HACC

HACC është kompetente jo vetëm për veprat korruptive *stricto sensu* por edhe për krime të ndërlidhura të tilla si abuzimi i pushtetit ose pozitës zyrtare, pasurimi i paligjshëm dhe pastrimi i parave. Sa i përket rasteve të cilat janë në proces e sipër në momentin kur HACC fillon të funksionojë, këto raste parashihet të vazhdojnë të zhvillohen para gjykatave ku ka filluar procedura.

Sistemi i gjykatave kundër korrupsionit dhe kanalet e ankesës

Sistemi i gjykatave anti-korrupsion përbëhet nga HACC dhe Dhoma Antikorrupsion e Gjykatës së Kasacionit Penal të Gjykatës Supreme (Dhoma Kundër-korrupsion). Brenda HACC vendoset një Dhomë e Apelit, gjyqtarët e së cilës janë kompetentë për të

shqyrtuar vendimet e HACC të cilat mund të apelojnë. Rishikimi i vendimeve të këtyre vendimeve të Dhomës së Apelit brenda HACC bien në kompetencën e Dhomës Kundër-korrupsion pranë Gjykatës Supreme.

Statusi i gjyqtarëve për anti-korrupsion

Për gjykatat kundër-korrupsion dhe gjykatësit janë paraparë masa të përparuar të sigurisë që janë mirëpritur nga Komisioni i Venecias, duke pasur parasysh që ata gjyqtarë do të kenë për të vendosur për çështjet e profilit të lartë të korrupsionit. Madje, Komisioni ka propozuar edhe të konsiderohen skema të posaçme të pagesës së këtyre gjyqtarëve, por të mos devijohet shumë nga rregullat gjenerale.

Procedura legjislative

Sipas Kushtetutës së Ukrainës, gjykatat themelohen, riorganizohen dhe shpërbëhen me ligj, dhe projektligji për ato çështje duhet t'i paraqitet organit legjislativ nga Presidenti i Ukrainës pas konsultimit me KLGJ. Disa vëzhgues argumentojnë se kjo dispozitë është shkelur që kur projektligji u paraqit në Parlament nga deputetët dhe jo nga Presidenti i Ukrainës.

Fusha e kompetencave të gjyqtarëve të specializuar

Komisioni i Venecias në opinionin e tij ka vlerësuar se kompetencat e gjyqtarëve të specializuar sipas projektligjit nuk janë mjaft të qarta. Drafti i referohet "krimeve të korrupsionit" dhe "kundërvajtjeve administrative në lidhje me korrupsionin". Duket e nevojshme të përcaktohet më qartë se cilat shkelje do të binin në ato koncepte. Për shembull, termi "krime korrupsioni" mund t'i referohet veprave penale në detyrë sipas Kodit Penal, andaj një specifikim i këtyre kompetencave është i domosdoshëm.

Përzgjedhja dhe mbrojtja e gjyqtarëve të specializuar

Është me rëndësi të madhe që gjyqtarët e specializuar për nivelet e larta rastet e korrupsionit të zgjidhen në një proces transparent bazuar në kritere objektive. Është gjithashtu kritike që gjyqtarë të tillë të mbrohen në mënyrë adekuate nga ndikimet e jashtme - p.sh. ndikimet politike, apo ndikimi dhe nga ndonjë sulm i mundshëm ndaj pavarësisë dhe sigurisë së tyre.

Rekomandimet e Komisionit të Venecias

- Komponentët kryesorë të këtij projektligji të mirëmbahen, përkatësisht krijimi i një HACC-je të pavarur dhe shkallës së apelit gjyqtarët e së cilës janë me reputacion

të pa të metë dhe zgjidhen në bazë të konkurrencës në një mënyrë transparente. Përkohësisht, organizatave ndërkombëtare dhe donatorëve aktivë në sigurimin e mbështetjes për programet antikorrupsion në Ukrainë duhet t'u jepet një rol vendimtar në organin që është kompetent për zgjedhjen e gjyqtarëve të specializuar anti-korrupsion, i ngjashëm me rolin e parashikuar për ta në projektligj.

Juridiksioni i HACC dhe shkallës së apelit duhet të korrespondojë me atë të Byrosë Kombëtare Antikorrupsion (NABU) dhe të Prokurorisë Speciale Kundër Korrupsionit (SAPO), në varësi të kërkesës që juridiksioni i gjykatave të përcaktohet saktësisht nga ligji.

· Duhet futur masa mbrojtëse shtesë për të siguruar që organi vendimmarrës në procedurën e emërimit të gjyqtarëve është mjaft i pavarur nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ. Kjo mund të arrihet, për shembull, duke dhënë një agjenci jo-politike siç është Komisioni i Lartë i Kualifikimit të Gjyqtarëve e drejta për të nominuar anëtarë në atë organ, përveç anëtarëve të propozuar nga donatorët ndërkombëtarë. Mirëpo, procedura për përfshirjen e organizatave ndërkombëtare dhe donatorëve në procedurën e përzgjedhjes duhet të rregullohet më hollësisht në mënyrë që të sigurojë një shkallë të lartë transparence dhe pajtueshmërie me Kushtetutën.

Ndryshimet në vitin 2019

Në vitin 2019 ndryshimet në kornizën ligjore në Ukrainë u paraqitën në rregullimin e Gjykatës Supreme dhe organeve gjyqësore të vetëqeverisjes.

Ligji Nr. 193-IX paraqiti ndryshime të mëdha në tre fusha kryesore:

- a. rregulla të reja për strukturën dhe rolin e Këshillit të Lartë të Gjyqtarëve dhe për përbërjen dhe statusin e Komisionit të Lartë të Kualifikimit të Gjyqtarëve,
- b. rregullat për zvogëlimin e numrit të gjyqtarëve në Gjykatën Supreme,
- c. rregullat për masat disiplinore.

Ligji për pastrimin e Qeverisë përfshinte edhe personat që në periudhën 2013-2019 kanë mbajtur pozita të Kryesuesit dhe zëvendës kryesuesit të Komisionit të Kualifikimit të Gjyqtarëve

Komisioni i Venecias tha disa përfundimeve në lidhje me këto ndryshime:

- Mirëpriti largimin e neneve që lustrimi mos të përdoret për zyrtarë që nuk janë të mirëseardhur nga qeveritë e mëparshme pas ndryshimit demokratik të qeverive.
- Theksoi që një reformë e madhe të jetë e suksesshme, nuk është e mjaftueshme ta "bësh atë mirë" në thelb. Procedura e përshtatjes është po aq e rëndësishme sa substanca. Një konsultë e duhur me të gjithë palët e interesit është thelbësore për ta bërë një reformë të besueshme dhe për të siguruar që ajo të jetë e pranueshme edhe për ata që e kundërshtojnë atë, në mënyrë që të mbijetojë nga ndryshimet e qeverisë me kalimin e kohës.
- Delegacioni i Komisionit të Venecias mësoi se palët kryesore të interesit në Gjyqësor, të tilla si Gjykata Supreme, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Komisioni i Lartë i Kualifikimit ose Avokatia, u ankuan se nuk ishin konsultuar në përgatitjen e projektligjit dhe komentet që ata bënë me iniciativën e tyre pasi projektligji u bë i qasshëm, nuk u diskutuan në detaje gjatë procedurave parlamentare.
- Përgatitja dhe miratimi i projektligjit ishte pjesë e një programi të gjerë legjislativ të Presidentit të sapo zgjedhur të Ukrainës, i cili paraqiti më shumë se 100 projektligje në një ditë të vetme. Është e pashmangshme që në një program kaq të gjerë legjislativ disa projektligje të përmbajnë mospërputhje.

Stabiliteti i kornizës ligjore dhe sistemit gjyqësor

Komisioni i Venecias kujton se, sipas Listës së Kontrollit të Sundimit të Ligjit, qartësia, para shikueshmëria, qëndrueshmëria dhe koherenca e kornizës legjislative, si dhe qëndrueshmëria e legjislacionit, janë shqetësimet kryesore për çdo rend ligjor të bazuar në parimet e sundimit të ligji.

Reforma e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Kualifikimit të Gjyqtarëve

Komisioni i Venecias rekomandon që struktura e organeve gjyqësore të jete koherente dhe e thjeshtë. Në Ukrainë është një sistem i veçantë i organeve gjyqësore i përbërë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) i cili është trup kushtetues dhe Këshilli i Lartë për Kualifikimin e Gjyqtarëve (KLKGJ) i cili është i themeluar me ligj dhe është konsideruar si relikth historik për shkak se KLGJ ishte vështirë të reformohej për shkak të kufizimeve kushtetuese. Projektligji përcakton se KLKGJ është "një organ publik kolegjal i qeverisjes gjyqësore që funksionon mbi një bazë të përhershme në sistemin e drejtësisë të Ukrainës". Do të ishte e preferueshme nëse ky nen do të përcaktonte qartë pozicionin e KLKGJ në lidhje me KLGJ, veçanërisht se ai është në varësi të KLD.

Sipas Projektligjit propozohet një formë e re e procedurës së formimit të KLKGJ që do të përbëhet nga 12 anëtarë me mandate 4 vjeçare të përzgjedhur nga KLGJ në proces kompetitiv dhe krijohet një subordinim i KLKGJ me KLGJ, që mirëpritet nga Komisioni i Venecias. Me hyrjen në fuqi të një prej ligjeve paraprake, të gjithë anëtarët e KLKGJ janë larguar dhe kjo ka bërë të ndërpriten të gjitha vlerësimet e gjyqtarëve në instancat e para dhe të dyta, gjë që sjell probleme të mëdha për qytetarët. Projektligji propozon themelimin e dy komisioneve në kuadër të KLGJ: Bordin Përzgjedhës për emërimin e anëtarëve të KLKGJ dhe Komisionin e Etikës dhe Integritetit që mbikëqyrë sjelljen të KLGJ dhe të KLKGJ. Që të dy komisionet përbëhen nga 3 anëtarë ndërkombëtarë dhe 3 kombëtarë.

2. Përbërja e KLKGJ

Anëtarët e KLKGJ përzgjidhen nga Bordi Selektues që përbëhet nga 3 anëtarë nga Këshilli i Gjyqtarëve dhe 3 ekspertë ndërkombëtarë që propozohen nga organizatat ndërkombëtare që Ukraina bashkëpunon në fushën e luftimit të korrupsionit. Komisioni i Venecias në opinionin e saj ka paraparë që përkohësisht, organizatave ndërkombëtare dhe donatorëve të ju jepet një rol thelbësor në seleksionimin e gjyqtarëve që do merren me rastet kundër korrupsionit, deri kur të arriten rezultatet e parapara. Problem i madh në këto ndryshime të propozuara nga Komisioni shihet fakti që këto ndryshime shumë herët, në mes të një periudhe kur gjyqtarët janë duke u testuar në instancë të parë dhe të dytë. Anëtarët e KLKGJ së paku është dashur të vazhdojnë punën deri në momentin kur zëvendësohen.

Ligji parashikon gjithashtu futjen e një Bordi të Integritetit dhe Etikës, që funksionon në KLGJ për të siguruar transparencën dhe llogaridhënien e anëtarëve të KLGJ dhe KLKGJ. Bordi i Integritetit dhe Etikës është një lloj organi mbikëqyrës mbi të dy organet, i cili vlerëson pajtueshmërinë e anëtarëve të tyre me parimet e integritetit dhe standardet etike të një gjykatësi si një përbërës integrale e etikës profesionale.

Reduktimi i numrit të Gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe përzgjedhja e gjyqtarëve

Amandamentimi i propozuar parasheh reduktimin e numrit maksimal të gjyqtarëve në Gjykatën Supreme nga 200 sa ishin në 100. Komisioni i Venecias vlerëson se numri i gjyqtarëve në Gjykatën Supreme ndryshon nga vendi në vend dhe nuk ka një numër ideal. Për secilin vend, numri i duhur varet nga ligjet procedurale, kultura ligjore, cilësia e punës në shkallët më të ulëta dhe besimi i përgjithshëm i njerëzve në sistemin e drejtësisë. Besimi i ulët në sistemin gjyqësor mund të çojë në një numër më të lartë të ankesave. Mirëpo, në rastin e Ukrainës nuk ka pasur arsyeshmëri një propozim i tillë dhe se nuk i është bërë vlerësim i ndikimit. Gjyqtarët në Gjykatën Supreme do të vlerësohen bazuar në kriteret e aftësive profesionale, etikës dhe integritetit. Ulja e numrit të gjyqtarëve do të shkaktojë një

numër akoma më të lartë të çështjeve të pazgjidhura dhe do të rrezikojë funksionimin e Gjykatës Supreme. Për shkak të ngarkesës së rëndë aktuale të çështjeve (rreth 70.000 raste), Gjykata nuk do të jetë në gjendje të sigurojë gjykime të arsyetuara siç duhet brenda një kohe të arsyeshme, sipas Nenit 6 të KEDNJ-së. Si Komisioni i Venecias ashtu edhe Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (CCJE) kanë pohuar se për të mos rrezikuar pavarësinë e gjyqësorit, vlerësimet dhe masat disiplinore dhe proceset duhet të diferencohen qartë. Në fakt, Opinioni i CCJE nr. 17 parasheh: “Disa pasoja, të tilla si shkarkimi nga detyra për shkak të një vlerësimi negativ, duhet të shmangen për të gjithë gjyqtarët që kanë marrë mandatin e përhershëm, përveç në rrethana të jashtëzakonshme”.

3. Përfundimet relevante për Kosovën

- Ndryshimet ligjore të bëhen në përputhje me Kushtetutën sepse në Ukrainë Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar si kundër kushtetuese disa prej ligjeve të propozuara
- Organet gjyqësore të kenë strukturë sa më të thjeshtë dhe në harmoni me njëra tjetrën
- Vetingu duhet të bëhet duke i koordinuar maksimalisht institucionet në mes vete
- Gjatë procedurës së vetingut të mos mbesin shumë vende vakante që përkeqëson gjendjen sidomos kur vendi ka numër të lartë të rasteve të pazgjidhura
- Personat/ gjyqtarët që do bëjnë vetingun të kenë masa sigurimi
- Procesi i vetingut të mos bëhet në formë të fragmentuar dhe duke nxjerrë shumë ligje por të bëhet në formë gjithëpërfshirëse me sa më pak ligje që është e mundur

1.5.2.3 Përvoja me vetingun në Armeni

1. Prapavija

I ashtuquajtur “Revolucioni Kadife” kulmoi me ndryshimin paqësor të pushtetit në Armeni në vitin 2018. Qeveria e re trashëgoi një shtet të zhytur në korrupsion, me sundim të dobët të ligjit dhe me nivel të lartë të varfërisë

Meqenëse qeveria e re kishte shumicën e nevojshme kushtetuese, u paralajmëruan iniciativë madhore dhe e gjerë e vetingut për të vlerësuar përshtatshmërinë e gjyqtarëve në detyrë. Qëllimi i procesit të vetingut ishte një gjyqësor efektiv dhe i drejtë, përmes zbulimit të lidhjeve të gjyqtarëve me regjimin e kaluar dhe trashëgiminë autoritare. Qeveria shpejt hoqi dorë nga qëllimet superlative dhe zgjodhi si metodë dialogun me shoqërinë civile dhe hisedarët ndërkombëtar rreth asaj se si do të duhej të duket vetingu. Me zhvillimin e një procesi të gjerë dhe gjithëpërfshirës të konsultimit publik, Qeveria arriti të hartojë një proces vetingu të definuar më mirë.

2. Modaliteti

Me qëllim të zhvillimit të procesit të vetingut, në vijimësi të ndryshimeve përkatëse kushtetuese, Armenia hartoi një pako ligjesh për të komplementuar procedurën e verifikimit të pasurisë së deklaruar të gjyqtarëve, përgjegjësini disiplinore dhe vlerësimin periodik. Pakoja ligjore gjithashtu përcaktoi një skemë të pensionimit të parakohshëm të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

3. Trupat e Vetingut

Pakoja ligjore propozoi ndryshimin e strukturës ekzistuese institucionale dhe sidomos përbërjes dhe funksioneve të organeve disiplinore. Sipas përcaktimit kushtetues të Armenisë, administrimi i gjyqësorit bëhet nga Këshilli Suprem Gjyqësor. Asambleja e Përgjithshme e Gjyqtarëve është një organ tjetër që përbëhet nga të gjithë gjyqtarët dhe funksionon në komisione të specializuara. Një nga këto komisione është Komisioni Disiplinor, që ka kompetencë të ngritë çështje disiplinore kundër gjyqtarëve përpara Këshillit që njëherësh është instanca e fundit sa i përket çështjeve disiplinore.

Reforma e vetingut ka paraparë ndryshime në përbërjen dhe funksionet e pikërisht këtyre komisioneve të specializuara të Asamblesë. Kompetenca për të ngritur çështje disiplinore përpara Këshillit i është njohur tri komisioneve: Komisionit për Etikë dhe Disiplinë të Asamblesë së Përgjithshme të Gjyqtarëve, Ministrin të Drejtësisë dhe Komisionit për Parandalimin e Korrupsionit (me kompetencë speciale lëndore, lidhur me deklarin e pasurisë së gjyqtarëve). Risi e reformës ligjore ishte se në përbërjen e Komisionit për Etikë dhe Disiplinë të Asamblesë së Përgjithshme të Gjyqtarëve, u përfshin edhe juristë të shquar, të nominuar nga organizatat e shoqërisë civile.

Komisionit për Etikë dhe Disiplinë të Asamblesë së Përgjithshme të Gjyqtarëve mund të iniciojnë çështje disiplinore mbi bazën e ankesave, informatave nga shtypi etj. Parimisht, shërben si “filtër” i rasteve të palejueshme dhe për këtë qëllim mund të zhvillojnë hulumtime paraprake mbi bazën faktike të pretendimeve për shkelje etike. Vendimmarrja i takon Këshillit Gjyqësor Suprem. Për këtë qëllim, mbahen seanca të shqyrtimit. Vendimet merren me shumicë të cilësuar. Ky mekanizëm bën vlerësimin dhe kontrollin e integritetit të atyre që për herë të parë marrin detyrën si gjyqtarë.

Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit shqyrton deklarinet financiare të gjyqtarëve dhe mund të iniciojë procedurë disiplinore pranë Këshillit Gjyqësor Suprem në rast se gjen parregullsi në deklarin. Në shqyrtimin e këtij aspekti të ligjit në fjalë, Komisioni i Venecias përmendi se kontrolli i deklarimeve financiare mund të bëhet nga një trup i brendshëm i

Këshillit ose nga një trup i jashtëm, siç është rasti i këtij Komisioni¹¹³. Përderisa modeli i parë është tregues i pavarësisë së gjyqësorit, atij i mungon transparenca. Prandaj, sipas modelit të kryerjes së këtij funksioni nga një trup i jashtëm, shqyrtimi i deklarimeve financiare të gjyqtarëve bëhet njësoj sikurse ai i deklarimeve të funksionarëve të tjerë publikë. Ky mekanizëm bën analizën e pasurisë dhe kontrollin e statusit pasuror të atyre që veçse janë gjyqtarë në detyrë, në momentin kur nisi reforma.

Njohja e kompetencës së Ministrisë të Drejtësisë për të iniciuar procedurë disiplinore kundër një gjyqtari pranë Këshillit Suprem Gjyqësor, fillimisht është parë me rezervë nga Komisioni i Venecias. Sidoqoftë, meqenëse Ministri ka kompetenca vetëm për inicim dhe jo vendimmarrje, kjo kompetencë është vlerësuar si e pranueshme.

Këshilli Suprem Gjyqësor vepron si gjykatë dhe zhvillon procedurë parimisht gjyqësore. Shqyrtimi ka karakter kundërshtues (*adversarial*) dhe gjyqtarit në procedurë i ofrohen të gjitha garancitë procedurale sikurse një pale në procedurë penale. Në anën tjetër, ligji garanton pavarësinë e Këshillit Suprem Gjyqësor, përmes dispozitave që parashohin emërimin e anëtarëve dhe kohëzgjatjen e mandatit të tyre. Ky sistem është në përputhje me një opinion të mëparshëm të Komisionit të Venecias, ku u përcaktua se procedurat disiplinore duhet të zhvillohen nga një autoritet ose gjykatë e pavarur që garanton të drejtën në gjykim të drejtë.

4. Barra e provës

Fillimisht, personat që vetohen dorëzojnë bashkë me dokumentet tjera, pyetësorin e plotësuar për vlerësimin e integritetit. Në pyetësor ofrohen të dhëna rreth pasurisë së personit, shkollimit, punësimit, të dhëna nëse ka bërë ndonjëherë shkelje penale, administrative ose disiplinore. Shtesë kësaj, Komisioni do të mbledhë informacion nga databaza të ndryshme, organe kompetente, media tradicionale dhe rrjete sociale.

Komisionit për Parandalimin e Korrupsionit i njihet me ligj qasja në regjistrim kadastral, byrotë kreditore, Bankën Qendrore të Armenisë, me qëllim të sigurimit të të dhënave rreth personit dhe familjarëve të tij. Komisioni nuk ka qasje sa i përket të dhënave sipas Ligjit për Sekretin Bankar. Është përmendur se zgjerimi i këtij 'hulumtimi' tek anëtarët e familjes dhe të afërmit e personit është bërë me qëllim të zbulimit nëse pasuria është regjistruar në emër të dikujt tjetër, për të fshehur gjurmët e korrupsionit.

Komisioni i Venecias ka vlerësuar se mundësimi i qasjes së këtij Komisioni tek të dhëna "të përgjithësuara" financiare dhe rreth transaksioneve në vlera të mëdha të gjyqtarit, nuk e

¹¹³ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)024-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)024-e)

cenojnë privatësinë e tij. Sidoqoftë, do të ishte e tepërt sikur Komisioni të kishte qasje në informata shumë të detajuara për edhe transaksionet më të vogla të gjyqtarit. Në këtë rast, do të mund të cenohej privatësia e gjyqtarit apo familjarëve të tij. Informatat e këtij niveli mund të sigurohen vetëm në procedurë penale, ku ekzistojnë garancitë e nevojshme procedurale.

Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit do të hartojë rekomandime të cilat do t'ia prezantojë Këshillit. Përndryshe, nëse nga kjo analizë e dokumenteve hetohen shkelje penale, atëherë Komisioni njofton autoritetet kompetente të ndjekjes penale për ekzistimin e mundshëm të elementeve të kryerjes së një vepre penale. Ngjashëm, nëse hetohen shkelje administrative, do të iniciohet procedura përkatëse për shkelje administrative.

5. Ankesa

Vendimi i Këshillit nuk mund të apelohej përpara gjykatave të rregullta. Shqyrtimin e ankesave e bën vetë Këshilli, sipas një procedure të ashtuquajtur të veçantë.

Komisioni i Venecias e ka kritikuar këtë “mekanizëm të apelit”, për të cilin ka vlerësuar se nuk mundëson apelim në plot kuptimin e fjalës, meqenëse faktikisht, rasti hapet për rishqyrtim nga po i njëjti trup që e ka vendosur një herë, mbi bazën e rrethanave të reja që mund të jenë paraqitur. Nocioni i apelit sipas Komisionit të Venecias, në esencë nënkupton kontrollin nga një trup tjetër të ligjshmërisë dhe meritave të një vendimi, mbi bazën e po të njëjtave fakte.

Komisioni i Venecias ka tërhequr vërejtjen se një situatë e tillë lehtësisht bie ndesh me përcaktimet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe cenon seriozisht të drejtën në gjykim të drejtë sipas nenit 6 të Konventës, që garanton shprehimisht qasjen në një gjykatë. Në këtë rast, do të duhej të shqyrtohej nëse Këshilli Gjyqësor Suprem përbën gjykatë në kontekst të realizimit të së drejtës sipas nenit 6 të Konventës. Në një rast të ngjashëm Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë, GJEDNJ gjeti se Këshilli i Lartë Gjyqësor Portugez ishte trup administrativ dhe se për t'u përmbushur e drejta e garantuar sipas nenit 6 të Konventës, palës së pakënaqur do të duhej t'i mundësohej kontrolli i mëtejshëm nga një trup gjyqësor me juridiksion të plotë. Prandaj, edhe nëse ligji e proklamon Këshillin Gjyqësor si gjykatë, GJEDNJ mund të gjej se ai trup nuk përmbush kërkesat për të qenë trup gjyqësor dhe si rrjedhojë, mos përmbushje të nenit 6 të Konventës për të drejtën në apelim përpara një gjykate sipas ligjit.

6. Përfundime relevante për Kosovën

Komisioni i Venecias kritikoi negativisht kompetencën e Komisionit të Etikës për të interpretuar rregullat e sjelljes dhe rregullat e etikës. Sipas një skenari të tillë, i bie që Komisioni do të bëjë vlerësime të sjelljes dhe etikës sipas rregullave që i ka interpretuar vetë me kërkesë të gjyqtarëve, në procedurën kundër po këtyre gjyqtarëve. Komisioni i Venecias propozoi që të krijohet një pozitë e ndarë e këshilltarit të etikës, me kusht që ky person të mos marrë pjesë gjatë shqyrtimit të pretendimeve lidhur me shkeljen e rregullit që e ka interpretuar vetë.

- Komisioni i Venecias përmendi se kontrolli i deklarimeve financiare mund të bëhet nga një trup i brendshëm i Këshillit Gjyqësor Suprem ose nga një trup i jashtëm, siç është rasti i Komisionit për Parandalimin e Korrupsionit. Përderisa modeli i parë është tregues i pavarësisë së gjyqësorit, atij i mungon transparenca. Prandaj, sipas modelit të kryerjes së këtij funksioni nga një trup i jashtëm, shqyrtimi i deklarimeve financiare të gjyqtarëve bëhet njësoj sikurse ai i deklarimeve të funksionarëve të tjerë publikë.

- Sipas Opinionit të Komisionit të Venecias, nuk ka përgjigje definitive në atë se çfarë trupi duhet të kryej kontrollin financiar. Kjo varet kryekëput nga historia, traditat, struktura administrative dhe situata faktike e shtrirjes së korrupsionit brenda sistemit të shtetit të caktuar. Nëse ekziston arsyeshmëria, atëherë mund edhe të themelohen trupa të veçantë hetimor dhe prokurorë të specializuar për luftimin e korrupsionit në gjyqësor.

- Në çështjen e dizejnit të një reforme të vetingut, sipas Komisionit të Venecias, pyetja me rëndësi nuk është se kush ka kompetencë për të iniciuar procedurat disiplinore, por kujt i takon vendimmarrja lidhur me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarit.

- Sipas Komisionit të Venecias, është i pranueshëm modeli sipas të cilit vendimmarrja është e rezervuar për Këshillin Gjyqësor Suprem. Ky model është në përputhje me përcaktimin e Komisionit të Venecias se procedurat disiplinore duhet të zhvillohen nga një autoritet ose gjykatë e pavarur që garanton të drejtën në gjykim të drejtë.

- Sipas vlerësimit të Komisionit të Venecias, në procedurë disiplinore duhet të ketë gjithsesi mekanizëm të apelit të vendimit dhe shkallë të dytë të shqyrtimit të ankesës. Kjo është kërkesë themelore e të drejtës në gjykim të drejtë, sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Sidoqoftë, ky trup nuk është e domosdoshme që të jetë gjykatë në kuptimin e parë për se, por funksionalisht mekanizëm që ushtron juridiksion të shkallës së dytë mbi çështjen.

1.5.2.4 Përvoja me vetingun në Poloni

1. Prapavija

Me rënien e regjimit komunist në Evropën Qendrore dhe Lindore në fund-vitet '80 dhe fillim vitet '90, shtetet e reja nisën odisejadën e gjatë e të rëndë drejt krijimit të sistemeve të forta demokratike. Me qëllim të sjelljes së drejtësisë dhe njëkohësisht ristrukturimit politik e shoqëror mbi vlerat e demokracisë, shtetet e ish-Bllokut Komunist, përfshirë Poloninë, iniciuan procese të ashtuquajtura të "lustrimit". Polonia inicioi për herë të parë procesin e lustrimit më 1997 dhe më pas më 2006. Përgjithësisht, lustrimi si koncept ishte proces vetingu, që nënkuptonte një proces vlerësimi dhe ekzaminimi të figurës së personave të caktuar abuzivë e korruptiv, që kishin punuar dhe bashkëpunuar me regjimin e rënë, me qëllim të largimit të tyre nga pozita publike me ndikim përmes një procedure të drejtë. Pra procesi i lustrimit në Poloni u shqua si "lustrim komunist" dhe në esencë, ishte proces i drejtësisë tranzicionale. Objekt verifikimi ishte vetëm nëse funksionari publik kishte qenë bashkëpunëtor i shërbimeve sekrete. Procesi i lustrimit u zhvillua fillimisht më 1997, e pastaj u "përditësua" më 2006.

Krahas sistemit të vendosur me ligjet speciale për lustrim e që nuk prodhoi rezultatet e synuara, më 2017 Polonia ndërmoi një reformë komplementare, me qëllim të verifikimit të serishëm të përshtatshmërisë së gjyqtarëve përmes procedura disiplinore. Tri ligje të nxjerra që trajtonin elemente lidhur me çështjen, vazhdojnë të jenë objekt i kritikës së vazhdueshme nga Komisioni i Venecias dhe Gjykata Evropiane e Drejtësisë.

2. Modaliteti

Iniciativa e parë për lustrim u ndërmor në vitin 1992 në formën e një rezolute të Kuvendit. Gjykata Kushtetuese e shpalli këtë akt jo kushtetues. Gjeti se çështje që prekin të drejtat e njeriut, nuk mund të vendosen me një akt që nuk i nënshtrohet procedurës legislative. Po ashtu, për shkak se rezoluta ishte shumë e përgjithshme dhe nuk përcaktonte mjaftueshëm detaje, Gjykata gjeti se si e tillë cenonte sigurinë juridike dhe sundimin e ligjit.

Ligji për Lustrimin 1997

Ligji i parë për Lustrimin u nxor në vitin 1997 dhe ishte hartuar në frymën e Rezolutës 1096 të Asamblesë së Këshillit të Evropës, që bënte thirrje për shkëputjen nga trashëgimia e sistemeve të mëparshme komuniste totalitare. Në këtë Rezolutë të vitit 1996, theksohej se çelësi drejt një bashkëjetese paqësore dhe tranzicioni të suksesshëm është vënia e barazpeshës delikate në mes të ofrimit të drejtësisë, pa kërkuar hakmarrjen. Qëllimi i ligjit ishte të shmangte shantazhin që mund t'i bëhej personave në poste publike për shkak të të

qenit të cenueshëm, si rrjedhojë e së shkuarës së tyre dhe lidhjeve me shërbimet sekrete. Ne dukje, ligji i vitit 1997 përkonte me standardet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut sipas Kushtetutës së Polonisë dhe instrumenteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Polonia.

Ligji obligonte ushtruesit e funksioneve publike që ishin në detyrë, të lindur para datës 01.08.1972 të deklarojnë formalisht nëse kanë qenë funksionarë, të punësuar ose bashkëpunëtorë të shërbimeve sekrete në vitet 1944-1990. Vlerësohet se fushëveprimi i këtij ligji ka prekur mbi 27,000 persona. Numri kaq i madh i subjekteve mund të vlerësohet si faktor problematik në arritjen e rezultateve të synuara.

Ligji iu nënshtrua kontrollit të kushtetutshmërisë shkurt pas hyrjes në fuqi, me pretendimet se procesi kishte natyrë arbitrare dhe se cenonte të drejtat dhe liritë e njeriut. Sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, lustrimi si proces ishte legjitim dhe kushtetues. Sipas këtij vendimi, një proces lustrimi, i zhvilluar mbi bazën e një mekanizmi të përcaktuar ligjërish, me qëllim të verifikimit të lidhjeve me të shkuarën të ushtruesve aktualë dhe të ardhshëm të funksioneve publike, që ngërthejnë përgjegjësi të lartë dhe kërkojnë besim qytetar, nuk është jo kushtetues.

Matyjek v. Polonia

Vendimi i datës 30.06.2006 mbi lejueshmërinë e ankesës¹¹⁴

Sistemi i procesit të lustrimit sipas ligjit të vitit 1997, u sfidua edhe pranë GJEDNJ-së, në rastin e shquar si Matyjek kundër Polonisë. Interpretimet dhe arsyetimi i GJEDNJ-së në vendimin e nxjerrë më 2006, u reflektuan në procesin e “përditësuar” të lustrimit, me nxjerrjen e një ligji të dytë special më 2006. Përpos kësaj, ky vendim rrëmbeu vëmendje edhe më gjerë sepse për herë të parë përpara GJEDNJ-së si objekt shqyrtimi ishte një proces lustrimi i një shteti të Evropës Lindore.

Matyjek, deputet i përjashtuar nga detyra për shkak se ishte gjetur se kishte deklaruar rrejshëm lidhur me lidhjet e tij me shërbimin sekret, ishte përjashtuar nga detyra dhe i ishte ndaluar ushtrimi i funksioneve publike për 10 vjet. Pretendonte shkelje të nenit 6 të Konventës për shkak se nuk i ishte lejuar qasje në shkresa e lëndës dhe nuk i ishte lejuar të mbaj shënime për vete gjatë shqyrtimit.

Në anën tjetër, Qeveria e Polonisë kontestoi juridiksionin e gjykatës, duke pretenduar se neni 6 i Konventës nuk gjen zbatim në këtë rast, meqenëse procedura e lustrimit nuk ndërlikohet as me përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile, e as me vendosjen

¹¹⁴ <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-75941%22%5D%7D>

rreth një akuze penale. Gjithashtu, Qeveria kundërshtoi duke theksuar se në rast se Konventa ishte e zbatueshme, megjithatë padia ishte e palejueshme për shkak se z. Matyjek nuk kishte shterur rrugët gjyqësore në vend, përkitazi me neni 35, paragrafi 1 të Konventës.

Gjykata nisi analizën së pari me shqyrtimin nëse çështja përbënte akuzë penale kundër ankuesit. Theksoi se termi “akuzë penale” sipas nenit 6 të Konventës ishte autonom dhe përcaktohet në bazë të tri kriterëve sipas jurisprudencës së Gjykatës, më saktësisht sipas rastit Ozturk dhe më tutje rastit Engel, e që janë:

1. Klasifikimi i procedurës sipas ligjit të brendshëm;
2. Natyra e shkeljes;
3. Natyra dhe shkalla e rëndesës e sanksionit që i nënshtrohej aplikuesi.

Kriteret nuk janë kumulative. Kriteri i parë ka vlerë formale dhe relative dhe përbën vetëm pikënisje të analizës. Dy kriteret tjera janë alternative; mjafton që njëri të përmbushur që një rast të cilësohet si penal sipas kuptimit të Konventës.

Lustrimi në Poloni rregullohej me ligj të veçantë, që nuk kategorizohej në vete as si penal e as si civil. Jurisprudenca polake i ishte referuar këtij ligji si “ligj tjetër që përbën bazë të përgjegjësisë penale”. Gjykata gjeti se megjithatë, vërehej një lidhje e ngushtë në mes të procedurës së lustrimit dhe fushës penale, sidomos për faktin se Ligji për Lustrimit referonte në zbatimin e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale për çështjet që nuk rregullonte vet. Njëherësh, Komisionerit të Interesit Publik i kishte mveshur kompetencat e njëjta që me Kodin e Procedurës Penale i ishin njohur prokurorit të shtetit. Po ashtu, Gjykata gjithashtu vërejti se proceduralisht, një procedurë lustrimi ka ngjashmëri me procedurën përpara një gjykate penale. Si e tillë, procedura e lustrimit ka tipare tipike dhe konotacion të procedurës penale.

Rreth kriterit të dytë, Gjykata vërejti se sanksioni pasonte nga të gënjyerit në një deklaratë që me ligj ishte i obliguar ta jap. Gjithashtu, shkelja e obligimit për të thënë të vërtetën në deklaratë dhe rrethana të tilla, njihet si shkelje në të drejtën e brendshme dhe ka për pasojë sanksionin, në raste edhe sanksion të natyrës penale. Po ashtu, u vlerësuar se kuptimi i parë i “deklaratës së rrejshme” është analog me veprën penale të “deklarimit të rremë”, që edhe jashtë kontekstit të procedurës së lustrimit, do të ishte bazë për zhvillimin e hetimit dhe më tej ndjekjes penale.

Në vlerësimin e kriterit të tretë, atë të natyrës së sanksionit, u vërejt që sanksioni si i tillë, nuk është tipik penal – pra nuk është dënim me gjobë ose dënim me burgim. Megjithatë, ndalimi i ushtrimit të profesionit dhe funksionit publik për 10 vjet, ka ndikim serioz në

personin dhe mundësinë e tij për të vijuar jetën profesionale. Prandaj, për nga natyra ky sanksion ka elemente të ndëshkimit.

Si rrjedhojë, Gjykata vendosi se neni 6 i Konventës është i zbatueshëm. Zbatueshmëria e nenit 6 të Konventës do të thotë se se e drejta në gjykim të drejtë, në kontekstin e një procedurë lustrimi me karakteristika të ngjashme sikurse në rastin e Polonisë, nënkupton obligimin e ofrimit të garancive procedurale tipike të një procedure penale. Të tilla garanci, që duhet të mirëmbahen gjatë gjithë zhvillimit të procedurës së lustrimit janë, ndër tjerash, prezumimi i pafajësisë, barazia e armëve dhe e drejta në ankesë. Në këtë vendim, gjykata shqyrtoi vetëm çështjen e lejueshmërisë së ankesës, pa paragjykuar çështjet meritore.

Vendimi i datës 24.09.2007 mbi meritat¹¹⁵

Një vit më vonë, GJEDNJ vendosi mbi meritat e çështjes, nëse kishte pasur shkelje të nenit 6 të Konventës ose jo. Z. Matyjek në ankesën e tij, sfidoi vetë lustrimin si proces, që sipas tij ishte i pabarabartë, sekret për nga natyra dhe i padrejtë për sa i përket qasjes në shkresat e lëndës dhe zhvillimit të shqyrtimeve. Si rrjedhojë, ai pretendonte se nuk ishte respektuar parimi i barazisë së armëve dhe se ai nuk kishte pasur mundësi të mbrojë veten. Për më tepër, pretendonte se ishte vënë në disavantazh kundrejt Komisionerit për Interesim Publik; shteti kishte qasje në të gjitha arkivat dhe kishte mundësitë teknike e financiare për të shqyrtuar materialet e nevojshme dhe për të vendosur se cilat do të përfshiheshin si shkresa të lëndës. Shumica e dokumenteve ishin sekrete dhe heqja e klasifikimit të këtyre dokumenteve si sekrete, ishte në vetvete arbitrare. Shkeljen e nenit 6, ankuesi e pretendonte edhe mbi bazën e asaj që nuk i ishte lejuar që të kundërshtojë provat e paraqitura kundër tij, e as të thërras ekspert të pavarur në shqyrtim. Ankohej po ashtu për faktin se nuk i ishte lejuar të merrte me vete shënimet e veta, që i kishte mbajtur gjatë shqyrtimi,

Si kundërpërgjigje, Qeveria polake deklaroi se “vështirësitë” që mund të kishte pasur ankuesi gjatë procedurave, ishin si pasojë e faktit se disa nga dokumentet e lëndës klasifikoheshin si sekret shtetëror, përkitazi me ligjin e zbatueshëm. Gjithashtu, për shkak të natyrës konfidenciale të çështjes, arsyetimi me shkrim i vendimit për lustrimin, nuk mund t’i shërbehej dhe qasja mund t’i lejohej vetëm përmes regjistrit sekret.

Në arsyetimin e vendimit dhe duke u thirrur në jurisprudencën e vet, GJEDNJ ri përsëriti se përkitazi me parimin e barazisë së armëve, e që është element i konceptit më të gjerë të gjykimit të drejtë, secilës palë duhet t’i ofrohet mundësia e arsyeshme për të prezantuar rastin, nën kushte që nuk e vendosin në disavantazh përballë kundërshtarit.

¹¹⁵ <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-80219%22%5D%7D>

Gjykata theksoi se, përveç nëse sipas fakteve specifike të rastit, nuk mund të merret se vazhdon të ketë interes të vazhdueshëm publik në vendosjen e kufizimeve të qasjes në materiale që ishin klasifikuar si konfidenciale nga një regjim i kaluar. Procedurat e lustrimit për nga natyra janë të orientuara në nxjerrjen e fakteve që datojnë nga periudha komuniste dhe nuk janë të lidhura me funksionet dhe operacionet e tanishme të shërbimeve sekrete. Procedurat e lustrimit pashmangshëm varen nga shqyrtimi i dokumenteve që ndërlidhen me operacionet e agjencive komuniste sekrete të dikurshme. Nëse palës të cilës i referohen këto materiale, i ndalohet qasja në to, atëherë i pamundësohet rëndë që ai të kundërshtojë versionin e paraqitur nga shërbimet sekrete.

Gjykata pranon se mund të ketë raste kur interesi shtetëror kërkon ruajtjen e sekretit të disa dokumenteve, edhe të tilla nga regjimet e kaluara. Sidoqoftë, rastet e tilla janë të jashtëzakonshme dhe jo norma, marrë parasysh faktin se ka kaluar kohë e konsiderueshme nga kur ato dokumente janë krijuar. Barra e provës është tek Qeveria që të dëshmojë ekzistimin e interesit të këtyre.

GJEDNJ thekson sërish se pjesëmarrja aktive e të akuzuarit gjatë shqyrtimit penal, duhet të përfshijë të drejtën e të akuzuarit për të marrë shënime që do të përdoren për përgatitjen e mbrojtjes së tij, pavarësisht se a mbrohet nga një avokat.

Në Vendimin e vitit 2007, GJEDNJ vendosi se për shkak të konfidencialitetit të dokumenteve dhe kufizimeve që i ishin vënë personit të lustruar në qasje në dosjen e lëndës, si dhe pozicionit të privilegjuar të Komisionerit të Interesit Publik në procedurën e lustrimit, ankuesit i ishte shkëlur e drejta e tij në gjykim të drejtë sipas nenit 6 të Konventës.

Ligji për Lustrimin 2006

Si rrjedhojë e rrethanave të reja më 2006, u nxor Ligji i ri për Lustrimin, që e shfuqizoi atë të vitit 1997. Procesit të lustrimit parashihej t'i nënshtroheshin plot 20 kategori të pozitive publike. Përderisa reforma e parë kishte prekur rreth 27,000 persona, reforma e re parashihej të kishte ndikim në 400,000 deri 700,000 persona. Edhe personat që kishin kaluar testin e lustrimit sipas ligjit të vitit 1997, duhej që sërish t'i nënshtroheshin verifikimit. Vënia nën llupë e një spektri kaq të gjerë të funksionarëve jo vetëm publikë, u kritikua gjerë nga organizatat për të drejtat e njeriut dhe u pa si rrezikim i vlerave të të drejtave të njeriut dhe demokracisë në Poloni. Ligji i ri u kritikua sidomos për kufizimin që ia bënte të drejtës në punë. U vlerësua se kufizohej edhe liria e shprehjes, pavarësia e medias dhe autonomia e institucioneve akademike, sidomos për shkak të përfshirjes së gazetarëve e mësimit në universitarë si grupe që do t'i nënshtroheshin vetingut.

Ashpërsia e këtij ligji zgjoi pakënaqësi dhe ngriti pikëpyetje rreth motivimit të reformës. Në opinion shihej si hakmarrje politike, e pabazuar në parime demokratike. Në anën tjetër, arsyetohej se vetëm me reforma të këtilla radikale do të mund të bëhej kalimi nga një sistem jo-demokratik në një sistem demokratik. Ligji u referua në Gjykatën Kushtetuese për shkak të shkeljes flagrante të pretenduar të nenit 2 të Kushtetutës, që bënte fjalë për demokracinë dhe sundimin e ligjit në vend. Vetë shqyrtimi kushtetues hasi në shumë peripeci, me përjashtimin nga vendimmarrja të dy gjyqtarëve që vet dyshoheshin të kishin pasur lidhje me sistemin e kaluar. Sipas vendimit të Gjykatës, 39 nene të ligjit u shpallën jo kushtetuese. 10 nga 11 gjyqtarët dhanë mendime mospajtuese.

3. Trupat e vetingut

Ligji për Lustrimin 1997

Vërtetësia e deklaratave verifikohet nga një zyrë e veçantë e pavarur e quajtur “Zëdhënësi i Interesit Publik”. Ky trup ishte i mandatuar vetëm të verifikonte vërtetësinë e deklaratave autoriale të personave në procedurë dhe nuk kryente ndonjë formë tjetër të hetimit të të kaluarës së tyre. Vendimet merreshin në procedurë gjyqësore, të zhvilluar nga e ashtuquajtura Gjykatë e Lustrimit.

Ligji për Lustrimin 2006

Me ligjin e ri, Zëdhënësi i Interesit Publik u zëvendësua me Byronë e Lustrimit të Institutit Përkujtimor Kombëtar. U shua Gjykata e Lustrimit dhe kompetenca kaloi tek gjykatat e qarkut, qe përbënin gjykata të rregullta.

4. Baza e të dhënave

Ligji për Lustrimin 1997

Sipas Ligjit për Lustrimin 1997, zyrtarët e lartë publikë të zgjedhur, ofronin deklaratë me shkrim nën betim lidhur me bashkëpunimin e tyre ose jo me policinë sekrete në të shkuarën. Procesi i dizajnuar sipas ligjit të viti 1997, në një farë forme “amnistonte” ata që deklarorin të vërtetën dhe nuk parashihte sanksione kundër tyre. Ndëshkim ishin paraparë për të ashtuquajturit gënjeshtarë të lustrimit. Nëse pas verifikimit të deklaratës nga Komisioneri për Interesin Publik rezultonte se zyrtari kishte gënjyer, ai dënohej.

Ligji për Lustrimin 2006

Sipas këtij ligi, personave që do t'i nënshtroheshin procesit u kërkohet të dorëzonin dëshmi me shkrim nëse kishin bashkëpunuar me organet shtetërore të sigurisë nga viti 1944-1990. Mosdorëzimi i dëshmisë e barazonte personin me gënjeshtar lustrimi.

Trupit vetues iu mundësua qasje publike në dokumentet e shërbimit sekret komunist, përveç "të dhënave të ndjeshme". Barra binte mbi personin që po vetohej që të kontestonte vërtetësinë e këtyre dokumenteve në rrugë gjyqësore – në procedurë civile. Rekursi në procedurë penale dhe garancitë e kësaj procedure nuk ofroheshin, përfshirë garancinë procedurale të prezumimit të pafajësisë.

Nuk ishte saktësisht e përcaktuar se cilat kualifikoheshin si "të dhëna të ndjeshme". Gjykata Kushtetuese gjeti se mundësimi i qasjes publike në të dhëna të caktuara personale mund të sillte diskriminim të pabazuar dhe kufizonte të drejtën e privatësisë. Prandaj, të dhëna të tilla si kodi gjenetik, të dhëna mbi varësitë, bindjet politike, anëtarësia në parti politike, pikëpamjet filozofike, e kaluara penale dhe të dhëna mbi sanksionet tjera administrative, duhet të konsiderohen si "të dhëna të ndjeshme". Këto të dhëna mund të bëheshin publike vetëm me pajtimin e personit.

Si burim i të dhënave ishte paraparë të shërbenin edhe publikimet e Byrosë së Lustrimit, divizion i Institutit Kombëtar Përkujtimor. Kjo byro do të mbledhte dhe publikonte katalogë me të dhënat personale të personave që ishin informantë dhe bashkëpunues, personave të përgjuar, agjentëve dhe të punësuarve të policisë sekrete dhe funksionarëve të lartë të partisë komuniste. Publikimi u ndalua nga një vendim i Gjykatës Kushtetuese. Gjykata gjeti se nuk kishte bazë ligjore që autorizonte krijimin dhe mirëmbajtjen e kësaj liste, që si e tillë kontribonte në shkeljen e të drejtave themelore kushtetuese.

5. Sanksionet

Ligji për Lustrimin 1997

Ligji nuk parashihte pasoja penale ose kuazi-penale për ish-bashkëpunëtorët e vet deklaruar. Ligji nuk pengonte personat që deklaronin vetë lidhjet me organet e sistemit të mëparshëm nga ushtrimi i funksioneve publike. Megjithëse formalisht njëfarë forme këta amnistoheshin, sa i përket pozitive të zgjedhura, ishte në vullnetin e votuesve nëse do t'i "ndëshkonin" ish-bashkëpunëtorët me votë.

Ligji parashihte sanksione për deklaruesit e rremë, "gënjeshtarët" e lustrimit. Deklarimi i rremë e diskualifikonte personin nga përshtatshmëria për funksion publik, si mos përmbushje e kushtit për të pasur karakter të lartë, reputacion të mirë dhe standarde të larta morale. Për deklarimin e rremë vendosej me vendim gjyqësor. Po ashtu, personit i

ndalohej që të ushtronte funksione publike për 10 vjet. Pra, sanksioni nuk rridhte nga të qenit bashkëpunëtor i dikurshëm i sistemit për se, por vinte si pasojë e bërjes së një deklarate të rremë - e që interpretohej si mos përshtatshmëri e personit në kuptim të standardeve morale që kërkoheshin sipas ligjeve përkatëse për ushtrimin e funksioneve publike.

Ligji për Lustrimin 2006

Ndryshe nga sistemi i vendosur sipas ligjit të vitit 1997, sipas ligjit të vitit 2006, deklarimi i bashkëpunimit me sistemin e kaluar ose mosdorëzimi i deklaratës me shkrim, kishte për pasojë sanksionin e ndalimit të ushtrimit të funksioneve publike për 10 vjet.

Në frymën e arsytimit në Matyjek kundër Polonisë dhe sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Polonisë të vitit 2008, sanksionet e këtilla ishin kushtetuese për aq sa i referoheshin një kuadri të arsyeshem kohor dhe përkonin me shkallën e rëndesës së shkëlqes së të drejtave të njeriut që ky person mund të kishte bërë, duke qenë bashkëpunëtor ose funksionar i ish-sistemit. Tërhiqej vërejtja se përgjegjësia nuk duhej të individualizohej dhe të penalizohej gjithsecili. Sanksioni me ndalimin e ushtrimit të funksioneve publike për 10 vjet, mund t'i shqiptohej vetëm personave që kanë dhënë urdhër për kryerjen e veprimeve që kanë përbërë shkëlqje të rëndë të të drejtave të njeriut, i kanë ndërmarrë vetë ato veprime ose i kanë mbështetur në shkallë të lartë.

6. Ankesa

Në të dyja rastet, trupit vetues iu mundësua qasje e gjerë në dokumentet e shërbimit sekret komunist. Barra binte mbi personin që po vetohej që të kontestonte vërtetësinë e këtyre dokumenteve në rrugë gjyqësore. Të dy ligjet parapanë instancë të dytë gjyqësore që fillimisht ishte në kompetencë të Gjykatë së Lustrimit si gjykatë e veçantë. Me ligjin e vitit 2006, kjo kompetencë u kaloi gjykatave të rregullta të qarkut.

7. Procedurat disiplinore sipas reformës ligjore të vitit 2017

Ndërmarrjet e gjera sipas ligjit të vitit 1997 e atij të vitit 2006, nuk sollën rezultatet e synuara. Sistemi nuk u pastrua. Rishtazi, autoritetet polake kanë ndërmarrë një reformë të gjerë ligjore, që synonte pastrimin dhe rritjen e kompetencës në gjyqësi.

Ndryshimet e propozuara në kontekst të rekrutimit, ngritjes në detyrë dhe procedurave disiplinore ndaj gjyqtarëve u kritikuan ashpër nga Avokati i Gjeneral i GJED¹¹⁶. Përkundër

¹¹⁶ <https://curia.europa.eu/jcms/upload/docs/application/pdf/2021-05/cp210075en.pdf>

që reforma nuk kishte kontekst të pastër lustrimi apo vetingu, elemente që kishin qenë objekt kritike i gjejmë edhe në kontekst të vetingut, prandaj meritojnë vëmendje.

Në parim, BE-ja nuk ka kompetencë të përgjithshme sa i përket çështjet së përgjegjesisë disiplinore të gjyqtarëve. Megjithatë, gjatë ushtrimit të kompetencës për organizimin e gjyqësorit, shtetet anëtarë duhet të veprojnë në përputhje me obligimet që rrjedhin nga e drejta e BE-së. Prandaj, shtetet anëtare duhet të sigurohen se garantohet mbrojtje efektive juridike, ashtu që vendimet e marra kundër gjyqtarëve në procedurë disiplinore, mund të shqyrtohen nga një mekanizëm i apelit.

Rishtazi, në një Opinion të datës 06.05.2021, Avokati Gjeneral i GJED-së arsyetoi se Gjykata duhet të vendosë se reforma polake përbën shkelje të së drejtës së BE-së. Në Opinionin e Avokatit Gjeneral u vlerësua se parimi i pavarësisë së gjyqësor cenohet në rast se përmbajtja e një vendimi gjyqësor merret për shqyrtim për qëllime të një procedure disiplinore. Sipas këtij opinionin, masa disiplinore duhet të ndërmerren kundër një gjyqtari që kryen format më serioze të sjelljes së keqe profesionale dhe jo mbi bazën e përmbajtjes së një vendimi gjyqësor, përmes shqyrtimit të fakteve, vlerësimit të provave apo interpretimit të ligjit. Një qasje e tillë është në kundërshtim me vlerat dhe parimet e vendosura sipas nenit 267 të Traktatit mbi Funkcionimin e BE-së.

8. Rezultati i vetingut

Deri në fund të vitit 2013, mbi 299,000 deklaramë ishin regjistruar pranë Byrosë së Lustrimit. Në 2,785 prej tyre, personat kishin deklaruar lidhjet me shërbimet sekrete. Deri më 2013, Byroja kishte verifikuar mbi 10,700 deklarata. Deri më 2013, gjykatat shpallën 183 aktgjykime në procedura lustrimi, prej të cilave në 135 raste ishte gjetur se ishin bërë deklaramë të rrejshme. Ndërmarrjet e gjera sipas ligjit të vitit 1997 e atij të vitit 2006, nuk sollën rezultatet e synuara.

9. Përfundime relevante për Kosovën

- Nga praktika e Polonisë, shihet se një proces vetingu është pashmangshëm proces që kufizon të drejtat e njeriut. Ky kufizim provoi të arsyetohej në shtetet post-komuniste për shkak se ishte i domosdoshëm për kalimin nga sisteme jodemokratike në sisteme demokratike; kufizimi i të drejtave të njeriut arsyetohej me kërcënimin që përndryshe i bëhej themelimit të shoqërisë demokratike.
- Sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese Polake të vitit 1992, procesi i vetingut mund të bëhet vetëm me ligj ose ndryshime kushtetuese. Instrumenti i përdorur duhet të precizojë saktë mbarë procedurën sepse përndryshe, përbën shkelje të Kushtetutës.

- Rasti Matyjek v. Polonia përbën referencë të rëndësishme për sa i përket dizajnimin të një procesi të vetingut në përputhje me kërkesat e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Në rast se një proces vetingu përmbush kriteret e vendosura në këtë Vendim dhe si rrjedhojë klasifikohet si rast i domenit penal në kuptim të nenit 6 të Konventës, atëherë përgjatë gjithë mbarëvajtjes së procedurës duhet të ofrohen garancitë minimale tipike për një procedurë penale.
- Sipas Vendimit meritor të GJEDNJ në Matyjek v. Polonia, deri te shkelja e të drejtës në gjykim të drejtë, përkatësisht elementit të barazisë së armëve, vjen në rastin kur pozita e personit që i nënshtrohet vetingut është më e pafavorshme se ajo e shtetit. Personi vihet në disavantazh përballë shtetit kur ky i fundit ka qasje dhe në dispozicion informatat nga baza e të dhënave në masë më të madhe dhe në kushte më të përshtatshme sesa personi që vetohet.
- Meqenëse vetingu si proces përbën natyrshëm materie kontestuese, të dy ligjet në Poloni ishin objekt shqyrtimi disa herë përpara Gjykatës Kushtetuese. Gjykata në asnjërin prej rasteve nuk e ndaloi procesin duke shpallur ligjin si të tërë jokushtetues, por interpretoi në mënyrë më ekstenzive disa dispozita, ndërsa dispozita të tjera i shfuqizoi. Prolongimi i procesit si pasojë e kontestimit kushtetues si dhe njëfarë fragmentimi i bazës ligjore si rrjedhojë e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, sollën probleme edhe më të mëdha në zbatim dhe procedura e institute gati jo-operabile.
- Vëmendje meriton sidomos kritika që po i bëhet nga BE dhe Avokati Gjeneral i GJED-së reformës së fundit ligjore rreth gjyqësorit. Shqyrtimi i vendimeve të gjyqtarit për qëllime të një procedure disiplinore është në kundërshtim me vlerat dhe parimet e vendosura sipas nenit 267 të Traktatit mbi Funkcionimin e BE-së.

1.5.3 Praktika tjera

1.5.3.1 Përvoja me vetingun në Kenia

1. Prapavija

Vetingu u ndërmor si mekanizëm i reformës institucionale në Kenia si rrjedhojë e mospajtimeve me rezultatet e zgjedhjeve presidenciale të vitit 2007. Këto mospajtime sollën tensione të ashpra dhe çuan në dhunë dhe jostabilitet të paprecedent. Me qëllim të vendosjes së paqes së qëndrueshme, stabilitetit dhe drejtësisë përmes sundimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, u iniciua një program i reformimit të thellë. Në rastin e Kenias, një proces i suksesshëm vetingu do të kthente besimin në gjyqësor dhe do të kontribuonte në forcimin e sistemit të qeverisjes.

Kenia ishte nënshkruese e një sërë instrumentesh ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Megjithatë, përkundër aderimit dhe zbatueshmërisë së këtyre instrumenteve ndërkombëtare dhe rajonale, dominonte mosbesimi dhe parregullsia në gjyqësor. Përgjatë viteve 1960-1998, tetë komitete apo komisione të ndryshme ishin themeluar me qëllim të analizimit të gjendjes në gjyqësor dhe dhënies së propozimeve për reformë. Shumica e raporteve nga këta trupa nuk ishin marrë parasysh.

Një proces vetingu ishte zhvilluar fillimisht në vitin 2003. U shqua si “operacioni radikal” për shkak të rezultateve që prodhoi. U identifikua se të përfshirë në korrupsion gjyqësor dhe kryerës të shkeljeve etike ishin 5 nga 9 gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, 18 nga 36 gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe 82 nga 254 magjistratët. Përpara se këta të njoftoheshin sipas procedurave të vëna për këto rezultate, emrat e tyre rrodhën në media. Kryeprokurori i shtetit kishte deklaruar se për shkak të gjykimit publik që veçse i ishte bërë këtyre emrave, këta gjyqtarë duhet të japin dorëheqje ose do të suspendoheshin menjëherë, pa zhvillimin e procedurave të mëtejme. Përkundër kësaj ndërmarrjeje radikale, u vlerësua se besimi popullor në gjyqësor, megjithatë, nuk u rikthye.

Reforma e vetingut e vitit 2007 u dizajnuar mbi premisat se procesi i vetingut është *sui generis*; si i tillë nuk mund të barazohet apo të modelohet sipas procedurave të tilla si *impeachment*, procedurat disiplinore, gjykimet civile apo penale, apo intervistat për punë e verifikimi për leje të sigurisë. Një proces vetingu duhet të modelohet i prirë dhe i orientuar nga objektivat dhe vlerat e vendosura nga Kushtetuta dhe Ligji.

Konteksti i përgjithshëm si dhe ai *situacional* dallon nga rasti i Kosovës. Megjithatë, praktika e Kenias mund të shërbejë për frymëzim për shkak të ngjashmërive të tilla si: proces i vetingut të gjyqtarëve, proces me objektiv kthimin e besimit popullor në gjyqësor, si dhe proces me fokus në vlerësimin dhe verifikimin e përshtatshmërisë së figurës së gjyqtarit për të ushtruar detyrën, sidomos në kuptim të paanësisë dhe pastërtisë nga aferat korruptive.

2. Modaliteti

Reformimi i thellë dhe i tërësishëm i sistemit të qeverisjes në Kenia u nis përmes nxjerrjes së Kushtetutës së re në vitin 2010. Synohej që përmes rregullimit të ri kushtetues, të adresoheshin shumë shqetësueset e mungesës së besimit popullor në gjyqësor. Analiza paraprake kishte vërejtur se gjyqtarët emëroheshin nga Presidenti me rekomandimin e Komisionit të Shërbimit Gjyqësor (KSHGJ). U vërejt se vlerësimi dhe verifikimi i figurës së kandidatëve për gjyqtarë që bëhej nga KSHGJ ishte jo-transparent, i pabazuar në kriteret e matshme dhe të ditura publikisht dhe jo konkurrues. Nga Task-Forca u vërejt se megjithëse

ky vlerësim dhe verifikim i figurës përbënte një lloj vetingu, mirëpo si i tillë nuk ishte i institucionalizuar në strukturat e KSHGJ-së.

Në dispozitat kalimtare, Kushtetuta parashihte që të gjithë gjyqtarët dhe magjistratët (ekuivalente me gjyqtarët e shkallës së parë sipas sistemit tonë) në detyrë në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj kushtetute, t'i nënshtroheshin vetingut me qëllim të vlerësimit të përshtatshmërisë së figurës së tyre për të vazhduar ushtrimin e detyrës. Në Kapitullin 6, nenin 23 të Kushtetutës theksohej se ky proces do të zhvillohej përkundër garancive ekzistuese kushtetuese për gjyqtarë. Kjo dispozitë kushtetuese përcaktonte se nuk mund të kundërshtohej vendimi për largimin e gjyqtarit përmes vetingut.

3. Trupat e vetingut

Përbërja

Sipas përcaktimit të Ligjit, Vetingu në Kenia bëhet nga Bordi i Vetingut. Këtij Bordi i njihet mandati për të bërë vetingun e gjyqtarëve në pajtim me dispozitat Kushtetuese dhe Ligjin. Ligji garanton pavarësinë e Bordit të Vetingut. Pra, ky Bord, i themeluar me veprimin e ligjit special, përbën një strukturë të veçantë që vepron si e pavarur nga institucionet ekzistuese dhe shtyllat e pushtetit.

Ligji përcakton që anëtarët e Bordit të jenë të kenë diplomë universitare, të paktën 15 vjet përvojë pune në fushën e tyre dhe të dëshmojnë vlera të larta morale dhe integritet. Ligji nuk përcakton profilin profesional të anëtarëve të Bordit. Parashihet se mund të jenë gjyqtarë të instancave të larta, akademikë të shquar, juristë që punojnë në gjyqësi ose veprimtari tjetër juridike në sferën publike, private apo tjetër. Bordi përbëhet nga nëntë anëtarë: gjashtë Kenian, prej të cilëve tre juristë dhe tre jo-juristë, si dhe tre anëtarë të huaj, gjyqtarë të pensionuar që kanë shërbyer në gjykatat e larta të shteteve të *Commonwealthit*.

Ligji po ashtu parasheh që Bordi të asistohet nga Sekretariati, që ka për detyrë të ofrojë mbështetje për procesin vendimmarrës. Ligji përcakton që Bordit dhe Sekretariatit t'i vihen në dispozicion burime adekuate financiare dhe materiale. Meqenëse Bordi do të duhet të vendosë për çështje të ndjeshme, duhet po ashtu të merret parasysh siguria e anëtarëve.

Kompetencat

Funksionet parësore të Bordit janë të bëj veting dhe të hetojë. Termi “bërje e vetingut”, definohet në ligj si proces sipas të cilit përcaktohet përshtatshmëria e një gjyqtari që të vazhdojë të mbetet në detyrë.

Ligji për Vetingun ndërtoi sistemin e vetingut mbi tri shtylla:

1. Bordit të Vetingut i njihet kompetenca për të mbledhur çfarëdo informacioni që konsideron relevant për qëllime të procesit, përfshirë prodhimin dhe qasjen në të gjitha llojet e dokumenteve, përfshirë ato me të dhënat financiare dhe bankare.
2. Bordit të Vetingut i njihet kompetenca për të zhvilluar intervista me individë, grupe apo anëtar të organizatave dhe shoqatave.
3. Bordi i Vetingut ka kompetencë që kryej "hetime" për qëllime të kryerjes së funksioneve të veta.

Bordi i vetingut nuk kishte kompetencë për të kryer hetime dhe as autorizim të drejtpërdrejtë për qasje në dokumente policore. Ato mund t'i siguronte përmes parashtrimit të kërkesës policisë, pa forcë detyruese.

Procedura

Bordi zhvillon intervista me gjyqtarët, si dhe shqyrton të dhëna rreth tyre. Informatat e fituara nga intervistat dhe të dhënat tjera mbahen konfidenciale. Gjyqtarët që vihen në llupë, duhet të jenë të njoftuar për këtë. Gjyqtarët në fjalë duhet të jenë të njoftuar për të gjitha pretendimet kundër tyre, të kenë mundësi që t'i kundërshtojnë dhe të kenë mundësi që t'iu parashtrajnë pyetjeve personave që japin deklaratë kundër tyre. Për këto qëllime, gjyqtari mund të angazhojë avokat, të cilin e mbulon me shpenzimet e veta.

Njoftimi se ishte marrë vendim për largimin e një gjyqtari në fjalë bëhej publik. Përmendje baza mbi të cilën ishte nxjerrë vendimi, por pa dhënë detaje për të dhëna private dhe konfidenciale. Megjithatë, ligji nuk përcakton nëse bashkë me njoftimin, publiku të njoftohet edhe me arsyet e vendimit. Gjithashtu, nuk përmendet nëse publiku duhet të njoftohet edhe me rastin e vendosjes së një gjyqtari është i përshtatshëm për ushtrimin e detyrës.

Seancat e shqyrtimit të Bordit janë të mbyllura, përveç nëse personi që i nënshtrohet vetingut kërkon seancë të hapur. Kjo dispozitë meriton vëmendje, meqenëse sipas ligjit Kenian, procedurat tjera gjyqësore, parimisht, zhvillohen me prezencën e publikut. Qëllimi këtu duhet të ketë qenë ruajtja e identitetit të zyrtarit gjyqësor, në pajtim me parimin e prezumimit të pafajësisë.

Me qëllim të rritjes së efikasitetit të punës, Ligji parashihte që Bordi të themelonte tri komisione apo panele me nga tre anëtarë (nga një nga secila kategori e anëtarëve), që do të mund të ndërmerrnin veprimtari paralelisht. Qëndrimi i Bordit ishte se edhe kur të

veprohet në formacione të pjesshme, panelet do t'i jepnin rekomandime Bordit, i cili në përbërje të plotë do të merrte vendimet.

Ligji përcaktoi se procesi i vetingut duhet të përmbyllet më së largu 1 vit nga dita e fillimit, me mundësi të zgjatjes së mandatit kohor nga miratimin e Kuvendit edhe për një vit tjetër.

Ligji përcaktonte saktë “fushëveprimin personal”: vetingut i nënshtrohen gjyqtarët, e që janë ditur saktë në numra nga fillimi. Ligji përcaktoi edhe radhën: vetingu do të niste nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, pastaj gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Referenti i Gjykatës së Lartë, Kryeadministratori i gjykatës, Krye-magjistratët dhe në fund magjistratët. Te gjithë këta veçse i kishin “mbijetuar” vetingut të vitit 2003.

Megjithëse ekzistonte mundësia e zhvillimit të punës në komisione, Bordi vendosi që në procesin e vetingut të Gjyqtarëve të Apelit, të veprojë në përbërje të plotë. U vendos kështu për shkak të rrisë së procesit dhe nevojës për të ndërtuar një qasje të përbashkët përballë çështjeve ligjore dhe procedurale që do të ngriteshin dhe domosdoshmërisë së vendosjes së një mënyre uniforme të zbatimit të kriterëve për përcaktimin e përshtatshmërisë.

Baza e vendimmarrjes

Kriteret

Ligji përcakton përgjithësisht se në procesin e vendimmarrjes, Bordi duhet të jetë i prirë nga parimet dhe standardet e pavarësisë së gjyqësorit, drejtësisë dhe praktikave më të mira ndërkombëtare. Përshtatshmëria nuk mund të vendosej me metoda mekanike, e as të zbatohej një formulë e përgjithshme dhe e përbashkët.

Më saktësisht, vlerësimi i përshtatshmërisë së figurës së gjyqtarit duhet të përcaktohet sipas:

- të dhënave nga puna paraprake, përfshirë deklaratat dhe qëndrimet publike të gjyqtarit, të dhëna nga ndonjë proces gjyqësor ose hetimor ku mund të ketë qenë i përfshirë;
- informata dhe ankesa nga Shoqëria Juridike e Kenias, Komisioni Anti-Korrupsion, Kryeprokurori i shtetit, Komisioni për Shërbimin Gjyqësor dhe trupa të tjerë të identifikuar.

Në bërjen e këtij vlerësimi, Bordi duhet të marr parasysh kompetencat profesionale, aftësitë e komunikimit në të shkruar dhe në të folur, integritetin, paanësinë, temperamentin, të

gjykuarit e mirë, përvojat profesionale ligjore dhe jetësore dhe përkushtimin për t'i shërbyer vendit dhe shoqërisë. Secila prej këtyre kategorive, zbërthehet më tutje në elemente përbërëse.

Për shembull, sa i përket pyetjes së temperamentit në Vendimin Nr. 4 të datës 21.09.2012, Bordi shqyrtoi disa ankesa rreth temperamentit të një gjyqtareje. U vlerësua se megjithëse temperamentit i saj lë për të dëshiruar, çka ajo shfaqë është një shkallë e padurueshmërisë që nuk është e pazakontë në gjykata kudo në botë. U gjet se nuk kishte prova që dëshmonin se ajo kishte probleme me temperamentin, të tilla si shpërthime të paarsyeshme, shprehje të bullizmit apo nënçmimit.

Vendimet gjyqësore si provë për shqyrtimin e përshtatshmërisë

Roli i Bordit nuk ishte ai i një gjykate të apelit që do të bënte vlerësim të saktësisë faktike e juridike të vendimeve që kishte nxjerrë gjyqtari, e as të bindjeve filozofike juridike që ndiqte gjyqtari në punën e tij. Bordi duhet të vlerësonte dhe të vërente në rastin kur një vendim paraqiste arsyeshmëri të çuditshme e të mangët, ashtu që të paraqiste mungesë të drejtshmërisë dhe paanësisë. Kjo çështje paraqitej si problematike, marrë parasysh se bëhej fjalë për gjyqtarë që kishin përvojë të gjatë dhe pashmangshëm kishin marrë pjesë në gjykime që kishin zgjuar debat.

Në Vendimin Nr. 4 të datës 21.09.2012, kundër një gjyqtari u hodhën akuza se kishte pranuar ryshfet. Pretendimi u bazua në atë se në një rast të vlerësimit të paluajtshmërisë kishte gjetur se një dispozitë e ligjit përkatës ishte jo-kushtetuese, ndërsa në një rast tjetër, kishte vendosur po mbi atë dispozitë. Qarkullonin fjalë se për këtë ai kishte marrë ryshfet, por nuk kishte prova. Gjyqtari i mohonte akuzat. Bordi vendosi se këto pretendime nuk përbënin bazë për të dyshuar integritetin e gjyqtarit. Dy rastet gjyqësore në fjalë nuk ishin të ndërlidhura dhe nuk kishte elemente të konfliktit të interesit mes tyre. Asnjëri prej vendimeve gjyqësore nuk u vlerësua të ketë pasur efekt në minimin e besimit popullor në gjyqësor. Në këtë Vendim, Bordi shprehimisht deklaroi se nuk është e përshtatshme për Bordin të kryej funksionin e një gjykate apeli që shqyrton saktësinë e gjetjeve të gjyqtarit, sidomos për faktin se vendimi i parë i përmendur, veçse ishte apeluar si i tillë.

Kundër po të njëjtit gjyqtar ishin hedhur akuza rreth një rasti të ndjeshëm penal, në të cilin të dy të akuzuarit dhe një nga viktimat ishin policë. Personat akuzoheshin për "Vrasje të rëndë", ndërsa gjyqtari në aktgjykim i kishte shpallur të fajshëm për "Vrasje" dhe kishte shqiptuar dënim në kohëzgjatje prej 10 vjetësh. Gjyqtari tani akuzohej se kishte qenë i anshëm, duke rikualifikuar veprën penale dhe duke dhënë dënim më të butë. Çështje ishte po ashtu në shqyrtim e sipër përpara Gjykatës së Apelit. Në shqyrtimin e këtyre akuzave,

Bordi mori për bazë aktgjykimin. Gjeti se ishte e vështirë të ndiqej linja e argumentimit dhe arsyetimit të gjyqtarit ku diskutonte për vetëmbrojtjen dhe provokimin. Si përgjigje ndaj këtyre pretendimeve, gjyqtari pranoi se mund të ketë gabuar. Sidoqoftë, Bordi gjeti se nuk mund të bënte rigjykim të çështjes dhe aspekteve faktike e juridike të rastit. Provat e paraqitura nuk dëshmonin ekzistencën e padrejtshmërisë apo motivimit tjetër nga ana e gjyqtarit.

Kundër një gjyqtareje ishin bërë ankesa se kishte urdhëruar zhvarrosjen e një personi nga një vend dhe rivarrosjen në një vend tjetër, pa ndjekur procedurat e përcaktuara për të urdhëruar zhvarrosjen. Përgjigja e saj ishte se kishte qenë e domosdoshme që kjo të bëhej sa më shpejtë për shkak të urgjencës së rastit dhe se dëshira e të ndjerit në testament kishte qenë që të varrosej ato ku tani ishte rivarrosur. Përkundër këtyre arsyetimeve, Bordi vendosi se procedurat ligjore do të duhej të ishin respektuar, sidomos marrë parasysh çështjet e ndjeshme kulturore.

Kundër po të njëjtës gjyqtare ishin shprehur pakënaqësi rreth çështjes së përcaktimit të vlerës së dëmshpërblimeve. Në një rast, ajo kishte vendosur që një punëtori që kishte humbur gjymtyrët gjatë kryerjes së detyrave të punës, t'i jepej dëmshpërblim në një vlerë të cilësuar si modeste, përderisa në një rast tjetër, pesëfishin e asaj shume ia kishte njohur një figureje publike në një rast të dëmtimit të reputacionit. Megjithatë, ishte vlerësuar se vendimet ishin bazuar në arsyetime mirë të shtjelluara.

Në një rast tjetër, një gjyqtar ishte pyetur rreth lirimit që i ishte bërë nga akuzat për vrasje të rëndë një figure të njohur politike. Gjyqtari mohoi të ketë qenë në dijeni për identitetin e të akuzuarit dhe shpjegoi se provat mjeko-ligjore, nuk i kishin lënë opsion tjetër.

4. Dokumentet

Detyrimi për të ofruar dokumentet relevante rreth kualifikimeve, kompetencës dhe integritetit, bie mbi personin që i nënshtrohet vetingut. Këto informata themelore ofrohen sipas formatit të paracaktuar nga Bordi i Vetingut. Megjithëse këtij Bordi i njihet kompetenca për të hetuar, ligji nuk parasheh themelimin e trupave të pavarur për këtë qëllim.

Bordi mori për bazë dokumentet si vijon:

1. Një pyetësor;
2. Deklaratën mbi pasurinë;
3. Ankesat/Pretendimet e Bordit;
4. Përgjigjen e gjyqtarit në ankesat/pretendimet e Bordit;

5. Transkriptet e intervistave me gjyqtarin në fjalë dhe Komisionin për Shërbimin Gjyqësor;
6. Çfarëdo materiali tjetër mbi punën e kaluar të gjyqtarit, përfshirë vendimet e nxjerra.

Intervistat i mundësuan Bordit që të vlerësojë temperamentin e gjyqtarit, të mësojë rreth përvojave të tij të përgjithshme dhe t'ia vlerësojë aftësitë e komunikimit.

4. Ankesa

Gjyqtari mund të paraqiste kundërshtime ndaj pretendimeve e ankesave të Bordit përgjatë zhvillimit të procedurës. Sipas përcaktimit kushtetues, vendimi i Bordit ishte përfundimtar dhe nuk mund të ankimohej në instancë tjetër. Pala e pakënaqur mund të paraqiste ankesë përpara po të njëjtit Bord vetëm në dy raste: paraqitja e fakteve dhe rrethanave të reja për të cilat gjyqtari nuk ka qenë në dijeni dhe gabime në shkresat e lëndës mbi të cilat është vendosur.

Qëllimi i ligjbërësit kishte qenë që të shmangej tej zgjatja dhe zvarritja e procesit të vetingut për shkak të ankesave, në dobi të kryerjes sa më shpejtë të reformës së vetingut dhe arritjes së afatit kushtetues 1 vjeçar.

5. Përfundime relevante për Kosovën

- Çështja e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së procesit nuk u sfidua për shkak të bazës së definuar kushtetuese dhe ligjore të procesit.
- Ndërtimi i procesit mbi bazën e një dispozite shumë të përgjithshme kushtetuese, mundësoi hapësirë për fleksibilitet dhe kreativitet në dizajnimin e trupave dhe procedurave të vetingut.
- Megjithëse u proklamua si trup *sui-generis*, në aspektin funksional, Bordi i Vetingut mund të cilësohet si organ kuazi-gjyqësor. Tiparet kuazi-gjyqësore ngritën pikëpyetje legjitime rreth një-shkallshmërisë së procesit.
- Fushëveprimi i përcaktuar saktë temporal dhe personal, mundësoi planifikim real dhe të suksesshëm të procesit.
- Raporti në mes të Bordit të Vetingut dhe Komisionit për Shërbimin Gjyqësor, që parimisht dhe përjashtimisht nga vetingu kishte kompetencë ekskluzive në çështjen e rekrutimit, emërimit, ngritjes në detyrë dhe përjashtimit të gjyqtarëve, u përçoll me tensione. Për shkak të lidhjes organike të punës, tensionet dhe mungesa e bashkëpunimit mund t'i ketë ndikuar rezultatet e procesit të vetingut.
- Me ligj ishte përcaktuar se institucione shtetërore, përfshirë Shoqërinë e Drejtësisë të Kenias, Ombuspersonin, Komitetin Disiplinor të Avokatëve, Komitetin

për Ankesat Disiplinore të Avokatëve, Kryeprokurorin e Shtetit, Komisionin Shtetëror Kenian për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi, do të duhej të ofronin input dhe informata me qëllim të përgatitjes së lëndës nga Bordi i Vetingut. Asnjëri prej këtyre institucioneve nuk dha kontribut dhe kjo u vlerësua si mos-pranueshmëri e procesit nga ata që do të duhej të ishin hisedarë të tij.

- Joformalisht ishte raportuar se as Policia nuk ka bashkëpunuar me Bordin e Vetingut, duke mos dhënë përgjigje në kërkesat që i ishin parashtruar për sigurimin e informatave dhe materialit në kompetencë të Policisë.

- Praktika e Kenias mund të shërbejë si referencë për deliminimin e vijës së hollë ndarëse për përdorimin e vendimeve të gjyqtarit si bazë për të dëshmuar papërshtatshmërinë, pa tejkalar në veprimin si gjykatë e apelit.

- Objektivi i vetingut kishte qenë kthimi i besimit popullor në gjyqësor dhe përfundimisht forcimi i sistemit demokratik të qeverisjes. U vlerësua se vetingu si masë e vetme, nuk arrin dot këto objektiva dhe duhet koordinim dhe programim i reformës më të gjerë.

Kapitulli 2: Objektivat

Në Kapitullin 1 është përkufizuar problemi kryesor, shkaku i tij dhe efektet. Gjithashtu janë listuar politikat, legjislacioni relevant, standardet dhe përvojat e shteteve tjera, si dhe janë përcaktuar palët e interesit. Në këtë kapitull përcaktohen objektivat që synohen të arrihen përmes kësaj politike.

Objektivi strategjik i kësaj politike është përmirësimi i integritetit të institucioneve të drejtësisë dhe rritja e besimit qytetar në drejtësi, përmes vetingut dhe mekanizmave tjerë, që rrjedhin nga Programi i Qeverisë 2021-2025, siç përshkruhen në figurën si më poshtë.

Vetingu do të jetë instrument kyç për verifikimin e integritetit, profesionalizmit dhe kontrollin e pasurisë të subjekteve të vetingut. Vetingu do të jetë po ashtu mekanizëm për të nxjerrë në pah gjyqtarët, prokurorët dhe personelin administrativ e mbështetës që kanë integritet, janë profesionalë dhe të rregullt. Vetingu do të zhvillohet në përputhje me standardet ndërkombëtare të elaboruara në Kapitullin 1, si dhe praktikat më të mira të shteteve që kanë zhvilluar vetingun para Kosovës. Si objektive operacionale në kuadër të këtij qëllimi strategjik është zhvillimi i kornizës juridike për fillimin e procesit të vetingut në sistemin e drejtësisë. Kjo do të arrihet përmes masave të shqyrtuara dhe propozuara në Kapitullin 3 të këtij Koncept Dokumenti.

Qëllimet që integriteti i rritur i gjyqtarëve dhe prokurorëve synon të arrijë janë si më poshtë:

1. Aktiviteti gjyqësor dhe prokurorial i integritetit më të lartë sigurohet përmes zbatimit të vazhdueshëm të kornizës ligjore dhe rregullative të gjyqtarëve dhe prokurorëve që është në përputhje me standardet ndërkombëtare.
2. Integriteti dhe aftësitë ripërtëritëse të sistemit të drejtësisë ruhen përmes kontrolleve të rregullta të integritetit për gjyqtarët, prokurorët dhe personelin mbështetës.
3. Dhënia e drejtësisë është e besueshme, sepse gjyqtarët dhe prokurorët me udhëheqje superiore dhe aftësi menaxheriale i bashkohen trupit gjykues.
4. Procedurat objektive, të drejta dhe transparente për emërimin e anëtarëve të KGJK dhe të KPK përkthehen në përfaqësues me përvojë shumë të lartë dhe të respektuar në mesin e kolegëve të tyre të gjyqësorit.

Figura 7: Objektivat relevante të Qeverisë

Qëllimi i politikës	Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi)
Qëllimi i politikës – Realizimi i procesit të vetingut në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe gjithëpërfshirëse.	Sipas këtij Koncept Dokumenti.
Objektivi strategjik – Përmirësimi i integritetit të institucioneve të drejtësisë, përmes vetingut dhe mekanizmave tjerë.	Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025.
Objektivi specifik – Kthimi i besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë.	Sipas këtij Koncept Dokumenti.

Kapitulli 3: Opsionet

Në kuadër të këtij kapitulli, Koncept Dokumenti trajton pesë opsione kryesore lidhur me nevojën për zhvillimin e vetingut për gjyqtarë dhe prokurorë në Kosovë, si dhe nëpunësit në pozita të larta në sistemin e drejtësisë:

1. Opsioni 1 - *pa asnjë ndryshim i cili parashihet ruajtjen e status quo;*
2. Opsioni 2 - *përmirësimi i zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjor i cili shtynë përpara idenë se gjendja aktuale mund të ndryshohet mjaftueshëm vetëm me implementim më të mirë të kornizës ekzistuese ligjore;*
3. Opsioni 3 - *zhvillimi i vetingut përmes ndryshimeve ligjore, kjo qoftë me ligje të reja apo amendamentim të atyre ekzistuese;*
4. Opsioni 4 - *zhvillimi i vetingu ad hoc dhe pastaj vlerësimi të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë nga një mekanizëm i jashtëm përmes ndryshimeve kushtetuese; dhe*
5. Opsioni 5 - *Zbatimi i procesit të vetingut me ndryshime kushtetuese që mundëson vetingun nga një trup ad-hoc dhe më pas vijimin e vlerësimi të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë nga KGjK dhe KPK.*

Kapitulli 3.1: Opsioni “asnjë ndryshim”

Opsioni ‘asnjë ndryshim’¹¹⁷ nënkupton që nuk do të merren kurrfarë masa as zbatuese dhe as legislative për të adresuar problemin kryesor, të shpjeguar më lartë.

¹¹⁷ Teksti që elaboron këtë alternativë është marrë dhe adaptuar nga Dokumenti “Modalitetet e llogaridhënies me përfshirjen e Vettingut në sistemin e drejtësisë në Kosovë”, nentor 2020.

Sipas ligjit, prokurorët dhe gjyqtarët duhet të kryejnë funksionin e tyre në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, ku një gjë e tillë garantohet nga Këshilli Prokurorial, respektivisht ai Gjyqësor i Kosovës, të cilët rekrutojnë, propozojnë, avancojnë, transferojnë dhe dispiplinojnë prokurorët, gjegjësisht, gjyqtarët. Për më tepër, legjislacioni aktual përcakton se llogaridhënia dhe transparenca janë vlera themelore me të cilat duhet të udhëhiqen profesionistët e drejtësisë gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duke kryer detyrat e tyre me përgjegjshmëri, nivel të lartë profesional, transparençë dhe efikasitet. Njëkohësisht të njëjtit, sipas ligjit, duhet të kenë karakter të lartë moral dhe profesional.

Mirëpo, problemi kryesisht qëndron se në praktikë llogaridhënia dhe integriteti i disa gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk janë në nivelin që normativa ligjore e Republikës së Kosovës e proklamonte të nevojshme. E njëjta mund të thuhet se vlen edhe për disa nga nëpunësit në pozita të larta në sistem. Një gjë e tillë argumentohet nga qytetarët në përgjithësi, shoqëria civile madje dhe akterë të shumtë ndërkombëtarë. Kështu, marrin gjithë vëmendjen parregullësitë në sistem, e mbesin jashtë fokusit individët profesionalë e me integritet.

Sot, sistemi i drejtësisë në Kosovë konsiderohet si një nga hallkat më të brishta të shtetësisë dhe i cili është lehtë i ndikueshëm nga politika dhe grupet tjera të interesit. Duke rikujtuar që organet e drejtësisë janë të thirrura për të mbajtur në përgjegjësi të gjithë të tjerët që bien ndesh me ligjin, kjo performancë e dobët e sistemit të drejtësisë konsiderohet se ndikon edhe në shtrembërimin e demokracisë në vend.

Po ashtu është e dukshme mungesa e performancës reale e një numri gjyqtarësh e prokurorësh, e cila pasqyrohet, dhe jo vetëm, në mos përgatitjen e duhur të akuzave, numrin e rasteve kur prokurorët kërkojnë shtyrjen e gjykimeve si pasojë e mos përgatitjes. Tjetër argument që zbehtë llogaridhënien e organeve të drejtësisë është shkelja e afateve procedurale ligjore në procedurat hetimore dhe nga momenti që shkojnë në gjykatë.

Me gjithë problemet e identifikuar, mekanizmat ekzistues janë mjaftë bujarë me vlerësimet që i'u bëjnë këtyre gjyqtarëve dhe prokurorëve - e si të tillë, të padrejtë ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve që bëjnë si duhet punën e tyre. Për ilustrim, në tri vitet e fundit mekanizmi për vlerësimin e performancës nuk ka vlerësuar dobët asnjë gjyqtar. Pra, përkundër rrethanave të dukshme e dallimeve në integritet e profesionalizëm në mesin e gjyqtarëve, në vlerësim nuk janë diferencuar. Duke parë në anën tjetër të gjitha raportimet për keqpërdorime dhe punë të dobët që bëhet jo rrallëherë në kuadër të organeve të drejtësisë, mund të konkludohet se mekanizmat ekzistues nuk ofrojnë një pasqyrë të qartë dhe vlerësim meritokratik të performancës dhe punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Hiç më mirë nuk qëndron çështja e disiplinimit, ku rrallë herë procedura disiplinore për

gjyqtarë dhe prokurorë rezulton me ndonjë sanksionim, madje kur kjo ndodhë atëherë sanksioni është shumë i butë.

Mos intervenimi një çfarëdo forme në gjendjen aktuale, do të lejojë degradimin e vazhdueshëm dhe gradual të integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në sistem, por edhe nëpunësve në pozita të larta. Bashkë me të, mundësohet edhe rënia e vazhdueshme e besimit të qytetarëve në drejtësi dhe efektet tjera negative. Situata e këtillë është njëkohësisht demotivuese dhe e padrejtë ndaj atyre individëve në sistem që kanë integritet, bëjnë punë të mirë, e janë të rregullt.

Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore

Në kuadër të këtij opsioni trajtohet mundësia e përmirësimit të situatës aktuale përmes përmbushjes së duhur të detyrimeve ekzistuese ligjore, qoftë edhe me mundësi të përkrahjes së buxhetore. Në kuadër të këtij opsioni nuk mund të parashihen as intervenimet në aktet nënligjore, siç janë Rregulloret aktuale të KGjK-së dhe KPK-së.

Mundësia e përmirësimit të situatës aktuale vetëm me përmirësimet e zbatimit të kornizës aktuale ligjore është kryesisht e cunguar nga vetë korniza ligjore.

Për fillim, duhet rikujtuar se njësitet aktuale për verifikim në kuadër të KGjK-së dhe KPK-së veprojnë pa bazë të mirëfilltë ligjore. Nenet 20 dhe 27 të Ligjit Nr. 06/L - 055 për KGjK-në i referohen kërkesës që gjyqtarët të kenë integritet personal dhe që procedura për vlerësimin e integritetit “do të realizohet përmes verifikimit të të dhënave të dorëzuara nga kandidati, të dhënat nga regjistrat publik përkatës për vlerësim, përfshirë verifikimin standard të regjistrave nga e kaluara penale.” Ngjashëm me këtë, Ligji Nr.06/L-056 për KPK, në nenet 19 dhe 20 i referohet kërkesës që prokurorët të kenë integritet personal. Neni 20(5) i referohet “verifikimit të të dhënave të dorëzuara nga kandidati, të të dhënave nga regjistrat relevant publik për vlerësim, përfshirë verifikimin standard të regjistrave për të kaluarën penale.” Megjithatë, asnjëra nga këto ligje nuk përmbajnë norma të cilat do të rregullonin ekzistencën dhe funksionimin, mandatin dhe përgjegjësitë e njësive për verifikim. Në draftet që ishin dërguar nga Ministria, në nenin 21 të Projektligjit për KPK-në, ishte paraparë krijimi i “njësisë për verifikim” por ajo ishte hequr nga Kuvendi më pas. Situata nuk është përmirësuar as deri më sot përmes rregulloreve të KGjK-së apo KPK-së për rekrutimin, testimin, emërimin dhe riemërimin e gjyqtareve dhe prokurorëve. Të dyja këto rregullore dështojnë që të japin një bazë të duhur ligjore apo rregullative për të përcaktuar funksionet, kompetencat dhe përgjegjësitë e njësive për verifikim. Për këtë

arsye, mungesa e bazës së mirëfilltë ligjore për Njësitë e Verifikimit në të dyja Këshillat e kufizon shumë mundësinë e Opsionit të dytë.

Megjithatë, duhet njohur fakti se të dyja këto njësi gjithashtu përballen me mungesë të kapaciteteve njerëzore. Ky aspekt i funksionimit të tyre do të mund të përmirësohej përmes formave të tjera të fuqizimit, që nuk do të kërkonin ndërhyrje ligjore.

Në KGJK procesi i verifikimit zbatohet nga një njësi e përbërë nga gjithsej shtatë anëtarë të stafit - kryesuesi, katër hetues, një ndihmës administrativ dhe një ndihmës për vlerësim. Stafi i kësaj Njësie ka qenë i përfshirë edhe në Vetingun e vitit 2010, duke qenë pjesëtarë të Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial (KPGJP). Ndërkohë, në KPK ekziston vetëm një zyrtarë e verifikimit. Përderisa zyrtarja në KPK ishte verifikuar nga INTERPOL para vitit 2010, zyrtarët aktualë në njësinë e KGJK-së nuk i janë nënshtruar ndonjë verifikimi.

Me kapacitete të shtuara njerëzore, veçanërisht në KPK, njësitë aktuale të verifikimit do të mund të përmirësonin dukshëm performancën e tyre. Kapacitetet e shtuara njerëzore do të mund të bëheshin në numër - duke shtuar numrin e zyrtarëve përgjegjës, por edhe duke investuar në aftësitë profesionale të zyrtarëve aktualë përmes trajnimeve të vazhdueshme. Ngritja e kapaciteteve njerëzore në këto dy njësi do të kishte implikime buxhetore shtesë, prandaj kërkohet që të ndahen burime shtesë për këtë qëllim. Në të njëjtën kohë, duke qenë se ka kaluar shumë kohë prej kur i janë nënshtruar (jo të gjithë) një vetingu të jashtëm, i gjithë stafi aktual ka nevojë që t'i nënshtrohet sërish një verifikimi, në mënyrë që të rilegjitimohet dhe ketë kredibilitet për t'i kryer detyrat që kërkohen për arritjen e qëllimit të kësaj politike. Një gjë e tillë nuk mundësohet aktualisht nga korniza ligjore, duke qenë se stafi i këtyre njësive nuk ka status të definuar qartë.

Përtej nevojës për një veting të këtyre zyrtarëve, ngritja e kapaciteteve të tyre është më se e nevojshme. Masa të këtilla parashihen edhe në Strategjinë për Sundimin e Ligjit. Për të shmangur mbingarkimin e këtij dokumenti me të gjitha aktivitetet e parapara në Strategjinë në fjalë, vlen vetëm të përmendet se shumica nga to janë aktivitete trajnuese, investim në infrastrukturë për të mundësuar punën e tyre, si dhe ngritje të buxhetit për të njëjtin qëllim.

Megjithatë, investimet e vetme në buxhet dhe ngritje të kapaciteteve nuk do të mund të adresojnë problemin kryesor të punës së këtyre njësive. Ky problem është mungesa e bazës së mjaftueshme ligjore e rregullative në të cilën do të sqaroheshin kompetencat dhe autorizimet e tyre si dhe baza tejet e ngushtë e të dhënave që mblidhen për kandidatët. Por, më e rëndësishmja, këtyre njësive ju mungon autorizimi ligjor e rregullativ për të bërë këtë punë në baza të rregullta.

Shtuar kësaj që pa një rregullativë ligjore të re, edhe nëpunësit në pozita të larta brenda sistemit të drejtësisë, e të cilët kanë rol të theksuar në funksionimin adekuat të sistemit, mbesin të pa-vetuar. Sa i përket pozitave të administratës së gjyqësorit që bien në fushëveprimin e këtij Koncept Dokumenti, sipas Aktgjykimi nr. KO203/19, Gjykata Kushtetuese, ka konstatuar se Ligji nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk zbatohet në raport me këto pozita. Rrjedhimisht, edhe çështja e rekrutimit dhe disiplinimit të këtyre pozitave mbetet e parregulluar, meqenëse nuk gjejmë zbatim as dispozitat e as rregullorja përkatëse e ligjit të përmendur. Deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë nga ana e Kuvendit, sipas Dispozitivit të këtij Aktgjykimi, dispozitat e këtij Ligji zbatohen vetëm për atë që nuk cenon funksionet dhe organizativet të Institucioneve të Pavarura.

Pavarësisht faktit se me legjislacionin në fuqi, Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial kanë mundësi që të përshtatin zbatimin e detyrave të tyre, përmes miratimit të akteve nënligjore, vullneti për një gjë të tillë në rastin e njësisë për verifikim ka munguar.

Përmes këtij opsioni është e pamundur të adresohen plotësisht dhe substancialisht problemet e identifikuar në këtë Koncept Dokument. Rrjedhimisht, ky opsion mundëson vetëm harrimin sipërfaqësor të mekanizmave ekzistues, pa ofruar mundësi për ndryshim real. Në një farë mënyrë, ky opsion do të ishte efektiv, për shkak të kostos më të ulët në krahasim me opsionet 3, 4 dhe 5, mirëpo efektiviteti i tij do të ishte i papërfillshëm, në raport me opsionet e tjera dhe qëllimet e kësaj politike.

Kapitulli 3.3: Zhvillimi i procesit të vetingut dhe vlerësimi i vazhdueshëm i performancës, integritetit dhe pasurisë përmes ndryshimeve ligjore

Ky opsion elaboron mundësinë e zhvillimit të procesit të vetingut dhe njëkohësisht edhe mundësinë e ndërtimit të mekanizmave për vlerësimin e vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë për gjyqtarë dhe prokurorë, si dhe nëpunës në pozita të larta drejtuese¹¹⁸ përmes ligjit të veçantë.

Ky proces do të vijë si përgjigje ndaj nevojës që të ndryshohet gjendja aktuale në sistemin e drejtësisë, ku shumica e masave të deritanishme për të përmirësuar këtë gjendje, në masë të madhe kanë rezultuar të pasuksesshme. Pra, zhvillimi i vetingut si dhe ndërtimi i mekanizmit për vlerësim të vazhdueshëm kanë për qëllim kthimin e besimit të qytetarëve

¹¹⁸, Drejtorët e Sekretariateve të KGJK-së dhe KPK-së, Administratorët e gjykatave, të prokurorive, Drejtori i Njësisë për Inspektim Gjyqësor si dhe Drejtori i Njësisë për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë.

në gjyqësorin, si dhe përmirësimin e pavarësisë, paanshmërisë, llogaridhënies dhe efikasitetit në sistemin e drejtësisë. Njëkohësisht, ky proces do të shërbejë për të nxjerrë në pah dhe vlerësuar drejtë edhe gjyqtarët, prokurorët dhe nëpunësit mbështetës administrativ që kanë integritet, janë profesionalë dhe të rregullt.

Sa i përket normimit, procesi i vetingut dhe ai i vlerësimit të vazhdueshëm, të parapara me këtë opsion, diferencohen. Konstruktimi i procesit të vetingut do të mundësohet përmes një ligji të veçantë i cili do të quhej Ligji për Vetingun dhe ndryshimeve dhe plotësimeve që do të shtrihen në ligjet tjera përkatëse, siç sqarohet më poshtë në këtë Koncept Dokument. Ndërkaq, ndryshimet në legjislacion sa i përket vlerësimit të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë, si proces pasues i vetingut, do të vinin më vonë, qoftë përmes akteve të reja ligjore, qoftë përmes ndryshimit të atyre ekzistuese.

Megjithatë, ajo çfarë duhet pasur kujdes në kuadër të këtij opsioni, është përputhshmëria me kornizat që i përcakton Kushtetuta. Duhet respektuar në këtë rast kompetencat e këshillave për të siguruar pavarësinë dhe paanshmërinë e sistemit gjyqësor e prokurorial dhe kështu, përputhshmërinë me përcaktimet kushtetuese sa i përket asaj se kush merr vendimet për karrierën e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Pra, pavarësisht ndryshimeve në legjislacion, propozimi dhe shkarkimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas këtij opsioni duhet të vazhdojë të bëhet nga mekanizmat kushtetues. Kështu, propozimi për shkarkim bëhet nga Këshilli Gjyqësor, gjegjësisht Këshilli Prokurorial dhe shkarkimi bëhet nga Presidenti. Ndërsa, në instancën e dytë vepron Gjykata Supreme sipas ankesës ndaj vendimit për shkarkim. Vendimi i Gjykatës Supreme për ligjshmërinë e vendimit mbi shkarkimin e gjyqtarit apo prokurorit është i formës së prerë dhe prodhon efekt juridik të detyrueshëm për palët.

Po ashtu, shkarkimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve do mund të bëhet vetëm për dy arsye: kryerja e veprës së rëndë penale si dhe mosrespektimi i rëndë i detyrave nga gjyqtarët dhe prokurorët. Arsyet për shkarkim mbi bazën e një vlerësimi negativ në procesin e vetingut, do të detajzohen me ligj. Megjithatë në kontekstin e analizës në këtë Koncept Dokument, shkarkimi, që mund të rezultojë si kërkesë nga procesi i vetingut apo vlerësimit të vazhdueshëm, duhet futur nën ombrellën e arsyes për shkarkim - mosrespektim i rëndë i detyrave.

Dispozitat kushtetuese që flasin për arsyet e shkarkimit të gjyqtarëve duket se duhet lexuar paralelisht me përcaktimet kushtetuese rreth mandatit të gjyqtarëve. Si të tilla, lënë hapësirë që *“mosrespektimi i rëndë i detyrave”* si shkak për shkarkim të gjyqtarëve të definohet me ligj. E njëjta vlen dhe sa i përket prokurorëve.

Ndonëse në kuptimin e ngushtë mund të mendohet se kjo bazë shkarkimi nuk mund të akomodojë çështjen e vlerësimit të integritetit si pikësynim i vetingut, duhet rikujtuar se kjo në një mënyrë veçse zbatohet për momentin. Me kornizën ekzistuese ligjore, integriteti personal është i përfshirë në kuadër të vlerësimit të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Prandaj koncepti i vlerësimit të integritetit edhe gjatë ushtrimit të detyrës nuk është i panjohur. Megjithatë, nuk është e qartë se si vlerësohet ai në praktikë.

Duhet theksuar se sipas Kushtetutës, sistemi gjyqësor në vend duhet të jetë i pavarur, i drejtë, jopolitik e i paanshëm. Në këtë rast, kushdo që nuk udhëhiqet nga këto parime përgjatë ushtrimit të profesionit si gjyqtar apo prokuror, do duhej konsideruar se ka bërë shkelje të detyrës.

Në kuadër të këtij opsioni është trajtuar një model i mundshëm për projektimin e procesit të vetingut dhe modalitetet e përgjithshme të ndërtimit të mekanizmit të vlerësimit të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë.

Në këtë pikë, do të trajtohen konturat e përgjithshme sa i përket procesit të vetingut, për të vazhduar pastaj me shtjellim të mekanizmit të vlerësimit të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë si mekanizëm dhe proces pasardhës i vetingut.

1. PROCESI I VETINGUT

Procesi i vetingut, siç u potencua, është proces *ad hoc* për vlerësimin, sa i përket aftësive profesionale dhe performancës, integritetit dhe pasurisë, e të gjithë gjyqtarëve, prokurorëve dhe nëpunësve në pozita të larta drejtuese brenda sistemit të drejtësisë. Ky proces synohet të zhvillohet brenda një afati tentativ prej pesë (5) vitesh, nga momenti i funksionalizimit të mekanizmave.

Më poshtë, krahas këtij opsioni, vëmendje më e theksuar do t'i kushtohet procesit të vetingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve duke marrë parasysh ndjeshmërinë e këtyre funksioneve. Për nëpunësit në pozita të larta drejtuese do vlejné përshtatshmërisht rregullat dhe procedurat e njëjta si për vetingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve, mirëpo me disa dallime dhe specifika të cilat shtrihen në tri drejtime. Fillimisht, krahasuar me vetingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për nëpunësit i) vlerësimi i performancës do ketë tjetër natyrë dhe të tjera kritere; ii) KGJK/KPK vet do të shkarkojnë nëpunësit në shkallë të fundit; dhe iii) instancë për ankim në rastet e shkarkimit do të jetë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës.¹¹⁹ Theksohet se vetingu për nëpunësit në pozita të larta drejtuese, bëhet për shkak të kompetencave dhe shkallës së ndikimit real që kanë ata në sistemin e drejtësisë.

¹¹⁹ Neni 101 i Kushtetutes se Republikës së Kosovës.

Sa i përket gjyqtarëve dhe prokurorëve, **shtyllat kyçe lidhur me procesin e vetingut** për gjyqtarë dhe prokurorë do të dukeshin si vijon:

a) **Mekanizmi dhe procedura e vetingut**

- **Organi kompetent për veting:** Do të krijohet për secilin sistem (gjyqësor dhe prokurorial) nga një mekanizëm për veting nga të cilët do të zhvillohet vetingu për gjyqtarë, përkatësisht prokurorë, si dhe nëpunësit në pozita të larta drejtuese.

Si rrjedhojë, me rastin e themelimit të Mekanizmave përkatës për veting, do të shuhen Komisioni për Vlerësimin e Performancës në KGJK/KPK-së dhe Njësia për Shqyrtimin e Performancës.

Mekanizmatgëzojnë një pavarësi fizike, infrastrukurore dhe buxhetore.. Kjo do të parashihet me ligj.

Mekanizmat përkatës për veting kanë për kompetencë të koordinojnë dhe mundësojnë mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, përmes së cilave do të përpilohen vlerësimet e kandidatëve që i nënshtrohen vetingut.

Të dy, mekanizmat përkatës për veting do ushtrojnë kompetencat e tyre mbi bazën e parimeve të barazisë para ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të vetingut.

- **Rekrutimi dhe verifikimi i anëtarëve të mekanizmave** - Duhet rikujtuar se bazuar në përcaktimet kushtetuese, anëtarët e këtyre mekanizmave do të zgjedhën sipas ligjit të Veçantë. Në këtë drejtim, për të siguruar cilësinë, profesionalizmin dhe paanshmërinë e mekanizmave, parashihet që procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të tyre të jetë transparent, gjithëpërfshirës dhe rigoroz. Është e rëndësishme që me rastin e rekrutimit, të ketë një përfshirje të akterëve jashtë strukturave aktuale gjyqësore dhe prokuroriale.

Procedura përmes së cilës parashihet të bëhet përzgjedhja e anëtarëve të mekanizmave, do të bëhet sipas ligjit të vecantë, në të cilin proces, do të ketë përfshirje të mekanizmave gjegjës ndërkombëtarë. Do të bëhet marrëveshje me trupa apo organizata ndërkombëtare për të kërkuar ndihmën e tyre në përzgjedhjen, përfshirë verifikimin, e anëtarëve të mekanizmave respektiv. Një model i ngjashëm

me këtë mund të shihet aktualisht në Kosovë në modalitetet e gjetura për përzgjedhjen e Pozitave të Larta Drejtuese, procedura këto në të cilat intervistimi dhe rekomandimi vjen nga trupa me përbërje ndërkombëtare (shembull me Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë). Pjesëmarrje monitorues do të kërkohet nga partnerët ndërkombëtarë edhe përgjatë gjithë periudhës sa zgjatë vetingu.

Pas përfundimit të procesit verifikues, do të dilet me rekomandimin për emrat të cilët propozohet që të zgjedhën nga organet kompetente. Emrat e personave të rekomanduar për t'u zgjedhur duhet të jenë publik, bashkë me arsyetimet për rekomandimin e tyre.

Duke u shërbyer me përvojën e vendeve tjera të trajtuara më sipër dhe në frymë e standardeve ndërkombëtare, si element tjetër për të siguruar pavarësinë dhe paanësinë e punës së mekanizmave është kohëzgjatja e mandatit të tyre. Anëtarët e mekanizmave të vetingut do të kenë mandat që do të zgjatë po aq sa procesi i vetingut.

Është thelbësore ndërmarrja e procesit të verifikimit për kandidatët për anëtarë të mekanizmave, kjo pasi që ata që bëjnë vetingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve, duhet vetë të jenë subjekte të verifikuar. Kështu, ofrohet garanci që procesi nuk do të jetë i cënueshëm në dëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve që i nënshtrohen vetingut.

- **Vendimmarrja në procesin e vetingut** - Ritheksohet se, sipas përcaktimit kushtetues, organet kompetente edhe gjatë procesit të vetingut do të vazhdojnë të mbesin instanca që vendos për karrierën e gjyqtarit/prokurorit. Panelet nuk nxjerrin vendime me fuqi detyruese por "vlerësime" që u vihen në dispozicion Këshillit përkatës, për vendimmarrje, e kur është e nevojshme, panelet rekomandojnë edhe masat që duhen ndërmarrë ndaj kandidatit. Rrjedhimisht, në rastin kur nga të dhënat, rezultojnë dyshime rreth integritetit apo përshtatshmërisë së gjyqtarit/prokurorit që i është nënshtruar vetingut, nga Këshillat do të duhej të iniciohej procedura disiplinore dhe marrja e masave disiplinore që përkojnë dhe janë të përshtatshme për natyrën apo intensitetin e të 'metave' të gjetura. Këtu nuk përjashtohet as propozimi i shkarkimit të gjyqtarit apo prokurorit. Standardet e propozimit të shkarkimit duhet të përcillen me një vendim të arsyetuar mbi bazë faktike të mirë-verifikuar.

Subjekti i vetingut ka të drejtën që gjatë procedurës që i nënshtrohet vetingut të përfaqësohet nga një avokat, dhe në rast se nuk ka mjete financiare, sipas kërkesës së tij/saj t'i caktohet një avokat me detyrë zyrtare.

Në pamundësi të marrjes së një vendimi final nga vetë mekanizmat përkatës, transparencja dhe publiciteti i vlerësimeve të mekanizmave është mënyra esenciale për të garantuar respektimin dhe efektivitetin e vlerësimeve të nxjerra nga mekanizmat.

Në situatën kur nga të gjeturat e mekanizmave, rezulton se ka elemente të veprës penale, mekanizmat çështjen duhet ta referojë tek organet kompetente.

- **Struktura e mekanizmave** - Secili prej dy mekanizmave, strukturalisht, do përbëhen nga një Sekretari dhe nga dy panele vlerësuese. Të dy panelet janë identike me njëra tjetrën për nga kompetenca.

Panelet do të vlerësojnë informacionet sa i përket aftësive profesionale dhe performancës, integritetit dhe pasurisë, të mbledhura për subjektin e vetingut, dhe do të vendosin për vlerësimin që u drejtohet organeve përkatëse. Përbërja e paneleve do të rregullohet dhe përcaktohet me ligjin përkatës. Të gjitha kriteret për rekrutim do të përcaktohen me Ligjin për Vetëingun.

Në kuadër të secilës prej Sekretarive të mekanizmave, do të funksionojë nga një Drejtor i Përgjithshëm dhe nga tri njësi: i) Njësia për vlerësim të aftësive profesionale dhe performancës, ii) Njësia për vlerësimin e pasurisë, dhe iii) Njësia për vlerësim të integritetit. Njësitë do të përbëhen nga Drejtori, stafi profesional që zhvillon hetimin dhe stafi administrativ.

Krahas njësive, do të funksionojnë nga 10 zyrtarë profesional, përfshirë Drejtorin e Njesisë, dhe nga 5 zyrtarë administrativ.

Figura 8: Struktura e Mekanizmit për veting të gjyqtarëve






Figura 8: Struktura e Mekanizmit për veting të prokurorëve



b) Baza e të dhënave që mblidhen

Me dispozitat përkatëse do përcaktohet tri kategori të dhënash të cilat mblidhen dhe shqyrtohen gjatë procesit të vetingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Për mbledhjen e këtyre të dhënave, fillimisht subjektet e vetingut do të dorëzojnë në panelet përkatëse nga një formular të plotësuar për secilën kategori të të dhënave, sipas specifikave të përcaktuara me ligj. Më pastaj, në lidhje me çështjet e specifikuara në formular, panelet do të verifikojnë saktësinë e të dhënave dhe do të krahasojnë ato me të gjeturat e mbledhura nga njësitë.

Krahas të dhënave që mblidhen me rastin e vetingut, përfshihen:

i) të dhënat rreth aftësive profesionale dhe performancës: të dhënat lidhur me performancën të cilat duhet të vlerësohet, do të jenë të kufizuara. Duhet pasur kujdes gjatë vlerësimit të performancës që kjo të bëhet pa u lëshuar në çështjet substanciale të vendimit apo të rigjykohet rasti.¹²⁰ Paneli duhet të vlerësojë dhe të vërej rastet kur një vendim paraqet arsyeshmëri të çuditshme e të mangët, ashtu që të rezultojë në mungesë të drejtshmërisë dhe paanësisë. Bërja e këtij vlerësimi në rast se pretendohet se në nxjerrjen e një vendimi të caktuar gjyqtari nuk është treguar profesional, nuk mund të bëhet me zbatim të një “formule të përgjithshme”. Kur në pyetje është shqyrtimi i profesionalitetit, duhet të shqyrtohen me kujdes të gjithë faktorët dhe rrethanat e rastit, si dhe bazueshmëria e pretendimeve në fakte dhe prova. Rregulloret e reja të KGJK-se dhe KPK-së përbëjnë një bazë solide dhe të duhur për matjen e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kriteret e matjes së performancës janë në parim të përmbajtura aty. Mangësia kryesore mbetet zbatimi i tyre në praktikë i cili, siç u diskutua më sipër, tregon të jetë tejet zemërgjerë me subjektin e vetingut. Për më tepër, në bazë të të dhënave të mbledhura do të kuptohet se a është gjyqtari/prokurori i aftë profesionalisht për të ushtruar detyrën.

Mendohet se nuk duhet zgjeruar përtej asaj që është paraparë në Rregulloret aktuale për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve/prokurorëve, të cilat në përgjithësi janë hartuar në maksimumin e lejueshmërisë së vlerësimit cilësor të vendimeve të pranuar nga gjyqtari/prokurori dhe aftësitë tjera profesionale. Gjithashtu, njëra nga kufizimet e bëra qartë nga Rekomandimet e Kievit (të shtjelluara më sipër), është së numri i vendimeve të kthyera nga gjykata e nivelit më të lartë nuk mund të shërbejë si kriter për matjen e performancës.

¹²⁰ Në drejtim të shënimit të kësaj vije ndarëse, mund të shërbehemi nga praktika e Kenias, shtjelluar më sipër. Sipas praktikës së Kenia, roli i trupit të vetingut nuk ishte ai i një gjykate të apelit që do të bënte vlerësim të saktësisë faktike e juridike të vendimeve që kishte nxjerrë gjyqtari, e as të bindjeve filozofike juridike që ndiqte gjyqtari në punën e tij.

ii) të dhënat rreth pasurisë: verifikimet lidhur me pasurinë do të përfshijnë analizimin lidhur me të gjitha asetet në përputhje me Ligjin përkatës për Deklarimin e Pasurisë. Objekt i verifikimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare. Vlerësimi rreth pasurisë do të jetë në drejtim të asaj se a është keqpërdorur pozita si gjyqtar/prokuror për t'i sjellë përfitime financiare vetes apo personit të tretë. Detajet lidhur me vlerësimet mbi pasurinë do të parashihen me Ligjin për Vetingun.

iii) informata të tjera të lidhura me integritetin: duke filluar nga informatat mbi lidhjet/afërsitë politike ose me grupet e tjera të interesit të kandidatit të cilat ndikojnë në vendimmarrjen e tyre, dhe informata të tjera të mbledhura nga terreni. Është e rëndësishme që në kuadër të këtyre informatave të merren edhe informatat mbi varësitë që mund të ketë subjekti i vetingut apo devijime të tjera të lidhura me integritetin, e që do të mund të ndikonin në aftësinë për të gjykuar, apo do ta bënin atë të padenjë për të ushtruar funksionin e tij.

Me ligj duhet të specifikohet qartë se cilat të dhëna mund të mblidhen, procedura e mbledhjes, administrimit dhe përpunimit të tyre e cila duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale; duhet të sanksionohet obligimi për proporcionalitet në mes kufizimit të të drejtës në privatësi dhe jetë familjare e cila mund të rezultojë si shkak i kërkimit dhe verifikimit të të dhënave personale dhe informatave tjera me qëllimin legjitim i cili synohet që të arrihet përmes mbledhjes së këtyre të dhënave; duhet të përcaktohet kohëzgjatja e procedurës për mbledhjen e të dhënave dhe rrethanat se kur duhet të ndërpritet; të parashihet e drejta e palës (subjektit në procedurë) për ankimim, qoftë në aspektin material apo procedural të mbledhjes së këtyre të dhënave si dhe të parashihet asgjësimi i të dhënave personale sipas legjislacionit përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në çdo rast, mbledhja e të këtyre të dhënave dhe informatave dhe ndërhyrjet pasuese do të bëhen në përputhje me nenin 8 të Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut dhe jurisprudencën gjyqësore të zhvilluar në çështje si vetingu ose lustrimi.

c) Subjektet që i nënshtrohen vetingut

Siç u cek më lartë, në procesin e vetingut, do të kalojnë të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët.¹²¹ Po ashtu, vetingut do t'i nënshtrohen edhe një kategori e zyrtarëve në pozita të larta drejtuese brenda sistemit.

Fillimisht, duke qenë se të gjitha vendimet përfundimtare merren nga vetë këshillat përkatës, është tejet e rëndësishme që procesi të fillojë me vetingun e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe atij Prokurorial të Kosovës. Po ashtu, është e rëndësishme që në të njëjtën kohë të funksionalizohet edhe Gjykata Supreme me gjyqtarë të vetuar të cilët do të adresonin ankesat potenciale të subjekteve që i janë nënshtrohur vetingut.

Është e rëndësishme që të ruhet funksionaliteti i këshillave ndërkohë që bëhet vetingu i anëtarëve të tyre. Prandaj, një formulë e përshtatshme për të siguruar vetingun e anëtarëve të KGJK dhe KPK parashihet të jetë kjo:

- Nga momenti i funksionalizimit të dy mekanizmave (sekretarisë dhe paneleve) do të fillojë faza hulumtuese krahas **fazës së parë** të vetingut për të gjithë anëtarët e KGJK/KPK-së. Në të njëjtën kohë, kjo fazë përfshinë edhe të paktën pesë anëtarë të Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurorin e Shtetit. Të gjithë këta do iu nënshtrohen vetingut nga mekanizmat respektiv për gjyqtarë apo prokurorë.

Po ashtu, paralelisht me vetingun e anëtarëve të këshillave nga mekanizmat respektivë, do të zhvillohet edhe procedura e vetingut të kandidatëve për anëtarët e ardhshëm të këshillave, duke respektuar mënyrën e përzgjedhjes që parashihet me Kushtetutë. Nëse rezultojnë të përshtatshëm, kandidatët do të mund të zënë vend si anëtarë të Këshillit gjegjës, nëse pozita është liruar me rastin e shkarkimit si pasojë e procesit të vetingut, apo kur t'i ketë pushuar mandati ndonjë anëtari të Këshillit përkatës.

Pas përfundimit të vetingut për subjektet në kuadër të fazës së parë, mekanizmi përkatës do të paraqesë në KGJK/KPK rezultatet e vetingut për nga një apo dy kandidat përnjëherë. Rezultatet paraqiten në formë të vlerësimeve për shkarkim, apo për të konstatuar 'përshtatshmërinë' e subjektit të vetingut, varësisht se si mekanizmi përkatës e vlerëson operacionalisht më të përshtatshme. Mekanizmat duhet të veprojnë strategjikisht dhe me plan adekuat sa i përket prezantimit në

¹²¹ Kjo nuk përjashton as gjyqtarët, prokurorët dhe nëpunësit në pozita të larta drejtuese të gjykatave/prokurorive të reja që mund të krijohen përgjatë periudhës sa zgjatë procesi i vetingut.

Këshilla të vlerësimeve për shkarkim, që të mos rrezikohet kuorumi ($\frac{2}{3}$ e anëtarëve) për vendimet e mëtejme të secilit prej këshillave, përfshirë edhe ato për propozim për shkarkim. Me rastin e pranimit të vlerësimit që konstaton përshtatshmërinë e gjyqtarit/prokuratorit, nuk është e nevojshme që Këshillat të votojnë, pasi që kjo paraqet vetëm konfirmim për vazhdimin e ushtrimit të funksionit.

Nëse shkohet me propozimet për shkarkime, nuk do të duhej të paragjykohej epilogu lidhur me shkarkimet, deri pas përfundimit të fazës së ankimit. Siç shtjellohet më poshtë, e gjithë procedura që nga propozimi për shkarkim deri tek marrja e vendimit në instancë të dytë pritet të zgjasë 75 ditë në total.

Sapo të arrihet vetingu i anëtarëve të këshillave dhe Panelit të Gjykatës Supreme që shqyrton ankesat për shkarkim, do të mund të kalohet në **fazën e dytë** të vetingut. Në fazën e dytë fillimisht do t'i nënshtrohet vetingut Gjykata Supreme në tërësi dhe do të pritet zëvendësimi i gjyqtarëve që potencialisht do të shkarkoheshin. Paralelisht, do t'i nënshtrohen vetingut edhe prokuratorët në Zyrën e Kryeprokuratorit të Shtetit.

Pas kësaj, subjekt i vetingut do të jenë gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, dhe prokuratorët e Prokurorisë së Apelit, prokuratorët e Prokurorisë Speciale, ndërkaq propozimet potenciale për shkarkim do të mund të paraqiten përnjëherë në numra deri në 3 gjyqtarë/prokuratorë, për të mos bllokuar në tërësi punën në këto institucione. Kjo fazë do të përfshijë edhe kryetarët e gjykatave dhe kryeprokuratorët.

Në rast se të gjeturat e Mekanizmit shpien në rekomandime për shkarkim të gjyqtarëve dhe prokuratorëve të listuar më lartë, do të pritet përfundimi i procedurave lidhur me shkarkimin e tyre për të vazhduar me përzgjedhjen dhe vetingun e kandidatëve për ato pozita. Në fazën e dytë do të vetohen edhe zyrtarët në pozita të larta drejtuese brenda sistemit, si: administratorët e gjykatave dhe prokurorive; drejtorët e sekretariateve; si dhe Drejtori i Njësisë për Inspektim Gjyqësor në KGJK.

Gjatë fazës së dytë do të zhvillohet procesi i rekrutimit të gjyqtarëve dhe prokuratorëve të rinj, si parapërgatitje për fazën e tretë të vetingut, në mënyrë që procesi i rregullt i punës mos të dëmtohet.

- **Në fazën e tretë** do të vazhdohet me vetingun e gjyqtarëve mbikëqyrës të degëve të gjykatave themelore, pastaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të gjykatave dhe prokurorive themelore. Në rast se mbesin pozita të zbrazëta pas vetingut në fazën e tretë, do të hapet konkurs për emërimin e gjyqtarëve/prokurorëve të rinj.

Procedura e vetingut për një kandidat do të zhvillohet në këto tri momente:

i) sipas radhës: Vetingu sipas radhës, i shtjelluar më sipër në këtë Koncept Dokument, është kategorizimi më i rëndësishëm në kuadër të procesit të vetingut dhe atij do t'i nënshtrohen të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët.

ii) tek kandidatët për rekrutim: kjo kategori do të vlerësohet gjatë procesit të rekrutimit si gjyqtarë/prokurorë, përgjatë kohës sa zgjatë procesi i vetingut, që do përfshijë fazën e vlerësimit të integritetit, arritjeve profesionale dhe kontrollimit të pasurisë si parakusht për të qenë pjesë e sistemit. Rekrutimi i tyre do të bëhet sipas kritereve rigorozë të frymëzuara nga ky sistem i vetingut, për aq sa është e zbatueshme.

iii) tek gjyqtarët/prokurorët që ngritën në detyrë: konsiderohet shumë e nevojshme që para marrjes së detyrës së re, atyre t'ju analizohet integriteti, performanca dhe pasuria. Gjyqtari/prokurori që kandidon për avancim dhe i është nënshtruar vetingut në vitet e fundit para avancimit, periudhë kjo që do të konkretizohet me ligj, nuk do të ketë nevojë t'i nënshtrohet sërish vlerësimit; dhe

iv) vetingu me shkas: vetingu do të mund të inicohet edhe në rast se paraqiten fakte apo rrethana që e vënë në dyshim përshtatshmërinë e gjyqtarit apo prokurorit për të vazhduar ushtrimin e funksionit të tij.

d) Masat që mund të ndërmerren

Që nga momenti i inicimit të vetingut, përkatësisht vlerësimit të vazhdueshëm, subjekti do të njoftohet se është duke u trajtuar lënda e tij. Ligji do të sigurojë respektimin e të drejtës së subjektit në gjykim të drejtë, duke përcaktuar se ai/ajo do të ketë qasje në materialin e lëndës së tij, pra në gjetjet dhe informatat e mbledhura nga Mekanizmat. Subjekti i vetingut do të ketë të drejtë t'i kundërshtojë këto gjetje dhe të paraqesë prova, dhe dëshmitarë, si dhe të marr në pyetje dëshmitarët të cilët dëshmojnë kundër tij apo saj, përpara se Mekanizmi gjegjës të bëjë vlerësimin që do t'i prezantojë Këshillit përkatës. Periudha kohore se kur duhet t'i prezantohen palës provat dhe afati kohor për përgatitjen e përgjigjes, do të përcaktohet me ligj. Pala në procedurë ka të drejtë të kërkojë hedhjen poshtë të provave

marrja e të cilave është në kundërshtim me dispozitat e aplikueshme në procedurën e vetingut, si dhe nëse të njëjtat nuk provojnë ndonjë fakt relevant në procedurë.

Për të analizuar masat që mund të ndërmerren në kuadër të këtij procesi, duhet të qartësohet fillimisht se jo çdo e gjetur e natyrës negative përbën bazë për shkarkim apo ka nevojë të sanksionohet. Disa informata që mund të zbulohen gjatë procesit të vetingut, mund të shërbejnë thjeshtë për të identifikuar një cenueshmëri të gjyqtarit/prokurorit ndaj një elementi të caktuar. Për këtë arsye, ligji duhet të bëjë shumë të qartë kategorizimin e të dhënave të cilat mund të përbëjnë bazë për shqiptim të çfarëdo mase ndaj kandidatit.

i) propozimi për shkarkim

Në përputhje me instrumentet ndërkombëtare të analizuara më sipër, propozimi për shkarkim duhet të vijë vetëm si rezultat i shkeljeve më serioze të detyrës. Në gjuhën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, parashihet termi '*mosrespektim i rëndë i detyrës*'. Është e nevojshme që Ligji për Vetingun të detajojë pikërisht përmbajtjen e këtij termi dhe të listojë shkeljet serioze që do të përbënin këtë shkelje.

Gjetja e mangësive serioze në integritetin e gjyqtarit apo prokurorit, siç mund të jenë lidhjet me grupe kriminale, shkëmbimi i favoreve apo dhuratave me ta, njëanshmëria politike e dëshmuar përmes vendimeve gjyqësore, gjegjësisht ndjekjes penale që ai i ka marrë, apo performanca aq e ulët sa që rrezikon të drejtat e palëve në procedurë, apo pasuria e pajustificueshme etj., mund të jenë disa nga këto shkelje.

Në mënyrë që të evitohet sfidat e hasura nga Shqipëria si rrjedhojë e mos planifikimit adekuat, procedurat dhe afatet duhet të jenë të para-planifikuara mirë, realisht dhe detajisht. Kështu, mendohet që nga momenti që Mekanizmi përkatës i rekomandon KGJK-së, përkatësisht KPK-së të propozojë shkarkimin e gjyqtarit, përkatësisht prokurorit që rezulton me integritet të munguar apo të meta të tjera të mëdha. Këshilli përkatës do të ketë kohë 15 ditë për të analizuar raportin e Mekanizmit dhe për të marrë vendim lidhur me propozimin për shkarkim. Në rast se Këshilli voton pro propozimit për shkarkim, Presidenti duhet të vendosë lidhur me shkarkimin e gjyqtarit/prokurorit brenda 15 ditësh. Të shkarkuarit, për t'i mundësuar përgatitje adekuate të mbrojtjes, do t'i lihen në dispozicion 15 ditë për ankesë, në analogji me procedurat e tjera gjyqësore. Nëse ky shfrytëzon të drejtën e tij në ankesë, Gjykata Supreme vendosë në instancë të dytë brenda afatit prej 30 ditësh.

Këto afate tentative¹²² pasqyrohen në figurën si më poshtë.

Aktiviteti	Vendimi i Këshillit mbi subjektin vetingut sipas vlerësimit të mekanizmit	Afati për apelim para Gjykatës Supreme	Afati brenda së cilës Gjykata Supreme duhet të vendos	Vendimi i Presidentit në lidhje me shkarkimin	Totali i ditëve
Afati kohor	15 ditë	15 ditë	30 ditë	15 ditë	75 ditë

ii) *propozimi për masa të tjera*

Përpos dorëheqjes, mekanizmat mund të rekomandojnë edhe masa të tjera për gjyqtarët dhe prokurorët që i janë nënshtruar vetingut, nëse konsiderohet të kenë mangësi vetëm në performancë, por që mangësitë nuk janë në nivelin e mjaftueshëm për të kërkuar shkarkim. Masa tjera që mund të rekomandohen janë: masa e trajnimit të detyrueshëm, përfshirë edhe kthimin në trajnim fillestar, dhe masa e uljes në detyrë. Arsyeshmëria për propozimin e këtyre masave ka të bëjë me garantimin e standardit më të lartë profesional për gjyqtarë dhe prokurorë.

e) Efektet tjera për gjyqtarë dhe prokurorë nga procesi i vetingut

Dorëheqja - Gjatë zhvillimit të vetingut, kandidatët kanë të drejtën e dorëheqjes në çdo moment. Në rast se subjekti aplikon në të ardhmen për pozitën e gjyqtarit apo prokurorit, subjekti do të hyjë në proces të vlerësimit të aftësive profesionale, integritetit dhe pasurisë njëjtë sikurse të gjithë kandidatët për rekrutim.

Pasojat e mos-kalimit të procesit të vetingut - Në rast se vlerësimi i mekanizmit është negativ dhe i njëjti propozon shkarkimin e subjektit, të njëjtit do t'i ndalohet aplikimi në pozitën e gjyqtarit dhe prokurorit, pavarësisht nga cila pozitë është shkarkuar.

¹²² Do të shikohet mundësia dhe nevoja e ndryshimit të dispozitave ligjore, për të akomoduar këto afate apo të tjera të zgjedhura, për procesin e vetingut.

Refuzimi i subjektit për t'iu nënshtruar vetingut - Vetingu është një proces i cili kërkon koordinim ndër-institucional si dhe bashkëpunim të subjekteve të vetingut. Refuzimi i bashkëpunimit të subjektit për t'iu nënshtruar vetingut do ketë pasojë shkarkimin nga pozita si dhe ndalimin për të aplikuar në pozitën e gjyqtarit apo prokurorit.

2. NDËRTIMI I MEKANIZMAVE PËR VLERËSIM TË VAZHUESHËM

Organi kompetent për vendosje/vlerësim - Pasi të jetë finalizuar procesi i vetingut, të dy mekanizmat për veting do të ristrukturohet përshtatshëm dhe shndërrohet në mekanizma për vlerësim të vazhdueshëm të integritetit, pasurisë dhe performancës brenda KGJK-së, përkatësisht KPK-së. Vlerësimi i vazhdueshëm do të bëhet në baza të rregullta për gjyqtarë, prokurorë, dhe për nëpunësit në pozita të larta drejtuese në sistemin e drejtësisë.

Ndërtimit të mekanizmave të përhershëm do t'i paraprijë një analizë paraprake për të specifikuar modalitetet e organizimit dhe funksionimit, duke u shërbyer me mësimet e marra nga procesi i vetingut.

Anëtarët në kuadër të secilit prej dy mekanizmave do të kenë mandat të caktuar dhe do bëjnë deklaram vjetor të pasurisë, gjë që do i mbajë ata në një lloj kontrolli nga përfitimet përgjatë mandatit të tyre.

Organi kompetent lidhur me ankesat - Për gjyqtarë dhe prokurorë, Gjykata Supreme, do shërbej si shkallë e dytë. Përkatësisht, në trup gjykues të përbërë nga tre (3) anëtarë, do të vendoset lidhur me ankesat e paraqitura ndaj vendimit për shkarkim. Ndërkaq për zyrtarët e shkarkuar nga pozitat e larta drejtuese, si instancë e dytë do shërbejë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës.

Subjektet e vlerësimit - Vlerësimi i vazhdueshëm i performancës, integritetit dhe pasurisë do të zhvillohet në këto tri momente:

i) tek kandidatët për rekrutim: kjo kategori do të vlerësohet gjatë procesit të rekrutimit si gjyqtarë/prokurorë dhe nëpunës në pozita të larta drejtuese, si parakusht për të qenë pjesë e sistemit;

ii) tek gjyqtarët/prokurorët që ngritën në detyrë: konsiderohet shumë e nevojshme që para marrjes së detyrës së re, atyre t'ju analizohet integriteti, performanca dhe pasuria. Gjyqtari apo prokurori që kandidon për avancim dhe i është nënshtruar vetingut/vlerësimit në dy vitet e fundit para avancimit nuk do të ketë nevojë t'i nënshtrohet sërish vlerësimit; dhe

iii) periodikisht, për të gjithë gjatë karrierës së rregullt: Gjyqtarët dhe prokurorët, si dhe nëpunësit në pozita të larta drejtuese do të vlerësohen sipas radhës në baza periodike, në përputhje me legjislacionin përkatës, në mënyrë që sistemi gjyqësor/prokurorial të filtrohet në baza të rregullta.

iv) vlerësimi me shkas: vlerësimi i performancës, integritetit dhe pasurisë do të mund të iniciohet në rast se paraqiten fakte apo rrethana që e vënë në dyshim përshtatshmërinë e gjyqtarit apo prokurorit apo nëpunësit përkatës për të vazhduar ushtrimin e funksionit të tij.

Baza e të dhënave që mblidhen – kategoritë e të dhënave që mblidhen dhe analizohen me rastin e vlerësimit të vazhdueshëm do të jenë objekt i një analize më të detajuar, pas mësimave të marra nga procesi i vetingut. Natyra dhe niveli i të dhënave që mblidhen do të jenë në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe Kushtetutën si dhe do të jenë proporcionale në raport me nevojat e vlerësimit të integritetit, performancës dhe pasurisë të bërë në suaza periodike.

Masat që mund të ndërmerren – procedura si dhe masat që rekomandohen nga secili prej dy mekanizmave, në rast se identifikohen mangësi apo shkelje në performancë, integritet apo pasuri pas vlerësimit të kandidatit, janë përshtatshëmrisht të njëjta me masat gjatë procesit të vetingut.

Vendimet lidhur me masat i takojnë këshillave përkatës. Ndërkaq, me rastin e rekomandimit për shkarkim të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Këshillat do të propozojnë shkarkimin, i cili do të bëhet nga Presidentit.

Kapitulli 3.4: Opsioni i katërt - Zhvillimi i procesit të vetingut dhe vlerësimit të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe verifikimit të pasurisë përmes ndryshimeve kushtetuese

Opsioni i katërt i zhvillimit të procesit të vetingut dhe vlerësimit të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë do të realizohet përmes ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore. Ky opsion ofron fleksibilitet në dizajnimin e procesit të vetingut, përmes ndryshimit të dispozitave relevante kushtetuese, të cilat për momentin kufizojnë modalitetet lidhur me këtë proces. Pra, për realizimin e vetingut sipas këtij opsioni duhet amendamentuar Kushtetuta.

Ky opsion shtjellon zhvillimin e vetingut dhe pastaj të vlerësimit të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë. Për të arritur këtë, ky opsion parasheh ndërtimin e

një mekanizmi të ri me Kushtetutë. Pas përfundimit të vetingut për të gjithë subjektet e listuara më poshtë, ky mekanizëm do të pësoj ndryshime, për të kryer vlerësimin e vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë së subjekteve në intervale të rregullta.

Subjekte të vetingut edhe me këtë opsion do jenë gjyqtarët, prokurorët, si dhe zyrtarët që mbajnë pozita të larta drejtuese brenda sistemit të drejtësisë, përfshirë: Administratorët e gjykatave dhe prokurorive, Drejtorët e Sekretariateve të KGJK/KPK si dhe Drejtori i Njësisë për Inspektim Gjyqësor në KGJK. Ky proces do të themelohet dhe zbatohet mbi bazën e standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira të shteteve të cilat kanë zhvilluar procesin e vetingut.

1. NDRYSHIMET KUSHTETUESE

Për zhvillimin e një procesi të mirëfilltë të vetingut, nevojitet të bëhen ndryshime kushtetuese të cilat do të shtrihen në plotësimin e dispozitave ekzistuese të Kushtetutës si dhe shtimin e dispozitave të reja të cilat do të akomodojnë një Mekanizëm të ri të pavarur për veting, i cili ndërtohet jashtë Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokuroriaë të Kosovës.

Përmes dispozitave të reja kushtetuese, do të parashihet që Mekanizmi i ri i krijuar për veting do të ndryshojë me rastin e përfundimit të vetingut për të gjithë subjektet të cilët i nënshtrohen atij. Rrjedhimisht, pas përfundimit të vetingut, Mekanizmi për veting do të shndërrohet në Mekanizëm për vlerësim të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë. Fushëveprimi dhe kompetencat e të njëjtit do të rregullohen më tej me ligj. Në tekstin e mëtejme jepet një reflektim i përgjithshëm se si synohet të funksionojë Mekanizmi për veting dhe Mekanizmi për vlerësimin e performancës, integritetit dhe pasurisë.

Në kuadër të ndryshimeve të dispozitave ekzistuese kushtetuese, rrjedh se duhet plotësuar nenet 104 (1) dhe 109 (7) që rregullojnë propozimin për emërim dhe shkarkim, si dhe nenin 84 për kompetencat e Presidentit, përkatësisht paragrafi (15), (16), (17) dhe (18). Kjo në mënyrë që kompetenca e propozimit për emërim/shkarkim t'i dorëzohet mekanizmit të pavarur për periudhën e vetingut dhe vlerësimit të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë. Ky propozim i drejtohet Presidentit, i cili pastaj do ketë të drejtën për shkarkim të subjektit përkatës. Përmes këtyre ndryshimeve do të kihet parasysh që propozimi për shkarkim të lihet në dorën e Mekanizmit të krijuar me dispozita të reja kushtetuese, pa pasur nevojë të kalojë përmes Këshillave.

Ndryshimet tjera do të fokusohen tek arsyet për shkarkim të subjekteve, kufizimin e të drejtës në privatësi në përputhje me nenin 8 të KEDNJ, vetingun në rast rekrutimi për gjyqtarë dhe prokurorë, si dhe kompetencat e Presidentit dhe çështje tjera të ndërlidhura.

Tutje, për të krijuar siguri juridike, nevojitet plotësimi i nenit 104 (4) dhe 109 (6) të Kushtetutës. Këto dy dispozita përcaktojnë dy arsye për shkarkim të gjyqtarit apo prokurorit, të cilat janë vepra e rëndë penale dhe mosrespektimi i rëndë i detyrave. Përmes ndryshimit të Kushtetutës parashihet zgjerimi i bazës për shkarkim të subjekteve të vetingut për arsye të lidhura me të gjeturat që dalin nga vetingu. Arsyet e detajuara për shkarkim mbi bazën e një vlerësimi negativ në procesin e vetingut, do të parashihen me ligjin përkatës për vetingun.

Po ashtu, me anë të këtij procesi duhet të parashihen kompetencat e Presidentit për emërim, riemërim dhe shkarkim të gjyqtarëve dhe prokurorëve në raport me procesin e vetingut. Këto kompetenca duhet të jenë kryesisht formale, por të krijojnë siguri dhe legjitimitet të procesit të vetingut. Pra, shkarkimi i subjektit vendoset në bashkëpunim në mes të mekanizmit dhe Presidentit, për të siguruar po ashtu kontrollin dhe balancin e procesit.

2. MEKANIZMI PËR VETING

Mekanizmi (shih më poshtë figurën me strukturën e tij) në tërësi parashihet të përbëhet nga: a) Mekanizmi për zhvillimin e procesit të vetingut, (shkalla e parë); b) Sekretariati dhe njësitë hetuese; dhe c) Kolegji për Apelim (shkalla e dytë).

a) Struktura e përgjithshme e mekanizmit për veting

Mekanizmi për veting parashihet të jetë një mekanizëm i pavarur i përbërë nga pesë panele, tre për gjyqtarë dhe dy për prokurorë. Panelet për gjyqtarë do të përbëhen nga tre anëtarë: dy gjyqtarë dhe një anëtar jo-gjyqtar. Panelet për prokurorë do të përbëhen nga tre anëtarë: dy prokurorë dhe një anëtar jo-prokuror. Anëtarëve të mekanizmit duhet t'iu sigurohet imunitet përshtatshëm me imunitetin e gjyqtarëve. Mekanizmi do të ketë kryesuesin i cili do të zgjidhet me rotacion nga radhët e anëtarëve gjyqtarë apo prokurorë të paneleve. Anëtarët gjyqtarë dhe prokurorë të paneleve do të kthehen në pozitat e tyre pas përfundimit të mandatit si anëtarë të paneleve.

b) Sekretariati dhe njësitë hetuese

Në përbërjen e Mekanizmit për veting do të parashihet Sekretariati, i cili do të ofrojë gjithë mbështetjen administrative dhe logjistike për panelet. Në përbërjen e Sekretariatit do të jenë tre njësi: a) Njësia për aftësi profesionale dhe performancë; b) Njësia për pasuri; dhe c)

Njësia për integritet. Secila nga këto njësi do të ketë nga 25 hetues profesionalë dhe 5 anëtarë të stafit administrativ. Këto njësi do të mbledhin dhe përpunojnë informacionet përkatëse për secilin subjekt të vetingut, të cilat i dërgohen paneleve për shqyrtim dhe vendosje. Të gjithë anëtarët e këtij organi do t'i nënshtrohen paraprakisht verifikimit.

c) Kolegji për Apelim

Në përbërjen e Mekanizmit për veting, parashihet që të jetë edhe Kolegji për Apelim i cili do të përbëhet nga pesë gjyqtarë. Anëtarët e këtij mekanizmi do të vetohen paraprakisht nga një organ i jashtëm me prezencë ndërkombëtare. Me fillimin e fazës së ristrukturimit të Mekanizmit dhe reduktimin e stafit, Kolegji i Apelimit do të shuhet dhe kompetencat për shqyrtimin e ankesave të subjekteve të vetingut do të kalojnë në Gjykatën Supreme.

Qëllimi i themelimit të Kolegjit për Apelim, është që subjektet e vetingut të kenë mundësinë e atakimit të vendimeve të Mekanizmit të shkallës së parë, mbi bazat e përcaktuara përmes ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore. Bazat e ankimimit duhet të përshtaten me ato të një procedure të rregullt gjyqësore, në mënyrë që subjekti i cili pretendon se i janë shkelur të drejtat, të mund të realizoj të drejtën për mjete efektive juridike, sipas konditave të përcaktuara me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Procedura e zhvilluar në shkallë të parë dhe të dytë duhet të jetë në linjë me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e në veçanti me nenin 6 të Konventës. Në të dyja instancat, subjekti i vetingut ka të drejtën që të përfaqësohet nga një avokat, dhe në rast se nuk ka mjete financiare, sipas kërkesës së tij t'i caktohet një avokat me detyrë zyrtare.

Me ligj do të përcaktohen specifikat e organeve të vetingut, duke përfshirë edhe procedurën disiplinore ndaj anëtarëve të saj dhe procedurën e shkarkimit të tyre.

3. MEKANIZMI PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS, INTEGRITETIT DHE VERIFIKIMIN E PASURISË

Në momentin kur të gjithë subjektet të jenë vetuar nga ana e Mekanizmit për veting, konsiderohet që filtrimi i mirëfilltë i sistemit të drejtësisë veçse është arritur, dhe pjesë e këtij sistemi mbesin vetëm personat me integritet dhe etikë të lartë profesionale. Për të mbajtur balancin në mes nevojës për këtë standard në sistemin e drejtësisë dhe masave që ndërmerren në këtë drejtim, parashihet ristrukturimi i Mekanizmit të vetingut në Mekanizmin për vlerësimin e performancës, integritetit dhe verifikimit të pasurisë. Përmes

këtij ristrukturimi parashihet reduktimi i pjesëve përbërëse të Mekanizmit dhe i numrit të anëtarëve të tyre.

a) Panelet

Panelet parashihet të mbesin edhe në kuadër të Mekanizmit për vlerësimin e performancës, integritetit dhe verifikimit të pasurisë, mirëpo të reduktohen në numër, meqenëse konsiderohet që vëllimi i punës do të jetë shumë më i vogël në krahasim me atë të Mekanizmit për veting.


b) Sekretariati dhe njësitë hetuese

Personeli administrativ i Sekretariatit do të zvogëlohet në numër. Edhe numri i hetuesve në kuadër të njësive do të reduktohet, meqenëse vlerësimi do të zhvillohet në intervale të rregullta kohore dhe me bazë të reduktuar të të dhënave. Rrjedhimisht, mbledhja dhe verifikimi i të dhënave të subjekteve të vlerësimit, do të jenë më sipërfaqësore në krahasim me ato që mbliidhen nga Mekanizmi për veting. Në këtë mënyrë synohet që të zvogëlohen resurset për kontrollin e përshtatshmërisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe ndërhyrjes në të drejtat e subjekteve të vlerësimit. Kjo sepse vlerësohet se nevoja për një kontroll të tillë do të zvogëlohet në mënyrë të konsiderueshme me përfundimin e procesit të vetingut.

c) Ankimimi

Një ndryshim tjetër në Mekanizmin për vlerësimin e performancës, integritetit dhe verifikimit të pasurisë, është se nuk do të ketë Kolegj për apelim, porse kompetencat e saj do të kalojnë në Gjykatën Supreme.

Figura 9: Mekanizmi për veting dhe vlerësim të vazhdueshëm të integritetit, pasurisë dhe performancës sipas Opsionit 4



4. PROCEDURA E PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË MEKANIZMIT

Procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të Mekanizmit, do të zhvillohet në bashkëpunim mes Kuvendit dhe Presidentit. Procedura e përzgjedhjes dhe mënyra e monitorimit e përzgjedhjes, por edhe zbatimit të vetingut dhe vlerësimit të vazhdueshëm, do të përcaktohet me ligj. Qëllimi i grupit punues për hartimin e këtij Koncept Dokumenti është që i tërë procesi të monitorohet nga një trup i përzier, në përbërjen e të cilit janë edhe partnerët ndërkombëtar. Anëtarët e Mekanizmit do të vetohen paraprakisht nga një organ me asistencë ndërkombëtare.

Thirrja publike për aplikim për t'u bërë anëtar i Mekanizmit të vetingut do të shpallet nga Zyra e Presidentit. Kriteret për kandidatët do të përcaktohen me ligj. Zyra e Presidentit do të jetë në marrëveshje me një institucion/organizatë ndërkombëtare për kryerjen e vetingut të kandidatëve për anëtarë të mekanizmave. Emrat e propozuar që kalojnë vetingun, bashkë me arsyet për propozime, do t'i paraqiten Presidentit për aprovim. Pas aprovimit nga Presidenti, emrat e anëtarëve të këtyre mekanizmave do të dërgohen në Kuvendit për aprovim. Specifikat e këtij procesi do të parashihet me dispozitat e reja amendamentuese.

5. PROCEDURA E VETINGUT DHE E VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS, INTEGRITETIT DHE PASURISË

Panelet përbërëse të Mekanizmit me rastin e pranimit të raporteve nga njësitë, do vlerësojnë subjektet e vetingut. Paneli vlerësues, do të konkludojë raportin me vlerësim pozitiv ose negativ për subjektet. Në rast të vlerësimit pozitiv, subjektet e vetingut (gjyqtarët dhe prokurorët, si dhe nëpunësit në pozita të larta drejtuese në sistemin e drejtësisë) vijojnë të mbajnë pozitat e tyre (konfirmohen në detyrë). Nëse subjektet marrin vlerësim negativ, për to do të propozohet sanksioni i caktuar.

Paneli propozimin për shkarkim të subjektit të vetingut do t'ia drejtojë Presidentit, i cili do të shkarkojë gjyqtarin/prokurorin e propozuar për shkarkim. Ndërkaq, propozimin për shkarkim të nëpunësve në pozita të larta drejtuese, Mekanizmi ia parashtron KGJK/KPK-së.

Në rastet kur shpallet konkursi për rekrutim në pozitën e gjyqtarit dhe prokurorit, kandidati do të kalojë fillimisht procesin e vetingut nga Mekanizmi. Vetëm pas kalimit të vetingut nga ana e Mekanizmit, kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë do t'i propozohen Këshillit për të bërë rekrutimin e tyre, e më pastaj për emërim nga Presidenti. Në qoftë se

kandidati vlerësohet negativisht nga mekanizmi, atëherë ai nuk mund të vijojë procesin e rekrutimit. E njëjta do të vlejë edhe për nëpunësit në pozita të larta drejtuese.

Mbledhja e raporteve, procesi i vlerësimit, propozimi i sanksionit si dhe procedura e vetingut në fazën e rekrutimit do të përcaktohen me ligj.

6. BAZA E TË DHËNAVE

Me dispozita përkatëse kushtetuese dhe ligjore do të përcaktohen tri kategori të dhënash të cilat do të mblidhen dhe shqyrtohen gjatë procesit të vetingut. Këtu përfshihen:

i) të dhënat rreth pasurisë: ku objekti i verifikimit të pasurisë mund të jetë deklarimi dhe kontrolli i pasurisë, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të saj, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për të vetuarin;

ii) të dhënat rreth profesionalizmit: ka të bëjë me vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjekteve të rivlerësimit. Të dhënat lidhur me performancën të cilat duhen të vlerësohen, do të jenë të kufizuara. Vlerësimi nuk duhet të lëshohet në çështjet meritorë të vendimeve. Mendohet se në këtë drejtim nuk duhet zgjeruar përtej asaj që është paraparë në rregulloret në fuqi për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve/prokurorëve, të cilat në përgjithësi janë hartuar në maksimumin e lejueshmërisë së vlerësimit cilësor të vendimeve të pranuar nga gjyqtari/prokurori dhe aftësitë tjera profesionale. Gjithashtu, njëra nga kufizimet e bëra qartë nga Rekomandimet e Kievit (të shtjelluara më sipër), është se numri i vendimeve të kthyer nga gjykata e nivelit më të lartë nuk mund të shërbejë si kriter për matjen e performancës.

iii) informata të tjera të lidhura për personalitetin: përfshirë informatat mbi lidhjet apo afërsitë politike të kandidatit, informatat e mbledhura nga terreni, informatat mbi varësitë që mund të ndikojnë në aftësinë për të gjykuar, apo devijime të tjera të lidhura me personalitetin të diagnostifikuar profesionalisht që ndikojnë në integritetin e kandidatit. Mbledhja, përdorimi dhe ruajtja e informatave mbi kandidatin dhe përcaktimi i kohëzgjatjes së ruajtjes së këtyre informatave do të përcaktohen me ligj, duke u siguruar proporcionaliteti në raport me të drejtën në jetë familjare dhe të drejtën në privatësi.

Për mbledhjen e këtyre të dhënave, fillimisht subjektet e vetingut do të dorëzojnë në panelet përkatëse nga një formular të plotësuar për secilën kategori të të dhënave, sipas specifikave të përcaktuara me ligj. Më pastaj, në lidhje me çështjet e specifikuar në formular, panelet do të verifikojnë saktësinë së këtyre të dhënave duke u bazuar në të dhënat mbledhura nga njësitë.

Me ligj duhet të specifikohet qartë se cilat të dhëna mund të mblidhen, procedura e mbledhjes, administrimit dhe përpunimit të tyre e cila duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale; duhet të sanksionohet obligimi për proporcionalitet në mes kufizimit të të drejtës në privatësi dhe jetë familjare e cila mund të rezultojë si shkak i kërkimit dhe verifikimit të të dhënave personale dhe informatave tjera me qëllimin legjitim i cili synohet që të arrihet përmes mbledhjes së këtyre të dhënave; duhet të përcaktohet kohëzgjatja e procedurës për mbledhjen e të dhënave dhe rrethanat se kur duhet të ndërpritet; të parashihet e drejta e palës (subjektit në procedurë) për ankimim, qoftë në aspektin material apo procedural të mbledhjes së këtyre të dhënave si dhe të parashihet asgjësimi i të dhënave personale sipas legjislacionit përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në çdo rast, mbledhja e të këtyre të dhënave dhe informatave dhe ndërhyrjet pasuese do të bëhen në përputhje me nenin 8 të Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut dhe jurisprudencën gjyqësore të zhvilluar në çështje si vetingu ose lustrimi.

Me rastin e hartimit të ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore, duhet të sigurohet që subjekti i vetingut, në procedurën që zhvillohet ndaj tij/saj, të ketë qasje paraprakisht në të gjitha provat të cilat përdoren në procedurë kundër tij/saj, në mënyrë që të mund të përgatis mbrojtjen, t'i kundërshtojë gjetjet, si dhe të mund të propozojë prova të cilat shkojnë në favor të tij apo të saj. Pala në këtë procedurë mund të propozojë dëshmitarë, si dhe të marr në pyetje dëshmitarët të cilët dëshmojnë kundër tij apo saj. Periudha kohore se kur duhet t'i prezantohen palës provat dhe afati kohor për përgatitjen e përgjigjes, do të përcaktohet me ligj. Pala në procedurë ka të drejtë të kërkojë hedhjen poshtë të provave marrja e të cilave është në kundërshtim me dispozitat e aplikueshme në procedurën e vetingut, si dhe nëse të njëjtat nuk provojnë ndonjë fakt relevant në procedurë.

7. SUBJEKTET E VETINGUT

Fillimisht, subjekte të vetingut do jenë të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët. **Faza e parë** do përfshijë: anëtarët e Këshillave; Kryetarin e Gjykatës Supreme dhe gjyqtarët e Gjykatës Supreme; Kryeprokurorin e Shtetit; dhe prokurorët në Zyrën e Kryeprokurorit të shtetit. Në **fazën e dytë** do përfshihen: Kryetari i Gjykatës së Apelit dhe gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, Kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit dhe prokurorët në Prokurorinë e Apelit; Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale dhe prokurorët e Prokurorisë Speciale; Kryetarët e gjykatave themelore dhe Kryeprokurorët e prokurorive themelore; Drejtori i Sekretariatit të KGJK-së, dhe KPK-së, administratorët te gjykatave dhe prokurorive dhe Drejtori i Njësisë për Inspektim Gjyqësor. **Faza e tretë** do përfshijë gjyqtarët mbikëqyrës, gjyqtarët e gjykatave themelore dhe prokurorët e prokurorive themelore. Përgjatë gjithë fazave do

të ketë edhe rekrutim, rrjedhimisht veting të kandidatëve të rinjtë për gjyqtarë dhe prokurorë.

Të gjithë gjyqtarët, prokurorët dhe nëpunësit në pozita të larta drejtuese do të kalojnë një here nëpër procedurën e vetingut. Pas përfundimit të vetingut do të kryhen vlerësime të vazhdueshme të performancës, integritetit dhe pasurisë në këto momente:

i) tek kandidatët për rekrutim: Gjyqtarët, prokurorët dhe nëpunësit në pozita të larta drejtuese do të vetohet gjatë procesit të rekrutimit, që do përfshijë fazën e vlerësimit të integritetit, aftësive profesionale dhe kontrollimit të pasurisë si parakusht për të qenë pjesë e sistemit. Normalisht, tek vetingu i këtyre kandidatëve, nuk do vlerësohet performanca por aftësitë e tyre profesionale.

ii) tek gjyqtarët/prokurorët që ngritën në detyrë: konsiderohet shumë e nevojshme që para marrjes së detyrës së re të njëjtëve si më lartë të i'u analizohet integriteti, performanca dhe pasuria;

iii) tek të gjithë, periodikisht sipas radhës: kjo do bëhet për gjyqtarët/prokurorët në përputhje me legjislacionin përkatës, në mënyrë që sistemi gjyqësor/prokurorial të filtrohet në baza të rregullta; dhe

iv) me shkas: vlerësimi i integritetit, pasurisë dhe performancës do të mund të iniciohet në çdo kohë, qoftë gjatë vetingut apo vlerësimit të vazhdueshëm, në rast se paraqiten fakte apo rrethana që e vënë në dyshim përshtatshmërinë e gjyqtarit apo prokurorit për të vazhduar ushtrimin e funksionit të tij. Pra, me këtë rast, gjyqtari apo prokurori i nënshtrohet vetingut, përkatësisht vlerësimit të performancës, integritetit dhe pasurisë, pa pritur radhën sipas planifikimit të rregullt.

8. SANKSIONET

Parashihen dy lloje të masave për subjektet e vetingut të cilët marrin vlerësim negativ: i) propozimi për shkarkim dhe ii) propozimi për masa të tjera.

Masa e shkarkimit: Shkarkimi i gjyqtarit apo prokurorit duhet të vijë vetëm si rezultat i shkeljeve më serioze të detyrës. Kjo në përputhje me instrumentet ndërkombëtare të analizuara më sipër.

Gjetja e mangësive serioze në integritetin e gjyqtarit apo prokurorit, siç mund të jenë lidhjet me grupe kriminale, shkëmbimi i favoreve apo dhuratave me ta, njëanshmëria politike e dëshmuar përmes vendimeve gjyqësore, gjegjësisht ndjekjes penale që ai i ka

marrë, apo performanca aq e ulët sa që rrezikon të drejtat e palëve në procedurë, apo pasuria e pajustificueshme etj., mund të jenë disa nga këto shkelje. Është e nevojshme që Ligji për Vetingun të detajojë këto dhe të tjera shkelje dhe mangësi për të cilat mund të shkarkohet një gjyqtar apo prokuror.

Nëse shkohet me masën për shkarkime, nuk do të duhej të paragjykohej epilogu lidhur me shkarkimin, deri pas përfundimit të fazës së ankimit.

Theksohet se procedurat dhe afatet pas marrjes së vendimit për shkarkim duhet të jenë të para-planifikuara mirë, realisht dhe detajisht. Kështu, mendohet që nga momenti që Mekanizmi vendos për shkarkim, subjekti ndaj të cilit vendoset shkarkimi mundet që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga pranimi i vendimit, të paraqes ankesë. Lidhur me ankesën, Kolegji i Apelit do të vendosë në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Më pas, në rast se konfirmohet shkarkimi, Presidenti brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh do të mund të shkarkojë gjyqtarin apo prokurorin.

Masa e shkarkimit mund të shqiptohet edhe ndaj nëpunësve në pozita të larta drejtuese, nëse një masë e tillë është proporcionale me të gjeturat e Mekanizmit të vetingut. Ligji për veting do të detajizoj modalitetet në këtë drejtim.

Masa të tjera për mangësi/shkelje më të lehta: Kur evidentohen mangësi vetëm në performancë, e që konsiderohen të tejkaluueshme, mund të shqiptohet edhe trajnimi i detyrueshëm për gjyqtarët/prokurorët, përfshirë trajnimin fillestar, apo edhe ulja në detyrë. Arsyeshmëria për propozimin e këtyre masave ka të bëjë me garantimin e standardit më të lartë profesional për gjyqtarë dhe prokurorë.

9. EFEKTET TJERA PËR GJYQTARË DHE PROKURORË NGA PROCESI I VETINGUT

Dorëheqja - Subjektet e vetingut kanë të drejtën në dorëheqje gjatë gjithë procesit. Megjithatë, në rast të ri-aplikimit për pozitën e gjyqtarit apo prokurorit, subjekti do të hyjë në proces të vetingut, njëjtë sikurse të gjithë kandidatët për rekrutim.

Refuzimi i subjektit për t'iu nënshtruar vetingut - Bashkëpunimi i subjektit nën veting është crucial për zhvillimin e suksesshëm të vetingut. Refuzimi i bashkëpunimit të subjektit për t'iu nënshtruar vetingut do ketë pasojë shkarkimin nga pozita si dhe ndalimin për të aplikuar në pozitën e gjyqtarit, prokurorit.

Pasojat e mos-kalimit të procesit të vetingut - Në rast se vetingu rezulton me shkarkimin e gjyqtarit apo prokurorit, të njëjtit do t'i ndalohet aplikimi në pozitën e gjyqtarit dhe prokurorit, pavarësisht nga cila pozitë është shkarkuar.

Procedura e vetingut do të zhvillohet sipas afateve të paraqitura më poshtë:

Aktiviteti	Afati për apelim para mekanizmit për veting, nga dita e marrjes së vendimit	Afati brenda së cilës mekanizmi për ankimim duhet të marrë vendim përfundimtar	Vendimi i Presidentit në lidhje me shkarkimin, pas vendimit përfundimtar	Totali i ditëve
Afati kohor	15 ditë	30 ditë	15 ditë	60 ditë

Vërejtje: Afatet e parapara në këtë tabelë vlejné vetëm për vetingun. Për vlerësimin e vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë, mund të planifikohen afate të tjera pas përfundimit të procesit të vetingut.

Kapitulli 3.5. Opsioni i pestë: Zbatimi i procesit të vetingut me ndryshime Kushtetuese që mundëson vetingun nga një trup *ad-hoc* dhe më pas vazhdimin e vlerësimit të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë në kuadër të KGJK dhe KPK

Opsioni i pestë parasheh ndërmarrjen e vetingut nga një organ i jashtëm dhe i pavarur dhe më pas, vlerësimin e vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë nga mekanizma të ndërtuar brenda këshillave. Subjekte të vetingut do të jenë të gjithë gjyqtarët, prokurorët, si dhe nëpunësit në pozita të larta drejtuese brenda sistemit të drejtësisë, si: administratorët e gjykatave dhe prokurorive, Drejtorët e Sekretariateve të KGJK/KPK si dhe Drejtori i Njësisë për Inspektim Gjyqësor në KGJK. Në vijim mund të shihet skema e përgjithshme strukturore sipas këtij opsioni, i cili do të shtjellohet më tutje.


Ngjashëm sikurse në Opsionin 3 dhe 4, parashihet që të ndërtohet një sistem përmes së cilit fillimisht zhvillohet vetingu i të gjitha subjekteve të identifikuara si më sipër që do të jenë në detyrë në momentin e nisjes së procesit.¹²³ Me të përfunduar vetingu, struktura institucionale e krijuar me atë qëllim, do të shërbejë si bazë për ndërtimin e një sistemi të rregullt të vlerësimit të vazhdueshëm. Pra, i ashtuquajtimi Mekanizëm për zhvillimin e vetingut – fillimisht mekanizëm i pavarur, do të shndërrohet në dy Mekanizma për vlerësimin e vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë së gjyqtarëve, përkatësisht prokurorëve, që do të integrohet brenda KGJK-së, gjegjësisht KPK-së. Në këtë formë, do të ndërtohet një sistem i qëndrueshëm që si i tillë, edhe do të prodhojë rezultate të qëndrueshme. Si rrjedhojë, për të shmangur punën e dyfishtë dhe burokracinë teknike, në kuadër të secilit Këshill, do të shuhet Komisioni për Vlerësimin e Performancës në KGJK/KPK-së dhe Njësia për Shqyrtimin e Performancës.

Qëllimi i grupit punues për hartimin e këtij Koncept Dokumenti është që i tërë procesi të monitorohet nga një trup i përzier, në përbërjen e të cilit janë edhe partnerët ndërkombëtar.

Figura 10 skicon sistemin e përgjithshëm që do të krijohet me zbatimin e Opsionit 5, ndërsa detajet shpjegohen tutje në këtë kapitull.

¹²³ Kjo nuk përjashton as gjyqtarët, prokurorët dhe nëpunësit në pozita të larta drejtuese të gjykatave dhe prokurorive të reja që mund të krijohen përgjatë periudhës sa zgjatë procesi i vetingut.

Figura 10: Mekanizmi i vetingut dhe vlerësimit të vazhdueshëm të performancës, pasurisë dhe integritetit sipas Opsionit 5



1. VETINGU ME NDRYSHIME KUSHTETUESE

Vetingu, sipas Opsionit 5, do të zbatohet mbi bazën e standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira të shteteve të cilat kanë zhvilluar procesin e vetingut.

Procesi i vetingut do të zhvillohet nga mekanizmi kushtetues sipas përbërjes, kompetencave dhe të gjitha autorizimeve të parapara në Opsionin 4 (zbatimi i vetingut me ndryshime Kushtetuese), megjithatë të njëjtat do të shtjellohen më poshtë, me qëllim të qartësisë.

Zhvillimi i procesit të vetingut me ndryshime kushtetuese ofron fleksibilitet në dizajnimin e procesit të vetingut, përmes ndryshimit të neneve relevante, të cilat për momentin kufizojnë modalitetet lidhur me këtë proces. Pra, sipas këtij lloji për realizimin e vetingut, do të amandamentohej Kushtetuta.

a) Ndryshimet kushtetuese

Për zhvillimin e një procesi të mirëfilltë të vetingut, nevojitet të bëhen ndryshime kushtetuese për të akomoduar një mori çështjesh. Amendamenti i Kushtetutës do të ndjek procedurën e paraparë kushtetuese.

Fillimisht, do duhej që në kuadër të dispozitave kushtetuese të parashihet themelimi i mekanizmit që do të zhvillojë procesin e vetingut, i cili si i tillë, do të shuhet me përfundimin e vetingut.¹²⁴

Sipas këtij modeli, propozimi për shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, përgjatë procesit të vetingut, do t'i lihet në dorë drejtpërdrejtë mekanizmit, pa pasur nevojë të kalojë përmes këshillave. Kështu, mekanizmi, propozimin për shkarkim do t'ia drejtojë Presidentit, i cili pastaj do ketë të drejtën për shkarkim të subjektit përkatës. Pra, shkarkimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve vendoset në bashkëpunim në mes të mekanizmit dhe Presidentit, për të siguruar po ashtu kontrollin dhe balancin e procesit.

Ndryshimet tjera kushtetuese do të fokusohen tek arsyet për shkarkim të subjekteve, kufizimin e të drejtës në privatësi, vetingun me rastin e rekrutimit për gjyqtarë dhe prokurorë, kompetencat e Presidentit dhe çështje tjera të ndërlidhura.

¹²⁴ Fushëveprimi dhe kompetencat e mekanizmit do të rregullohen më tej me ligj.

Kështu, rrjedh se duhet plotësuar nenet 104 (1) dhe 109 (7) që rregullojnë propozimin për emërim dhe shkarkim, si dhe nenin 84 për kompetencat e Presidentit, gjegjësisht paragrafi (15), (16), (17) dhe (18).

Po ashtu, për të krijuar siguri juridike, neni 104 (4) dhe 109 (6) duhet plotësuar. Këto dy dispozita përcaktojnë dy arsye për shkarkim të gjyqtarit apo prokurorit, të cilat janë *vepra e rëndë penale* dhe *mosrespektimi i rëndë i detyrave*. Me ndryshim të Kushtetutës parashihet zgjerimi i bazës për shkarkim të subjekteve të vetingut, duke shtuar edhe një arsye për shkarkim, që ndërlidhet me të gjeturat e vetingut, atëherë kur plotësohen kushtet për shkarkim të subjektit. Arsyet e detajuara për shkarkim mbi bazën e një vlerësimi negativ në procesin e vetingut, do të parashihen me ligjin përkatës për vetingun.

b) Rradhët e vetingut

Siç u potencua më lartë, subjekte të vetingut do jenë të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët dhe nëpunësit në pozita të larta në sistemin e drejtësisë. Megjithatë, procesi i vetingut do i kategorizojë disa radhë të subjekteve ndaj të cilëve do të zhvillohet vetingu, dhe rrjedhimisht do të ndahet në disa faza. **Faza e parë** do përfshijë: anëtarët e këshillave; Kryetarin e Gjykatës Supreme dhe gjyqtarët e Gjykatës Supreme; Kryeprokurorin e Shtetit; dhe prokurorët në Zyrën e Kryeprokurorit të shtetit.. Në **fazën e dytë** do përfshihen: Kryetari i Gjykatës së Apelit dhe gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, Kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit dhe prokurorët në Prokurorinë e Apelit; Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale dhe prokurorët e Prokurorisë Speciale; Kryetarët e gjykatave themelore dhe Kryeprokurorët e prokurorive themelore; Drejtori i Sekretariatit të KGJK-së, dhe KPK-së, administratorët te gjykatave dhe prokurorive dhe Drejtori i Njësisë për Inspektim Gjyqësor. **Faza e tretë** do përfshijë gjyqtarët mbikëqyrës, gjyqtarët e gjykatave themelore dhe prokurorët e prokurorive themelore. Përgjatë gjithë fazave do të ketë edhe rekrutim, rrjedhimisht veting të kandidatëve të rinj për gjyqtarë dhe prokurorë. Plani i zbatimit për Opsionin 5, më poshtë në këtë Koncept Dokument, detajon më tej radhën dhe afatet e zhvillimit të procesit të vetingut.

Theksohet se të gjithë gjyqtarët, prokurorët dhe nëpunësit në pozita të larta drejtuese do të kalojnë vetëm një herë nëpër procedurën e vetingut.

c) Struktura e përgjithshme organizative e Mekanizmit të vetingut

Sipas këtij Opsioni dhe si rrjedhojë e ndryshimeve kushtetuese, do të themelohet një mekanizëm i pavarur. Mekanizmi i vetingut, strukturalisht, parashihet të ketë këtë përbërje: a) Mekanizmi për zhvillimin e procesit të vetingut (shkalla e parë); b) Sekretariati dhe njësitë hetuese; dhe c) Kolegji për Apelim (shkalla e dytë).

Paraqitja skematike e sistemit të vetingut sipas Opsionit 5 është prezantuar në Figurën 11 më poshtë.

Mekanizmi për zhvillimin e procesit të vetingut

Siç u shpjegua më sipër, ndryshimet kushtetuese do t'i hapin rrugë themelimit të Mekanizmit për zhvillimin e procesit të vetingut.

Mekanizmi për zhvillimin e procesit të vetingut parashihet të përbëhet prej pesë paneleve. Prej këtyre, tri panele do të ndërmarrin vetingun e gjyqtarëve, ndërsa dy atë të prokurorëve. Numri i paneleve është caktuar përkitazi me numrin e subjekteve nga secili profil, ashtu që vetingu të përfundojë në kohë të njëjtë si për sistemin gjyqësor, ashtu edhe për atë prokurorial.

Tri panelet për gjyqtarë do të jenë të njëjta për nga përbërja dhe do të zhvillojnë paralelisht punën. Panelet do të kenë në përbërja nga tre anëtarë, prej të cilëve nga dy gjyqtarë dhe nga një anëtar jo-gjyqtar. Ngjashëm, dy panelet për prokurorë, që po ashtu do të zhvillojnë në të njëjtën kohë punën, do të përbëhen secili nga tre anëtarë. Prej tyre, nga dy do të jenë prokurorë, ndërsa nga një anëtar nuk do të jetë prokuror. Në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe komentet e pranuar gjatë konsultimit publik, parashihet që anëtarët e paneleve që nuk do të jenë as gjyqtarë e as prokurorë, të jenë profesionistë të fushës së drejtësisë, të shquar dhe me integritet të lartë dhe të cilët nuk kanë pasur pozita politike për një kohë të caktuar para kandidimit në këtë pozitë. Këto dhe kriteret të tjera për rekrutim do të përcaktohen me Ligjin për Vetingun. Anëtarët gjyqtarë dhe prokurorë të paneleve do të kthehen në pozitat e tyre pas përfundimit të mandatit si anëtarë të paneleve.

Puna e mekanizmit si tërësi, do të udhëhiqet nga një Kryesues, i cili do të zgjidhet me rotacion nga radhët e të gjithë anëtarëve të mekanizmit. Meqenëse në këtë fazë nuk mund të flasim me precizitet aritmetik, në rast se nevojat praktike dëshmojnë ndryshe, numri i paneleve dhe anëtarëve të tyre mund të ndryshohet dhe përshtatet gjatë hartimit të ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore.

Duke u shërbyer me përvojën e vendeve tjera të trajtuara më sipër dhe në frymë e standardeve ndërkombëtare, si element tjetër për të siguruar pavarësinë dhe paanësinë e punës së mekanizmave është kohëzgjatja e mandatit të tyre. Anëtarët e mekanizmave të vetingut do të kenë mandat që do të zgjatë po aq sa procesi i vetingut.

Sekretariati dhe njësitë hetuese

Në përbërjen e Mekanizmit do të parashihet Sekretariati, i cili ofron gjithë mbështetjen administrative dhe logjistike për mbarë Mekanizmin për zhvillimin e vetingut.

Në përputhje me tri segmentet në të cilat do të përqendrohet vetingu, në përbërjen e Sekretariatit do të jenë tri njësi: a) Njësia për aftësi profesionale dhe performancë; b) Njësia për pasuri dhe; c) Njësia për integritet. Parashihet që secila nga këto njësi do të ketë nga 25 hetues profesionalë dhe 5 anëtarë të stafit administrativ. Njësitë operacionale do të kenë detyrën e rëndësishme të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave dhe informacioneve nga segmenti përkatës për subjektin që është nën shqyrtim. Raportet me gjetjet e hetuesve profesionalë, do t'i dërgohen panelit përpara të cilit zhvillohet procedura e vetingut ndaj atij personi.

Për shkak të natyrës së punës që do të duhet të bëjnë, përveç se do të rekrutohen mbi bazën e kriterëve të larta, të gjithë anëtarët e Sekretariatit do t'i nënshtrohen po ashtu paraprakisht vetingut.

Kolegji për Apelim

Gjatë zhvillimit të vetingut, mekanizmi i përgjithshëm për vetingun sipas Opsionit 5, do të ketë në përbërje edhe instancën e dytë. Kolegji i Apelit do të krijohet në kuptim të Tribunalit dhe për t'i shërbyer të drejtës së subjektit në mjet efektiv juridik, sipas përcaktimeve të nenit 6 dhe nenit 13 të KEDNJ-së dhe jurisprudencës së GJEDNJ. Vendimet e nxjerrë nga Mekanizmi për zhvillimin e vetingut në cilësinë e tij si instancë e parë, subjekti i pakënaqur do të mund t'i apelojë pranë Kolegjit të Apelit. Bazat e ankimit duhet të përshtaten me ato të një procedure të rregullt gjyqësore. Kolegji i Apelimit do të ketë në përbërje pesë gjyqtarë. Këta gjyqtarë do t'i nënshtrohen paraprakisht vetingut nga një organ i jashtëm dhe me prezencë ndërkombëtare. Detajet tjera për sa i përket Kolegjit të Apelimit dhe procedurës në shkallë të dytë, do të përcaktohen përmes ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore.

d) Procedura e përzgjedhjes së anëtarëve të Mekanizmit

Moment kyç për ndërmarrjen e vetingut sipas Opsionit 5 është padyshim përzgjedhja e anëtarëve të strukturave si më sipër, që bashkërisht përbëjnë Mekanizmin e vetingut. Procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të Mekanizmit, përfshirë Organet për zhvillim të vetingut dhe Kolegjin e Apelit, do të zhvillohet në bashkëpunim mes Kuvendit dhe Presidentit. Me qëllim të ruajtjes së balancit të forcave, parashihet që thirrja publike për aplikim për t'u bërë anëtar i Mekanizmit të vetingut do të shpallet nga Zyra e Presidentit. Kriteret për kandidatët do të përcaktohen me ligj. Zyra e Presidentit do të jetë në marrëveshje me një institucion/organizatë ndërkombëtare, për kryerjen e vetingut të kandidatëve për anëtarë të mekanizmave. Emrat e propozuar që kalojnë vetingun, bashkë me arsyet për propozime, do t'i propozohen Presidentit. Pas aprovimit nga Presidenti, emrat e anëtarëve të këtyre mekanizmave do t'i dërgohen Kuvendit për votim.

Përkundër që ky opsion parasheh ndryshimin e Kushtetutës, ky model, megjithatë, është paraparë në frymën e ndarjes së pushteteve dhe kompetencave tipike përkatëse të secilit institucion për një demokraci parlamentare, siç është Kosova.

Vetë anëtarët e mekanizmave, do të vetohen paraprakisht nga një organ me asistencë ndërkombëtare. Është thelbësore ndërmarrja e procesit të verifikimit për kandidatët për anëtarë të mekanizmave, kjo pasi që ata që bëjnë vetingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve, duhet vetë të jenë subjekte të verifikuar. Kështu, ofrohet garanci që procesi nuk do të jetë i cenueshëm në dëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve që i nënshtrohen vetingut. Detajet tjera, përfshirë procedurën e përzgjedhjes dhe detajet rreth përzgjedhjes, elementeve siguroese si mbikëqyrja dhe mekanizmat e llogaridhënies së procesit, do të përcaktohet me ligj.

e) Procedura e vetingut

Sipas përshkrimit më sipër rreth sekuencimit të procesit, fillimisht do të zhvillohet procesi i vetingut, planifikimi kohor i të cilit është detajuar në Planin e zbatimit për Opsionin 5. Ky plani i zbatimit detajon gjithashtu radhën për kryerjen e vetingut në sistemin gjyqësor dhe atë prokurorial.

Pra, sipas strukturës së përshkruar më sipër, panelet do të jenë ato që shqyrtojnë meritorisht rastet. Të gjitha panelet punojnë paralelisht. Thënë ndryshe, njëkohësisht do

të mund të jenë në shqyrtim pesë subjekte – tre nga sistemi gjyqësor e dy nga sistemi prokurorial.

Mbledhja e të dhënave dhe informacioneve për rastin në shqyrtim do të bëhet nga njësitë. Të gjeturat e njërive përmbledhen në formë të një raporti. Paneli përkatës vlerësues, në kolegji me përbërje të plotë prej tre anëtarëve të tij, do të shqyrtojë meritoretishtë lëndën.

Në rast se marrë në përgjithësi, nga vlerësimi prej të tri segmenteve, subjekti rezulton si i përshtatshëm, i rregullt dhe i aftë për punën e vet, atëherë paneli nxjerr vendim pozitiv. Me këtë rast, ai subjekt konfirmohet në detyrën që veçse është duke e ushtruar. Në rast se gjatë shqyrtimit të rastit, paneli vëren shkelje apo të meta tjera, atëherë për subjektin do të propozohet sanksioni i caktuar. Vendimet do të jenë të arsyetuara mirë. Parimisht dhe pa cenuar privatësinë e subjektit, vendimet do të jenë publike.

Që nga momenti i inicimit të vetingut, subjekti do të njoftohet se është duke u trajtuar lënda e tij. Ligji do të sigurojë respektimin e të drejtës së subjektit në gjykim të drejtë, duke përcaktuar se ai/ajo do të ketë qasje në materialin e lëndës së tij, pra në gjetjet dhe informatat e mbledhura mbi të cilat vendosë paneli. Subjekti i vetingut do të ketë të drejtë t'i kundërshtojë këto gjetje dhe të paraqesë prova, dhe dëshmitarë, si dhe të marrë në pyetje dëshmitarët të cilët dëshmojnë kundër tij apo saj. Periudha kohore se kur duhet t'i prezantohen palës provat dhe afati kohor për përgatitjen e përgjigjes, do të përcaktohet me ligj. Pala në procedurë ka të drejtë të kërkojë hedhjen poshtë të provave marrja e të cilave është në kundërshtim me dispozitat e aplikueshme në procedurën e vetingut, si dhe nëse të njëjtat nuk provojnë ndonjë fakt relevant në procedurë.

Subjektit të vetingut i garantohet gjithashtu e drejta në ankesë, të cilën mund ta paraqesë përpara Kolegjit të Apelimit. Siç u tha, bazat e ankimit duhet të përshtaten me ato të një procedure të rregullt gjyqësore.

Në të dyja instancat, subjekti i vetingut ka të drejtën që të përfaqësohet nga një avokat, dhe në rast se nuk ka mjete financiare, sipas kërkesës së tij/saj t'i caktohet një avokat me detyrë zyrtare. Procedura e zhvilluar në shkallë të parë dhe të dytë do të jetë në linjë me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e në veçanti me nenin 6 të Konventës.

Procedura e vetingut sipas përshkrimit të mësipërm, do të zhvillohet në këto katër momente:

i) **sipas radhës:** Vetingu sipas radhës, i elaboruar më sipër në këtë Koncept Dokument, është kategorizimi më i rëndësishëm në kuadër të procesit të vetingut dhe atij do t'i nënshtrohen të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët.

ii) tek kandidatët për rekrutim: kjo kategori do të vlerësohet gjatë procesit të rekrutimit si gjyqtarë/prokurorë, përgjatë kohës sa zgjatë procesi i vetingut, që do përfshijë fazën e vlerësimit të integritetit, arritjeve profesionale dhe kontrollimit të pasurisë si parakusht për të qenë pjesë e sistemit.

Duke pasur parasysh se në rast se disa nga subjektet do të shkarkohen nga detyrat që mbajnë për shkak të rezultateve të vetingut, është paraparë që në mundësinë e parë, vendet vakante të plotësohen. Në këtë rast, Këshillat përkatës do të ndërmarrin veprimet e caktuara në kompetencën e tyre për rekrutimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj. Rekrutimet e reja do t'i nënshtrohen po ashtu vetingut nga Mekanizmi për zhvillimin e vetingut. Sigurisht, vetingu i rekrutëve të rinj do të dallojë nga vetingu i subjekteve që veçse janë në detyrë. Detajet për këtë do të përcaktohen në ligj.

Vetëm pasi të kenë marrë vlerësim pozitiv, këta kandidatë do t'i propozohen Këshillit përkatës, që sipas procedurës së rregullt t'i propozohen Presidentit. Nëse kandidati vlerësohet negativisht nga mekanizmi, atëherë ai nuk mund të vijojë procesin e rekrutimit. E njëjta do të vlejë edhe për nëpunësit në pozita të larta drejtuese.

iii) tek gjyqtarët/prokurorët që ngritën në detyrë: konsiderohet shumë e nevojshme që para marrjes së detyrës së re, atyre t'ju analizohet integriteti, performanca dhe pasuria. Gjyqtari ose prokurori që kandidon për avancim dhe i është nënshtruar vetingut në vitet e fundit para avancimit, periudhë kjo që do të konkretizohet me ligj, nuk do të ketë nevojë t'i nënshtrohet sërish vlerësimit; dhe

iv) vetingu me shkas: vetingu do të mund të inicohet në rast se paraqiten fakte apo rrethana që e vënë në dyshim përshtatshmërinë e gjyqtarit apo prokurorit, apo nëpunësit në pozitë të lartë drejtuese, për të vazhduar ushtrimin e funksionit të tij.

f) Baza e të dhënave

Me rastin e vetingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve, janë tri kategori të dhënash të cilat mblidhen dhe shqyrtohen dhe mbi të cilat vendoset. Së pari, me inicimin e vetingut ndaj një gjyqtari/prokurori, atij do i kërkohet të dorëzoj tek mekanizmi formularin e plotësuar për secilën kategori të dhënash, sipas specifikave të përcaktuara me ligj. Më pastaj, në lidhje me çështjet e specifikuar në formular, paneli përkatës do të verifikojë saktësinë e të dhënave dhe do të krahasojë ato me të gjeturat e mbledhura nga njësitë.

Gjatë procesit të vetingut të një subjekti, do të mblidhen të dhënat si:

i) të dhënat rreth aftësive profesionale dhe performances - Të dhënat lidhur me performancën të cilat duhet të vlerësohet, do të jenë të kufizuara. Duhet pasur kujdes gjatë vlerësimit të performancës që kjo të bëhet pa u lëshuar në çështjet substanciale të vendimit apo të rigjykohet rasti. Paneli duhet të vlerësojë dhe të vërej rastet kur një vendim paraqet arsyeshmëri të çuditshme e të mangët, ashtu që të rezultojë në mungesë të drejtshmërisë dhe paanësisë. Bërja e këtij vlerësimi në rast se pretendohet se në nxjerrjen e një vendimi të caktuar gjyqtari nuk është treguar profesional, nuk mund të bëhet me zbatim të një “formule të përgjithshme”. Kur në pyetje është shqyrtimi i performancës, duhet të shqyrtohen me kujdes të gjithë faktorët dhe rrethanat e rastit, si dhe bazueshmëria e pretendimeve në fakte dhe prova. Rregulloret e reja të KGjK-se dhe KPK-së përbëjnë një bazë solide dhe të duhur për matjen e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kriteret e matjes së performancës janë në parim të përmbajtura aty. Mangësia kryesore mbetet zbatimi i tyre në praktikë i cili, siç u diskutua më sipër, tregon të jetë tejet zemërgjerë me kandidatët. Për më tepër, në bazë të të dhënave të mbledhura do të kuptohet se a është gjyqtari/prokurori i aftë profesionalisht për të ushtruar detyrën.

Konsiderohet se nuk duhet zgjeruar përtej asaj që është paraparë në Rregulloret aktuale për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve/prokurorëve, të cilat në përgjithësi janë hartuar në maksimumin e lejueshmërisë së vlerësimit cilësor të vendimeve të pranuar nga gjyqtari/prokurori dhe aftësitë tjera profesionale. Gjithashtu, njëra nga kufizimet e bëra qartë nga Rekomandimet e Kievit (të shtjelluara më sipër), është së numri i vendimeve të kthyera nga gjykata e nivelit më të lartë nuk mund të shërbejë si kriter për matjen e performancës.

ii) të dhënat rreth pasurisë - Të dhënat që verifikohen sa i përket pasurisë, do të përfshijnë të gjitha asetet në përputhje me Ligjin përkatës për Deklarimin e Pasurisë. Verifikimi i pasurisë ka për objekt deklarimin dhe kontrollin e pasurive, ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre, si dhe përmbushjen e detyrimeve financiare. Pasuria do të vlerësohet sa i përket asaj se a është keqpërdorur pozita si gjyqtar/prokuror për t’i sjellë përfitime financiare vetes apo personit të tretë. Me Ligjin për Vetingun do të detajohen modalitetet sa i përket vlerësimit të pasurisë.

iii) informata të tjera të lidhura për personalitetin - Informatat e lidhura për personalitetin, të cilat do të mblidhen dhe vlerësohen me rastin e vetingut të subjektit përfshijnë: informatat mbi lidhjet/afërsitë politike ose me grupet e tjera të interesit të kandidatit të cilat ndikojnë në vendimmarrjen e tyre; informatat mbi varësitë që mund të ketë subjekti i vetingut apo devijime të tjera të lidhura me personalitetin, që do të mund

të ndikonin në aftësinë për të gjykuar, apo do ta bënë subjektin e vetingut të padenjë për të ushtruar funksionin e tij; informata të tjera të mbledhura nga terreni.

Baza e të dhënave për vetingun e nëpunësve në pozita të larta drejtuese do të precizohet me ligj. Po ashtu për ta, do të mblidhen dhe vlerësohen të dhëna sa i përket performancës së tyre, integritetit dhe pasurisë.

Në situatën kur nga të gjeturat e mekanizmit, rezulton se ka elemente të veprës penale, mekanizmi çështjen duhet ta referojë tek organet kompetente.

Me ligj duhet të specifikohet qartë se cilat të dhëna mund të mblidhen, procedura e mbledhjes, administrimit dhe përpunimit të tyre e cila duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale; duhet të sanksionohet obligimi për proporcionalitet në mes kufizimit të të drejtës në privatësi dhe jetë familjare e cila mund të rezultojë si shkak i kërkimit dhe verifikimit të të dhënave personale dhe informatave tjera me qëllimin legjitim i cili synohet që të arrihet përmes mbledhjes së këtyre të dhënave; duhet të përcaktohet kohëzgjatja e procedurës për mbledhjen e të dhënave dhe rrethanat se kur duhet të ndërpritet; të parashihet e drejta e palës (subjektit në procedurë) për ankimim, qoftë në aspektin material apo procedural të mbledhjes së këtyre të dhënave si dhe të parashihet asgjësimi i të dhënave personale sipas legjislacionit përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në çdo rast, mbledhja e të këtyre të dhënave dhe informatave dhe ndërhyrjet pasuese do të bëhen në përputhje me nenin 8 të Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut dhe jurisprudencën gjyqësore të zhvilluar në çështje si vetingu ose lustrimi.

g) Sanksionet

Gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët Mekanizmi për veting i ka bërë vlerësim negativ, varësisht nga natyra dhe intensiteti i shkeljeve/mangësive të evidentuara, mund t'u shqiptohen:

Masa e shkarkimit: Shkarkimi i gjyqtarit apo prokurorit duhet të vijë vetëm si rezultat i shkeljeve më serioze të detyrës. Kjo në përputhje me instrumentet ndërkombëtare të analizuar më sipër.

Gjetja e mangësive serioze në integritetin e gjyqtarit apo prokurorit, siç mund të jenë lidhjet me grupe kriminale, shkëmbimi i favoreve apo dhuratave me ta, njëanshmëria politike e dëshmuar përmes vendimeve gjyqësore, gjejësisht ndjekjes penale që ai i ka marrë, apo performanca aq e ulët sa që rrezikon të drejtat e palëve në procedurë, apo

pasuria e pajustificueshme etj., mund të jenë disa nga këto shkelje. Është e nevojshme që Ligji për Vetingun të detajojë këto dhe të tjera shkelje dhe mangësi për të cilat mund të shkarkohet një gjyqtar apo prokuror.

Nëse shkohet me masën për shkarkime, nuk do të duhej të paragjykohej epilogu lidhur me shkarkimin, deri pas përfundimit të fazës së ankimit.

Theksohet se procedurat dhe afatet pas marrjes së vendimit për shkarkim duhet të jenë të para-planifikuara mirë, realisht dhe detajisht. Kështu, mendohet që nga momenti që Mekanizmi vendos për shkarkim, subjekti ndaj të cilit vendoset shkarkimi mundet që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga pranimi i vendimit, të paraqes ankesë. Lidhur me ankesën, Kolegji i Apelit do të vendosë në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Më pas, në rast se konfirmohet shkarkimi, Presidenti brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh do të mund të shkarkojë gjyqtarin apo prokurorin.

Afatet tentative lidhur me shkarkimin e gjyqtarit apo prokurorit janë paraqitura më poshtë:

Aktiviteti	Afati për apelim të vendimit për shkarkim	Vendimi i Kolegjit të Apelit lidhur me ankesën	Vendimi i Presidentit sa i përket shkarkimit të gjyqtarit/prokurorit	Totali i ditëve
Afati kohor	15 ditë	30 ditë	15 ditë	60 ditë

Vërejtje: Afatet e parapara në këtë tabelë vlejné vetëm për vetingun. Për vlerësimin e vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë, mund të planifikohen afate të tjera pas përfundimit të procesit të vetingut.

Masa e shkarkimit mund të shqiptohet edhe ndaj nëpunësve në pozita të larta drejtuese, nëse një masë e tillë është proporcionale me të gjeturat e Mekanizmit të vetingut. Ligji për veting do të detajizoj modalitetet në këtë drejtim.

Masa të tjera për mangësi/shkelje më të lehta: Kur evidentohen mangësi vetëm në performancë, e që konsiderohen të tejkalueshme, mund të shqiptohet edhe trajnimi i

detyrueshëm për gjyqtarët/prokurorët, përfshirë trajnimin fillestar, apo edhe ulja në detyrë. Arsyeshmëria për propozimin e këtyre masave ka të bëjë me garantimin e standardit më të lartë profesional për gjyqtarë dhe prokurorë.


h) Efektet tjera për gjyqtarët dhe prokurorët gjatë procesit të vetingut

Dorëheqja - Subjektet e vetingut kanë të drejtën në dorëheqje gjatë gjithë procesit. Megjithatë, në rast të ri-aplikimit për pozitën e gjyqtarit apo prokurorit, subjekti do të hyjë në proces të vetingut, njëjtë sikurse të gjithë kandidatët për rekrutim.

Refuzimi i subjektit për t'iu nënshtruar vetingut - Bashkëpunimi i subjektit nën veting është crucial për zhvillimin e suksesshëm të vetingut. Refuzimi i bashkëpunimit të subjektit për t'iu nënshtruar vetingut do ketë pasojë shkarkimin nga pozita si dhe ndalimin për të aplikuar në pozitën e gjyqtarit, prokurorit.

Pasojat e mos-kalimit të procesit të vetingut - Në rast se vetingu rezulton me shkarkimin e gjyqtarit apo prokurorit, të njëjtit do t'i ndalohet aplikimi në pozitën e gjyqtarit dhe prokurorit, pavarësisht nga cila pozite është shkarkuar.

Figura 11: Mekanizmi për veting sipas Opsionit 5



2. VLERËSIMI I VAZHduESHËM I PERFORMANCËS, PASURISË DHE INTEGRITETIT

Mekanizmi Kushtetues për veting do të përfundojë punën e tij me vetingun e plotë të gjyqtarëve, prokurorëve dhe nëpunësve në pozitat e larta drejtuese. Kështu, Këshillat do të kenë përbërje me anëtarë dhe nëpunës tashmë të vetuar dhe, aty e tutje, konsiderohet se Këshillat do të jenë të gatshëm dhe për vazhduar garantimin e performancës dhe integritetit në baza të vazhdueshme.

Duke konsideruar se me anë të vetingut arrihet qëllimi i fazës së parë, pra i filtrimit të sistemit të drejtësisë, për të vazhduar me ruajtjen e të njëjtit nivel dhe ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm, do të vijohet me fazën e dytë, e cila do të jetë një vlerësim i vazhdueshëm i performancës, pasurisë dhe integritetit. Kjo do të zhvillohet duke marrë parasysh përvojën dhe rezultatet e vetingut, si dhe analizat e mëtutjeshme që do të zhvillohen në ndërkohë. Qëllimi është krijimi i mekanizmave përkatës brenda këshillave për vlerësim të vazhdueshëm.

Ndryshimet e parapara në kuadër të kësaj faze mundësohen përmes hartimit të legjislacionit përkatës.

Mekanizmat për Vlerësim të Vazhdueshëm të Performancës, Pasurisë dhe Integritetit të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve

Kur në përputhje me planifikimet e detajuara në Planin e zbatimit për Opsionin 5 të jetë përfunduar vetingu i gjyqtarëve, prokurorëve dhe pozitave të larta të administratës së gjyqësorit si më sipër, Mekanizmi për zhvillimin e procesit të vetingut do të ketë përmbushur mandatin e vet. Mbi bazën e strukturës institucionale dhe kapaciteteve tjera të këtij mekanizmi, do të krijohen dy mekanizma – njëri do të shërbejë për kryerjen e vlerësimit të vazhdueshëm për gjyqtarë, e tjetri për prokurorë. Pra, nga një mekanizëm i pavarur, do të krijohen dy mekanizma të rregullt brenda KGJK-së, përkatësisht KPK-së. Më saktësisht, panelet për gjyqtarë do të marrin formën e mekanizmit për vlerësimin e vazhdueshëm për gjyqtarë që do të përbëj entitet integral të KGJK-së. Panelet për prokurorë, do të marrin formën e mekanizmit për vlerësimin e vazhdueshëm për prokurorë, i cili do të integrohet në kuadër të KPK-së. Detajet e shndërrimit të mekanizmit fillestar dhe tutje integritetit të mekanizmave të rinj në Këshilla, do të përcaktohen në amandamentet kushtetuese dhe në ligjet përkatëse

Mekanizmat do të kenë pavarësi funksionale në kuadër të kompetencave dhe detyrave që kanë sipas ligjit. Mekanizmat përkatës do të zhvillojnë ekskluzivisht procesin e

vlerësimin të vazhdueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët aktualë, si dhe për kandidatët potencialë për gjyqtarë dhe prokurorë.

Në përbërjen e secilit prej këtyre dy mekanizmave do të jenë nga dy panele dhe nga një sekretari. Në kuadër të secilit mekanizëm do të funksionojnë: 1. Paneli për vlerësimin e performancës dhe 2. Paneli për vlerësimin e pasurisë dhe integritetit. Të dy panelet do të përbëhen nga dy anëtarë gjyqtarë, përkatësisht prokurorë dhe një anëtar jo-gjyqtar përkatësisht jo-prokuror.

Ajo që i dallon këta mekanizma është sekretaria, kjo pasi që stafi administrativ i secilës prej Sekretarive përkatëse do të ndryshojë për nga numrat, meqë numri i gjyqtarëve është më i madh, atëherë edhe numri i zyrtarëve administrativ do të jetë më i madh për mekanizmin brenda KGJK-së, sesa atij në KPK.

Në kuadër të Sekretarisë të Mekanizmit brenda KGJK-së do të funksionojnë: 1. Njësia për performancë; 2. Njësia për pasuri; dhe 3. Njësia për integritet. Të tre njësitë do të jenë të përbëra nga 5 zyrtarë hetues dhe 3 staf administrativ për njësi. Njësitë e njëjta e përbëjnë edhe mekanizmin brenda KPK-së, mirëpo me nga 4 zyrtarë hetues dhe 3 staf administrativ për njësi.

Vlerësimet përfundimtare të mekanizmave do të dërgohen në KGJK, përkatësisht KPK. Gjetjet do të shërbejnë për marrjen e vendimit mbi gjyqtarin, përkatësisht prokurorin, qoftë sa i përket avancimit, trajnimit të detyrueshëm, propozimit për emërim, apo propozimit për shkarkim.

Ashtu siç dikton Kushtetuta aktuale, propozimi dhe shkarkimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve në këtë fazë do të bëhet nga mekanizmat kushtetues përkatës, gjegjësisht, propozimi për shkarkim si gjyqtar nga Këshilli përkatës dhe shkarkimi nga Presidenti. Ndërsa, në instancën e dytë do të veprojnë Gjykata Supreme sipas ankesës ndaj vendimit për shkarkim. Vendimi i Gjykatës Supreme për ligjshmërinë e vendimit mbi shkarkimin e gjyqtarit apo prokurorit do të jetë i formës së prerë dhe prodhon efekt juridik të detyrueshëm për palët.

a) Struktura e mekanizmit kompetent:

Në saje të modelit të prezantuar në kuadër të këtij Opsioni, mekanizmat për vlerësim të vazhdueshëm, do të formohen brenda KGJK dhe KPK, të cilët ndahen në disa panele si vijon:

i) Paneli për vlerësimin e performancës

Ky panel do të zëvendësonte punën e komisioneve aktuale të matjes së performancës së gjyqtarëve, përkatësisht prokurorëve.

Përbërja e panelit do të jetë me shumicë gjyqtarësh, gjegjësisht prokurorësh, por me prezencë edhe të anëtarëve jo-gjyqtarë, respektivisht, jo-prokurorë, për të siguruar një lloj llogaridhënie. Këta anëtarë jo-gjyqtarë dhe jo-prokurorë do të jenë profesionistë të fushës së drejtësisë, të shquar dhe me integritet të lartë dhe të cilët nuk kanë pasur pozita politike për një kohë të caktuar para kandidimit në këtë pozitë. Paneli do të përbëhet nga dy anëtarë gjyqtarë, përkatësisht prokurorë dhe me nga një anëtar jo-gjyqtar, përkatësisht jo-prokuror. Paneli nuk nxjerr vendime me fuqi detyruese, por "vlerësime" mbi cilësinë e performancës së gjyqtarëve/prokurorëve.

Duhet pasur kujdes gjatë përcaktimit të veprimtarisë së këtij paneli që vlerësimi i performancës të bëhet pa u lëshuar në çështjet substanciale të vendimit apo të rigjykohet rasti.¹²⁵ Paneli përkatës përpilon vlerësimet e veta të performancës dhe profesionalizmit të gjyqtarit apo prokurorit. Në kuadër të këtij vlerësimi, kur është e nevojshme, paneli rekomandon edhe masat që duhen ndërmarrë ndaj kandidatit. Ky vlerësim më pas përcillet edhe me vlerësimet e panelit për vlerësimin e pasurisë dhe integritetit dhe të gjitha së bashku i vihen në dispozicion Këshillit respektiv për vendimmarrje.

ii) Paneli për verifikim mbi pasurinë dhe integritetin

- Ky panel do të kishte kompetencë për të hetuar detajisht pasurinë dhe integritetin e kandidatit dhe për të analizuar dyshimet për keqpërdorime potenciale. Të gjeturat, në formë të verifikimit mbi pasurinë, paneli do t'i përcillte pastaj në organet përkatëse vendimmarrëse. Paneli do të përbëhet nga dy anëtarë gjyqtarë, përkatësisht prokurorë dhe me nga një anëtar jo-gjyqtar, përkatësisht jo-prokuror.

¹²⁵ Në drejtim të shënjitimit të kësaj vije ndarëse, mund të shërbehemi nga praktika e Kenias, shtjelluar më sipër. Sipas praktikës së Kenia, roli i trupit të vetingut nuk ishte ai i një gjykate të apelit që do të bënte vlerësim të saktësisë faktike e juridike të vendimeve që kishte nxjerrë gjyqtari, e as të bindjeve filozofike juridike që ndiqte gjyqtari në punën e tij. Mekanizmi i vlerësimit të vazhdueshëm duhet të vlerësojë dhe të vërej rastet kur një vendim paraqet arsyeshmëri të çuditshme e të mangët, ashtu që të rezultojë në mungesë të drejtshmërisë dhe paanësisë. Bërja e këtij vlerësimi në rast se pretendohet se në dokumentet e përpiluara, gjyqtari apo prokurori nuk është treguar profesional, nuk mund të bëhet me zbatim të një "formule të përgjithshme". Kur në pyetje është shqyrtimi i profesionalizmit, duhet të shqyrtohen me kujdes të gjithë faktorët dhe rrethanat e rastit, si dhe bazueshmëria e pretendimeve në fakte dhe prova.


Do të disponojë me ekspertizë dhe resurse të nevojshme për të zhvilluar vlerësimin mbi pasurinë dhe integritetin.

Anëtarët e paneleve dalin nga mekanizmi për veting, të cilët do të vlerësohen pastaj në baza të rregullta. Për të siguruar pavarësinë dhe pacenueshmërinë gjatë kryerjes së kësaj detyre, anëtarët e këtyre trupave rekomandohet të kenë mandat të përcaktuar me ligj.

iii) Sekretaria

Sekretaria është organ administrativ i mekanizmit, i cili në përbërje të vete ka 3 njësi: 1. Njësia për aftësi profesionale dhe performancë; 2. Njësia për pasuri dhe 3. Njësia për integritet. Njësitë përbëhen nga zyrtarë hetues profesionalë dhe staf administrativ mbështetës, të cilët kanë qenë pjesë e mekanizmit të vetingut dhe të njëjtit më parë kanë qenë të vetuar, siç parashihet në fazën e parë. Njësitë përkatëse do t'i shërbejnë paneleve përkatëse, varësisht nga fusha e vlerësimit të paneleve, pra do të hetojnë, nxjerrin informacione mbi kandidatin si dhe do të asistojnë sipas nevojave të paneleve. Këto njësi do të përbëhen nga 5 zyrtarë hetues dhe 3 staf administrativ për KGJK-në, kurse nga 4 zyrtarë hetues dhe 3 staf administrativ për KPK-në.



Figura 12: Mekanizmi për vlerësimin e vazhdueshëm të performancës, pasurisë dhe integritetit sipas Opsionit 5



Vlerësimi i vazhdueshëm

Vetingu

Opsioni 5



b) Baza e të dhënave që mblidhen

Me dispozitat përkatëse do përcaktohet tri kategori të dhënash të cilat mblidhen dhe shqyrtohen gjatë procesit të vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Këtu përfshihen:

i) të dhënat rreth performancës: të dhënat lidhur me performancën të cilat duhen të vlerësohet, do të jenë të kufizuara. Siç u përmend më lartë, vlerësimi nuk duhet të lëshohet në çështjet meritore të vendimeve. Mendohet se në këtë drejtim nuk duhet zgjeruar përtej asaj që është paraparë në Rregulloret aktuale për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve/prokurorëve, të cilat në përgjithësi janë hartuar në maksimumin e lejueshmërisë së vlerësimit cilësor të vendimeve të pranuar nga gjyqtari/prokurori dhe aftësitë tjera profesionale. Gjithashtu, njëra nga kufizimet e bëra qartë nga Rekomandimet e Kievit (të shtjelluara më sipër), është se numri i vendimeve të kthyera nga gjykata e nivelit më të lartë nuk mund të shërbejë si kriter për matjen e performancës.

ii) të dhënat rreth pasurisë: ku do hyjnë të gjitha asetet në përputhje me Ligjin përkatës për Deklarimin e Pasurisë;

iii) informata të tjera të lidhura për integritetin: përfshirë informatat mbi lidhjet/afërsitë politike të kandidatit dhe informatat e mbledhura nga terreni. Mbledhja, përdorimi dhe ruajtja e informatave mbi kandidatin dhe përcaktimi i kohëzgjatjes së ruajtjes së këtyre informatave do të përcaktohen me ligj, duke u siguruar proporcionaliteti në raport me të drejtën në jetë familjare dhe të drejtën në privatësi.

Gjithsesi, periudha kohore si dhe llojet e të dhënave për të cilën vlerësohet një gjyqtar apo prokuror, do të dallojë nga vetingu me ndryshime kushtetuese. Pra, kategoritë e të dhënave, natyra dhe niveli i të dhënave që do mblidhen, do të jenë objekt i një analize më të detajuar, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kushtetutën si dhe do të jenë proporcionale në raport me nevojat e vlerësimit të vazhdueshëm.

c) Subjektet që i nënshtrohen vlerësimit të vazhdueshëm

Pas kompletimit të procesit të vetingut, **vlerësimi i vazhdueshëm i performancës, integritetit dhe pasurisë** do të zhvillohet në këto momente:

i) **tek kandidatët për rekrutim** si gjyqtarë/prokurorë dhe nëpunës në pozita të larta drejtuese: kjo kategori do të vetohet gjatë procesit të rekrutimit, që do përfshijë fazën e vlerësimit të integritetit, aftësive profesionale dhe kontrollimit të pasurisë si parakusht

për të qenë pjesë e sistemit. Normalisht, tek vetingu i këtyre kandidatëve, nuk do vlerësohet performanca por arritjet e tyre profesionale;

ii) tek gjyqtarët/prokurorët që ngritën në detyrë: konsiderohet shumë e nevojshme që para marrjes së detyrës së re të njëjtëve të i'u analizohet integriteti, performanca dhe pasuria; dhe

iii) tek të gjithë, periodikisht sipas radhës: kjo do bëhet për gjyqtarët/prokurorët në përputhje me legjislacionin përkatës, në mënyrë që sistemi gjyqësor/prokurorial të filtrohet në baza të rregullta.

iv) me shkas: vlerësimi i integritetit, pasurisë dhe performancës do të mund të inicohet në çdo kohë, qoftë gjatë vetingut apo vlerësimit të vazhdueshëm, në rast se paraqiten fakte apo rrethana që e vënë në dyshim përshtatshmërinë e gjyqtarit apo prokurorit për të vazhduar ushtrimin e funksionit të tij. Pra, me këtë rast, gjyqtari apo prokurori i nënshtrohet vetingut, përkatësisht vlerësimit të performancës, integritetit dhe pasurisë, pa pritur radhën sipas planifikimit të rregullt.

Vlerësim i vazhdueshëm i performancës, integritetit dhe pasurisë, në baza të rregullta do zhvillohet edhe për administratorët, Drejtorët e Sekretariateve të KGjK/KPK, si dhe Drejtori i Njësisë për Inspektim Gjyqësor në KGjK, në mënyrën dhe procedurën e konkretizuar me ligj.

d) Masat që mund të ndërmerren

Për të analizuar masat që mund të ndërmerren në kuadër të këtij procesi, duhet të qartësohet fillimisht se jo çdo e gjetur e natyrës negative përbën bazë për shkarkim apo ka nevojë të sanksionohet. Disa informata që mund të zbulohen gjatë procesit të vlerësimit të vazhdueshëm, mund të shërbejnë thjeshtë për të identifikuar një cenueshmëri të gjyqtarit/prokurorit ndaj një elementi të caktuar. Për këtë arsye, legjislacioni përkatës duhet të bëjë shumë të qartë kategorizimin e të dhënave të cilat mund të përbëjnë bazë për shqiptim të çfarëdo mase ndaj kandidatit.

Nëse konsiderohet e nevojshme, panelet mund të propozojnë dy lloje të masave për gjyqtarët/prokurorët të cilët nuk kalojnë procesin e vlerësimit të vazhdueshëm, e që janë propozimi për shkarkim dhe propozimi për masa të tjera.

i) propozimi për shkarkim

Në përputhje me instrumentet ndërkombëtare të analizuara më sipër, propozimi për shkarkim duhet të vijë vetëm si rezultat i shkeljeve më serioze të detyrës. Në gjuhën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, parashihet termi “mosrespektim i rëndë i detyrës”. Është e nevojshme që legjislacioni përkatës të detajojë pikërisht përmbajtjen e këtij termi dhe të listojë shkeljet serioze që do të përbënin këtë shkelje.

Gjetja e mangësive serioze në integritetin e gjyqtarit apo prokurorit, siç mund të jenë lidhjet me grupe kriminale, shkëmbimi i favoreve/dhuratave me ta, njëanshmëria politike e dëshmuar përmes vendimeve gjyqësore/ndjekjes penale që ai i ka marrë, apo performanca aq e ulët sa që rrezikon të drejtat e palëve në procedurë, apo pasuria e pajustificueshme etj., mund të jenë disa nga këto shkelje.

Gjyqtarëve dhe prokurorëve të shkarkuar si rezultat i procesit të vlerësimit të vazhdueshëm u ndalohet ri-aplikimi për funksionet qoftë si gjyqtar, ashtu edhe si prokuror, pavarësisht nga cila pozitë janë shkarkuar.

Nëse administratorët e gjykatave dhe prokurorive, Drejtorët e Sekretariateve të KGJK/KPK si dhe Drejtori i Njësisë për Inspektim Gjyqësor në KGJK rezultojnë të papërshtatshëm pas vlerësimit të vazhdueshëm, ata do shkarkohen nga ana e këshillave dhe do të zëvendësohen me zyrtarë të rinj të zgjedhur në bazë të konkursit. Rekrutimi i tyre do të bëhet sipas kritereve rigoroze të frymëzuara nga procesi i vetingut, për aq sa është e zbatueshme.

ii) propozimi për masa të tjera

Shqiptimi i këtyre masave mund të parashihet për rastet kur kandidati ka marrë vlerësime negative në disa aspekte të figurës së tij, por të cilat nuk janë të mjaftueshme të detyrojnë shkarkimin e tij. Të tilla mund të jetë edhe masa e trajnimit të detyrueshëm për gjyqtarët/prokurorët të cilët konsiderohen të kenë mangësi vetëm në performancë, përfshirë edhe kthimin në trajnim fillestar.

Për gjyqtarë dhe prokurorë, Gjykata Supreme, siç u përmend më lartë, do shërbejë si shkallë e dytë. Një trup gjykues të përbërë nga tre anëtarë, do të vendosë lidhur me ankesat e paraqitura ndaj vendimit për shkarkim. Ndërkaq për zyrtarët e lartë të shkarkuar nga pozitat e larta drejtuese, si instancë e dytë do shërbejë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës.

Pjesa mbi vlerësimin e vazhdueshëm, megjithëse është planifikuar detajisht, do të variojë varësisht nga rezultatet e një analize më të thellë e cila do të përpilohet në vitet e ardhshme. Pra, pasi që vlerësimi i vazhdueshëm do fillojë pas një periudhe të vetingut 5

vjeçar, mund të ndryshojë dhe përshtatet në bazë të nevojave që mund të kemi në atë kohë.

Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme

Tabela më poshtë paraqet ndikimet më të rëndësishme që janë identifikuar në këtë fazë. Shtojcat 1 deri 4 paraqesin vlerësimin e të gjitha ndikimeve në përputhje me mjetet për identifikimin e ndikimeve ekonomike, shoqërore, mjedisore dhe ndikimeve të të drejtave themelore. Katër shtojcat gjithashtu tregojnë vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve të ndryshme dhe nivelin e preferuar të analizës.

Figura 13: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit

Kategoritë ndikimeve	Ndikimet përkatëse të identifikuara
Ndikimet ekonomike	<p>Raportet vendore dhe ndërkombëtare, në veçanti raportet e Komisionit Evropian për vendin, në vazhdimësi i kanë identifikuar gjyqësorin e ngadalshëm dhe joefikas, korrupsionin, si dhe mungesën e sundimit të ligjit, si disa nga pengesat kryesore për zhvillimin ekonomik në Kosovë. Në raportin e tij të fundit për vendin, Komisioni Evropian ka vlerësuar se rritja e profesionalizmit dhe kapacitetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet të jetë prioriteti kryesor për gjyqësorin në Kosovë.¹²⁶</p> <p>Ndërkaq, raporti i vitit 2020 i Departamentit të Shtetit për klimen e investimeve në Kosovë, vlerëson se korrupsioni i profilit të lartë mbetet pengesa kryesore për investimet e huaja në Kosovë, përderisa adresimi i rasteve të korrupsionit nga gjykatat e Kosovës mbetet relativisht më i ulët krahasuar me vendet e rajonit.¹²⁷</p> <p>Në këtë drejtim, rritja e efikasitetit dhe kualitetit të punës së gjyqësorit është një parametër kyç që do të ndikojë pozitivisht për përmirësimin e kushteve për operimin e bizneseve ekzistuese, si dhe tërheqjen e investimeve të reja. Një gjyqësor profesional, me integritet dhe efikas, duke rritur sigurinë juridike për bizneset ekzistuese që aktualisht operojnë në Kosovë, do të ndikojë edhe në tërheqjen e investimeve të reja, sidomos</p>

¹²⁶ Raporti i Komisionit Evropian për vendin për vitin 2020. Konsultuar më datë 13.06.2021 në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf

¹²⁷ Raporti i vitit 2020 i DASH për klimen e investimeve në Kosovë. Konsultuar më datë 13.06.2021 në: <https://www.state.gov/reports/2020-investment-climate-statements/kosovo/>

	<p>investimeve të huaja direkte, të cilat do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës. Në veçanti, rritja e efikasitetit në adresimin dhe zgjidhjen e rasteve të korrupsionit të profilit të lartë, përmes proceseve gjyqësore me integritet dhe larg ndikimeve politike, do të ndikojë ndjeshëm në përmirësimin e klimës së investimeve të huaja në Kosovë, si dhe do të rrisë besimin e qytetarëve dhe bizneseve vendore në sistemin e drejtësisë.</p> <p>Rritja e besimit të qytetarëve, përfshirë punonjësit, mund të ketë efekt pozitiv edhe në adresimin e ekonomisë joformale në Kosovë. Një gjyqësor me integritet dhe efikas do të shërbejë si një incentivë për qytetarët, në veçanti punonjësit në ekonominë joformale, që të denoncojnë veprimtaritë joformale ekonomike në Kosovë, duke zvogëluar kështu informalitetin, që do të ketë ndikim direkt në rritjen ekonomike të vendit.</p> <p>Një ndikim potencial negativ që procesi i vetingut mund të ketë në zhvillimin ekonomik, është pezullimi i investimeve të reja për sa kohë që do të zhvillohet ky proces. Kjo për faktin se, bazuar në përvojat e vendeve të tjera, mund të ketë zvogëlim potencial të numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, gjë që do të ndikonte në punën dhe efikasitetin e gjyqësorit, duke e rritur pasigurinë juridike.</p>
Ndikimet shoqërore	<p>Integriteti, pavarësia dhe paanësia e gjyqësorit janë parakushte për një qasje të drejtë dhe efektive drejtësisë dhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Sidoqoftë, diskriminimi dhe praktikat korruptive shpesh parandalojnë qytetarët, veçanërisht grupet e marginalizuara, nga mundësitë e barabarta dhe mbrojtja e të drejtave të tyre.¹²⁸</p>

¹²⁸ United Nations Development Program, A transparent and accountable judiciary to deliver justice for all, 2016

	<p>Sipas raporteve vendore dhe ndërkombëtare, besimi i qytetarëve në institucionet e drejtësisë është i ulët.¹²⁹</p> <p>Zhvillimi i procesit të vetingut është thelbësor për arritjen e objektivit strategjik që është përmirësimi i integritetit dhe profesionalizmit të institucioneve të drejtësisë. Ky përmirësim rrjedhimisht do të ndikojë në rritjen e besimit qytetar në drejtësi, i cili sipas elaborimeve në seksionin e Problemit kryesor, shkaqet dhe efektet, është mbështetur në raporte vendore dhe ndërkombëtare.</p> <p>Përmes procesit të vetingut synohet të evitohen këto mangësi e që do kenë për rezultat ngritjen e integritetit dhe efikasitetit të institucioneve të sistemit të drejtësisë, luftimin efikas të korrupsionit dhe rikthimin e besimit të qytetarëve në këto institucione. Në lidhje me korrupsionin, në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën në vitin 2020 është theksuar që Kosova është në fazë të hershme në luftën kundër korrupsionit.¹³⁰</p> <p>Në këtë drejtim, rritja e profesionalizmit dhe përmirësimi i integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve do të ndikojë pozitivisht edhe në forcimin e sundimit e ligjit, si dhe zvogëlimin e korrupsionit të të gjitha niveleve.</p> <p>Masat e propozuara mund të kenë ndikime pozitive shoqërore meqë synimi i tyre në mënyrë të tërthortë është sigurimi i zbatimit më efikas të të drejtave të njeriut, e rrjedhimisht edhe parandalimi dhe luftimi i krimit, siguria më e madhe për qytetarët dhe qasje më efikase të tyre në drejtësi.</p> <p>Procesi i vetingut do të ketë ndikim potencial në arsimin dhe aftësimin profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë si dhe atyre që aplikojnë për herë të parë. Kjo synohet të arrihet përmes trajnimeve në rastet kur evidentohen mangësi në performancën në punë tek gjyqtarët dhe prokurorët.</p>
--	---

¹²⁹ Comission Staff working Document, Kosovo 2019 Report, Brussels, 29.5.2019, në : <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>

¹³⁰ Raporti i Komisionit Evropian për vendin për vitin 2020. Konsultuar më datë 13.06.2021 në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf

Roli kryesor i prokurorëve është ndjekja e kryerësve të veprave penale ndërsa ajo e gjyqtarëve (në procedurën penale) është shqiptimi i sanksionit ndaj kryerësve të veprave. Shqiptimi i dënimit, ndër tjerash, bëhet për qëllim të satisfaksionit të viktimave të krimit. Në një shoqëri ku këto institucione kyçe të drejtësisë janë jo efikase, të anshme dhe të prekura nga korrupsioni, viktimat e krimit janë drejtpërdrejtë të afektuara nga mungesa e funksionimit të mirëfilltë të gjyqësorit dhe prokurorisë sipas parimeve të shtetit të së drejtës.

Përmes vetingut në sistemin e drejtësisë synohet të tejkalohen këto mangësi, përmes largimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët kanë vepruar në kundërshtim me parimet e një gjyqësori të drejtë, të pavarur, të paanshëm dhe efikas.

Për të siguruar cilësinë, profesionalizmin dhe paanshmërinë e mekanizmit, parashihet që procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të këtij mekanizmi të jetë proces transparent dhe rigoroz.

Emrat e personave të rekomanduar për t'u zgjedhur duhet të jenë publike, bashkë me arsyetimet për rekomandimin e tyre.

Puna e mekanizmit shoqërohet me transparencë të shtuar gjatë gjithë fazave të procedurave. Vlerësimet e tyre, për aq sa është e mundshme dhe pa prekur të drejtat themelore të kandidatit, janë publike.

Procesi i vetingut potencialisht do të përmirësojë llogaridhënien dhe transparencën e gjyqësorit e cila do ndikojë në ngritjen e objektivitetit dhe besimit të qytetarëve në organet gjyqësore.

Procesi i vetingut do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në marrëdhënien e punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kjo për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës, në rast se këta nuk konfirmohen në pozitat e tyre të punës.

Prandaj, ky proces duhet të jetë në linjë me drejtat themelore të njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, legjislacionin në fuqi, me konventa dhe standardet tjera ndërkombëtare si dhe të parasheh masat siguroese për një proces të drejtë dhe objektiv sipas parimeve të një gjykate të rregullt.

	<p>Si rezultat i vetingut, gjyqtarëve dhe prokurorëve që veçse janë profesionalë, të rregullt dhe me integritet do t'ju afirmohen këto cilësi dhe do t'i krijohet ambient më i favorshëm i punës. Vënia në pah e individëve të këtyllë që veçse janë në sistem, do të ndikojë drejtpërdrejtë edhe në rritjen e besimit qytetar në sistemin e drejtësisë.</p> <p>Një efekt i mundshëm negativ i vetingut, bazuar në praktikën e shteteve të tjera që kanë zhvilluar proces të ngjashëm, është zvogëlimi drastik i numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kjo ndikon në thellimin e mëtejme të problemit të mos-efikasitetit të organeve të gjyqësorit dhe prokurorisë, përmes zvarritjes më të madhe të procedurave dhe përkohësisht do të afektojë të drejtën për qasje në gjykatë.</p> <p>Kjo mund të rezultojë në pezullimin e realizimit të disa nga të drejtat themelore të njeriut.</p>
Ndikimet mjedisore	<p>Konsiderohet se procesi i vetingut nuk do të ketë ndikime të drejtpërdrejta në mjedis. Megjithatë, duke konsideruar se procesi i vetingut pritet të ndërtojë një sistem gjyqësor më të drejtë, të paanshëm dhe më të pavarur, ai mund nxisë ndjekjen dhe ndëshkimin më adekuat të krimeve ndaj mjedisit.</p> <p>Kështu, kjo politikë potencialisht do të ndikojë në mbrojtjen e natyrës, biodiversitetit dhe trashëgimisë kombëtare.</p>
Ndikimet në të drejtat themelore	<p>Nga praktika e shteteve tjera të shtjelluara më sipër, vërehet se një proces i vetingut, pashmangshëm prek, cenon e edhe kufizon liritë dhe të drejtat e njeriut të parapara me instrumente ndërkombëtare. Çështja e vendosjes së baraspeshës në mes të arritjes së qëllimeve të vetingut si interes i përgjithshëm në një anë, dhe respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut në anën tjetër, paraqitet si shumë kritike. Standardet e vendosura nga instrumentet ndërkombëtare të përmendura, si dhe nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, shërbejnë si udhëzues drejt arritjes së kësaj baraspeshë.</p>

	<p>Më poshtë është analizuar ndikimi i procesit të vetingut në të drejtat themelore në përgjithësi, nga këndvështrimi i palës në procedurën e vetingut (I), si dhe më tej, nga këndvështrimi i shoqërisë që përfundimisht përfiton nga zhvillimi i procesit të vetingut (II).¹³¹</p>
Ndikimi gjinor	<p>Ndërhyrjet e propozuara sipas Opsioneve më sipër, në mënyrë të barabartë dhe adekuate, prodhojnë rezultat si për burrat, ashtu edhe për gratë.</p> <p>Nga të dhënat e vitit 2021, në sistemin e drejtësisë shërbejnë 132 gjyqtare krahas 259 gjyqtarëve dhe 77 prokurore krahas 98 prokurorëve. Nga këto të dhëna mund të vërehet se numri i prokurorëve burra, e veçanërisht gjyqtarëve burra është dukshëm më i lartë sesa numri i prokuroreve respektivisht gjyqtareve gra.</p> <p>Prandaj, ndikim më i shprehur gjinor do të mund të vërehet varësisht nga rezultatet që procesi i vetingut do të ketë në përfaqësimin gjinor në institucionet që do t'i nënshtrohen vetingut. Duke marrë shembull vendet e tjera që kanë kaluar nëpër një proces të vetingut, veçanërisht atë të Shqipërisë, numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve burra që janë larguar nga sistemi ka qenë dukshëm më i lartë sesa i gjyqtareve dhe prokurorëve gra¹³².</p> <p>Megjithatë, çdo parametër për të bërë këtë matje në këtë moment është paragjykses ndaj rezultateve të zbatimit dhe jo matje e saktë e ndikimit gjinor.</p>
Ndikimet buxhetore	<p>Opsionet 2, 3, 4 dhe 5 do të kenë kosto shtesë e cila do të llogaritet pas finalizimit të opsioneve nga grupi punues</p>

¹³¹ Marrë parasysh kontekstin e përgjithshëm dhe specifikat tjera, kjo analizë e ndikimit në të drejtat themelore është zhvilluar duke marrë për bazë sidomos gjetjet e GJEDNJ në rastin Xhoxhaj kundër Shqipërisë.

¹³² <https://balkaninsight.com/2020/07/22/gender-gap-ehy-men-are-failing-albanias-judicial-vetting/>

Ndikimet e barazisë sociale	Nuk ka indikacione se grupe të caktuara janë të pabarabarta krahasuar me të tjerat. Ndërhyrjet e propozuara sipas cilitdo prej opsioneve, nuk mbingarkojnë një grup të caktuar me kërkesa për zbatim të tyre.
Ndikimet tek të rinjtë	Nuk parashihet të ketë ndikim të drejtpërdrejtë tek të rinjtë.
Ndikimet në ngarkesën administrative	Nuk parashihet të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në ngarkesën administrative.
Ndikimi i NVM-ve	Nuk parashihet të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në NVM-ve, përveç aspektit që klima e biznesit do të jetë edhe më e përshtatshme me zhvillimin e procesit të vetingut në Kosovë.

Ndikimet në të drejtat themelore

I. Ndikimi në të drejtat themelore të palës në procedurën e vetingut

A. E drejta në gjykim të drejtë

Analizës më të detajuar të ndikimeve që procesi i vetingut ka në të drejtën në gjykim të drejtë, të përkufizuar sipas nenit 6, paragrafi 1 të Konventës Evropiane, i paraprin kategorizimi i procesit si “penal” apo “civil”, përkitazi me formulimin e nenit 6. Varësisht prej kësaj, atëherë edhe elementet e së drejtës në gjykim të drejtë identifikohen dhe maten përkitazi, sa u përket Opsioneve më sipër.

Neni 6

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij **të natyrës civile**, ashtu edhe për bazueshmërinë e **çdo akuze penale** në ngarkim të tij.
2. (...)

Të dyja llojet e procedurave përbëjnë terme autonome, kuptimësia e të cilave rrjedhë nga vetë jurisprudenca e GJEDNJ. Sipas “Kritereve Engel”¹³³, për të përcaktuar nëse procesi po zhvillohet sipas një *akuze penale*, duhet të plotësohen tri kritere. Kjo analizë është shtjelluar edhe më sipër nga rasti Matyjek kundër Polonisë.¹³⁴ Kriteri i parë është klasifikimi ligjor që i bëhet procesit sipas ligjit të vendit. Kriteri i dytë është natyra e shkeljes sipas së cilës zhvillohet procedura, ndërsa kriteri i tretë ka të bëjë me shkallën e rëndesës së sanksionit që mund t’i shqiptohet personit në procedurë. Kriteri i dytë dhe i tretë janë alternativë dhe jo patjetër kumulativë.

Për shembull, në rastin Matyjek kundër Polonisë, GJEDNJ kishte gjetur se neni 6 i Konventës ishte i zbatueshëm në kuptimin e tij penal sa i përket procesit të lustrimit në Poloni. Për të arritur tek ky përfundim, Gjykata kishte vërejtur se në procedurë zbatohet Kodi i Procedurës Penale të Polonisë, natyra e shkeljes për të cilën “akuzohej” personi, gjegjësisht deklarimi i rrejshëm, kishte ngjashmëri me veprën penale të deklarimit të rrejshëm, si dhe sanksioni i ndalimit të mbajtjes së një posti publik për 10 vjet, ishte i rëndë për nga natyra dhe pasojat. Zbatueshmëria e nenit 6 të Konventës do të thoshte se e drejta në gjykim të drejtë, në kontekstin e një procedurë lustrimi me karakteristika të ngjashme sikurse në rastin e Polonisë, nënkuptonte obligimin e ofrimit të garancive procedurale tipike të një procedure penale. Të tilla garanci, që duhet të mirëmbahen gjatë gjithë zhvillimit të procedurës së lustrimit ishin, ndër tjerash, prezumimi i pafajësisë, barazia e armëve dhe e drejta në ankesë.

Testi sipas “Kritereve Engel” është zhvilluar si hap i parë edhe në Vendimin e GJEDNJ në rastin Xhoxhaj kundër Shqipërisë. Në këtë rast, meqenëse kriteret si më sipër nuk u plotësuan, u gjet se Konventa ishte e zbatueshme në kuptimin e një procedure civile. Si elemente që çuan deri tek ky përfundim ishte fakti se përgjatë procedurës së vetingut, siç përcaktohej në Aneksin Kushtetues, barra e provës lëvizë nga trupi i vetingut, tek pala në procedurë. Zhvendosja e barrës së provës është shprehimisht e ndaluar dhe përjashtuar nga çfarëdolloj procedure penale. Në këso rrethanash, pozita e palës në procedurë nuk ngjason me atë të personit të akuzuar, e as pozita e trupit të vetingut nuk ngjason me atë të prokurorisë në një procedurë penale. Për shembull, nëse përgjatë procesit të vetingut parashihet zhvendosja e barrës së provës, atëherë apriori do të duhej

¹³³ Engel dhe të tjerët kundër Holandës (8 qershor 1976), par. 82. I qasshëm: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-57478%22%5D%7D>

¹³⁴ Matyjek kundër Polonisë (Vendimi mbi lejueshmërinë) (30 maj 2006). I qasshëm: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-75941%22%5D%7D>

që procedura të sigurojë “masat mbrojtëse” sipas të kuptuarit të procesit të vetingut si sipas nocionit autonom të GJEDNJ si proces civil.

Sa i përket rëndesës së sanksionit, e që në rastin e Shqipërisë nënkuptonte ndalimin e përhershëm të ushtrimit të detyrës së gjyqtarit, Gjykata gjeti se qëllimi i ndalimit nga rikthimi në sistemin e drejtësisë nuk kishte kuptimin e dënimit individual me shkarkim nga detyra, por në kuptimin qëllimor, ishte i orientuar nga sigurimi dhe ruajtja e besimit publik në gjyqësor. Për dallim nga rasti Matyjek kundër Polonisë si më sipër, Gjykata kishte vlerësuar se fakti se ndalimi i ushtrimit është i përhershëm, nuk do të thotë se sanksioni ka karakter ndëshkues.¹³⁵ Sipas këtyre qëndrimeve të GJEDNJ, masat e propozuara sipas Opsioneve më sipër, nuk mund të thuhet se kanë karakter ndëshkues. Pra, edhe më tej procesi i vetingut i dizajnuar sipas Opsioneve më sipër, i afrohet nocionit të procesit civil, sipas përkufizimit të GJEDNJ.

Në shtjellimin tutje të ndikimit të procesit të vetingut në të drejtat e njeriut, sipas cilitdo prej Opsioneve më sipër, do të analizohen elemente që sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së përbëjnë esencën e garantimit të kësaj të drejte. Siç do të vërehet më poshtë, krahas parimeve të përgjithshme, elementeve të tjera karakterizojnë procesin në zbatimin e nenit 6 të Konventës në kuptim penal dhe tjera kur procesi kategorizohet si proces civil. Varësisht se cili është rasti, përshtatshëm duhet që të ofrohen “masat mbrojtëse” për të siguruar respektimin e të drejtave të njeriut gjatë gjithë procedurës.

a) Gjykimi nga një gjykatë ose Tribunal i themeluar sipas ligjit

Zhvillimi i procedurës nga një gjykatë ose tribunal të themeluar sipas ligjit është element themelor i respektimit të së drejtës në gjykim të drejtë. Zhvillimi i procedurës nga një gjykatë e rregullt, që veçse është pjesë e sistemit dhe strukturës gjyqësore të një vendi, është i vetëkuptueshëm. Kështu, nga jurisprudenca e GJEDNJ, merret gati se e mirëqenë se procedura e zhvilluar nga një gjykatë e rregullt, parimisht, garanton të drejtën në gjykim të drejtë. I tillë do të ishte rasti i zhvillimit të procesit të vetingut sipas Opsionit 3 (të dy nën-opsionet) dhe sipas fazës së dytë përkitazi me Opsionin 5.

Në anën tjetër, në jurisprudencën e Strasburgut shpesh është trajtuar nocioni i “Tribunalit të themeluar sipas ligjit”. Për të përcaktuar nëse një mekanizëm tjetër nga gjykata përbën “tribunal të themeluar sipas ligjit”, zbatohet testi i ashtuquajtur “Vilho Eskelinen”¹³⁶. Tribunali nënkupton trupin që në substancë kryen funksion gjyqësor, pra vendosë çështje

¹³⁵ Ibid.

¹³⁶ Vilho Eskelinen dhe të tjerët kundër Finlandës (19 prill 2007). I qasshëm: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-80249%22%5D%7D>

brenda kompetencës së vet, mbi bazën e rregullave ligjore dhe me zbatimin e procedurës së përshkruar në ligj. Për t'u cilësuar si tribunal, ky trup duhet të plotësojë edhe kritere të tjera, siç është pavarësia, sidomos nga ekzekutivi. Tribunalin duhet ta karakterizojë edhe fuqia vendimmarrëse dhe efekti juridik i vendimeve që nxjerrë. Sipas formulimit të nenit 6 të Konventës, ky tribunal nuk duhet që patjetër të jetë i integruar në makinerinë standarde gjyqësore. Mund të themelohet për qëllim të caktuar dhe të administrohet jashtë sistemit të zakonshëm gjyqësor.¹³⁷ Si rrjedhojë, modelimi i strukturës institucionale të krijuar që kryen vetingun sipas Opsionit 4 dhe fazës së parë të Opsionit të 5, do të duhet të jenë shumë i kujdesshëm, ashtu që mekanizmi që kryen vetingun të përmbushë kriteret e një "Tribunali të themeluar sipas ligjit", përkitazi me testin Vilho Eskelinen.

b) Gjykimi i pavarur dhe i paanshëm

Krahas zhvillimit të procedurës nga një gjykatë ose Tribunal i themeluar sipas ligjit, për të pasur respektim të së drejtës në gjykim të drejtë, gjykata ose Tribunali në fjalë duhet të jetë i pavarur dhe i paanshëm. "Pavarësia", e që paraqitet si kritike sidomos tek tribunalet, nënkupton pavarësi vis-a-vis pushteteve tjera (ekzekutivit dhe legjislativit), si dhe përballë palëve. Këto aspekte duhet të trajtohen me shumë kujdes për sa u përket mekanizmave të krijuar sipas Opsionit 4 dhe fazës së parë të Opsionit 5. Pavarësia kuptohet si pavarësi për nga personeli dhe si pavarësi institucionale, e si e tillë përbën parakusht për vendimmarrje të paanshme. Për të analizuar nëse një trup i këtillë është i pavarur dhe i paanshëm, si orientim shërbejnë mënyra e emërimit dhe mandatit të anëtarëve të këtij Tribunali.

Ishte pikërisht mandati i kufizuar i anëtarëve të trupit të vetingut (5 vjet për anëtarët e shkallës së parë dhe 8 vjet për anëtarët e shkallës së dytë), si pikë në të cilën ishte mbështetur pretendimi i ish-gjyqtarës Xhoxhaj në padinë përpara GJEDNJ-së kundër Shqipërisë. Në këtë rast, gjykata nuk kishte parë si problematik mandatin e përcaktuar dhe të kufizuar në kohë të anëtarëve të trupave të vetingut.¹³⁸ Megjithëse kohëzgjatja e mandatit ishte relativisht e shkurtër, kjo është e kuptueshme marrë parasysh natyrën e jashtëzakonshme të procesit të vetingut. Për më tepër, kur analizon mandatin, GJEDNJ nuk ndalet vetëm tek kohëzgjatja, por theksin vë sidomos tek pamundësia e shkarkimit të anëtarëve, si element kyç i pavarësisë së tyre.¹³⁹ Në rastin e Shqipërisë, megjithëse Ligji për Vetëingun nuk përcaktonte shprehimisht se anëtarët e trupave ishin të jo-shkarkues,

¹³⁷ Xhoxhaj kundër Shqipërisë (31 maj 2021), par. 284. I qasshëm: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-208053%22%5D%7D>

¹³⁸ Ibid, par. 298.

¹³⁹ Id.

ligji megjithatë përcaktonte masat e nevojshme mbrojtëse për mos-shkarkimin dhe pavarësinë e tyre. Këto elemente duhet të merren parasysh në përcaktimin e mandatit të anëtarëve të trupave që kryejnë vetingun sipas Opsionit 3 (modeli i decentralizuar), Opsionit 4 dhe fazës së parë të Opsionit 5, ashtu që të sigurohet dhe garantohet pavarësia e trupave që bëjnë vetingun.

Pretendimet në këtë padinë kundër Shqipërisë në rastin Xhoxhaj u mbështetën edhe në atë se mekanizmat e vetingut, nuk kishin në përbërje as gjyqtarë e as prokurorë, pra kishin përbërje tërësisht jo-gjyqësore, përkundër që standardet ndërkombëtar bëjnë thirrje për trupa me përfaqësim substancial gjyqësor në çështje “disiplinore”. Duke qenë se mbarë reforma e vetingut i targetonte të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë, Gjykata gjeti se procesi i vetingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri ishte *sui generis* dhe duhet të dallohet nga çfarëdolloj procedure e zakonshme disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve.¹⁴⁰ Si rrjedhojë, nuk u pa si problematike ose në dëm të pavarësisë së trupave kjo përbërje e tyre.

c) Gjykimi i drejtë dhe publik

Sipas nenit 6 të Konventës, gjykata ose Tribunali që zhvillon procedurën, duhet të zhvillojë shqyrtim adekuat të pretendimeve, argumenteve dhe provave të vëna përpara nga cilado palë në procedurë, pa paragjykuar apriori relevancën e tyre.¹⁴¹ Për më tepër, trupi gjykues është i obliguar që në vendim të shtjellojë qartë arsyet në të cilat bazon vendimin.¹⁴²

Zhvillimi i gjykimit publik në kuptim të nenit 6, paragrafi 1 të Konventës, nënkupton të drejtën për gjykim publik në të paktën një shkallë të procedurës.¹⁴³ Mungesa e shqyrtimit publik në shkallën e dytë ose të tretë mund të arsyetohet me natyrën specifike të procedurës, me kusht që në shkallën e parë është zhvilluar shqyrtim publik.¹⁴⁴ Sidoqoftë, në kuptim të procedurave disiplinore kundër gjyqtarëve, marrë parasysh sanksionin në pyetje dhe pasojat që ka në jetën, karrierën dhe mirëqenien financiare të personit, duhet të mbahet shqyrtim publik. Mos-mbajtja e shqyrtimit publik duhet të jetë

¹⁴⁰ Id., para. 299, 412.

¹⁴¹ Id., par. 325.

¹⁴² Fischer kundër Austrisë (26 prill 1995), par. 44. I qasshëm: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-57916%22%5D%7D>

¹⁴³ Salomonsson kundër Suedisë (12 nëntor 2002), par. 36. I qasshëm: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-60736%22%5D%7D>

¹⁴⁴ Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë (6 nëntor 2018), par. 210. I qasshëm: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-187507%22%5D%7D>

një masë e jashtëzakonshme.¹⁴⁵ Këto elemente duhet të merren parasysh sidomos në dizajnimin e procesit sipas Opsionit 4 dhe fazës së parë të Opsionit 5. Në procesin e zhvilluar sipas Opsionit 3, janë gati se të mirëqena dhe të vetëkuptueshme.

d) Barazia e armëve

Sipas Vendimit meritor në Matyjek kundër Polonisë¹⁴⁶, GJEDNJ kishte ripërsëritur se përkitazi me parimin e barazisë së armëve, e që është element i konceptit më të gjerë të gjyqimit të drejtë në kontekstin penal të kësaj të drejte, secilës palë duhet t'i ofrohet mundësia e arsyeshme për të prezantuar rastin, nën kushte që nuk e vendosin në disavantazh përballë kundërshtarit. Pjesëmarrja aktive e të akuzuarit gjatë shqyrtimit penal, duhet të përfshijë të drejtën e të akuzuarit për të marrë shënime që do të përdoren për përgatitjen e mbrojtjes së tij, pavarësisht se a mbrohet nga një avokat. Përkthyer në rrethanat e rastit Matyjek kundër Polonisë, GJEDNJ kishte vendosur se për shkak të konfidencialitetit të dokumenteve dhe kufizimeve që i ishin vënë personit të lustruar në qasje në dosjen e lëndës, si dhe pozicionit të privilegjuar të Komisionerit të Interesit Publik në procedurën e lustrimit, ankuesit i ishte shkelur e drejta e tij në gjykim të drejtë sipas nenit 6 të Konventës. Respektimi i këtij parimi duhet të trajtohet me kujdes sidomos në dizajnimin e procesit sipas Opsionit 4 dhe fazës së parë të Opsionit 5.

e) E drejta në ankesë

Dyshkallshmëria është element tjetër qenësor i realizimit të së drejtës në gjykim të drejtë. Dilemat ngritën sidomos kur trupi gjykues është mekanizëm tjetër nga gjykatat e rregullta. Në rastin Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë¹⁴⁷, GJEDNJ gjeti se Këshilli i Lartë Gjyqësor Portugez ishte trup administrativ dhe se për t'u përmbushur e drejta e garantuar sipas nenit 6 të Konventës, palës së pakënaqur do të duhej t'i mundësohej kontrolli i mëtejshëm nga një trup gjyqësor me juridiksion të plotë. Siç shihet edhe nga praktika e Armenisë më sipër, nocioni i apelit, nënkupton kontrollin nga një trup tjetër të ligjshmërisë dhe meritave të një vendimi, mbi bazën e po të njëjtave fakte.

Për t'u përmbushur e drejta në ankesë, shkalla e dytë, përveç se duhet të ketë juridiksion të plotë, duhet që po ashtu të jetë e pavarur. Shtjelluar në kontekstin e Dhomës së Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese në rastin Xhoxhaj kundër Shqipërisë, GJEDNJ po ashtu gjeti se ky trup ishte i pavarur, meqenëse u plotësuan kushtet si vijon: (i) vendoste meritat e

¹⁴⁵ Ibid.

¹⁴⁶ Matyjek kundër Polonisë (Vendimi meritor) (24 shtator 2007). I qasshëm: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-80219%22%7D>

¹⁴⁷ Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë (6 nëntor 2018), par. 210.

çështjes në mënyrë të pavarur; (ii) kishte diskrecion të plotë në vendosjen rreth strukturës së vet organizative dhe personelit; (iii) nuk merret udhëzime nga ekzekutivi dhe (iv) propozonte buxhetin vjetor që ndahet nga Parlamenti, pa mundësinë e ndërhyrjes në këtë çështje nga ana e ekzekutivit.¹⁴⁸

Kriteret e cekura si më lartë duhet të merren parasysh në dizejnimin e mekanizmit të apelit sipas Opsionit 4 dhe fazës së parë të Opsionit 5. Në Opsionet tjera ky mekanizëm mbetet Gjykata Supreme, e cila tanimë i plotëson kriteret e lartpërmendura.

B. E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare

Sipas Parimeve Bangalore, të shtjelluara më sipër, gjyqtarët, që për shkak të natyrës së punës së tyre konsiderohen garantues të sundimit të ligjit, duhet të ndjekin standard tejet të lartë të integritetit edhe në jetën private, jashtë mureve të gjykatës, me qëllim që të mirëmbajnë dhe rrisin besimin e publikut në integritetin e gjyqësorit.¹⁴⁹

E drejta në privatësi, përkufizohet sipas Konventës Evropiane kështu:

Neni 8:

- 1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.*
- 2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.*

Në rastin Xhoxhaj kundër Shqipërisë, GJEDNJ nisi analizën përkitazi me nenin 8 duke marrë për bazë vendimin e Gjykatës në rastin Denisov.¹⁵⁰ Në këtë rast, Gjykata kishte konfirmuar se kontestet e lidhura me punësimin nuk përjashtohen për se nga fushëveprimi i termit “jetë private” sipas nenit 8 të Konventës. Ka aspekte tipike të jetës private që ndikohen nga shkarkimi nga detyra dhe masa të ngjashme. Këto aspekte prekin (i) rrethin e brendshëm të personit; (ii) mundësinë e personit për të krijuar dhe zhvilluar raporte me të tjerët dhe (iii) reputacionin shoqëror dhe profesional të personit. Në këtë kuptim, sipas vendimit në rastin Denisov, ka dy mënyra se si këto aspekte ndikohen: qoftë për shkak të arsytimit e motivimit prapa zbatimit të masave të tilla,

¹⁴⁸ Xhoxhaj kundër Shqipërisë (31 maj 2021), par. 314.

¹⁴⁹ Ibid, par. 407.

¹⁵⁰ Denisov kundër Ukrainës (25 shtator 2018). I qasshëm: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:\[%22001-186216%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-186216%22]})

qoftë për shkak të pasojave që zbatimi i atyre masave ka në jetën private. Në rastin Xhoxhaj, analiza rreth nenit 8 ishte zhvilluar duke marrë për bazë pasojat që shkarkimi sipas vetingut do të kishte, me kusht që këto pasoja të jenë shumë serioze dhe me ndikim të lartë në jetën private të ish-gjyqtarës.¹⁵¹

Në shqyrtimin e kësaj pike të ankesës së znj. Xhoxhaj, GJEDNJ gjeti se krijimi i aseteve sipas rrethanave të rastit, nuk mund të konsiderohet aspekt i jetës private; nuk ishte shkak për sanksionin disiplinor shuma e aseteve ose jeta që ajo bënte, por pamundësia që ajo të dëshmojë ligjshmërinë e burimit të këtyre të ardhurave. Të dëshmuarit e ligjshmërisë së burimit të të ardhurave u pa me të drejtë si parakusht për sigurimin e besimit publik në integritetin e saj. Prandaj, zhvillimi i auditimit të pasurisë së saj në saje të procesit të vetingut, përbënte ndërhyrje të ligjshme dhe të arsyetuar sipas nenit 8, paragrafi 2 të Konventës.¹⁵²

Zbatimi i nenit 8 u analizua edhe përkitazi me elementin e tretë si më sipër dhe pasojat që procesi i vetingut dhe vendimi në procesin e vetingut pati në reputacionin e znj. Xhoxhaj. Duke qenë se si pasojë, ajo u stigmatizua gjerë në publik si e padenjë për profesionin gjyqësor, Gjykata gjeti se e drejta e saj sipas nenit 8 të Konventës, ishte e zbatueshme.¹⁵³

Vërejtjet dhe çështjet e ndjeshme sa i përket të drejtës së garantuar me nenin 8 të Konventës Evropiane, meritojnë vëmendje tek secili prej Opsioneve. Ndryshimet qoftë kushtetuese ose ligjore, do të bazohen plotësisht në Konventë dhe jurisprudencën e zhvilluar të GJEDNJ-së, ku veçanërisht mbledhja e informatave dhe masat tjera për zhvillimin e vetingut ndaj një zyrtari do të jenë plotësisht proporcionale për arritjen e qëllimit legjitim. Në këtë drejtim do të përdoren kufizimet e të drejtave, të lejuara me Nenin 8(2) të Kosovës, ngase korrupsioni dhe ndikimi politik i përhapur tej mase në sistemin e drejtësisë, ndikon drejtpërdrejtë në sigurinë publike, atë kombëtare, mbrojtjen rendit, shëndetit dhe moralit, por sidomos në mirëqenien ekonomike dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve (ku vlen të theksohet sidomos e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e paraparë në Nenin 6 të Konventës dhe Nenin 31 të Kushtetutës). Prezenca e përhapur tej mase e korrupsionit dhe ndikimit politik në sistemin e drejtësisë vërtetohet nga raporte ndërkombëtare dhe vendore,¹⁵⁴ si dhe ka penguar dhe vazhdon të pengoj zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe ka ndikuar në veprime ose mos-veprime

¹⁵¹ Ibid, par. 116.

¹⁵² Xhoxhaj kundër Shqipërisë (31 maj 2021), par. 362.

¹⁵³ Ibid, par. 364.

¹⁵⁴ Shih Raportet e përmendura në Kapitullin 1 të këtij Koncept Dokumenti.

që kanë rezultuar dhe vazhdojnë të rezultojnë me shkelje të të drejtave të njeriut në Kosovë.

II. Ndikimi në të drejtat themelore në përgjithësi

1. Përfitimet e përgjithshme nga procesi i vetingut

Siç ishte theksuar edhe nga Komisioni i Venecias, vetingu i gjyqtarëve dhe prokurorëve jo vetëm se ishte i arsyeshëm, por edhe i domosdoshëm për mbrojtjen e vendit nga korrupsioni që në rast se nuk adresohet, mund të shkatërronte mbarë sistemin gjyqësor.¹⁵⁵ Tutje, siç ishte thënë edhe në vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, kufizimet e vendosura nga Ligji për Vetingun arsyetohen nga interesi publik në zvogëlimin e nivelit të korrupsionit dhe kthimin e besimit qytetar në gjyqësor, e që ndërliket drejtpërdrejtë me sigurinë e vendit, rendin publik dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore.¹⁵⁶ Nisur nga kjo dhe duke marrë parasysh ngjashmëritë kontekstuale sa i përket nevojës për ndërmarrjen e vetingut në Kosovë, mbështetur gjithashtu në përshkrimin e dhënë edhe tek Përkufizimi i problemit, atëherë asesi nuk mund të shihet si zgjidhje veprimi sipas Opsionit 1 ose 2.

2. Siguria juridike

Sistemi i vetingut potencialisht mund të kenë ndikime në dobësimin e parimit të sigurisë juridike.¹⁵⁷ Sipas këtij parimi i cili është mishëruar si në të drejtën e brendshme ashtu edhe në atë ndërkombëtare, sistemi juridik duhet të lejojë që të gjithë ata që i nënshtrohen ligjit të rregullojnë sjelljen e tyre konform rregullave ligjore dhe t'i mbrojnë ata nga përdorimi arbitrar i pushtetit shtetëror. Parimi i sigurisë juridike kërkon që ligjet të jenë mjaftueshëm të sakta për të lejuar personin - nëse është e nevojshme, të parashikojë, në një shkallë të arsyeshme në rrethana, pasojat që mund të sjellë një veprim i caktuar. Andaj sipas sigurisë juridike, ligjet dhe vendimet duhet të bëhen publike, të jenë të qarta, retroaktiviteti i ligjeve dhe vendimeve të jetë i kufizuar dhe interesat legjitime të mbrohen. Këto aspekte duhet të merren në konsideratë për sa i përket hartimit të akteve përkatëse sipas Opsioneve 3, 4 dhe 5.

¹⁵⁵ Opinioni i Komisionit të Venecias (15 janar 2016) (CDL-AD(2012016)009) par. 52. I qasshëm: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)009-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)009-e). Cituar në Xhoxhaj kundër Shqipërisë, para. 96, 392.

¹⁵⁶ Xhoxhaj kundër Shqipërisë, para. 175, 392.

¹⁵⁷ UNDP, Vetting Public Employees in Post-conflict Settings, 2006, <https://www.ictj.org/sites/default/files/ICTJ-UNDP-Global-Vetting-Operational-Guidelines-2006-English.pdf>

A. Siguria juridike dhe retroaktiviteti

Në rastin Xhoxhaj kundër Shqipërisë, znj. Xhoxhaj kishte pretenduar se procesi i vetingut siç ishte zhvilluar në Shqipëri, cenonte sigurinë juridike. Një nga pikat në të cilat ishte mbështetur ky pretendim ishte çështja e retroaktivitetit. Me qëllim të vlerësimit të prejardhjes së pasurisë, trupi i vetingut bënte hetim të dokumenteve dhe ngjarjeve që kishin ndodhur shumë përpara – në rastin e znj. Xhoxhaj, që nga vitet '90.

GJEDNJ kishte vlerësuar se afatet e parashkrimit shërbejnë për qëllime të rëndësishme, sidomos për qëllime të sigurisë juridike, plotfuqishmërisë së vendimeve dhe sidomos për t'i mbrojtur palët e akuzuara nga pretendime që e kanë të vështirë t'i kundërshtojë, e nga padrejtësia që mund të jetë për pasojë në rast se gjykata vendosë rreth ngjarjeve që kanë ndodhur në të shkuarën e largët, mbi bazën e dëshmive që mund të jenë bërë më pak të besueshme për shkak të kalimit të kohës. Kështu, afatet e parashkrimit janë të zakonshme në sisteme të ndryshme juridike, për sa i përket shkeljeve penale, disiplinore dhe të tjera.¹⁵⁸

Megjithatë, GJEDNJ gjeti se vendosja e afateve strikte të parashkrimit për vlerësimin e pasurisë, kufizon mundësinë e autoriteteve shtetërore për të vlerësuar ligjshmërinë e prejardhjes së pasurisë së përgjithshme, që personi që i nënshtrohet vetingut e ka fituar përgjatë karrierës profesionale. Si rrjedhojë, vlerësimi i aseteve në kontekstin e vetingut, u vlerësua nga GJEDNJ që dallon nga vlerësimet në procedura të zakonshme disiplinore. Marrë parasysh qëllimin e kthimit dhe forcimit të besimit qytetar në gjyqësor, ndërmarrja e vlerësimit të aseteve në saje të procedurës së vetingut mund të bëhet me shcallë më të lartë të fleksibilitetit për sa i përket afateve të parashkrimit. Gjykata thekson se një qëndrim i tillë ka kuptim sidomos në rastin e Shqipërisë, kur dihet se nuk ka pasur më parë, e as rregullisht, vlerësim të mirëfilltë të asteve të deklaruara. Bërja e vlerësimit të pasurisë mbi bazën e deklaratave të mëparshme mbi pasurinë, nuk cenon sigurinë juridike.¹⁵⁹ Pra, veprimi retroaktiv i mirë bazuar në ligj, jo vetëm se nuk cenon sigurinë juridike, por është i domosdoshëm për kryerjen e verifikimeve, sidomos rreth prejardhjes së pasurisë. Në përcaktimin e pikënisjes në kohë, duhet të merren parasysh aspektet praktike të qasjes në të dhëna dhe dokumente për justifikimin dhe dëshmimin e prejardhjes së pasurisë së personit që vetohet, si nga ana e mekanizmit, ashtu edhe nga ana e subjektit të vetingut (varësisht se kush caktohet të ketë barrën e provës). Marrë parasysh ngjashmëritë kontekstuale, këto elemente duhet të merren parasysh për sa i

¹⁵⁸ Xhoxhaj kundër Shqipërisë, par. 349.

¹⁵⁹ Gogitidze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë (15 maj 2015), par. 122. I qasshëm: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-154398%22%5D%7D>

përket përcaktimit të fushëveprimit kohor të akteve normative, sidomos ligjit special që do të përcaktojë aspektet procedurale, sipas Opsioneve 3, 4 dhe 5.

B. Siguria juridike dhe përshkallëzimi i masave

Në rastin *Xhoxhaj kundër Shqipërisë* ankuesja kishte pretenduar po ashtu se siguria juridike cenohej për shkak të mungesës së përshkallëzimit të sanksionit dhe si rrjedhojë, joproportionalitetit të sanksionit.

Gjykata kishte gjetur se në parim, ky pretendim qëndronte: mungesa e përshkallëzimit të sanksioneve nuk ishte në përputhje me parimin e proporcionalitetit.¹⁶⁰ Megjithatë, GJEDNJ theksoi sërish se procedurat e vetingut janë *sui generis* për nga natyra, megjithëse mund të duket se kanë ngjashmëri me procedurat e zakonshme disiplinore. Në rastin e Shqipërisë, theksohet se vetingu ishte ndërmarrë si kundërpërgjigje e shkallës së lartë të korrupsionit në gjyqësor, me qëllim të largimit të elementeve korruptive dhe ruajtjes së pjesës së shëndoshë të sistemit. Në raste të këtilla, të rrethanave të jashtëzakonshme që i paraprinë nxjerrjes së Ligjit për Vetëingun, GJEDNJ gjeti se gama më e kufizuar e masave sanksionuese është në përputhje me idenë e vetingut.¹⁶¹ Masat e propozuara sipas Opsioneve 3, 4 dhe 5 ndjekin po këtë frymë dhe si të tilla, garantojnë sigurinë juridike edhe po qe se nuk parashihen më shumë masa.

Nga ankuesja ishte argumentuar po ashtu se masa e përjashtimit të përhershëm nga të ushtruarit e detyrës së gjyqtarit, gjithashtu cenonte sigurinë juridike dhe garancitë e mirënjohura të ushtrimit të këtij profesioni. GJEDNJ ritheksoi se gjyqtarët, sidomos ata në pozita me përgjegjësi të lartë shtetërore, ushtrojnë një pjesë të pushtetit sovran të shtetit. Ndalimi që përjetë të ushtrojë profesionin e gjyqtarit për një person që është shkarkuar mbi bazën e shkeljeve shumë serioze etike, nuk është në mospërputhje, e as joproportional kundrejt qëllimit legjitim të shtetit për të siguruar integritetin e gjyqësorit dhe besimin qytetar në sistemin e drejtësisë.¹⁶² Masa përfundimtare e shkarkimit sipas Opsioneve 3, 4 dhe 5 ndjek po këtë frymë.

Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave

Grupi punues për hartimin e këtij Koncept Dokumenti kishte përbërje nga akterë të ndryshëm relevant si brenda institucioneve të Kosovës, ashtu edhe jashtë saj. Si rrjedhojë,

¹⁶⁰ Oleksandër Volkov kundër Ukrainës (27 maj 2013), par. 182. I qasshëm: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-115871%22%5D%7D>

¹⁶¹ *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, par. 412.

¹⁶² *Ibid*, par. 413.

nuk janë hasur sfida në mbledhjen e të dhënave që janë nevojitur për kryerjen e analizave në këtë Koncept Dokument.

Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi

Zhvillimi i procesit të vetingut është një proces për të cilin ka një interesim të madh qoftë nga anëtarët e sistemit të drejtësisë, organizatat e shoqërisë civile që e ndihmojnë dhe monitorojnë punën e tyre, donatorët ose partnerët zhvillimor dhe publiku në përgjithësi.

Si rrjedhojë, Ministria e Drejtësisë ka përfshirë në grup punues partnerët kryesor të interesuar për procesin të cilët kanë pasur mundësinë të kontribuojnë drejtpërdrejtë në hartimin dhe analizimin e këtij dokumenti. Përveç kësaj, Ministria ka mbajtur takim publik me të gjitha palët e interesuara si dhe Ministrja e Drejtësisë dhe anëtarët tjerë të kabinetit të saj dhe menaxhmentit të MD-së kanë ofruar informata tek publiku për punën dhe elementet që janë trajtuar në Dokument, gjatë adresimit të tyre përmes mediave.

Anëtarët e grupit punues të themeluar nga Ministria e Drejtësisë, gjatë takimeve të mbajtura por edhe në mënyrë të shkruar i kanë paraqitur komentet dhe propozimet e tyre për Koncept Dokumentin.

Qëndrimet e Sistemit Prokurorial të Kosovës

Anëtari i grupit punues nga KPK, ka theksuar pikëpamjet e sistemit prokurorial të Kosovës, që është se Kosova e ka kaluar një sistem të vetingut në vitin 2010 dhe se çdo lloj i kontrollit të vazhdueshëm të integritetit dhe verifikimit në sistemin e drejtësisë duhet të bëhet në përputhje me standardet ndërkombëtare, që garantojnë pavarësinë e gjyqësorit dhe prokurorisë.

Gjithashtu, qëndrimi i KPK-së është se kontrolli fillimisht do të duhej të bëhej për të gjithë akterët e sundimit të rendit dhe ligjit, pa përjashtim, sistemi gjyqësor, Policia, ATK, AKI, duke përfshirë edhe administratën e tyre.

Sistemi prokurorial në Kosovë tanimë e ka kaluar fazën e tranzicionit, ka krijuar mekanizma të bazuar në standarde ndërkombëtare nga të cilët duhet të kërkohet llogari e vazhdueshme dhe se i njëjti dallon nga shtete tjera, ngase është themeluar me mbështetje në fillim nga UNMIK-u, pastaj nga EULEX-i, si dhe partnerët kryesor ndërkombëtar të Kosovës. Sipas tyre, realizimi i vetingut në shtete si Shqipëria, Armenia, Moldavia, Rumania, Maqedonia e Veriut dhe Serbia ka qenë i vështirë dhe ka pasur më shumë anë negative, duke sjellë jo avancim të sistemit gjyqësor në përgjithësi.

Si rrjedhojë, sistemi prokurorial përkrah Opsionin 3 të Koncept Dokumentit, i cili sipas tyre është në përputhje me të gjeturat e Procesit të Rishikimit FunkSIONAL të Sektorit të Sundimit të Ligjit. Ky Opsion përkrahet edhe nga Shoqata e Prokurorëve të Kosovës, të cilët theksojnë se i njëjti duhet të trajtohet më mjaft kujdes, në mënyrë që të mos kompromentohet procesi si i ndikuar politikisht. Opsionet me mekanizëm të jashtëm, sipas KPK-së do ta shkaktonin grumbullimin e lëndëve të pa zgjidhura si dhe do të shtonin edhe një problematikë për plotësimin e vendeve ku kërkohet përvojë e lartë në instancat më të larta si: ZKPSH dhe Prokurori të Apelit. Opsioni 4 dhe 5 sipas tyre mundësojnë ndërhyrjen e ekzekutivit dhe legjislativit në gjyqësor dhe prokurori, që duhet të jenë të pavarura. As Opsioni 1 dhe 2 nuk e adresojnë problematikën e identifikuar. Gjithashtu, sipas Shoqatës së Prokurorëve, çdo veting *ad-hoc* me mekanizëm të jashtëm, krijon praktikë të një vetingu politik dhe çdo parti që vije në pushtet mund të bëjë veting sipas kriterëve të veta. Sipas tyre, dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës paraqesin një garancë së procesi i vetingut do të jetë i drejtë.

Qëndrimet e Sistemit Gjyqësor të Kosovës

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, është i mendimit se varianti i dytë i opsionit 3 mund të jetë më efektiv në vetimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Sipas KGJK-së, aspekti i vlerësimit të integritetit personal të gjyqtarëve, bazuar në ligjet aktuale, nuk është i rregulluar mjaftueshëm dhe ka bazë për ndryshime dhe plotësime ligjore për të krijuar bazën e qartë dhe të plotë për këtë vlerësim, pasi që pjesë e vlerësimit të integritetit personal të gjyqtarëve domosdoshmërisht do të duhej të ishte edhe verifikimi i të dhënave të siguruara që lidhen me çështjen e pasurisë. Për më tepër, vlerësimi i integritetit duhet të jetë i verifikuar në periudhë të caktuar kohore (vlerësim i rregullt) dhe në rastet kur paraqitet dyshimi se po cenohet integriteti nga ana e gjyqtarit (vlerësim me shkas apo i jashtëzakonshëm).

Siç është cekur edhe më lartë, në pjesët relevante, KGJK vlerëson se mekanizmi i kontrollit të integritetit mund të bëhet përmes krijimit të një mekanizmi të ri në kuadër të KGJK-së, i cili në bashkëpunim me ZVVGj-në ekskluzivisht do të merrej vetëm me verifikimin e integritetit personal të gjyqtarëve, duke mos përjashtuar edhe verifikimin e pasurisë për qëllim të vlerësimit të integritetit. Për tu realizuar ky proces i kontrollit të integritetit duhet të bëhen ndryshime ligjore.

Nëse konsiderohet se do të ishte më e përshtatshme që deklarimi i pasurisë të bëhej në ndonjë mënyrë apo organ tjetër, atëherë përmes ndryshimeve ligjore kjo do të mund të bëhej në KGJK, e cila do të krijonte ndonjë mekanizëm të veçantë edhe për verifikimin e

pasurisë së deklaruar, apo që deklarimi prapë të bëhej tek Agjencioni Kundër Korrupsion (AKK) pranë të cilit do të mund të themeloheshin mekanizma shtesë funksional që do të vlenin për verifikimin e pasurisë për të gjithë zyrtarët e lartë publik duke përfshirë edhe gjyqtarët, ndryshime këto të cilat mund të bëheshin në kuadër të procesit të rishikimit funksional të Sistemit të Drejtësisë. Por, siç është cekur edhe më lartë, sipas KGJK-së e rëndësishme është të theksohet se nuk do të duhej të kishte asnjë trajtim ndryshe të gjyqtarëve në raport me zyrtarët e tjerë të lartë përkitazi me procesin e verifikimit të pasurisë së tyre. Intenca që të krijohen mekanizma të veçantë për verifikim të pasurisë të gjyqtarëve dhe prokurorëve, konsiderojnë se bie ndesh me vet dispozitat e kontrollit të pasurisë bazuar në Ligjin nr. 04/L-050. Në anën tjetër, IKD vlerëson se ky qëndrim i KGJK-së nuk është i arsyeshëm. Rëndësia e sistemit gjyqësor dhe prokurorial si dhe integriteti i kontestuar i këtyre dy (2) sistemeve, pa mëdyshje e ndërtojnë legjitimitetin për trajtim më specifikim të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Për më tepër, IKD vlerëson se KGJK në këtë rast nuk mund të thirret në Ligjin për Deklarimin e Pasurisë, pasi ky ligj shërben vetëm në fushën e deklarimit të pasurisë të të gjithë zyrtarëve të lartë dhe nuk mund të konsiderohet si “kushtetutë” për të gjitha problemet që evidentohen në institucionet publike, në rastin konkret në institucionet e sistemit të drejtësisë.¹⁶³

Po ashtu, sipas KGJK-së duhet përjashtuar pjesëmarrjen e AKI –së në proces të verifikimit, pasi që kjo bie ndesh rregullimin aktual kushtetues, ligjet bazike, si dhe me instrumentet dhe standardet ndërkombëtare që e garantojnë pavarësinë e gjyqësorit.

KGJK ka dalë me këto rekomandime:

1. Të ruhet pavarësia e gjyqësorit, ashtu që të gjitha institucionet shtetërore duhet të përmbahen nga veprimet që e cenojnë pavarësinë e gjyqësorit;
2. Nevoja për rishikim funksional;
3. Ligjet që përfshihen në rishikimin funksional (Ligji për KGJK; Ligji për Gjykatat dhe Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve);
4. Ndryshimi i Ligjit për KGJK-në, me qëllim të krijimit të bazës ligjore për organizimin dhe funksionimin e Zyrës për Vlerësim dhe Verifikim të gjyqtarëve;
5. Ndryshimi i Ligjit për KGJK-në, me qëllim të krijimit të bazës ligjore për krijimin e një mekanizmi të ri në kuadër të KGJK-së, i cili në bashkëpunim me ZVVGj-në do të merrej vetëm me verifikimin e integritetit personal të gjyqtarëve dhe verifikimin e pasurisë për qëllim të vlerësimit të integritetit;
6. Ndryshimi i Ligjit për Gjykatat, sa i përket strukturës organizative të gjykatave (Gjykata Administrative dhe Dhoma e Posaçme);

¹⁶³ Komentet nga Konsultimi Publik nga IKD-ja, fq. 11-12.

7. Ndryshimi i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sa i përket përgjegjësi të autoriteteve kompetente, procedurave dhe masave disiplinore;
8. Në procesin e rishikimit të jetë i përfshirë sistemi gjyqësor;

Qëndrimet e organizatës GLPS

Organizata GLPS është e mendimit se tek opsioni 4, fushëveprimi dhe kompetencat e mekanizmit të veçantë për veting të përcaktohen me amendament kushtetues. Ndër tjera si dispozita eksplicite duhet të jenë:

1. Autorizimi kushtetues për krijimin dhe përbërjen një mekanizmi të vazhdueshëm që do të jetë bartës i procesit të vetingut;
2. Autorizimi kushtetues për të kryer vetingun ndaj subjekteve të vetingut duke përfshirë edhe autoritetin për të bërë shkarkimin e një subjekti që nuk kalon procesin e vetingut;
3. Klauzola për përfundimin e përhershëm të mandatit të gjyqtarit dhe prokurorit dhe subjekteve të tjera që kanë një mandat të tillë.
4. Përcaktimin e subjekteve të vetingut duke mos u kufizuar vetëm në gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese, gjyqtar dhe prokuror por edhe duke lënë mundësinë që me ligj të përcaktohen edhe kategoritë e personave të tjerë zyrtar që vlerësohen se duhet të kalojnë procesin e vetingut.
5. Kriteret mbi të cilat do të kryhet vetingu duke përfshirë: vlerësimin e integritetit, profesionalizmit dhe pasurisë. Pësia e secilit kriter duhet të përcaktohet me ligj.
6. Mekanizmi ankimor dhe juridiksioni i plotë për të vendosur mbi ankesat e subjekteve të vetingut.

Po ashtu, tek opsioni 4 në lidhje me masat që parashihen për gjyqtarët/prokurorët të cilët nuk kalojnë procesin e vetingut, GLPS konsideron që procesi i vetingut duhet të shërbejë si filtër për pastrimin e sistemit. Thënë kështu, të gjithë ata të cilët nuk e kalojnë këtë proces duhet të largohen nga sistemi prandaj edhe propozimi për masa të tjera përveç që është i pakuptimit nuk ka asnjë vlerë. Rikujtojmë se me anë të procesit të vetingut si element mbizotërues do të jetë vlerësimi i integritetit të subjekteve që i nënshtrohen vetingut sidomos lidhjet e tyre me qarqet kriminale dhe partizane dhe ndikimi i tyre në ushtrimin e funksionit publik të dhënë sipas ligjit.

Ndërkaq, lidhur me organet që zhvillojnë vetingun GLPS propozon që: Mekanizmi i vetingut duhet të përmbajë dy nivele:

- I. Instancën e dytë që me përbërje nga ndërkombëtarët që do të shërbente si instancë e apelit në rastet kur janë shkelur masat mbrojtëse procedurale, dhe,
- II. Instancën e parë që do të shërbente si mekanizmi i shkallës së parë për të rishikuar përputhshmërinë e figurës së gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe si shkalla e vetme që gjykon aspektet faktike në lidhje me figurën e gjyqtarëve dhe prokurorëve; të përbërë nga avokatë të shquar lokalë, gjyqtarë dhe prokurorë.

Pas përfundimit të draftit të parë të Koncept Dokumentit, i njëjti është përcjellë në konsultim paraprak dhe konsultimi publik për të gjitha institucionet, organizatat dhe partnerët tjerë të cilat nuk e kanë pasur mundësinë që të jenë pjesë e grupit të tyre, dhe kjo ishte një platformë e mirë që të ofrojnë kontributin e tyre për t'i pasuruar tutje analizat që janë bërë. Për fund, planifikohet të zhvillohen edhe aktivitetet e komunikimit të kësaj politike të re, në përputhje me opsionin e rekomanduar, ashtu që të sigurohet që zhvillimi i procesit të vetingut do të jetë i drejtë dhe transparent.

Figura 14: Përmbledhje e aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të kryera për një koncept dokument

Procesi i konsultimit synon:						
- Konsultimin e palëve të interesuara për përmbajtjen e Koncept Dokumentit, dhe veçanërisht për opsionet e shqyrtuara dhe ndikimin e vlerësuar të tyre.						
Qëllimi kryesor	Grupi i synuar	Aktiviteti	Komunikimi/njoftimi	Afati i ndikativ	Buxheti i nevojshëm	Personi përgjegjës
Takimi i hapur për të gjithë palët e interesuar	Të gjitha palët e interesuara	Takim publik (online)	Përmes e-mailit dhe rrjeteve sociale	17 maj 2021	/	Egzon Osmanaj, DIEKP, MD
Konsultim i paraprak me shkrim	Institucione të Republikës së Kosovës	Konsultim i brendshëm	Përmes e-mailit	15 deri 30 qershor 2021	/	Lulzim Beqiri DIEKP, MD

Konsultim i publik me shkrim	Të gjitha palët e interesuara	Publikimi i konsultimit në portalin për konsultim publik	Përmes portalit	29 korrik deri 19 gusht, 2021	/	Lulzim Beqiri DIEKP, MD
Konsultim i publik	Të gjitha palët e interesuara	Tryezë/Punëtori për diskutimin e komenteve të pranuar në konsultim publik	Përmes e-mailit	29 korrik deri 19 gusht, 2021		Lulzim Beqiri DIEKP, MD

Takimi publik për Koncept Dokumentin është mbajtur me datë 17 maj 2021 përmes platformës Zoom.

Të gjeturat kryesore nga ky takim ishin:

- Mungojnë mekanizmat e vazhdueshëm për të përcjellë punën e prokurorëve dhe gjyqtarëve;
- Nevoja për zbatimin e vetingut në përputhje me standardet më të mira;
- Gjatë zbatimit të vetingut, duhet të ndërmerren të gjitha masat adekuate në mënyrë që procesi të jetë i suksesshëm dhe sistemi të mos mbetet peng i reformave të vazhdueshme dhe të pa përfunduara;
- Vetingu, duhet të jetë edhe i vazhdueshëm, përndryshe nuk ka qëndrueshmëri, dhe
- Analiza për këtë Koncept Dokument duhet të merr parasysh edhe analizat e mëhershme të përgatitura në këtë temë, në formate të ndryshme.

Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve

Për të adresuar problemet e analizuara në këtë dokument, janë propozuar pesë opsione konkrete, disa prej të cilave parashohin modalitete të ndryshme brenda vetes. Në këtë seksion do të krahasohen ato mes vete, duke përdorur analizën shumë-kriterëshe, që bazohet në metodologjinë e zhvilluar 'EEE'. Kjo metodologji merr parasysh tri kritere: efikasiteti, efektiviteti, etikën. Bazuar në këto tre kritere, pastaj është bërë notimi nga 1 deri në 5 i secilit opsion, ku 5 tregon nivelin më të lartë të plotësimit të kriterit.




Figura 15: Tre kriteret që janë konsideruar për krahasimin e opsioneve

Pra, nevojitet kujdes i shtuar për të siguruar që çdo sistem i zgjedhur është efektiv, efikas dhe etik. Subjektet private në të kaluarën janë fokusuar në efikasitetin (koston) dhe efektivitetin (ndikimin) si një model i performancës. Në mjediset e sektorit publik është thelbësore që të konsiderohet edhe etika si një faktor shtesë i cili sigurohet nëpërmjet qeverisjes dhe dizajnit të mirë të sistemit.

Fillimisht, për të kuptuar se sa efikase janë opsionet e ndryshme, është bërë, duke u bazuar në opsionet e zhvilluara, llogaritja e koston të secilit opsion, marr parasysh kategoritë e shpenzimeve për vitet 2021-2025 të zbatimit të Koncept Dokumentit.

Tabela e kostos së opsioneve për 5 vite

Opsioni 2

Opsioni 2	2021	2022	2023	2024	2025
Paga dhe Meditje		469,007.09	471,352.13	473,708.89	476,077.43
Mallra dhe Shërbime	Kosto Administrative	189,080.00	148,380.00	148,380.00	148,380.00
Komunali					
Kapitale		125,000.00	0.00	0.00	0.00
Totali		783,087.09	619,732.13	622,088.89	624,457.43
Totali për 5 vite: 2,649,365.53					

Opsioni 3

Opsioni 3	2021	2022	2023	2024	2025
Paga dhe Meditje		2,994,736.80	3,009,710.48	3,024,759.04	3,039,882.83
Mallra dhe Shërbime (duke përfshirë nën-kategorinë: Shërbime kontraktuese për njësinë e vetingut fillestar me përfshirje ndërkombëtare)	Kosto Administrative	3,897,460.00	526,560.00	526,560.00	526,560.00
Komunali		30,000.00	30,000.00	30,000.00	30,000.00
Kapitale		400,000.00	0.00	0.00	0.00
Totali		7,322,196.8	3,566,270.484	3,581,319.04	3,596,442.83
Totali për 5 vite: 18,066,229.15					

Opsioni 4

Opsioni 4	2021	2022	2023	2024	2025
Paga dhe Meditje		3,154,852.80	3,170,627.06	3,186,480.20	3,202,412.60
Mallra dhe Shërbime (duke përfshirë nën-kategorinë: Shërbime kontraktuese për njësinë e vetingut fillestar me përfshirje ndërkombëtare)	Kosto Administrative	3,870,740.00	417,640.00	417,640.00	417,640.00

kategorinë: Shërbime kontraktuese për njësinë e vetingut fillestar me përfshirje ndërkombëtare)					
Komunali		30,000.00	30,000.00	30,000.00	30,000.00
Kapitale		400,000.00	0.00	0.00	0.00
Totali		7,455,592.80	3,618,267.06	3,634,120.20	3,650,052.60
Totali për 5 vite: 18,358,032.66					

Opsioni 5

Opsioni 5	2021	2022	2023	2024	2025
Paga dhe Meditje		3,154,852.80	3,170,627.06	3,186,480.20	3,202,412.60
Mallra dhe Shërbime (duke përfshirë nën-kategorinë: Shërbime kontraktuese për njësinë e vetingut fillestar me përfshirje ndërkombëtare)					
Kosto Administrative		3,870,740.00	417,640.00	417,640.00	417,640.00
Komunali		30,000.00	30,000.00	30,000.00	30,000.00
Kapitale		400,000.00	0.00	0.00	0.00
Totali		7,455,592.80	3,618,267.06	3,634,120.20	3,650,052.60
Totali për 5 vite: 18,358,032.66					

Opsioni i parë - opsioni pa ndryshime, parasheh vazhdimin e situatës pa bërë asnjë ndryshim, qoftë në burimet njerëzore apo kornizën ligjore. Përparësitë e këtij opsioni janë krejtësisht të limituara, për të mos thënë inekzistente. Përparësi e vetme e këtij opsioni është kostoja e ulët ngase nuk parashihet ndonjë shpenzim shtesë. Megjithatë, ky opsion do të ishte joefikas sepse të gjitha problemet e identifikuar në kuadër të këtij dokumenti do të vazhdonin të ekzistonin. Në mesin e këtyre, duhet veçuar vazhdimin e cenueshmerisë së sistemit gjyqësor dhe prokurorial nga akterët e jashtëm e cila, në mes tjerash, në fund rezulton drejtpërdrejtë me mungesën së besimit të qytetarëve në drejtësi.

Rrjedhimisht, vazhdimi i funksionimit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial ashtu siç është tani, përveç se nuk do të mënjanonte problemet ekzistuese, vlerësohet se do ta përkeqësonte gjendjen edhe më shumë. Ndonëse ndryshime në drejtësi parashihen dhe ndodhin vazhdimisht, veçanërisht me procesin e Rishikimit Funksional, megjithatë edhe ky proces e ka bërë të qartë tashmë se mënyra më e mirë për të adresuar llogaridhënien dhe integritetin e sistemeve është një sistem i mirëfilltë i vetingut. Për këtë arsye, opsioni pa ndryshime apo *status quo* shihet si opsioni më së paku i përshtatshëm apo i pranueshëm.



Figura 16: Notimi i Opsionit 1 sipas analizës shumë-kriterëshe

Opsioni i dytë - përmirësimi i zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore është njëra nga opsionet që propozon një ndërhyrje në situatën aktuale, megjithëse të limituar meqë me këtë opsion nuk parashihen ndryshime të natyrës ligjore. Siç është elaboruar edhe në kuadër të këtij opsioni më sipër, njësitet aktuale për verifikim në kuadër të këshillave gëzojnë kompetenca mjaft të kufizuara ligjore. Baza e tyre aktuale janë Rregulloret e brendshme të këshillave dhe ato deri diku rregullojnë funksionimin e tyre përbrenda. Megjithatë, mungesa e një baze ligjore e cila do t'i mundësonte këtyre njësive që të mbledhin të dhëna përtej regjistrave publikë është e meta më e madhe në kuadër të këtij opsioni. Në mungesë të ndërhyrjeve në bazë ligjore apo rregullative, këto kufizime në punën e tyre do të vazhdonin të ekzistonin. Thënë shkurt, njësitet do të vazhdojnë të mbledhin vetëm informata mbi prapavijën e subjektit, që janë të qasshme në regjistrat publikë. Veç asaj, ajo nuk bëhet në baza të rregullta. Duhet rikujtuar gjithashtu se këto

njësi janë krejtësisht të varura nga Këshillat dhe nuk gëzojnë pavarësi në vendimmarrje si dhe nuk kanë incentiva shtesë për punën e ndjeshme që ato kryejnë.

Gjithashtu, duhet ritheksuar se këto njësi janë njësi që kryejnë vetëm verifikime bazike, e që dallon konceptualisht nga koncepti i vetingut siç është shpalosur në këtë dokument. Pavarësisht se ky opsion konsiderohet efikas për shkak të kostos shumë më të ulët në raport me opsionet tjera që propozojnë ndryshim në sistemin aktual, efektiviteti i tij është shumë i ulët në raport me objektiven e e këtij Koncept Dokumenti dhe pritshmëritë e opinionit publik. Për këtë arsye, opsioni i dytë është opsion i cili do të mund të sillte rezultate paksa më pozitive se ai i pari, por shumë të limituara.



Figura 17: Notimi i Opsionit 2 sipas analizës shumë-kriterëshe

Opsioni i tretë - Opsioni i zhvillimit të vetingut përmes ndryshimeve ligjore është njëra nga opsionet që parashohin ndryshime më të thukëta për të adresuar problemet e identifikuara në dokument. Ky opsion parashih zhvillimin e një procesi të vlerësimit të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë, duke ruajtur kompetencat e këshillave në kuadër të kornizës aktuale kushtetuese. Kështu, opsioni mundohet të maksimizojë mundësitë e zhvillimit të një procesi të vetingut brenda këshillave si autoritete vendimmarrëse, por duke u përpjekur që të garantojë një lloj pavarësie të mekanizmave të vetingut në kuadër të këtyre këshillave.

Opsioni i tretë parasheh rezultatet më të mira të mundshme që mund të arrihen përmes përmirësimit të kornizës ligjore... Mirëpo, pamundësia e vetë mekanizmave që të marrin vendime për masat që duhen shqiptuar për subjektet e vetingut dhe nevoja që çdo vlerësim dhe rekomandim i tyre të jetë subjekt i vendimeve të lira të këshillave, mund të kufizojë suksesin e këtij procesi. Thënë këtë, kjo është njëkohësisht edhe njëra nga anët më të dobëta të këtij opsioni.

Një mangësi tjetër e këtij opsioni është edhe pamundësia për të zgjedhur përfundimisht anëtarët e mekanizmit vetues, pa involvim të këshillave aktualë. Ndonëse ky opsion parasheh involvim tejet aktiv të mekanizmave ndërkombëtarë në procesin e përzgjedhjes së tyre, duke e kushtëzuar atë gjithashtu me transparencë dhe publicitet të skajshëm, megjithatë vendimi final për të gjithë anëtarët e mekanizmit mbetet të merret nga vetë Këshillat, anëtarët e të cilëve në atë pikë janë të pa-vetuar.

Mangësi tjetër e këtij opsioni është edhe fillimi i ngadalshëm që pritet të ketë ky opsion, për shkak të nevojës së vetingut gradual të anëtarëve të këshillave dhe gjyqtarëve të Gjykatës Supreme. Siç është elaboruar më lartë, për të mundësuar ruajtjen e kuorumit dhe funksionit të përditshëm të këshillave, të gjeturat e vetingut të anëtarëve të këshillave duhen votuar sipas radhës. Në të njëjtën kohë, duhen zhvilluar me shumë kujdes procedurat e përzgjedhjes dhe vetingut të anëtarëve të ardhshëm të këshillave, të cilët do t'i zënë ulëset potenciale të anëtarëve që mund të humbasin anëtarësinë e tyre në Këshill si rezultat i procesit të vetingut. Përkundër përpjekjeve për të planifikuar detajisht edhe në mënyrë simultane të gjithë këtë proces, është e mundur që të ketë ngecje në njërin apo tjetrën. Si rezultat i këtyre ngecjeve potenciale, mund të vonohet fillimi i procesit të vetingut për gjyqtarët dhe prokurorët tjerë më pas.

Investimi në një opsion të këtillë, ndonëse pritet të ketë një fillim më të sfiduar dhe rezultate ndoshta më të ngadalshme, është investim në zhvillimin afatgjatë të kapaciteteve të këshillave për të udhëhequr procese të rregullta dhe të vazhdueshme të vetingut. Mësimet e marra nga fillimi i këtij procesi do të mbeteshin brenda institucioneve dhe do të mund të shtronin rrugën për përmirësime të vazhdueshme të procesit gjatë dekadave që vijnë. Stafi i involvuar në kuadër të këtyre institucioneve, do të vazhdonte të përsoste profesionalizmin e tyre dhe njohuria do të garantonte një memorie institucionale për gjeneratat në vijim.

Megjithatë, kostoja e këtij opsioni në raport me efektivitetin dhe pritshmëritë e opinionit publik dhe hisedarëve të përfshirë është shumë e lartë.



Figura 18: Notimi i Opsionit 3 sipas analizës shumë-kriterëshe

Opsioni i katërt - Zhvillimi i vetingut përmes ndryshimeve kushtetuese:

Opsioni 4 parasheh që me ndryshime kushtetuese të krijohet një mekanizëm i veçantë, që do të zhvillojë vetingun fillestar dhe më pas do të bëjë vlerësimin e vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë.., Me ndryshimin e Kushtetutës, ligjvënësve ju jepet mundësi për të projektuar një mekanizëm, natyrisht në përputhje me standardet ndërkombëtare, i cili më së shumti i përshtatet nevojave reale për veting dhe masave që do të ndërmerren, në raport me problemet e identifikuar. Ky opsion eliminon dilemat e përputhshmërisë së opsioneve ligjore me Kushtetutën. Përparësi e këtij opsioni është edhe fakti se do të krijohet një mekanizëm i ri, i përbërë nga profesionistë me integritet të lartë, të cilët vetohen paraprakisht. Kjo zvogëlon mundësinë e kompromentimit të procesit. Mekanizmi i ri do të shërbente si adresë e vetme të cilën shoqëria civile, publiku në përgjithësi dhe partnerët ndërkombëtar do ta mbanin rregullisht në vëzhgim për aktivitetet e ndërmarra. Pra, me Opsionin 4, sigurohet që do të ketë transparencë dhe llogaridhënie më të madhe.

Një dobësi, e cila duhet të shqyrtohet më tej, është fakti se me mekanizëm të ri të përhershëm kushtetues, këshillave i merren kompetencat aktuale në periudhë më afatgjatë (deri te ndryshimet tjera eventuale kushtetuese). Kjo mund të krijojë një situatë ku roli i këshillave minimizohet dhe ngrit pikëpyetje për përputhshmërinë me qëllimin e krijimit dhe funksionimit të tyre. Gjithashtu, ekziston rrezik sa i përket qëndrueshmërisë së një mekanizmi të përhershëm jashtë këshillave, ngase pas disa fazave ose viteve, mund

të lind nevoja që zyrtarët brenda këtij mekanizmi të lëvizin nga pozita e tyre për të ndjekur karrierë tjetër, që nënkupton zhvillimin e procesit të ri të rekrutimit i cili pas një kohe mund të mos ketë vëmendjen e duhur si në fillim, ose ndikimin e tij, dhe si rrjedhojë të krijojë një mekanizëm jo të qëndrueshëm dhe më pak llogaridhënës në periudhë afatgjate. Në të njëjtën kohë, krijimi i një mekanizmit të përhershëm për vlerësimin e performancës, pasurisë dhe integritetit jashtë këshillave përkatës, mund të mos jetë në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të elaboruara më lartë. Rrjedhimisht, ky opsion, megjithëse mund të jetë efektiv, etikën e tij e ka të cenuar, në aspekt afatgjatë.



Figura 19: Notimi i Opsionit 4 sipas analizës shumë-kriterëshe

Opsioni i pestë - Zhvillimi i procesit të vetingut përmes dy fazave

Opsioni i pestë pra është opsioni i zhvillimit të procesit të vetingut në dy faza: së pari vetingut fillestar përmes mekanizmit të jashtëm që krijohet me ndryshime kushtetuese (i paraparë me Opsionin 4), dhe pastaj vlerësimit të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë, përmes transformimit të këtij mekanizmi në mekanizma të brendshëm në kuadër të këshillave (përshtatshëmrisht me vlerësimin e vazhdueshëm të Opsioni 3).

Për vetingun fillestar me ndryshime kushtetuese, mund të konkludohet se vlejné përparësitë e elaboruara në Opsionin 4 më lartë sipas fazës së parë, dhe marr parasysh se mekanizmi i ri kushtetues sipas Opsionit 5 do ta bëjë vetëm vetingun fillestar dhe nuk do bëjë vlerësim të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë, i eliminon të gjitha pasiguritë dhe rreziqet për minimizimin afatgjatë të rolit të këshillave në proces.

Vlerësimi i vazhdueshëm i performancës, integritetit dhe pasurisë, pas vetingut fillestar, do të bëhet pra në kuadër të kornizave të këshillave. Ky opsion duket edhe më i përshtatshëm se Opsioni 3, ngase kjo kompetencë do të kaloj tek panelet e këshillave vetëm pasi që vetingut fillestar ti nënshtrohen të gjithë kandidatët (gjyqtarët, prokurorët dhe nëpunësit në pozita të larta). Kështu mund të supozohet se vetingu fillestar ka sukses, dhe pastaj vlerësimi i vazhdueshëm i performancës, integritetit dhe pasurisë nuk ka rrezik të kompromentimit, meqë ai do të bëhet dhe vendimet do të merren nga zyrtarët dhe personat të cilët në atë fazë veç janë të vetuar. Këto fakte e bëjnë Opsionin 5 të jetë më më etik se të gjitha opsionet tjera. Ky Opsion parashihet të jetë edhe mjaft efektiv, mirëpo gjatë tërë viteve të zbatimit të tij, në mënyrë që të sigurohet efekti i synuar, duhet një përfshirje e mirëfilltë dhe monitorim i vazhdueshëm nga shoqëria civile dhe publiku i gjerë.

Pavarësisht kostos së lartë buxhetore, ‘vlera për paranë’ besohet se do të arrihet dhe sistemi i drejtësisë në Republikën e Kosovës, përmes këtij opsioni, do të jetë një sistem profesional dhe me integritet që i shërben publikut në mënyrë të duhur.



Figura 20: Notimi i Opsionit 5 sipas analizës shumë-kriterëshe

Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme

Figura 21: Plani i zbatimit për Opsionin 2

Qëllimi i politikës	Realizimi i procesit të vetingut në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe gjithëpërfshirëse.								Shifra e kostos së pritur
Objektivi strategjik	Përmirësimi i integritetit të institucioneve të drejtësisë, përmes vetingut dhe mekanizmave tjerë.								
	Outputi, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës								
Objektivi Specifik 1 - Kthimi i besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë	Outputi	Aktiviteti	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
	Outputi 1.1 Njësitë për verifikim të fuqizuara	Aktiviteti 1.1.1 - Trefishimi i buxhetit për mallra dhe shërbime të Njësisë për verifikim në KGJK	x					KGJK, Kuvendi	
		Aktiviteti 1.1.2 - Trefishimi i buxhetit për mallra dhe shërbime të Njësisë për verifikim në KPK	x					KPK, Kuvendi	

Aktiviteti 1.1.3 - Rekrutimi i 15 zyrtarëve në Njësisë për verifikim në KGJK	x					KGJK	
Aktiviteti 1.1.4 - Rekrutimi i 10 zyrtarëve në Njësisë për verifikim në KPK	x					KPK	
Aktiviteti 1.1.5 - Trajnimi i zyrtarëve në Njësisë për verifikim në KGJK sipas profilit	x	x	x	x	x	KGJK	
Aktiviteti 1.1.6 - Trajnimi i zyrtarëve në Njësisë për verifikim në KPK sipas profilit	x	x	x	x	x	KPK	
Aktiviteti 1.1.7 - Trajnimi shtesë i zyrtarëve të AKK-së për verifikimin e pasurisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve	x		x			AKK	
Aktiviteti 1.1.8 - Rekrutimi i 6 zyrtarëve shtesë për të mbështetur Komisionin për Vlerësimin e Performancës në KGJK	x					KGJK	
Aktiviteti 1.1.9 - Rekrutimi i 6 zyrtarëve shtesë për të mbështetur Komisionin për	x					KPK	

Vlerësimin e Performancës në KPK							
Aktiviteti 1.1.10 - Mbajtja e një trajnimi për zyrtarët shtesë që mbështesin Komisionin për Vlerësimin e Performancës në KGJK	x					KGJK	
Aktiviteti 1.1.11 - Mbajtja e një trajnimi për zyrtarët shtesë që mbështesin Komisionin për Vlerësimin e Performancës në KPK	x					KPK	
Aktiviteti 1.1.12 - Zhvillimi i takimeve dhe aranzhimeve të përbashkëta të punës ndërmjet njësive të verifikimit të KGJK dhe KPK, duke përfshirë këtu ndarjen e informatave dhe praktikave të qëndrueshme të punës në të dy njësitë.		x	x			KGJK/KPK	
Aktiviteti 1.1.13 - Hartimi i Planit të Integritetit për gjyqtarë		x				KGJK	

	Aktiviteti 1.1.14 - Hartimi i Planit të Integritetit për prokurorë		x				KPK	
Outputi	Aktiviteti	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
Outputi 1.2 Anëtarët e sistemit gjyqësor të verifikuar	Aktiviteti 1.2.1 - Verifikimi i kandidatëve për gjyqtarë gjatë rekrutimit		x	x	x	x	KGJK	
	Aktiviteti 1.2.2 - Verifikimi i kandidatëve gjyqtarë për avancim		x	x	x	x	KGJK	
	Aktiviteti 1.2.3 - Verifikimi i të gjithë gjyqtarëve në përputhje me procesin e vlerësimit të performancës		x	x	x	x	KGJK	
Outputi	Aktiviteti	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
Outputi 1.3 Anëtarët e sistemit	Aktiviteti 1.3.1 - Verifikimi i kandidatëve për prokurorë gjatë rekrutimit		x	x	x	x	KPK	

prokurorial të verifikuar	Aktiviteti 1.3.2 - Verifikimi i kandidatëve prokurorë për avancim		x	x	x	x	KPK	
	Aktiviteti 1.3.3 - Verifikimi i të gjithë prokurorëve në përputhje me procesin e vlerësimit të performancës		x	x	x	x	KPK	

Totali:

Figura 22: Plani i zbatimit për Opsionin 3.

Qëllimi i politikës	Realizimi i procesit të vetingut në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe gjithëpërfshirëse.								Shifra e kostos së pritur
Objektivi strategjik	Përmirësimi i integritetit të institucioneve të drejtësisë, përmes vetingut dhe mekanizmave tjerë.								
	Outputi, aktivitetet, viti dhe organizata/ departamenti përgjegjës								
Objektivi Specifik 1 - Kthimi i besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë	Outputi	Aktiviteti	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
	Outputi 1.1 Legjislacioni për veting i miratuar	Aktiviteti 1.1.1 - Hartimi dhe konsultimi i Ligjit për Veting	x					MD, KGJK, KPK	
		Aktiviteti 1.1.2 - Procedimi i Ligjit për Veting për miratim	x					MD	
		Aktiviteti 1.1.3 - Hartimi dhe konsultimi i ligjeve relevante që ndërlidhen me Ligjin për Veting	x					MD, KGJK, KPK, AD	

Outputi	Aktiviteti	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
Outputi 1.2 Mekanizmat për veting të themeluar	Aktiviteti 1.2.1 - Ngritja e resurseve të nevojshme për njësinë fillestare për veting		x				Kuvendi	
	Aktiviteti 1.2.2 - Caktimi i anëtarëve të njësisë fillestare për veting me përfshirje ndërkombëtare		x				Partnerët ndërkombëtarë	
	Aktiviteti 1.2.3 - Propozimi i gjashtë anëtarëve në mekanizmin e ri për veting në KGJK (Dy panelet)		x				KGJK	
	Aktiviteti 1.2.4 - Vetingu i anëtarëve të propozuar të mekanizmit të ri për veting në KGJK		x				Njësia fillestare për veting	
	Aktiviteti 1.2.5 - Propozimi i gjashtë anëtarëve në mekanizmin e ri për veting në KPK (Dy panelet)		x				KPK	

Aktiviteti 1.2.6 - Vetingu i anëtarëve të propozuar të mekanizmit të ri për veting në KPK		x				Njësia fillestare për veting	
Aktiviteti 1.2.7 - Ngritja e resurseve të nevojshme për Sekretarinë e Mekanizmit të Vetingut në KGJK dhe KPK		x				Kuvendi, KGJK dhe KPK	
Aktiviteti 1.2.8 - Rekrutimi i 61 zyrtarëve në Sekretarinë e Mekanizmit të Vetingut në KGJK		x				KGJK	
Aktiviteti 1.2.9 - Rekrutimi i 46 zyrtarëve në Sekretariatë e Mekanizmit të Vetingut në KPK		x				KPK	
Aktiviteti 1.2.10 - Vetingu i anëtarëve të propozuar të Sekretariateve		x				Njësia fillestare për veting	
Aktiviteti 1.2.11 - Trajnimi i anëtarëve të paneleve në KGJK		x	x			KGJK	
Aktiviteti 1.2.12 - Trajnimi i anëtarëve të paneleve në KPK		x	x			KPK	

		Aktiviteti 1.2.13 - Trajnimi i anëtarëve të Sekretarive në KGJK dhe KPK		x	x			KGJK/KPK	
Outputi		Aktiviteti	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
Outputi 1.3	Anëtarët e sistemit gjyqësor të vetuar	Aktiviteti 1.3.1 - Vetingu i anëtarëve të KGJK-së		x	x			Mekanizmi i Vetingut në KGJK	
		Aktiviteti 1.3.2 - Vetingu i të paktën 5 gjyqtarëve të Gjykatës Supreme		x	x			Mekanizmi i Vetingut në KGJK	
		Aktiviteti 1.3.3 - Hapja e thirrjes për anëtarë të rinjë të KGJK-së		x	x			KGJK	
		Aktiviteti 1.3.4 - Vetingu i kandidatëve për anëtarë të KGJK-së		x	x			Mekanizmi i Vetingut në KGJK	
		Aktiviteti 1.3.5 - Vetingu i gjyqtarëve tjerë të Gjykatës Supreme			x			Mekanizmi i Vetingut në KGJK	

Aktiviteti 1.3.6 - Vetingu i kandidatëve për Gjyqtarë të Gjykatës Supreme			x			Mekanizmi i Vetingut në KGJK	
Aktiviteti 1.3.7 - Vetingu i gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit			x	x		Mekanizmi Vetingut në KGJK	
Aktiviteti 1.3.8 - Vetingu i kandidatëve për Gjyqtarë të Gjykatës së Apelit			x	x		Mekanizmi i Vetingut në KGJK	
Aktiviteti 1.3.9 - Vetingu i Drejtorit të Sekretariatit të KGJK-së, administratorëve të gjykatave dhe Drejtorit të Njësisë për Inspektim Gjyqësor			x	x		Mekanizmi i Vetingut në KGJK	
Aktiviteti 1.3.10 - Zhvillimi i fazës së rekrutimit të gjyqtarëve të rinj			x	x		KGJK	
Aktiviteti 1.3.11 - Vetingu i kandidatëve të propozuar për gjyqtarë			x	x		Mekanizmi i Vetingut në KGJK	
Aktiviteti 1.3.12 - Vetingu i Kryetarëve të Gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës				x		Mekanizmi i Vetingut në KGJK	

	Aktiviteti 1.3.13 - Vetingu i gjyqtarëve të gjykatave themelore				x	x	Mekanizmi i Vetingut në KGJK	
Outputi	Aktiviteti	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
Outputi 1.4 Anëtarët e sistemit prokurorial të vetuar	Aktiviteti 1.4.1 - Vetingu i anëtarëve të KPK-së		x	x			Mekanizmi i Vetingut në KPK	
	Aktiviteti 1.4.2 - Vetingu i Kryeprokurorit të Shtetit		x	x			Mekanizmi i Vetingut në KPK	
	Aktiviteti 1.4.3 - Hapja e thirjes për anëtarë të rinjë të KPK-së		x	x			KPK	
	Aktiviteti 1.4.4 - Vetingu i kandidatëve për anëtarë të KPK-së		x	x			Mekanizmi i Vetingut në KPK	
	Aktiviteti 1.4.5 - Vetingu i prokurorëve në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit		x	x			Mekanizmi i Vetingut në KPK	

Aktiviteti 1.4.6 - Vetingu i kandidatëve për prokurorë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit			x			Mekanizmi i Vetingut në KPK	
Aktiviteti 1.4.7 - Vetingu i prokurorëve të Prokurorisë së Apelit			x			Mekanizmi i Vetingut në KPK	
Aktiviteti 1.4.8 - Vetingu i kandidatëve për Prokurori të Apelit			x			Mekanizmi i Vetingut në KPK	
Aktiviteti 1.4.9 - Vetingu i prokurorëve të Prokurorisë Speciale			x			Mekanizmi i Vetingut në KPK	
Aktiviteti 1.4.10 - Vetingu i Drejtorit të Sekretariatit të KPK-së dhe administratorëve të prokurorive			x			Mekanizmi i Vetingut në KPK	
Aktiviteti 1.4.11 - Zhvillimi i fazës së rekrutimit të prokurorë të rinjë			x	x		KPK	
Aktiviteti 1.4.12 - Vetingu i kandidatëve të propozuar për prokurorë			x	x		Mekanizmi i Vetingut në KPK	

	Aktiviteti 1.4.13 - Vetingu i Kryeprokurorëve			x	x		Mekanizmi i Vetingut në KPK	
	Aktiviteti 1.4.14 - Vetingu i prokurorëve të prokurorive themelore				x	x	Mekanizmi i Vetingut në KPK	
Outputi	Aktiviteti	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
Outputi 1.5 Mekanizmat për vlerësim të vazhdueshëm të themeluar	Aktiviteti 1.5.1 - Shndërrimi në mekanizma të rregullt të vlerësimit të vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve					x	Kuvendi, Qeveria, KGJK, KPK	
							Totali:	

Figura 23: Plani i zbatimit për Opsionin 4

Qëllimi i politikës	Realizimi i procesit të vetingut në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe gjithëpërfshirëse.								Shifra e kostos së pritur	
Objektivi strategjik	Përmirësimi i integritetit të institucioneve të drejtësisë, përmes vetingut dhe mekanizmave tjerë.									
	Outputi, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës									
Objektivi Specifik 1 - Kthimi i besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë	Outputi	Aktiviteti	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës		
	Outputi 1.1 Ndryshimet kushtetuese dhe legjislativi për	Aktiviteti 1.1.1 - Hartimi dhe konsultimi i amendamenteve kushtetuese	x						MD, KGJK, KPK	
		Aktiviteti 1.1.2 - Procedimi i amendamenteve kushtetuese për miratim	x						Qeveria	
		Aktiviteti 1.1.3 - Hartimi dhe konsultimi i Ligjit për Veting	x	x					MD, KGJK, KPK	

veting i miratuar	Aktiviteti 1.1.4 - Procedimi i Ligjit për miratim		x				MD	
	Aktiviteti 1.1.5 - Hartimi dhe konsultimi i ligjeve relevante që ndërlidhen me Ligjin për Veting		x				MD, KGJK, KPK	
	Aktiviteti 1.1.6 - Procedimi i ligjeve relevante që ndërlidhen me Ligjin për Veting		x				MD	
Outputi	Aktiviteti	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
Outputi 1.2 Mekanizmat për veting të themeluar	Aktiviteti 1.2.1 - Ngritja e resurseve të nevojshme për njësinë fillestare për Veting		x				Kuvendi	
	Aktiviteti 1.2.2 - Caktimi i anëtarëve të njësisë fillestare për Veting me përfshirje ndërkombëtare		x				Presidenca, Kuvendi	
	Aktiviteti 1.2.3 - Ngritja e resurseve të nevojshme për Mekanizmin Kushtetues për Veting		x				Kuvendi	

Aktiviteti 1.2.4 - Procedura e rekrutimit të 15 anëtarëve në Panelet e Mekanizmit Kushtetues për Veting		x				Presidenca, Kuvendi	
Aktiviteti 1.2.5 - Procedura e rekrutimit të 5 anëtarëve të Kolegjit të Apelit në Mekanizmin Kushtetues për Veting		x				Presidenca, Kuvendi	
Aktiviteti 1.2.6 - Vetingu i anëtarëve të propozuar të Paneleve të Mekanizmit Kushtetues për Veting		x				Njësia fillestare për Veting	
Aktiviteti 1.2.7 - Vetingu i anëtarëve të propozuar të Kolegjit të Apelit të Mekanizmit		x				Njësia fillestare për Veting	
Aktiviteti 1.2.8 - Ngritja e resurseve të nevojshme për Sekretariatit e Mekanizmit Kushtetues për Veting		x				Kuvendi	
Aktiviteti 1.2.9 - Rekrutimi i 91 zyrtarëve në Sekretariatit e Mekanizmit Kushtetues për Veting		x				Mekanizmi Kushtetues për Veting / Sekretaria	

	Aktiviteti 1.2.10 Vetingu i zyrtarëve të propozuar të Sekretarisë së Mekanizmit Kushtetues për Veting		x					Njësia fillestare për Veting	
	Aktiviteti 1.2.11 - Trajnimi i anëtarëve të Paneleve të Mekanizmit Kushtetues		x	x				Njësia fillestare për Veting	
	Aktiviteti 1.2.12 - Trajnimi i anëtarëve të Kolegjit të Apelit të Mekanizmit		x	x				Njësia fillestare për Veting	
	Aktiviteti 1.2.13 - Trajnimi i anëtarëve të Sekretariatit			x				Njësia fillestare për Veting	
Outputi	Aktiviteti	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5		Institucioni /departamenti përgjegjës	
Outputi 1.3 Anëtarët e sistemit gjyqësor të vetuar	Aktiviteti 1.3.1 - Vetingu i anëtarëve të KGJK-së			x				Mekanizmi Kushtetues për Veting	
	Aktiviteti 1.3.2 - Vetingu i të paktën 5 gjyqtarëve të Gjykatës Supreme			x				Mekanizmi Kushtetues për Veting	

Aktiviteti 1.3.3 - Vetingu i gjyqtarëve tjerë të Gjykatës Supreme			x			Mekanizmi Kushtetues për Veting	
Aktiviteti 1.3.4 - Vetingu i kandidatëve për Gjyqtarë të Gjykatës Supreme			x			Mekanizmi Kushtetues për Veting	
Aktiviteti 1.3.5 - Vetingu i gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit			x	x		Mekanizmi Kushtetues për Veting	
Aktiviteti 1.3.6 - Vetingu i kandidatëve për Gjyqtarë të Gjykatës së Apelit			x	x		Mekanizmi Kushtetues për Veting	
Aktiviteti 1.3.7 - Vetingu i Drejtorit të Sekretariatit të KGJK-së, administratorëve të gjykatave dhe Drejtorit të Njesisë për Inspektim Gjyqësor			x	x		Mekanizmi Kushtetues për Veting	
Aktiviteti 1.3.8 - Zhvillimi i fazës së rekrutimit të gjyqtarëve të rinj				x		KGJK, Mekanizmi Kushtetues për Veting	

	Aktiviteti 1.3.9 - Vetingu i kandidatëve të propozuar për gjyqtarë				x		Mekanizmi Kushtetues për Veting	
	Aktiviteti 1.3.10 - Vetingu i Kryetarëve të Gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës				x		Mekanizmi Kushtetues për Veting	
	Aktiviteti 1.3.11 - Vetingu i gjyqtarëve të gjykatave themelore				x	x	Mekanizmi Kushtetues për Veting	
Outputi	Aktiviteti	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
Outputi 1.4 Anëtarët e sistemit prokurorial të vetuar	Aktiviteti 1.4.1 - Vetingu i anëtarëve të KPK-së			x			Mekanizmi Kushtetues për Veting	
	Aktiviteti 1.4.2 - Vetingu i Kryeprokurorit të Shtetit			x			Mekanizmi Kushtetues për Veting	

Aktiviteti 1.4.3 - Vetingu i prokurorëve në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit			x			Mekanizmi Kushtetues për Veting	
Aktiviteti 1.4.4 - Vetingu i kandidatëve për prokurorë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit			x			Mekanizmi Kushtetues për Veting	
Aktiviteti 1.4.5 - Vetingu i prokurorëve të Prokurorisë së Apelit			x			Mekanizmi Kushtetues për Veting	
Aktiviteti 1.4.6 - Vetingu i kandidatëve për Prokurori të Apelit			x			Mekanizmi Kushtetues për Veting	
Aktiviteti 1.4.7 - Vetingu i prokurorëve të Prokurorisë Speciale			x			Mekanizmi Kushtetues për Veting	
Aktiviteti 1.4.8 - Vetingu i Drejtorit të Sekretariatit të KPK-së dhe administratorëve të prokurorive			x			Mekanizmi Kushtetues për Veting	

Aktiviteti 1.4.9 - Zhvillimi i fazës së rekrutimit të prokurorëve të rinj			x	x		KPK, Mekanizmi Kushtetues për Veting	
Aktiviteti 1.4.10 - Vetingu i kandidatëve të propozuar për prokurorë			x	x		Mekanizmi Kushtetues për Veting	
Aktiviteti 1.4.11 - Vetingu i Kryeprokurorëve			x	x		Mekanizmi Kushtetues për Veting	
Aktiviteti 1.4.11 - Vetingu i prokurorëve të prokurorive themelore				x	x	Mekanizmi Kushtetues për Veting	
						Totali:	

Figura 24: Plani i zbatimit për Opsionin 5

Qëllimi i politikës	Realizimi i procesit të vetingut në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe gjithëpërfshirëse.	Shifra e kostos së pritur
---------------------	--	---------------------------

Objektivi strategjik	Përmirësimi i integritetit të institucioneve të drejtësisë, përmes vetingut dhe mekanizmave tjerë.								
	Outputi, aktivitetet, viti dhe organizata/ departamenti përgjegjës								
Objektivi Specifik 1 - Kthimi i besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë	Outputi	Aktiviteti	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
	Outputi 1.1 Ndryshimet kushtetuese dhe legjislativni për veting i miratuar	Aktiviteti 1.1.1 - Hartimi dhe konsultimi i amendamenteve kushtetuese	x					MD, KGJK, KPK	
		Aktiviteti 1.1.2 - Procedimi i amendamenteve kushtetuese për miratim	x					Qeveria	
		Aktiviteti 1.1.3 - Hartimi dhe konsultimi i Ligjit për Veting	x	x				MD, KGJK, KPK	
		Aktiviteti 1.1.4 - Procedimi i Ligjit për miratim		x				MD	
		Aktiviteti 1.1.5 - Hartimi dhe konsultimi i ligjeve relevante që ndërlidhen me Ligjin për Veting		x				MD, KGJK, KPK	

	Aktiviteti 1.1.6 - Procedimi i ligjeve relevante që ndërlidhen me Ligjin për Veting		x				MD	
Outputi	Aktiviteti	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
Outputi 1.2 Mekanizmat për veting të themeluar	Aktiviteti 1.2.1 - Ngritja e resurseve të nevojshme për njësinë fillestare për Veting		x				Kuvendi	
	Aktiviteti 1.2.2 - Caktimi i anëtarëve të njësisë fillestare për Veting me përfshirje ndërkombëtare		x				Presidenca, Kuvendi	
	Aktiviteti 1.2.3 - Ngritja e resurseve të nevojshme për Mekanizmin Kushtetues për Veting		x				Kuvendi	

Aktiviteti 1.2.4 - Procedura e rekrutimit të 15 anëtarëve në Panelet e Mekanizmit Kushtetues për Veting		x				Presidenca, Kuvendi	
Aktiviteti 1.2.5 - Procedura e rekrutimit të 5 anëtarëve të Kolegjit të Apelit në Mekanizmin Kushtetues për Veting		x				Presidenca, Kuvendi	
Aktiviteti 1.2.6 - Vetingu i anëtarëve të propozuar të Paneleve të Mekanizmit Kushtetues për Veting		x				Njësia fillestare për Veting	
Aktiviteti 1.2.7 - Vetingu i anëtarëve të propozuar të Kolegjit të Apelit të Mekanizmit		x				Njësia fillestare për Veting	
Aktiviteti 1.2.8 - Ngritja e resurseve të nevojshme për Sekretariatit e Mekanizmit Kushtetues për Veting		x				Kuvendi	

Aktiviteti 1.2.9 - Rekrutimi i 91 zyrtarëve në Sekretariatit e Mekanizmit Kushtetues për Veting		x				Mekanizmi Kushtetues për Veting / Sekretaria	
Aktiviteti 1.2.10 Vetingu i zyrtarëve të propozuar të Sekretarisë së Mekanizmit Kushtetues për Veting		x				Njësia fillestare për Veting	
Aktiviteti 1.2.11 - Trajnimi i anëtarëve të Paneleve të Mekanizmit Kushtetues		x	x			Njësia fillestare për Veting	
Aktiviteti 1.2.12 - Trajnimi i anëtarëve të Kolegjit të Apelit të Mekanizmit		x	x			Njësia fillestare për Veting	
Aktiviteti 1.2.13 - Trajnimi i anëtarëve të Sekretariatit			x			Njësia fillestare për Veting	

Outputi	Aktiviteti	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
Outputi 1.3 Anëtarët e sistemit gjyqësor të vetuar	Aktiviteti 1.3.1 - Vetingu i anëtarëve të KGJK-së			x			Mekanizmi Kushtetues për Veting	
	Aktiviteti 1.3.2 - Vetingu i i të paktën 5 gjyqtarëve të Gjykatës Supreme			x			Mekanizmi Kushtetues për Veting	
	Aktiviteti 1.3.3 - Vetingu i gjyqtarëve tjerë të Gjykatës Supreme			x			Mekanizmi Kushtetues për Veting	
	Aktiviteti 1.3.4 - Vetingu i kandidatëve për Gjyqtarë të Gjykatës Supreme			x			Mekanizmi Kushtetues për Veting	
	Aktiviteti 1.3.5 - Vetingu i gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit			x	x		Mekanizmi Kushtetues për Veting	

Aktiviteti 1.3.6 - Vetingu i kandidatëve për Gjyqtarë të Gjykatës së Apelit			x	x		Mekanizmi Kushtetues për Veting	
Aktiviteti 1.3.7 - Vetingu i Drejtorit të Sekretariatit të KGJK-së, administratorëve të gjykatave dhe Drejtorit të Njësisë për Inspektim Gjyqësor			x	x		Mekanizmi Kushtetues për Veting	
Aktiviteti 1.3.8 - Zhvillimi i fazës së rekrutimit të gjyqtarëve të rinj				x		KGJK, Mekanizmi Kushtetues për Veting	
Aktiviteti 1.3.9 - Vetingu i kandidatëve të propozuar për gjyqtarë				x		Mekanizmi Kushtetues për Veting	
Aktiviteti 1.3.10 - Vetingu i Kryetarëve të Gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës				x		Mekanizmi Kushtetues për Veting	
Aktiviteti 1.3.11 - Vetingu i gjyqtarëve të gjykatave themelore				x	x	Mekanizmi Kushtetues për Veting	

Outputi	Aktiviteti	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
Outputi 1.4 Anëtarët e sistemit prokurorial të vetuar	Aktiviteti 1.4.1 - Vetingu i anëtarëve të KPK-së			x			Mekanizmi Kushtetues për Veting	
	Aktiviteti 1.4.2 - Vetingu i Kryeprokurorit të Shtetit			x			Mekanizmi Kushtetues për Veting	
	Aktiviteti 1.4.3 - Vetingu i prokurorëve në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit			x			Mekanizmi Kushtetues për Veting	
	Aktiviteti 1.4.4 - Vetingu i kandidatëve për prokurorë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit			x			Mekanizmi Kushtetues për Veting	
	Aktiviteti 1.4.5 - Vetingu i prokurorëve të Prokurorisë së Apelit			x			Mekanizmi Kushtetues për Veting	
	Aktiviteti 1.4.6 - Vetingu i kandidatëve për Prokurorit të Apelit			x			Mekanizmi Kushtetues për Veting	

	Aktiviteti 1.4.7 - Vetingu i prokurorëve të Prokurorisë Speciale			x			Mekanizmi Kushtetues për Veting	
	Aktiviteti 1.4.8 - Vetingu i Drejtorit të Sekretariatit të KPK-së dhe administratorëve të prokurorive			x			Mekanizmi Kushtetues për Veting	
	Aktiviteti 1.4.9 - Zhvillimi i fazës së rekrutimit të prokurorëve të rinj			x	x		KPK, Mekanizmi Kushtetues për Veting	
	Aktiviteti 1.4.10 - Vetingu i kandidatëve të propozuar për prokurorë			x	x		Mekanizmi Kushtetues për Veting	
	Aktiviteti 1.4.11 - Vetingu i Kryeprokurorëve			x	x		Mekanizmi Kushtetues për Veting	
	Aktiviteti 1.4.11 - Vetingu i prokurorëve të prokurorive themelore				x	x	Mekanizmi Kushtetues për Veting	
Outputi	Aktiviteti	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	

Outputi 1.5 Mekanizmat për vlerësim të vazhdueshëm të themeluar	Aktiviteti 1.5.1 - Shndërrimi në mekanizma të rregullt të vlerësimit të vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve					x	Kuvendi, Qeveria, KGJK, KPK	
							Totali:	

Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm

Në bazë të analizave të bëra në këtë Koncept Dokument dhe marr parasysh krahasimin e opsioneve të shqyrtuara, në mënyrë që të eliminohen problemet e identifikuara dhe të arrihen objektivat e caktuara, Qeverisë i rekomandohet miratimi i Opsionit 5, gjegjësisht zbatimi i procesit të vetingut me ndryshime Kushtetuese që mundëson vetingun nga një trup *ad-hoc* dhe më pas vazhdimin e vlerësimit të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë në kuadër të KGjK-së dhe KPK-së. Plani i zbatimit të opsionit të rekomanduar, pra opsionit 5, është paraqitur në Kapitullin 6 të këtij dokumenti.

Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin

Monitorimi i zbatimit të këtij Opsioni, marr parasysh që përfshin institucionet nga tre pushtetet: legjislativin, ekzekutivin dhe gjyqësorin, do të bëhet nga të tre këto. Lidhur me zbatimin e Koncept Dokumentit do të përgatiten raporte vjetore me qëllim të informimit të institucioneve të cekura si më lartë. Vlerësimi ex-post sipas metodologjisë së përcaktuar, i amendamenteve kushtetuese dhe ligjit të ardhshëm për veting do të bëhet në vitin e 5 të zbatimit të Koncept Dokumentit.

Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik

Kategoria e ndikimeve ekonomike	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	
Vendet punës ¹⁶⁴	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?		x			
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		x			
	A do të ndikojë në nivelin e pagesës?		x			
	A do të ndikojë në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?		x			
Bërja biznesit	A do të ndikojë në qasjen në financa për biznes?		x			
	A do të largohen nga tregu produkte të caktuara?		x			
	A do të lejohen në treg produkte të caktuara?		x			

¹⁶⁴ Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime shoqërore.

	A do të detyrohen bizneset të mbyllen?		x			
	A do të krijohen biznese të reja?		x			
Ngarkesa administrative	A do të detyrohen bizneset t'i përmbushin detyrimet e dhënjes së informatave të reja?		x			
	A janë thjeshtuar detyrimet e dhënjes së informatave për bizneset?		x			
Tregtia	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të importit?		x			
	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të eksportit?		x			
Transporti	A do të ketë efekt në mënyrën e transportit të pasagjerëve dhe/ose mallrave?		x			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në kohën e nevojshme për të transportuar pasagjerë dhe/ose mallra?		x			
Investimet	A pritet që kompanitë të investojnë në veprimtari të reja?		x			

	A pritet që kompanitë t'i anulojnë ose shtyjnë për më vonë investimet?		x			
	A do të rriten investimet nga diaspora?		x			
	A do të zvogëlohen investimet nga diaspora?		x			
	A do të rriten investimet e huaja direkte?		x			
	A do të zvogëlohen investimet e huaja direkte?		x			
Konkurruesh mëria	A do të rritet çmimi i biznesit të produkteve, siç është energjia elektrike?		x			
	A do të ulet çmimi i inputeve të bizneseve, siç është energjia elektrike?		x			
	A ka gjasa që të promovohen inovacioni dhe hulumtimi?		x			
	A ka gjasa që inovacioni dhe hulumtimi të pengohen?		x			

Ndikimi në NVM	A janë kompanitë e prekura kryesisht NVM?		x			
Çmimet dhe konkurrenca	A do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?		x			
	A do të zvogëlohet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?		x			
	A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		x			
	A do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		x			
Ndikimet ekonomike rajonale	A do të ndikohet ndonjë sektor i veçantë i biznesit?		x			
	A është ky sektor i koncentruar në një rajon të caktuar?		x			
Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik	A do të ndikohet rritja e ardhshme ekonomike?		x			
	A mund të ketë ndonjë efekt në normën e inflacionit?		x			

Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore

Kategoria e ndikimeve shoqërore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	
Vendet punës ¹⁶⁵	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?		X			
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		X			
	A ndikohen vendet e punës në një sektor të caktuar të biznesit?		X			
	A do të ketë ndonjë ndikim në nivelin e pagesës?		X			
	A do të ketë ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?		X			
Ndikimet shoqërore rajonale	A janë ndikimet shoqërore të përqendruara në një rajon apo qytete të veçanta?		X			

¹⁶⁵ Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime ekonomike.

Kushtet e punës	A ndikohen të drejtat e punëtorëve?	X				
	A parashihen apo shfuqizohen standardet për punën në kushte të rrezikshme?		X			
	A do të ketë ndikim mbi mënyrën e zhvillimit të dialogut social ndërmjet punonjësve dhe punëdhënësve?		X			
Përfshirja sociale	A do të ketë ndikim mbi varfërinë?	X				
	A ndikohet qasja në skemat e mbrojtjes sociale?		X			
	A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve themelore?		X			
	A do të ketë ndikim në financimin apo organizimin e skemave të mbrojtjes sociale?		X			
Arsimi	A do të ketë ndikim në arsimin fillor?		X			
	A do të ketë ndikim në arsimin e mesëm?		X			
	A do të ketë ndikim në arsimin e lartë?		X			

	A do të ketë ndikim në aftësimin profesional?	X				
	A do të ketë ndikim në arsimimin e punëtorëve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës?	X				
	A do të ketë ndikim në organizimin apo strukturën e sistemit arsimor?		X			
	A do të ketë ndikim në lirinë akademike dhe vetëqeverisjen?		X			
Kultura	A ndikon opsioni në diversitetin kulturor?		X			
	A ndikon opsioni në financimin e organizatave kulturore?		X			
	A ndikon opsioni në mundësitë për personat që të përfitojnë nga aktivitetet kulturore ose të marrin pjesë në to?		X			
	A ndikon opsioni në ruajtjen e trashëgimisë kulturore?		X			

Qeverisja	A ndikon opsioni në aftësitë e qytetarëve të marrin pjesë në procesin demokratik?	X				
	A trajtohet çdo person në mënyrë të barabartë?		X			
	A do të informohet më mirë publiku në lidhje me çështje të caktuara?	X				
	A ndikon opsioni në mënyrën se si funksionojnë partitë politike?		X			
	A do të ketë ndonjë ndikim në shoqërinë civile?		X			
Shëndeti dhe siguria publike ¹⁶⁶	A do të ketë ndonjë ndikim në jetën e njerëzve, siç është jetëgjatësia apo shkalla e vdekshmërisë?		X			
	A do të ketë ndikim në cilësinë e ushqimit?		X			
	A do të rritet apo zvogëlohet rreziku shëndetësor për shkak të substancave të dëmshme?		X			

¹⁶⁶ Kur ka ndikim në shëndet publik dhe siguri, atëherë rregullisht ka ndikime mjedisore.

	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në nivelet e zhurmës apo cilësinë e ajrit, ujit dhe/ose tokës?		X			
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në përdorimin e energjisë?		X			
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në deponimin e mbeturinave?		X			
	A do të ketë ndikim në mënyrën e jetesës së njerëzve, siç janë nivelet e interesimit për sport, ndryshimet në ushqyeshmëri, ose ndryshimet në përdorimin e duhanit ose alkoolit?		X			
	A ka grupe të veçanta që përballen me rreziqe shumë më të larta se të tjerat (të përcaktuar sipas faktorëve, të tillë si mosha, gjinia, aftësia e kufizuar, grup shoqëror apo rajoni)?		X			
Krimi dhe siguria	A ndikohen gjasat që të kapen kriminelët?	X				

	A ndikohet fitimi i mundshëm nga krimi?	X				
	A ndikon në nivelet e korrupsionit?	X				
	A ndikohet kapaciteti i zbatimit të ligjit?	X				
	A ka ndonjë efekt në të drejtat dhe sigurinë e viktimave të krimit?	X				

Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore

Kategoria e ndikimeve mjedisore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	
Klima dhe mjedisi i qëndrueshëm	A do të ketë ndikim në emetimin e gazrave serë (dioksid karboni, metani etj.)?		x			
	A do të ndikohet konsumi i karburanteve?		x			
	A do të ndryshojë shumëllojshmëria e burimeve që përdoren për prodhimin e energjisë?		x			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në çmim për produktet miqësore ndaj mjedisit?		x			
	A do të bëhen më pak ndotëse disa aktivitete të caktuara?		x			
Cilësia e ajrit	A do të ketë ndikim në emetimin e ndotësve të ajrit?		x			

Cilësia e ujit	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave të ëmbla?		x			
	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave nëntokësore?		x			
	A ndikon opsioni në burimet e ujit të pijshëm?		x			
Cilësia e tokës dhe shfrytëzimi i tokës	A do të ketë ndikim në cilësinë e tokës (në lidhje me acidifikimin, ndotjen, përdorimin e pesticideve apo herbicideve)?		x			
	A do të ketë ndikim në erozionin e tokës?		x			
	A do të humbet tokë (përmes ndërtimit, etj.)?		x			
	A do të fitohet tokë (përmes dekontaminimit, etj.)?		x			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në shfrytëzimin e tokës (p.sh. nga shfrytëzimi pyjor në shfrytëzim bujqësor apo urban)?		x			

Mbeturinat dhe riciklimi	A do të ndryshojë sasia e mbeturinave të gjeneruara?		x			
	A do të ndryshojnë mënyrat në të cilat trajtohen mbeturinat?		x			
	A do të ketë ndikim në mundësitë për riciklimin e mbeturinave?		x			
Përdorimi i burimeve	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme (rezervave të peshkut, hidrocentraleve, energjisë diellore etj.)?		x			
	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve, të cilat nuk janë të ripërtëritshme (ujërat nëntokësore, mineralet, qymyri etj.)?		x			
Shkalla e rreziqeve mjedisore	A do të ketë ndonjë efekt në gjasat për rreziqe, të tilla, si zjarret, shpërthimet apo aksidentet?		x			
	A do të ndikojë në gatishmërinë në rast të fatkeqësive natyrore?		x			
	A ndikohet mbrojtja e shoqërisë nga fatkeqësitë natyrore?		x			

Biodiversiteti, flora dhe fauna	A do të ketë ndikim në speciet e mbrojtura apo të rrezikuara apo në zonat ku ato jetojnë?		x			
	A do të preket madhësia apo lidhjet midis zonave të natyrës?		x			
	A do të ketë ndonjë efekt në numrin e specieve në një zonë të caktuar?		x			
Mirëqenia e kafshëve	A do të ndikohet trajtimi i kafshëve?		x			
	A do të ndikohet shëndeti i kafshëve?		x			
	A do të ndikohet cilësia dhe siguria e ushqimit të kafshëve?		x			

Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore

Kategoria e ndikimit në të drejtat themelore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	

Dinjiteti	A ndikon opsioni në dinjitetin e njerëzve, në të drejtën e tyre për jetë apo në integritetin e një personi?	X				
Liria	A ndikon opsioni në të drejtën e lirisë së individëve?		X			
	A ndikon opsioni në të drejtën e një personi për privatësi?	X				
	A ndikon opsioni në të drejtën për t'u martuar apo krijuar familje?		X			
	A ndikon opsioni në mbrojtjen ligjore, ekonomike ose shoqërore të individëve apo familjes?	X				
	A ndikon opsioni në lirinë e mendimit, ndërgjegjes apo fesë?		X			
	A ndikon opsioni në lirinë e shprehjes?		X			
	A ndikon opsioni në lirinë e tubimit ose asociimit?	X				
Të dhënat personale	A përfshin opsioni përpunimin e të dhënave personale?	X				

	A janë të drejtat e individit për qasje, korrigjim dhe kundërshtim të garantuara?	X				
	A është e qartë dhe e mbrojtur mirë mënyra në të cilën përpunohen të dhënat personale?	X				
Azili	A ndikon ky opsioni në të drejtën për azil?		X			
Të drejtat pronësore	A do të ndikohen të drejtat e pronësisë?	X				
	A ndikon opsioni në lirinë për të bërë biznes?	X				
Trajtimi i barabartë ¹⁶⁷	A e mbron opsioni parimin e barazisë para ligjit?	X				
	A ka gjasa që grupe të caktuara do të dëmtohen në mënyrë direkte apo indirekte nga diskriminimi (p.sh. ndonjë diskriminim në bazë gjinore, racore, ngjyre, etnie, opinioni politik ose tjetër, moshe ose orientimi seksual)?	X				

¹⁶⁷ Barazia gjinore trajtohet në *Vlerësimin e Ndikimit Gjinor*

	A ndikon opsioni në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara?		X			
Të drejtat e fëmijëve	A ndikon opsioni në të drejtat e fëmijëve?		X			
Administrimi i mirë	A do të bëhen procedurat administrative më të komplikuar?		X			
	A ndikohet mënyra në të cilën administrata merr vendime (transparenca, afati procedural, e drejta për qasje në një dosje, etj.)?		X			
	Për të drejtën penale dhe ndëshkimet e parashikuara: a ndikohen të drejtat e të paditurit?		X			
	A ndikohet qasja në drejtësi?	X				